

KËSHILLI i Lartë GJYQËSOR

Raport mbi veprimtarinë e
Këshillit të Lartë Gjyqësor
2019



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

RAPORT

MBI

GJENDJEN E SISTEMIT

GJYQËSOR DHE VEPRIMTARINË

E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

PËR VITIN 2019

Ky raport u përgatit nga Grupi i Punës i ngritur për këtë qëllim me Urdhrin e Kryetares së KLGJ-së Nr. 12 datë 28.01.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projekt-raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor për vitin 2019”, i përbërë nga Znj. Helena Papa, Znj. Baisa Sefa, Znj. Luljeta Laze, Z. Vildan Kaloshi, Znj. Rudina Palloj, Znj. Çiljeta Prifti, Z. Qemal Zaimi, Z. Sajmir Shehu dhe Znj. Brunilda Aliaj.

Raporti u shqyrtua dhe u miratua nga Komisioni i Përhershëm pranë KLGJ-së, për Planifikimin Strategjik, Administrimin dhe Buxhetin, i drejtuar nga Kryetarja e Këshillit Znj. Naureda Llagami dhe anëtarët e tij Znj. Fatmira Luli dhe Z. Medi Bici.

Në përfundim raporti u miratua në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor me Vendimin Nr. 148 datë 05.05.2020.

KËSHILLI
I LARTË GJYQËSOR



RAPORT
MBI GJENDJEN
E SISTEMIT
GJYQËSOR DHE
VEPRIMTARINË E KËSHILLIT
TË LARTË GJYQËSOR PËR
VITIN 2019

TABELA E LËNDËS

SHKURTIME	6
KËSHILLI NË SHIFRA PËR VITIN 2019.....	7
PËRBËRJA E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR.....	8
PËRMBLEDHJE E PROBLEMATIKAVE KRYESORE	11
1. VEPRIMTARIA E KËSHILLIT	17
1.1 MBLEDHJET PLENARE.....	17
1.2 NGRITJA E KOMISIONEVE DHE E STRUKTURËS ADMINISTRATIVE	17
1.2.1 BURIMET NJERËZORE TË KLGJ-SË.....	17
1.3 VEPRIMTARIA E KOMISIONEVE TË KËSHILLIT	21
1.3.1 KOMISIONET E PËRHERSHME.....	21
1.3.1.1 KOMISIONI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK, ADMINISTRIMIT DHE BUXHETIT.....	23
1.3.1.2 KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE VEPRIMTARISË PROFESIONALE	31
1.3.1.3 KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS	44
1.3.1.4 KOMISIONI DISIPLINOR	58
1.3.2 KOMISIONET E PËRKOHSHME	61
1.4 BASHKËPUNIMI I BRENDSHËM DHE I JASHTËM.....	66
1.4.1 BASHKËPUNIMI I BRENDSHËM	66
1.4.2 BASHKËPUNIMI I JASHTËM	75
2. TRANSPARENCA	82
3. RIVLERËSIMI KALIMTAR I GJYQATARËVE & MASAT E MARA NGA KLGJ-JA PËR GARANTIMIN E MBARËVAJTJES SË SISTEMIT GJYQËSOR.....	86
4. HARTA GJYQËSORE	94
5. SISTEMET E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE.....	97
6. ANALIZA MBI SITUATËN E GJYKATAVE	101
6.1 RIFUNKSIONALIZIMI I GJYKATËS SË LARTË.....	101
6.2 KRIJIMI I GJYKATAVE TË POSAÇME PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR.....	105
6.3 ANALIZA E TË DHËNAVE STATISTIKORE	108
6.3.1 METODOLOGJIA	109
6.3.2 VOLUMI I PUNËS SË GJYKATAVE	112
6.3.2.1 STOKU I ÇËSHTJEVE TË MBARTURA.....	112
6.3.2.2 ÇËSHTJE TË REGJISTRUARA.....	117
6.3.3 BURIMET NJERËZORE	122
6.3.4 NGARKESA MESATARE E GJYQATARËVE (TREGUESI WR).....	126
6.3.5 NORMA E EFIÇENCËS (TREGUESI ER).....	127
6.3.6 RAPORTI I QARKULLIMIT TË ÇËSHTJEVE	135
6.3.7 KOHA E NEVOJSHME PËR EVADIMIN E ÇËSHTJES (TREGUESI DT).....	137
6.3.8 NORMA E ZGJIDHJES SË ÇËSHTJEVE (TREGUESI CR)	141
6.3.9 REGJISTRIMI AUDIO NË GJYKATA	145
6.3.10 KOHËZGJATJA E ÇËSHTJEVE	148
7. VEPRIMTARIA FINANCIARE DHE BUXHETI	156
7.1 BUXHETI I NEGOCIUAR DHE ALOKUAR PËR VITIN 2019	156
7.1.1 NË SHPENZIME PERSONELI.....	159
7.1.2 NË SHPENZIME OPERATIVE.....	160
7.1.3 NË SHPENZIME KAPITALE.....	160
7.2 BUXHETI I MIRATUAR PËR PUSHTETIN GJYQËSOR PËR VITIN 2020.....	161
7.2.1 NË SHPENZIME KORRENTE (NË PERSONEL DHE OPERATIVE)	162
7.2.2 NË SHPENZIME KAPITALE.....	162
7.3 NEVOJAT BUXHETORE	162
7.3.1 NEVOJA PËR INVESTIME NË INFRASTRUKTURËN GJYQËSORE	163
7.3.2 NEVOJA PËR INVESTIME NË SISTEMET TIK.....	163
7.3.3 NEVOJA PËR INVESTIME NË BURIME NJERËZORE.....	163
8. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	166

*S*HKURTIME

RSH	Republika e Shqipërisë
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
KLD	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
CEPEJ	Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë
CCJE	Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
KPA	Kolegji i Posaçëm i Apelit
KPSAB	Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit
KZHK	Komisioni i Zhvillimit të Karrierës
KVEVP	Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale
KD	Komisioni Disiplinor
GJL	Gjykata e Lartë
ONM	Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit
SHM	Shkolla e Magjistraturës

KËSHILLI NË SHIFRA PËR VITIN 2019

Mbledhje Plenare 57	Struktura e KLGJ 125	Prop/Emërime & Caktime 44 ¹	Verifikime 76
Akte të miratuara 315 ²	Anëtarët 11	Gjykata e Lartë 3	Kandidatë për GJL 23
Komisioni i Zhvillimit të Karrierës 226	Aktivite Bashkëpunuese 30	Gjykatat e Rretheve Gjyqësore 25	Kandidatë për formim fillestar SHM V'18-'19 28
Komisioni i Vlerësimit Etik - Profesional 35	Aktivite me Shoqërinë Civile 7	6 Gj. A (5 & 1) 10 Gj. Shk1 (4 & 6) Gjykatat e Posaçme³ të Shk I & Apeli	Kandidatë Magjistrat 25
Komisioni i Planifikimit Strategjik & Buxhetit 24	Takime me Kryetarët e Gjykatave 10	Zgjedhje Zëvendës Kryetarë Gjykatash 36	Kuotat për Magjistratë në SHM V'19-'20 40
Komisioni Disiplinës 1	Kancelarë të Trajnuar 32	Caktime gjyqtarësh për çështje të veçanta 1209	
Komisioni i Përkohshëm i VEP 99		Transferime 12 ⁴	Kërkesa për Informacion 68

¹ Përfshihen Propozimet për emërim në GJL, Emërimet në Gj.Rr. Gjyqësor dhe Caktimet e përhershme dhe të përkohshme në Gjykatat e Posaçme.

² Përfshihen 315 vendimet e KLGJ-së nga të cilat 286 aktet e propozuara nga Komisionet e Përhershme & 29 të tjera.

³ Situata në vitin 2020. Lexoni pjesën e Gjykatave të Posaçme për më shumë informacion.

⁴ 12 gjyqtarë të transferuar nga të cilët 5 me pëlqim.



PËRBËRJA E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

KRYETARJA	
Znj. Naureda Llagami	Juriste e spikatur, përzgjedhur nga radhët e shoqërisë civile Mandat 5-vjeçar (2018-2023)
ZËVENDËSKRYETARI	
Z. Maksim Qoku	Jurist i spikatur, përzgjedhur nga trupa e pedagogëve Mandat 3-vjeçar (2018-2021)
ANETARËT GJYQTARË	
Znj. Brikena Ukperaj Përfaqësuese e Gjykatave të Apelit Mandat 5-vjeçar (2018-2023)	Znj. Brunilda Kadi Përfaqësuese e Gjykatave të Shkallës së Parë Mandat 3-vjeçar (2018-2021)
Z. Dritan Hallunaj Përfaqësues i Gjykatave të Shkallës së Parë Mandat 5-vjeçar (2018-2023)	Z. Ilir Toska Përfaqësues i Gjykatave të Apelit Mandat 3-vjeçar (2018-2021)
Znj. Marçela Shehu	Z. Medi Bici

Përfaqësuese e Gjykatave të Shkallës së Parë Mandat 5-vjeçar (2018-2023)	Përfaqësues i Gjykatës së Lartë Mandat 3-vjeçar (2018-2021)
ANËTARËT JOGJYQTARË	
Z. Alban Toro Jurist i spikatur, përzgjedhur nga radhët e avokatëve Mandat 5-vjeçar (2018-2023)	Z. Erjon Muharremaj Jurist i spikatur, përzgjedhur nga trupa e pedagogëve Mandat 3-vjeçar (2018-2021)
Z. Fatmira Luli Juriste e spikatur, përzgjedhur nga radhët e avokatëve Mandat 5-vjeçar (2018-2023)	



PROBLEMATIKAVE

KRYESORE

Arkitektura e sistemit të reformuar të drejtësisë do të merrte jetë me krijimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), më 12.12.2018. Problematikat e hasura më parë në lidhje me funksionimin e sistemit gjyqësor, evidentuan nevojën për krijimin e një organi kushtetues të pavarur dhe përgjegjës për mirëqeverisjen e sistemit. Këtij organi iu akorduan kompetenca të thelluara në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe funksionet administrativo - menaxheriale për gjykatat në vend. Në nivel strategjik, Këshilli ndjek dinamikat e sistemit, duke marrë masa për t'iu përgjigjur në kohë dhe me efikasitet nevojave të tij.

Kompetencat kushtetuese dhe ligjore:

Kompetencat e Këshillit burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

Ky kuadër ligjor i ka atribuar Këshillit kompetenca më të gjëra sesa paraardhësi i tij (Këshilli i Lartë i Drejtësisë - KLD) lidhur me rregullimin e brendshëm të gjykatave nga pikëpamja e burimeve njerëzore dhe planifikimit financiar ashtu dhe përcaktimin e standardeve etike profesionale të gjyqtarëve, me qëllim garantimin e një sistemi funksional, të paanshëm, eficient dhe me fokus qytetarin.

Kompozimi i Këshillit (anëtarë gjyqtarë dhe jogjyqtarë si dhe mungesa e eksponentëve politikë) është një garanci për të siguruar pavarësisë e sistemit gjyqësor, duke

shmangur në maksimum praktikat klienteliste, korruptive dhe komprometuese, të cilat cenojnë profesionalizmin, transparencën dhe cilësinë e vendimmarrjeve të Këshillit. Për shkak të dinamikave të sistemit gjyqësor, Këshilli gjatë veprimtarisë së tij ka aplikuar një qasje proaktive, e cila del në pah me funksionimin e komisioneve të përkohshme. Krahas komisioneve të përhershme, të cilat derivojnë drejtpërdrejt nga fushat e veprimit të Këshillit, komisionet e përkohshme janë mekanizma fleksibël që i japin mundësi Këshillit të reagojë në kohë dhe me mjetet e duhura ndaj zhvillimeve të sistemit gjyqësor, duke qenë gjithmonë 'rregullatori' i tij.

Kompetenca Strategjike: Krahas funksioneve administruese dhe planifikuese, Këshilli ka dëshmuar edhe funksione strategjike, të cilat lidhen me drejtimin/orientimin e veprimtarisë institucionale të vetë KLGJ-së dhe gjykatave njëkohësisht. Këto funksione burojnë nga dispozitat ligjore⁵ dhe **vizioni** i Këshillit për ndërtimin e një drejtësie të pavarur dhe efikase e cila garanton besimin e publikut për trajtim të drejtë dhe të barabartë para ligjit.

Për këtë qëllim, gjatë vitit të parë të veprimtarisë së tij, Këshilli ka ndërmarrë një proces dinamik të planifikimit strategjik për të bashkërenduar përpjekjet me aktorë të tjerë në fushën e drejtësisë, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve gjyqësore, transparencës dhe forcimit të besimit të publikut. Me Vendimin nr. 126 datë 19.07.2019, Këshilli miratoi Planin Strategjik për vitin 2019-2020, i cili është një udhërrëfyes për veprimtarinë e vetë Këshillit dhe sistemit gjyqësor në tërësi.

Plani Strategjik i miratuar, shoqërohet me një Plan Veprimi, në të cilin synimet zërthen në objektiva operacional dhe aktivitete/ masa konkrete duke përcaktuar qartësisht njësitë

⁵Ligji nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" neni 81

zbatuese, faturën financiare si dhe indikatorët matës cilësorë dhe sasiorë për vlerësimin e rezultateve në një hark kohor të përcaktuar. 5 shtyllat e drejtimit të Planit Strategjik janë:

SYNIMI 1: Përshpejtimi i Reformës së Pushtetit Gjyqësor dhe Akordimit të Burimeve.

SYNIMI 2: Përcaktimi dhe Zbatimi i Standardeve për Ekselencë Gjyqësore.

SYNIMI 3: Ofrimi Efikas i Shërbimeve dhe Funkcionimi më i Mirë i Gjykatave.

SYNIMI 4: Zhvillimi i Kapaciteteve të Brendshme të KLGJ-së.

SYNIMI 5: Hartimi i Strategjive të Efektshme për Komunikimin e Jashtëm.

Gjatë hartimit të dokumentit strategjik është mbajtur parasysh harmonizimi dhe përputhja me kuadrin nënligjor, konkretisht Urdhri i Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë Nr. 93 datë 07.08.2012, i cili përcakton strukturën dhe elementët e domosdoshëm që duhet të përmbajnë strategjitë sektoriale dhe ndër-sektoriale në Republikën e Shqipërisë. Dokumente të tjerë referues të konsultuar përfshijnë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2017-2020, Strategjinë e Reformës në Administratën Publike, Strategjinë Ndër-sektoriale të Drejtësisë dhe Planin e Veprimit 2019-2021. Gjithashtu, duke mbajtur në konsideratë aspiratat e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, është parë e domosdoshme edhe konsultimi i dokumenteve të tillë si Marrëveshja e Stabilizim Asocimit, Progres-raporti i BE-së për Shqipërinë 2018, Instrumenti i Asistencës së Para - anëtarësimit (IPA II) 2014-2020, si mjete me të cilat BE-ja mbështet reformat e shtetit shqiptar me anë të ndihmës financiare dhe asaj teknike.

Procesi i konsultimit të Planit Strategjik: Për t'u siguruar mbi koherencën, vlefshmërinë,

dhe përfaqësimin e dokumenteve strategjik të lartpërmendur, Plani është produkt i një procesi të kujdesshëm konsultimi gjithëpërfshirës, i cili përfshin 5 runde konsultimi:

- Anëtarët e KLGJ-së – jo vetëm anëtarët e Komisionit të Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit, por të gjithë anëtarët e Këshillit janë konsultuar gjatë këtij procesi për të siguruar një qëndrim të unifikuar.
- Gjykatat - për të siguruar përfaqësimin e duhur të nevojave të gjykatave.
- 15 përfaqësues të shoqërisë civile që veprojnë në fushën e drejtësisë dhe mbrojnë të drejtat e grupeve në nevojë - për të siguruar transparencë dhe reflektuar perspektivën e qytetarëve.
- Ministria e Drejtësisë - si entiteti përgjegjës për Strategjinë e Përgjithshme të Drejtësisë.
- Gjithashtu, pas miratimit të tij, Plani Strategjik është prezantuar dhe konsultuar me 70 Donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë, për të kanalizuar asistencën e donatorëve në aspektet më prioritare të KLGJ-së por edhe një mundësi për të prodhuar sinergji midis aktorëve të ndryshëm.

Plani Strategjik dhe ai i veprimit gjurmojnë rrugëtimin institucional të KLGJ-së në funksionin e përmbushjes së *misionit* të tij në ndërtimin, udhëheqjen dhe drejtimin e një sistemi gjyqësor me performancë të lartë, që synon ekselencën gjyqësore dhe meriton besimin e publikut. Përmes parametrave të kostimit financiar dhe indikatorëve matës të rezultateve, ky Plan funksionon si barometër i brendshëm për matjen e ecurisë së veprimtarisë së Këshillit në drejtim të vetë rregullimit dhe mirëqeverisjes së sistemit gjyqësor.

Monitorimi i Planit Strategjik: Plani Strategjik i nënshtrohet monitorimit 3 dhe 6-mujor, në kuadër të së cilës struktura përgjegjëse harton raporte monitorimi ku analizohet ecuria e zbatimit të Planit Strategjik përkundrejt objektivave të përcaktuara. Qëllimi i këtij procesi nuk është monitorimi “*per se*” sesa nevoja për të identifikuar arsytet që e pengojnë realizimin e planit të miratuar dhe propozimi i masave të caktuara për adresim e tyre në të ardhmen.

Për vitin 2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar raportin e monitorimit për zbatimin e Planit të Veprimit të Planit Strategjik, shkalla e realizimit të së cilit rezultoi 66,6%. Për sa i përket masës së realizimit për secilin synim, situata paraqitet si më poshtë:



Arritjet e KLGJ-së gjatë vitit 2019: Në veprimtarinë e tij 1-vjeçare, Këshilli është udhëhequr nga parime themelore të tilla si pavarësia, integriteti, profesionalizmi, paanshmëria dhe llogaridhënia, në funksion të së cilave shënjestrohen zhvillime pozitive.

Kështu lidhur me **Veprimtarinë e KLGJ-së (janar 2019 – dhjetor 2019) vlen të theksohet:**

- 57 mbledhje plenare dhe 315 vendimmarrje në ndihmë të të gjithë sistemit gjyqësor, duke përfshirë hartimin e akteve nënligjore me karakter normativ;

- Plotësimi i vakumit të krijuar nga shkarkimet e kryetarëve të gjykatave si pjesë e procesit të (vettingut): 36 zëvendëskryetarëve nga 37 gjykata;
- Ngritja e Këshillave të Gjykatave si njësia drejtuese për çdo gjykatë;
- Delegimi i gjyqtarëve për 845 çështje në përgjigje të kërkesave të gjykatave kur gjenden në pamundësi për të krijuar trupa gjyqësore; duke caktuar mbi 1209 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme.
- Intensifikimin e bashkëpunimit me organet e vettingut: dorëzimin e 99 raporteve të hollësishme dhe të arsyetuara të vlerësimit profesional të shoqëruara me 495 dosje gjyqësore për këta subjekte rivlerësimi.
- Konstituimi i Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar duke caktuar në mënyrë të përhershme 5 gjyqtarë dhe në mënyrë të përkohshme 13 gjyqtarë⁶.
- Nisja e procesit të rifunksionalizimit të Gjykatës së Lartë dhe përfundimi i procedurës së përzgjedhjes dhe emërimit për 3 gjyqtarë në 2020.
- Emërimi dhe caktimi i magjistratëve diplomuar në gjykata e vendit në total për 25 magjistratë të profilit “gjyqtar” në vitet 2018 dhe 2019;
- Rritja e numrit të kandidatëve magjistratë në profilin gjyqtar në Shkollën e

⁶ Të dhënat reflektojnë situatën e numrit të gjyqtarëve në momentin e krijimit të gjykatave të posaçme, dhjetor 2019.

Magjistraturës me 25 për vitin akademik 2019-2020 dhe 40 për vitin 2020-2021.

Një angazhim voluminoz Këshilli ka treguar për miratimin e rregullave të rëndësishme përfshirë edhe ato për funksionalizimin e Gjykatës së Lartë, Gjykatave të Posaçme dhe Gjykatave të Apelit si:

- Rregullat për verifikimin e pasurisë, figurës dhe kriterëve ligjore për të gjithë magistratët duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, si dhe rregullat për procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes për kandidatët për në Gjykatën e Lartë që vijnë nga radhët e juristëve të spikatur;
- Kriterëve dhe procedurave për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve;
- Skemën e re të vlerësimit të gjyqtarëve duke përfshirë “Rregullat plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”, “Metodologjinë e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”;
- Hartimin e rregullores “Për Verifikimin e kriterëve dhe kushteve ligjore për kancelarët në detyrë” e cila do t’i hapë rrugë procesit të verifikimit paraprak të të gjithë kancelarëve në detyrë, 37 kancelarë;
- Miratimin e rregullave për përshpejtimin e çështjeve në gjykatat me juridiksion apeli;
- Miratimin e “Programit të Transparencës për Këshillin e Lartë Gjyqësor” dhe caktimin e gjyqtarëve për mediat, në juridiksion apeli.

Ndërsa, për sa i përket proceseve të rëndësishme që Këshilli ka iniciuar gjatë vitit 2019, vlen të përmenden:

- Hapja e garës për 4 vende vakante në Gjykatën e Lartë për kandidatët

jomagjistratë⁷;

- Studimin për rikonfigurimin e hartës gjyqësore duke synuar përmirësimin e aksesit në drejtësi për qytetarët dhe veçanërisht shtresave në nevojë;
- Fillimin e procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për 121 gjyqtarë në vitin 2020;
- Hartimi i një propozimi për tarifatat gjyqësore;

Reagimet e Këshillit si përgjigje të problematikave: Në përmbushje të të gjithë synimeve dhe përgjegjësi të përcaktuara nga Kushtetuta në nenin 147, pika 1 dhe kuadrit ligjor të miratuar në funksion të Reformës në Drejtësi, Këshilli i Lartë Gjyqësor, gjatë vitit të parë të veprimtarisë, ka ndërmarrë disa hapa të domosdoshëm si reagime ndaj problematika të konstatuara. Këto reagime, të cilat vijnë në formën e vendimmarrjeve të Këshillit, do të raportohen në mënyrë të detajuar në kapitujt vijues të këtij raporti. Në terma të përgjithshëm çështjet e trajtuara në këtë raport janë:

- **Veprimtaria e vetë institucionit**, e cila shpërfaqet përmes funksionimit të komisioneve të përhershme dhe të përkohshme dhe vendimmarrjeve respektive.
- **Burimet njerëzore të KLGJ-së**, është kapitulli që trajton procesin e miratimit dhe plotësimit të strukturës organizative të institucionit për të siguruar vetë funksionimin si dhe miradministrimin e sistemit gjyqësor. Vëmendje të veçantë merr procesi i rekrutimeve, ngritjes së kapaciteteve si dhe krijimi i databazave elektronike.
- **Bashkëpunimi ndër – institucional**, në të

⁷ dhe 6 vendeve për ata që vijnë nga sistemi gjyqësor në fillim të 2020.

cilën ofrohet një mozaik i larmishëm bashkëpunimesh të Këshillit me institucionet shtetërore, shoqërinë civile dhe organizatat dhe misionet ndërkombëtare, me qëllim përfitimin e praktikave dhe standardeve më të mira ndërkombëtare dhe rajonale për të garantuar një sistem gjyqësor të pavarur, të paanshëm, me integritet dhe profesional.

- **Transparenca në vendimmarrjen e Këshillit dhe rritja e besimit të publikut.** Në këtë kapitull trajtohet në mënyrë të hollësishme qasja e Këshillit për një institucion të hapur dhe transparent në funksion të plotë të së drejtës së informimit dhe komunikimit me publikun. Organizimi i mbledhjeve të hapura plenare, miratim i programit institucional të transparencës, hartimi i strategjisë së komunikimit, **aktimi i Anëtarit të KLGJ-së përgjegjës për marrëdhëniet me publikun, si dhe** aktimi i gjyqtarëve për median në 8 gjykatat e juridiksionit të apelit, janë disa nga vendimmarrjet e Këshillit të cilat gjejnë pasqyrim të plotë në këtë pjesë të raportit.
- **Mbështetja e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe masat e marra nga Këshilli me qëllim garantimin e mbarëvajtjes së sistemit.** Bashkëpunimi me organet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve është një detyrim kushtetues në kuadër të reformës në drejtësi me qëllim përfundimin e shpejtë të këtij procesi. Masat e ndërmarra nga KLGJ-ja për lehtësimin e ndikimit të vettingut në sistemin gjyqësor me qëllim sigurimin e mbarëvajtjes së tij.
- **Rikonfigurimi i sistemit gjyqësor përmes hartës së re gjyqësore.** Vlerësimi dhe riorganizimi i kompetencave tokësore të gjykatave, duke marrë në konsideratë kriterin e largësisë gjeografike, popullsisë,

numrin e çështjeve dhe indeksin ekonomik-social të zonave të caktuara janë çështjet kryesore që trajtohen në këtë kapitull.

- **Sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore,** ofron një tablo të qartë lidhur me aplikimin, funksionimin dhe problematikat e evidentuara në zbatimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, të cilat kanë një rol thelbësor në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore.
- **Rifunksionalizimi i Gjykatës së Lartë,** është kapitulli i cili trajton një nga çështjet më të debatuar dhe me ndjeshmëri të lartë për opinionin publik. Masat e marra nga KLGJ-ja në kuadër të reduktimit të numrit të çështjeve të mbartura në këtë gjykatë, procesi dhe vendimmarrja e Këshillit lidhur me propozimin për emërim të kandidatëve jomagjistratë, janë disa nga çështjet e trajtuara me përparësi në këtë kapitull.
- **Krijimi Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar,** funksionalizimit të plotë të tyre përmes procesit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve dhe problematikat e evidentuara me këtë proces dhe në lidhje me pagat e këtyre gjyqtarëve.
- **Situata e sistemit gjyqësor,** e cila ofron një analizë të thelluar sasiore dhe cilësore mbi nivelin e efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë që jepet në 38 gjykatat e vendit për vitin 2019. Qëllimi i kësaj analize është matja dhe interpretimi i treguesve të performancës së gjyqësorit me synim evidentimin e nevojave për përmirësimin e punës dhe ofrimin e një drejtësie cilësore qytetarëve.

Veprimtaria buxhetore dhe financiare e KLGJ-së dhe sistemit gjyqësor, vjen e trajtuar përmes shpenzimeve në zëra operative,

personeli dhe kapitale. Analiza e thelluar e shpenzimeve sipas këtyre zërave hedh dritë mbi nevojat buxhetore të sistemit gjyqësor që do të garantojnë përmirësime cilësore në funksion të ofrimit të një shërbimi eficient, transparent e të shpejtë për publikun.

1. VEPRIMTARIA E KËSHILLIT

1.1 Mbledhjet Plenare

Gjatë vitit 2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka organizuar 57 mbledhje plenare dhe ka miratuar 315 vendime. Kjo vendimmarrje është rritur në mënyrë cilësore dhe sasiore duke marrë në konsideratë që institucioni pararendës, ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, për të njëjtin hark kohor miratonte rreth 54 vendime. Kjo tregon një rritje prej 6-fish të numrit të vendimmarrjeve të Këshillit në raport me pararendësin e tij. Vendimmarrjet e Këshillit kanë pasur në fokus:

- i) rregullimin e veprimtarisë së KLGJ-së;
- ii) miradministrimin e gjykatave nëpërmjet rregulloreve e udhëzimeve të ndryshme si, skema e delegimit, transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve, caktimi i gjyqtarëve për gjykimin në çështje të veçanta në gjykata të tjera apo për gjykimin e çështjeve me të mitur viktimë e veprës penale apo në konflikt me ligjin, zgjedhja e zëvendëskryetarëve të gjykatave.
- iii) statusin e gjyqtarëve duke përfshirë nisjen e procesit të emërimit të magistratëve të rinj, nisjen e procedurës për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbarimin e statusit të magistratit për shkak të daljeve në pension, përfundimit të mandatit, dorëheqjeve, etj.

Nga 315 vendimmarrje, 286 prej tyre kanë qenë iniciativë propozuese e komisioneve të përhershme. Ndërkohë, 29 vendime janë vendimmarrje të komisioneve të përkohshme dhe miratime të procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit. Nga këto vendimmarrje 12 prej tyre janë akte të mirëfillta nënligjore të cilat janë publikuar në fletoren zyrtare të Republikës së Shqipërisë, pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare. Ndërkohë që 46 të tjera janë akte kolektive dhe akte rregullatorë të brendshme.

1.2 NGRITJA E KOMISIONEVE DHE E STRUKTURËS ADMINISTRATIVE

1.2.1 BURIMET NJERËZORE TË KLGJ-SË

Ngritja e një strukture të re organizative e cila garanton mirëqeverisjen e sistemit, si dhe veprimtarinë e KLGJ-së. Struktura organizative e KLGJ-së është miratuar me Vendimin nr. 12, datë 18.01.2019, i ndryshuar (Vendimi nr. 4, datë 12.03.2019, i ndryshuar me Vendim nr. 80, datë 30.05.2019) dhe përfshin një administratë me të gjitha njësitë e nevojshme mbështetëse dhe të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi, si më poshtë vijon:

- Njësia mbështetëse për çështje të përgjithshme juridike;

- Njësia mbështetëse për programimin dhe administrimin e buxhetit të Këshillit dhe buxhetit gjyqësor;
- Njësia e përgjithshme e burimeve njerëzore dhe shërbimeve;
- Njësia mbështetëse e komisioneve të përhershme;
- Njësia e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve;
- Njësia e marrëdhënieve me publikun;
- Njësia e auditimit të brendshëm.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi një strukturë prej 125 punonjësish menjëherë pas daljes së aktit normativ të përcaktimit të buxhetit (qershor 2019) e cila shënon dhe një rritje me pothuajse 30% më tepër burime njerëzore nga struktura e mëparshme e ish-KLD-së dhe ish-ZABGJ-së. Ndonëse numri i akorduar i punonjësve ishte më i vogël se ai i kërkuar nga Këshilli, struktura e tij organizative i siguron - aktualisht - anëtarëve të KLGJ-së mbështetjen e nevojshme për përmbushjen e misionit dhe qëllimit të institucionit, atij të garantimit të pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor. Krahas ngritjes dhe funksionimit të komisioneve të përhershme, ngritja e një administrate të përgatitur, e cila reflekton dhe i përgjigjet detyrave dhe përgjegjësisë të çdo fushe që institucioni i KLGJ-së ka, ishte pa diskutim një premisë e mirë për realizimin e misionit dhe vizionit të KLGJ-së.

Nga ana formale-teknike ishte VKM nr. 343, datë 2.5.2019 *"Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve dhe fondeve buxhetore për institucionet e sistemit të drejtësisë, për vitin 2019"*, që përcaktoi numrin 1493 punonjës për KLGJ-në, ku përfshiheshin 1368 punonjës të pushtetit gjyqësor dhe 125 punonjës të KLGJ-së (54 punonjës të KLGJ-së, 50 punonjës të ish-KLD, 21 punonjës të ish-ZABGJ-së).

Pagat e KLGJ-së u rregulluan me VKM nr. 214, datë 17.4.2019 *"Për disa shtesa në Vendimin nr. 187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit", të ndryshuar*, dhe për administratën mbështetëse me VKM nr. 213, datë 17.4.2019 *"Për një shtesë në Vendimin nr. 717, datë 23.6.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore"* duke mundësuar një kategorizim të tyre në përputhje me skemën e pagave të parashikuara për institucionet shtetërore të RSH.

Procesi i krijimit të KLGJ-së përmes ristrukturimit të ish-KLD-së dhe ish-ZABGJ-së. Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, neni 50, pika 2 dhe 3; VKM nr. 125, datë 17.2.2016 *"Për transferimin e*

përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë", kreu II, pika 20; Urdhrit nr. 39, datë 10.6.2019 "Për krijimin e komisionit të ristrukturimit në Këshillin e Lartë Gjyqësor" u ngrit Komisioni i Ristrukturimit i përbërë nga përfaqësues të ish-KLD-së dhe ish-ZABGJ-së, i cili ndoqi procedurën e transferimit dhe shkrirjes të stafit të dy institucioneve.

Procedura filloi në muajin qershor dhe aktiviteti i administratës së KLGJ-së filloi më 1 korrik 2019. Duke filluar nga muaji korrik 2019 menaxhimi i burimeve njerëzore të KLGJ-së dhe të pushtetit gjyqësor realizohet nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative me dy Sektorët përgjegjës - Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimit të Magjistratëve dhe Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimit të Administratës. Ndërkohë që u zhvillua procesi i ristrukturimit, u përfundua gjithashtu dhe *hartimi i përskrimeve të punës dhe vlerësimi i të gjithë punonjësve* (nëpunësit civilë dhe punonjësit administrativ të KLGJ-së dhe ZABGJ-së). KLGJ-ja e re përthithi të gjithë punonjësit e dy institucioneve paraardhëse duke përfutur nga eksperiencia e tyre disavejeçare në fushën e menaxhimit financiar të gjykatave apo çështjeve të tjera të administrimit të sistemit gjyqësor, dhe kjo në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Rekrutimet e reja në KLGJ. Gjatë gjashtëmujorit të dytë të 2019 filloi puna për plotësimin e vendeve të lira të strukturës së KLGJ-së për sa i përket si nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të administratës.

Ka filluar procesi i rekrutimit të stafit të ri për pozicionet e lira dhe aktualisht, janë rekrutuar 15 punonjës sipas ligjit "Për shërbimin civil", si më poshtë:

- 2 nivel i lartë drejtues, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtor departamenti;
- 6 këshilltarë nivel i mesëm drejtues;
- 2 shefa sektori nivel i ulët drejtues;
- 5 specialistë;

Gjithashtu, përmes një procedure konkurruese, objektive dhe transparente, 5 magjistratë nga sistemi gjyqësor janë komanduar në KLGJ dhe kjo për të përfutur nga eksperiencia e tyre shumëvjeçare në sistemin gjyqësor. Kabineti i Kryetares së KLGJ-së është funksional dhe përbëhet nga 1 drejtor kabineti dhe 3 këshilltarë.

Në total nga momenti i miratimit të strukturës deri në mars 2020, janë rekrutuar 24 persona si personel i ri për KLGJ-në, duke mundësuar rritjen e efikasitetit në çdo njësi të tij, rritur cilësinë e përpunimit të akteve, shkresave, si dhe përmirësimin e ndjeshëm të afateve kohore të realizimit të detyrave funksionale.

Vlen të theksohet se nevoja për burime njerëzore nuk është përmbushur plotësisht, dhe kjo për shkak se infrastruktura aktuale⁸ nuk i krijon mundësinë KLGJ-së të

⁸ KLGJ-ja ndodhet me godinë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe ambientet aktuale janë të

funksionojë me një strukturë të plotë. Procesi i rekrutimeve për të përmbushur strukturën e miratuar të KLGJ-së me 125 punonjës dhe për pasojë funksionimin e tij me kapacitet të plotë, do të vijojë më intensivisht në momentin e transferimit në mjediset e godinës së dedikuar institucioneve të reja të drejtësisë- Polit të Drejtësisë- ku do të sigurohen të gjitha hapësirat e nevojshme të punës.

Në zbatim të VKM nr. 109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë” Departamenti ndoqi procedurën e vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë për vitin 2019. Vlerësimi u bë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019, pasi edhe aktiviteti i stafit ka filluar më 1 korrik 2019.

Inovacioni përmes krijimit dhe funksionimit të databazave elektronike të të dhënave për burimet njerëzore. Gjatë 2019 dhe në përputhje me vendimin nr. 114 të KLGJ-së miratuar në datë 09.07.2019 “Mbi krijimin dhe administrimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të dosjes personale dhe regjistrin të gjyqtarëve”, Departamentit të Burimeve Njerëzore, i mbështetur dhe nga Misioni EURALIUS V, ka punuar intensivisht për krijimin e databazave të posaçme për burimet njerëzore nëpër gjykata. Kështu u krijua dhe u bë funksional, në korrik të vitit 2019, sistemi “Pro magistratë” i cili ka krijuar regjistrin digjital të dosjeve profesionale të gjyqtarëve të cilat tashmë mund të azhurnohen në mënyrë periodike. Të dhënat e përpiluara gjatë procesit të skanimit të dosjeve janë përmbledhur nëpër raporte individuale të gjyqtarëve të cilat japin informacion të shpejtë dhe të saktë për vjetërsinë në profesion të gjyqtarëve, lëvizjet në sistem, moshën për pension, vlerësimet e ndryshme etiko-profesionale, pezullimet, masat disiplinore dhe çdo gjë tjetër që ka të bëjë me karrierën e tyre. Në këtë sistem janë hedhur të dhëna për 355 gjyqtarë, duke përfshirë këtu edhe gjyqtarët e pezulluar nga ish-KLD-ja dhe ato të shkarkuar me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar. Vlen të theksohet së ky sistem ka hedhur bazat për ngritjen e lotit për caktimin e gjyqtarëve, i përfunduar dhe funksional në fund të vitit 2019.

Krijimi i bazës së të dhënave për stafin e nëpunësve civil gjyqësorë, dhe përditësimi i vazhduar sipas informacioneve të vazhdueshme nga gjykatat ka filluar që prej vitit 2019 dhe po punohet dhe në këtë drejtim për të pasur rezultate të pritshme përpara mbarimit të mandatit të parë të KLGJ-së.

Ngritja e kapaciteteve në KLGJ. Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2019, janë trajnuar në mënyrë të vazhduar rreth 25 % e punonjësve të KLGJ-së që bëjnë pjesë në shërbimin civil, dhe kjo në bashkëpunim të ngushtë me Shkollën e Administratës Publike. Komunikimi me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) për trajnimet e punonjësve ka qenë i përmuajshëm dhe kjo me

pamjaftueshme për të akomoduar punonjësit aktual të tij.

qëllim identifikimin e trajnimeve të nevojshme për stafin e KLGJ-së dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të tyre.

Hartimi i planit afatmesëm të kërkesave infrastrukturore. Hartimi dhe miratimi i një plani afatmesëm për përmirësimet që nevojiten në infrastrukturën e gjykatave si dhe advokimi për burime financiare adekuate në pajtim me hollësitë e përcaktuara në këtë plan, janë dy procese të lidhura ngushtë me miratimin e Hartës së Re Gjyqësore. Kjo për faktin se është e pritshme që riorganizimi i sistemit gjyqësor, përmes kësaj harte, të sjellë një realitet dhe një peizazh të ri të konfigurimit dhe shpërndarjes së gjykatave në vend, i cili do duhet të reflektohet dhe në planet financiare dhe buxhetore të propozuara. Në kushtet kur propozimet për Hartën e re gjyqësore nuk janë ende diskutuar apo miratuar në Këshill, zhvillimi i proceseve të lartpërmendura është shtyrë për zbatim në një periudhë të mëvonshme.

KLGG-ja me kompetenca të reja në administrimin e gjykatave dhe burimeve njerëzore të tyre (nëpunësve civil gjyqësor). Reforma e sistemit të drejtësisë krijoi një Këshill të Lartë Gjyqësor me kompetenca të shtuara dhe për sa i përket ndjekjes dhe menaxhimit të burimeve njerëzore nëpër gjykata dhe stafit mbështetës gjyqësor. Për rrjedhojë në fillim të vitit 2019 personeli i ish-ZABGJ-së ndoqi procedurën e detajimit të numrit të punonjësve të pushtetit gjyqësor, të miratuar me Ligjin Nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”. Për vitin 2019, pushtetit gjyqësor, iu akorduan 1389 punonjës ose një shtesë prej 20 punonjësish në krahasim me vitin viti 2018. KLGJ-ja me vendimin nr. 70, datë 03.05.2019 “Për detajimin dhe shpërndarjen e numrit shtesë në disa gjykata” detajoi 20 punonjësit për disa gjykata dhe disa pozicione.

Ndërkohë që gjatë vitit 2019, Departamenti i Burimeve Njerëzore, ka punuar për të detajuar kërkesat për burime njerëzore për vitin 2020 në gjykata në përputhje me Ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”. Pushtetit gjyqësor iu akorduan, 100 (njëqind) punonjës shtesë në krahasim me viti 2019. *Për më shumë detaje mbi situatën e burimeve njerëzore në sistemin gjyqësor mund të lexoni kapitullin X faqe Y*

1.3 VEPRIMTARIA E KOMISIONEVE TË KËSHILLIT

1.3.1 KOMISIONET E PËRHERSHME

Këshilli në mbledhjen plenare të datës 18.01.2019, me Vendimin nr. 13, vendosi ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme. Ngritja e këtyre komisioneve nuk ishte vetëm një përmbushje e detyrimit ligjor, por erdhi si një domosdoshmëri për mirëfunksionimin e vetë Këshillit. Kjo për faktin se funksionimi i këtyre komisioneve ndihmon thellësisht në përmbushjen me efikasitet të përgjegjësive dhe detyrave që ligji i ka ngarkuar KLGJ-së.

Në nenin 62, pika 2 e ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikohet që pasi zgjedh Kryetarin, Këshilli merr vendim për përbërjen e komisioneve të përhershme, përfshirë edhe anëtarët zëvendësues. Duke marrë në konsideratë përbërjen e Këshillit, me anëtarë gjyqtarë dhe jogjyqtarë, numrin e anëtarëve, si dhe nevojën për ndarje të drejtë të ngarkesës së punës dhe respektimin e kërkesave dhe të raporteve midis anëtarëve gjyqtarë dhe jogjyqtarë, në pikën 4 të nenit të lartpërmendur është parashikuar që çdo Komision përbëhet nga tre anëtarë, si dhe në dispozicion të çdo Komisioni caktohen edhe 2 anëtarë zëvendësues.

Në krijimin e komisioneve është mbajtur në konsideratë, që anëtarët nuk mund të marrin pjesë në më shumë se dy komisione, gjë e cila sjell një shpërndarje të barabartë të anëtarëve në komisione duke bërë të mundur jo vetëm ngritjen por dhe funksionimin efikas të tyre.

Ndaj sa më sipër, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë ngritur Komisionet e Përhershme si më poshtë, sipas parashikimeve në ligj:

1. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit

Në përbërje me tre anëtarë (2 anëtarë jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar).
2 anëtarë zëvendësues (1 anëtar jogjyqtar dhe 1 anëtar gjyqtar).

2. Komisioni Disiplinor

Në përbërje me tre anëtarë (2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar).
2 anëtarë zëvendësues (1 anëtar gjyqtar dhe 1 anëtar jogjyqtar).

3. Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale

Në përbërje me tre anëtarë (2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar).
2 anëtarë zëvendësues (1 anëtar gjyqtar dhe 1 anëtar jogjyqtar).
Anëtarët e këtij komisioni nuk mund të jenë edhe anëtarë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

4. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Në përbërje me 3 anëtarë (2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar).
2 anëtarë zëvendësues (1 anëtar gjyqtar dhe 1 anëtar jogjyqtar).
Anëtarët e këtij komisioni nuk mund të jenë edhe anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Vlen të theksohet se dhe shpërndarja e anëtarëve të përhershëm dhe atyre zëvendësues nëpër Komisione është bërë duke mbajtur në konsideratë:

- i) Preferencat e anëtarëve të Këshillit;
- ii) Eksperiencat e tyre në raport me fushën e veprimtarisë së Komisionit, ashtu si dhe,
- iii) Mandatet e anëtarëve të Këshillit.

Gjatë vitit 2019 këto komisione kanë zhvilluar një punë intensive e cila është materializuar në një numër voluminoz aktesh nënligjore në kuadër të rregullimit, mbarëvajtjes dhe miradministrimit të sistemin gjyqësor. Veprimtaria e komisioneve të përhershme do të analizohet në vijim të këtij raporti, duke pasqyruar jo vetëm çështjet që ka trajtuar secili komision, por gjithashtu duke evidentuar problematikat e konstatuara dhe nevojat për përmirësime të mundshme në të ardhmen.

Në mënyrë të përmbledhur, veprimtaria e Komisioneve të Përhershme të Këshillit është si më poshtë:

Komisionet e Përhershme	Nr. i akteve propozuara
1 Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit	24
2 Komisioni Disiplinor	1
3 Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale	35
4 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës	226
5 Akte të Komisioneve të Përhershme	286
6 Akte të miratuara nga KLGJ (2019)⁹	315

1.3.1.1 KOMISIONI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK, ADMINISTRIMIT DHE BUXHETIT

Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit (KPSAB) është përgjegjës për planifikimin, hartimin, zbatimin dhe administrimin e buxhetit. Komisioni merr pjesë në hartimin e politikave buxhetore, planeve strategjike e dokumenteve të tjerë të nevojshëm për një administrim të mirë e efikas të sistemit gjyqësor shqiptar. Komisioni zhvillon kërkime dhe bën propozime për të siguruar një mirëfunksionim të sistemit të menaxhimit financiar, i raporton Këshillit problematikat e evidentuara si dhe harton projektvendime, rregullore apo udhëzime të cilat i paraqiten Këshillit për miratim.

Përbërja:

Kryetare: Naureda Llagami
Anëtare: Fatmira Luli
Anëtar: MediBici
Anëtar Zëvendësues:
 Brikena Ukperaj
 Erjon Muharremaj

Veprimtaria e Komisionit ka qenë e përqendruar në hartimin e akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, por edhe në

⁹ Këtu përfshihen dhe aktet e miratuara nga Komisionet e Përkohshme si dhe aktet e miratimit të procesverbaleve të mbledhjes plenare.

trajtimin e një sërë çështjeve të tjera të rëndësishme duke proceduar me dhënie opinionesh apo kthim përgjigjesh për këto raste. Konkretisht, gjatë vitit 2019 Komisioni ka hartuar dhe paraqitur për miratim **gjithsej 24 akte nënligjore** (dy prej të cilave përbëjnë ndryshime/shtesë të aktit kryesor) si më poshtë:

1. Vendimi nr. 12, datë 18.01.2019 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i ndryshuar¹⁰.

Ky vendim ka si synim krijimin e strukturës organizative të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të administratës së tij. Është shumë e rëndësishme për të bërë të mundur ushtrimin e detyrimeve kushtetuese por dhe ligjore si një organ që siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, që Këshilli i Lartë Gjyqësor të ketë:

- (i) strukturën organizative të tij dhe të administratës së tij;
- (ii) përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësisive të të gjitha njësive organizative dhe të pozicioneve individuale;
- (iii) rregullat procedurale, sipas të cilave vepron administrata në mënyrë të atillë që të sigurojë mbështetje efikase dhe efektive për Këshillin dhe komisionet e tij.

Vendimi është miratuar me propozim të Kryetares së Këshillit, pasi në këtë periudhë nuk ishin krijuar ende komisionet e përhershme. Më pas, ky akt, me propozim të KPSAB-së, i është nënshtuar dy herë rishikimit nga ana e Këshillit, duke marrë formën përfundimtare të tij.

2. Vendimi nr. 13, datë 18.01.2019 “Mbi ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor”

Vendimi i propozuar nga Kryetarja e Këshillit për ngritjen dhe funksionimin e Komisioneve të Përhershme, erdhi jo vetëm si detyrim për zbatimin e Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i cili përcakton detyrimin e Këshillit për miratimin e përbërjes së Komisioneve të Përhershme, përfshirë edhe anëtarët zëvendësues, por mbi të gjitha si një nevojë e institucionit për të garantuar mirëfunksionimin e tij. (lexo më sipër përmbajtjen e këtij akti).

3. Vendimi nr. 15, datë 22.01.2019 “Mbi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve”¹¹

Propozimi nga KPSAB-ja për miratimin e këtij vendimi, erdhi si një vlerësim i rëndësishëm që ka Këshilli në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe subjekteve të tjera të rivlerësimit, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin

¹⁰ Me vendimin nr.44, datë 12.03.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr.12, datë 18.01.2019 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si dhe me vendimin nr.80, datë 30.05.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr.12, datë 18.01.2019, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor” i ndryshuar.

¹¹Ndryshuar pika 5 e projekt-aktit gjatë shqyrtimit në mbledhje plenare të KLG-së.

kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe kjo nëpërmjet hartimit dhe përpilimit të raporteve analitike të aftësive profesionale të gjyqtarëve. Komisioni i krijuar do të koordinojë punën e tij si me Këshillin dhe me institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve me qëllim përmbushjen e detyrave të tij përgjatë këtij procesi. Për më shumë informacion referohu kapitullit të Rivlerësimit kalimtar.

4. Vendimi nr. 44, datë 12.03.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr. 12, datë 18.01.2019 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”

Ky vendim ka si synim përmirësimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit, të miratuar në mbledhjen e datës 18 janar 2019, me vendimin nr. 12. KPSAB-ja ia ka propozuar miratimin e këtij vendimi mbledhjes plenare të Këshillit, si një domosdoshmëri për të reflektuar në të, të gjitha propozimet e bëra nga Kuvendi i Republikës në lidhje me strukturën e administratës së KLGJ-së.

5. Vendimi nr. 59, datë 24.04.2019 “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për vlerësimin e statusit individual dhe karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”

Ky vendim është hartuar dhe paraqitur për propozim në vijim dhe zbatim të rekomandimeve të Komisionit të Monitorimit dhe të partnerëve ndërkombëtarë (Misionit EURALIUS dhe USAID). Mbi bazën e këtyre propozimeve të këtij komisioni, Këshilli ka marrë vendim për çdo inspektor duke përcaktuar qartë se kush prej tyre ka statusin e magjistratit dhe kush nuk e ka këtë status. Për më shumë informacion referohu kapitullit të Komisioneve të Përkohshme.

6. Vendimi nr. 68, datë 24.04.2019 “Për caktimin e anëtarit për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun”.

Përmes këtij vendimi, Këshilli ka caktuar një nga anëtarët e tij, Z. E. Muharremaj, të jetë përgjegjës edhe për marrëdhëniet me publikun dhe median, duke garantuar kështu një kanal të drejtpërdrejtë të përcjelljes së informacionit zyrtar me qëllim garantimin dhe rritjen e transparencës mbi vendimmarrjen e vetë KLGJ-së.

7. Vendimi nr. 69, datë 03.05.2019, “Miratimin e raportit “Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2018”.

Hartimi i Raportit vjetor “*Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2018*”, përbën një detyrim ligjor¹² për Këshillin. Raporti u përgatit nga Grupi i Punës i ngritur për këtë qëllim me Urdhrin nr. 129 datë 01.04.2019 “*Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e*

¹² Neni 82 pika 1 e ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikon se: “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor raporton para Kuvendit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, jo më pak se një herë në vit. Raporti përshkruan veprimtarinë e Këshillit dhe të komisioneve të tij, si dhe përmban rekomandimet për përmirësimet e nevojshme”.

projekt-raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor për vitin 2018". Raporti u shqyrtua dhe u miratua nga KPSAB-ja dhe u miratua në mbledhjen e Këshillit, datë 03.05.2019 me Vendimin nr.69.

8. Vendimi nr. 70, datë 03.05.2019 “Për detajimin dhe shpërndarjen e punonjësve shtesë në disa gjykata”

Ky vendim ka si synim plotësimin e nevojave për punonjës shtesë në administratën gjyqësore për efekt të Ligjit Nr. 98/2016 “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor*”, si dhe kërkesave të gjykatave të paraqitura në vijimësi.

KPSAB-ja ka propozuar miratimin e këtij vendimi në zbatim të parashikimeve ligjore të cilat përcaktojnë se përgjegjës për ndjekjen e çështjeve të burimeve njerëzore në gjykata është vetë Këshilli i Lartë Gjyqësor ndaj dhe i takon këtij të fundit që të bëjë shpërndarjen e këtyre punonjësve nëpër gjykata. Shpërndarja e punonjësve bëhet duke mbajtur në konsideratë, nevojat që ka administrata e gjykatave për punonjës, dhe duke vlerësuar që roli dhe funksionimi i saj përbën një element të rëndësishëm të pavarësisë organizative të sistemit gjyqësor, dhe i shërben miradministrimit të gjykatave.

Në kushtet kur kërkesat e gjykatave dhe nevojat e tyre janë të ndryshme, për detajimin e 20 punonjësve shtesë, është vendosur që shtesa prej 20 punonjësish të shkojë për plotësimin e nevojave të administratës gjyqësore.

9. Vendimi nr. 80, datë 30.05.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr. 12, datë 18.01.2019, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”

Ky vendim ka si synim saktësimin e emërtimeve, në detajimin e strukturës sipas funksioneve dhe organigramës së administratës së Këshillit. Struktura organizative sipas organigramës së propozuar është e njëjtë me atë të miratuar më parë, në Vendimin nr. 44, datë 12.3.2019, pa ndryshuar numrin e përgjithshëm të administratës prej 125 punonjës. Ky vendim pasqyron pakësimin e numrit të punonjësve në dy sektorë dhe shtimin e tyre në dy sektorë të tjerë, si dhe saktësimin i emërtesës/titullit të pozicioneve sipas funksionit.

Propozimi dhe miratimi i këtij vendimi mori shkas edhe nga hyrja në fuqi e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 213, datë 17.4.2019, “Për një shtesë në vendimin nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave “*Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore*”, të ndryshuar.

10. Vendimi nr. 126, datë 19.07.2019 “Për miratimin e planit strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë viti 2019-2020”

Hartimi i Planit Strategjik të KLGJ-së është dokument që shkon përtej detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 81 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së

sistemit të drejtësisë”. Ai është një instrument planifikimi i cili synon të prioritetizojë objektivat, sistematizojë veprimet në të cilat duhet të investohet Këshilli duke maksimizuar burimet financiare dhe njerëzore, si dhe duke adresuar strategjikisht problemet dhe nevojat më akute të sistemit gjyqësor. Plani Strategjik i miratuar, është një plan 2-vjeçar që shoqërohet me një Plan Veprimi, në të cilin synimet zërthehen në objektiva operacional dhe aktivitetet konkrete duke përcaktuar qartësisht njësitë zbatuese, kostot financiare si dhe indikatorët matës cilësorë dhe sasiorë për vlerësimin e rezultateve në një hark kohor të përcaktuar. Ai paraqet vizionin dhe vlerat në të cilat mbështetet KLGJ-ja në përmbushje të misionit të saj për ndërtimin, udhëheqjen dhe qeverisjen e një gjyqësori me performancë të lartë, që synon ekselencën dhe meriton besimin e publikut si dhe zërthehet në 5 synime kryesore.

Plani Strategjik është hartuar me mbështetjen dhe ekspertizën e projektit “Drejtësi për të Gjithë” të USAID, dhe i është nënshtruar një cikli konsultimesh si brenda sistemit gjyqësor ashtu edhe jashtë tij, ashtu siç detajohet në përmbledhjen e problematikave kryesore, në faqet 11-13 të këtij raporti.

11. Vendimi nr. 155, datë 30.07.2019 “Për miratimin e projektbuxhetit afatmesëm 2020-2022 të pushtetit gjyqësor (faza e dytë)”

Ky vendim ka si synim hartimin e buxhetit vjetor dhe afatmesëm të Këshillit, në konsultim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave. Hartimi i Projektbuxhetit Afatmesëm 2020-2022, është realizuar nga Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, në respektim të plotë të kuadrit ligjor¹³.

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, me Urdhrin nr. 134, datë 09.04.2019, është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) i përbërë nga:

1. Znj. Naureda Llagami, Kryetare e KLGJ-së - Kryetare
2. Z. Maksim Qoku, Zëvendëskryetar i KLGJ-së - Anëtar
3. Z. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm - Anëtar
4. Znj. Luljeta Laze, Drejtore Buxheti – Sekretare

Në mbledhjen e datës 17 prill 2019, GMS shqyrtoi dhe miratoi, dokumentet e Fazës së I-rë strategjike të PBA 2020-2022. Deri më datën 30 prill 2019, u përfundua projektbuxheti i integruar i pushtetit gjyqësor, që përmban:

¹³Ligjin Nr. 8379, datë 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 115 /2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Udhëzimin Nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” dhe Udhëzimin Nr. 8, datë 28.02.2019 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2020 – 2022”.

- Kërkesat buxhetore të Programit buxhetor “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, për Këshillin e Lartë Gjyqësor, dhe
- Kërkesat buxhetore për Programin buxhetor “Buxheti Gjyqësor”, për funksionimin e aktivitetit të gjykatave në të tre nivelet.

Mbështetur në Udhëzimin Nr. 7, datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm”, në dokumentin e PBA 2020-2022, dorëzuar në Ministrinë e Financave, është propozuar bashkimi i dy programeve buxhetore, në një program të vetëm “Planifikim, menaxhim dhe administrim”.

Gjithashtu, me shkresë zyrtare i është kërkuar Ministrisë së Drejtësisë konsultimi i Projektbuxhetit Afatmesëm 2020-2022 të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Ky konsultim me përfaqësues të MD-së u krye në datën 11.07.2019 dhe u drejtuan pyetje që kishin të bënin kryesisht me përfshirjen në PBA të masave të përcaktuara në Strategjinë Ndër-sektoriale të Drejtësisë 2017-2020 (SNSD). Ndërsa konsultimi me Ministrinë e Financave, kryhet nëpërmjet takimeve negociuese për Fazën e I-rë dhe Fazën e II-të të PBA-së. Konsultimi i Fazës së I-rë është kryer në datë 29.05.2019, ku u parashtruan kërkesat buxhetore 2020-2022, në mënyrë të detajuar dhe argumentet përkatëse, ndërsa ai i fazës së II-të është kryer në 21 nëntor 2019.

Qëllimi kryesor i këtij programi buxhetor është përmirësimi i sistemit gjyqësor, sigurimi i burimeve dhe kapaciteteve të nevojshme për të bërë të mundur ofrimin efikas të shërbimeve dhe punë më të mirë në gjykatat e të tre niveleve.

12. Vendimi nr. 156, datë 30.07.2019, “Për ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës për shkak të dorëheqjes”

Nëpërmjet këtij vendimi është deklaruar ndërprerja e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, për shkak se ai ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga ky funksion. Në zbatim të dispozitave ligjore, organi kompetent për emërimin ashtu dhe për ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor është Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Sa më sipër, K PSAB-ja, në kushtet e paraqitjes së dorëheqjes së motivuar të Kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës për shkak të fitimit të konkursit për të qenë pjesë e Institucionit të Avokatit të Shtetit, i propozon Këshillit: “Ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës z. Shikim Korbi, për shkak të dorëheqjes.

13. Vendimi nr. 179, datë 26.09.2019, “Caktimin e një anëtari në komisionin për mbrojtjen e gjyqtarëve ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”;

Ky vendim ka për qëllim caktimin e z. Bici si një nga anëtarët e Komisionit për Mbrojtjen e Gjyqtarëve, i cili njëkohësisht do të ushtrojë dhe detyrën e kryetarit të tij. Vendimi është miratuar me propozim të K PSAB-së në zbatim të Vendimit Nr.

564, datë 31.07.2019 "Për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e veçantë të magistratit gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij", të Këshillit të Ministrave. Vendimi i Këshillit të Ministrave parashikon në pikën 7 të tij ngritjen e Komisionit për Mbrojtjen e Gjyqtarëve pranë KLGJ-së, në përbërje të të cilit janë, nga një përfaqësues, të Këshillit, të MD-së, të Ministrisë së Brendshme, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe Kryetari i Gjykatës pranë së cilës ushtron detyrën gjyqtari, për të cilin kërkohet mbrojtje. Mandati i këtyre përfaqësuesve është dyvjeçar.

14. Vendimi nr. 267, datë 02.12.2019 "Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në gjykatat e qarqeve Durrës, Tiranë, dhe Lezhë"

Ky vendim ka për qëllim marrjen e masave për mbrojtjen e jetës së qytetarëve dhe gjithë stafit të gjykatave të rrezikuara nga tërmeti i datës 26.11.2019. Për këto arsye, me propozim të KPSAB-së, u vendos pezullimi i veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në gjykatat të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të ndodhur nga tërmeti i datës 26.11.2019.

Gjithsesi, përjashtohen nga efektet e këtij pezullimi veprimtaria dhe shërbimet gjyqësore, që lidhen me çështje me natyrë të ngutshme, shqyrtimi i të cilave mund të zhvillohet edhe në ambiente të tjera jashtë gjykatës të cilat ofrojnë siguri. Kohëzgjatja e pezullimit, ishte përcaktuar deri në momentin kur autoritetet përgjegjëse të bëjnë vlerësimin e kushteve ekzistuese të riskut të ambienteve të gjykatës dhe të garantohet eliminimi i çdo rreziku të mundshëm që mund çojë në dëmtim të jetëve njerëzore ashtu dhe të pronës.

15. Vendimi nr. 268, datë 03.12.2019 "Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore në sistemin e drejtësisë"

Ky vendim ka për qëllim miratimin e rishpërndarjes së fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor, si më poshtë:

- a) Rialokimim e fondeve në programin "Planifikim, Menaxhim, Administrim" 1110, pakësuar nga shpenzimet operative, shtuar në shpenzime paga, për vlerën 3 500 mijë lekë.
- b) Rialokimin e fondeve në programin "Buxheti gjyqësor" 3310, pakësuar nga shpenzime paga (fonde të lira), shtuar në shpenzime për paga, në favor të:
 - i. Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një vlerë 21 000 mijë lekë;
 - ii. Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për një vlerë 3 600 mijë lekë;
 - iii. Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për një vlerë 300 mijë lekë;
 - iv. Gjykatës Apelit Durrës, për një vlerë 800 mijë lekë.

16. **Vendimi nr. 271, datë 04.12.2019 “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në disa gjykata të qarkut Tiranë, Durrës, Lezhë”.**
17. **Vendimi nr. 273 datë 05.12.2019, “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit”.**
18. **Vendimi nr. 274, datë 06.12.2019 “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”.**
19. **Vendimi nr. 275, datë 06.12.2019 “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore të Gjykatës së Apelit Durrës dhe transferimin e përkohshëm të selisë së saj pranë godinës ku ushtron veprimtarinë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.**
20. **Vendimi nr. 321 datë 20.12.2019 “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësorë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe transferimin e përkohshëm të selisë së saj në ndërtesën e prokurorisë pranë kësaj gjykate”.**

Me anë të këtyre vendimeve, u bë e mundur rifillimi i veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në datën 05.12.2019 për disa gjykata të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në qarkun Tiranë, Durrës dhe Lezhë, pasi ishte vendosur pezullimi i veprimtarisë së tyre me Vendimin Nr. 267, datë 02.12.2019 të KLGJ-së. Menjëherë pas marrjes së informacionit nga gjykatat se sipas akt konstatimit të ekspertëve, godinat e këtyre gjykatave ishin të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë, K PSAB-ja i propozoi Këshillit miratimin e vendimit për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në gjykatat që përfshihen në qarkun Tiranë, Durrës, Lezhë.

Duhet theksuar fakti, se për Gjykatën e Apelit Durrës me Vendimin Nr. 275, datë 06.12.2019, KLGJ-ja vendosi rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore, si dhe transferimin e përkohshëm të selisë së saj pranë godinës ku ushtron veprimtarinë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Gjithashtu, për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me Vendimin Nr. 321, datë 20.12.2019, KLGJ-ja vendosi rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësorë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, si dhe transferimin e përkohshëm të selisë së saj në ndërtesën e prokurorisë pranë kësaj gjykate. Vendimmarrjet për transferimin e përkohshëm të godinave të këtyre gjykatave ishin rezultat i faktit që godinat e tyre u konstatuan si të papërshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore në këto ambiente.

21. **Vendimi nr. 317 datë 19.12.2019, “Për ngritjen e komisionit të përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë”**

Ky vendim ka si qëllim marrjen e masave emergjente për reduktimin e stokut të çështjeve gjyqësore të prapambetura në Gjykatën e Lartë. K PSAB-ja, në zbatim edhe të Planit të Veprimit të Strategjisë së KLGJ-së për periudhën Janar 2019-Dhjetor 2020, i propozoi KLGJ-së ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimi lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë.

Ushtrimi i veprimtarisë së komisionit fillon nga data 6 janar deri më 31 mars 2020, afat brenda të cilit komisioni duhet të depozitojë pranë Këshillit planin e përgatitur në funksion të qëllimit për të cilin është ngritur. Mirëpo, për shkak të pandemisë globale Covid-19, ky afat është pezulluar.

22. Vendimi nr. 323 datë 27.12.2019 “Për detajimin e fondeve buxhetore, shpenzimeve korente, në sistemin gjyqësor për vitin buxhetor 2020”

Ky vendim i propozuar ka si synim detajimin e fondeve buxhetore, shpenzimet korente (shpenzimeve për paga, shpenzime sigurimeve shoqërore dhe shpenzimeve operative) për sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2020. Në vendim paraqitet buxheti i miratuar për vitin 2020, të dhënat e buxhetit të vitit pararendës si dhe kërkesa në projekt-buxhetin afatmesëm 2020-2022, për të dy programet sipas zërave kryesorë të shpenzimeve.

Gjithashtu, me qëllim garantimin e mirëfunksionimit të vetë Këshillit të Lartë Gjyqësor apo administratës së tij, KPSAB-ja për t'iu përgjigjur nevojave për automjete dhe karburant, ka marrë 2 vendimet e mëposhtme:

- 1. Vendimi nr. 322, datë 24.12.2019 “Për shpërndarjen e automjeteve të reja dhe atyre në përdorim në sistemin gjyqësor” dhe**
- 2. Vendimin nr. 107, datë 05.07.2019 “Për caktimin e limitit të karburantit për automjetet në dispozicion të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”**

Të rëndësishme!

- ❖ 24 akte nënligjore të hartuara dhe miratuara.
- ❖ Zgjedhja e 36 e zëvendëskryetarëve të Gjykatave gjatë 2019, si rrjedhojë e miratimit të rregullave për zgjedhjen e tyre në 2018.
- ❖ Miratimi i strukturës organizative dhe administratës së Këshillit.
- ❖ Caktimi i anëtarin përgjegjës të KLGJ-së për marrëdhëniet me publikun dhe median.
- ❖ Alokimi i 20 punonjësve shtesë në disa gjykata.
- ❖ Miratimi i Projektbuxhetit Afatmesëm 2020 -2022 për pushtetin gjyqësor.
- ❖ Caktimi i anëtarit dhe kryetarit të Komisionit për Mbrojtjen e Gjyqtarëve.
- ❖ Krijimi i komisionit të përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë”.

1.3.1.2 KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE VEPRIMTARISË PROFESIONALE

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (KVEVP) fokusohet në trajtimin e çështjeve të etikës dhe veprimtarisë profesionale të gjyqtarëve. Menjëherë pas konstituimit, Komisioni ka organizuar punën me qëllim përmbushjen e funksioneve, duke zhvilluar veprimtarinë e tij në disa drejtime, si më poshtë:

- Hartimin, diskutimin dhe paraqitjen për miratim të akteve nënligjore normative dhe kolektive që përfshijnë fushën e veprimtarisë së KVEVP-së si dhe veprimtari të tjera, në bashkëpunim me Komisionet e tjera të përhershme dhe të përkohshme të Këshillit;
- Trajtimin e kërkesave të gjyqtarëve drejtuar Këshillit për çështje që janë në fushën e veprimtarisë së KVEVP-së dhe paraqitjen e tyre pranë Këshillit për miratim;
- Administrimin, përpunimin dhe raportimin në Mbledhje Plenare të informacionit periodik të dërguar nga gjykatat në lidhje me veprimtarinë gjyqësore;
- Administrimin e kërkesave të gjyqtarëve për ushtrimin e veprimtarive jashtë funksionit;
- Dhënien e opinionit për ndryshime ligjore të propozuara;
- Trajtimin e dokumentacionit dhe praktikave të kaluara pranë Komisionit.

Gjatë punës njëvjeçare, Komisioni është angazhuar në procesin e hartimit, diskutimit dhe paraqitjes për miratim pranë Këshillit të disa akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Konkretisht, Komisioni ka hartuar dhe paraqitur për miratim gjithsej **35 aktet administrative** (normative, kolektive ose individuale) si më poshtë:

- 1. Vendim nr. 35, datë 7.02.2019 “Mbi informacionin periodik të Kryetarëve të Gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore”,** ndryshuar pjesërisht me vendimin nr. 115 datë 9.7.2019, duke reflektuar problematikat e hasura gjatë raportimit tremujor të Kryetarëve të Gjykatave.

Hartimi dhe miratimi i këtij vendimi, ka për qëllim ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të Këshillit për të garantuar përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor si dhe krijimin e kuadrit nënligjor të nevojshëm për të siguruar bashkëpunimin dhe komunikimin e vazhdueshëm të Këshillit me Kryetarin dhe Këshillin e Gjykatës në lidhje me këto çështje. Miratimi dhe zbatimi i këtij akti ka bërë të mundur marrjen e informacionit periodik tremujor nga çdo gjykatë në lidhje me çështje të rëndësishme sa i përket ushtrimit të

Përbërja:

Kryetare: Brikena Ukperaj
(Lubonja)

Anëtare: Brunilda Kadi

Anëtar: Erjon Muharremaj

Anëtar Zëvendësues:

Fatmira Luli

Medi Bici

funksioneve gjyqësore, etikën dhe solemnitetin, funksionimin dhe përdorimin e sistemit audio dhe sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykata, vonesat në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara etj.

Informacioni i paraqitur çdo tre muaj nga Gjykatat është përpunuar nga Komisioni dhe është paraqitur nëpërmjet një raporti të detajuar në Mbledhjen Plenare, duke siguruar informacion në kohë reale lidhur me mbarëvajtjen e veprimtarisë gjyqësore në gjykata dhe problematikat e evidentuara të cilat shërbejnë si tregues për të adresuar vendimmarrje të tjera të Këshillit me qëllim zgjidhjen e tyre.

Në kuadër të zbatimit të këtij vendimi, pas administrimit të informacionit nga çdo gjykatë, gjatë vitit 2019 janë hartuar, përpunuar dhe diskutuar në mbledhjet e Komisionit dhe më pas paraqitur në Këshill raportet tremujore si më poshtë:

- Raportim periodik 3-mujor në lidhje me veprimtarinë gjyqësore, për periudhën Janar 2019-Mars 2019, paraqitur në mbledhjen e datës 9.7.2019;
- Raportim periodik 3-mujor në lidhje me veprimtarinë gjyqësore, për periudhën Prill 2019-Korrik 2019, paraqitur në mbledhjen e datës 04.11.2019;
- Raportim periodik 3-mujor në lidhje me veprimtarinë gjyqësore, për periudhën Korrik 2019-Shtator 2019, paraqitur në mbledhjen e datës 19.12.2019;

2. Udhëzim nr. 38, datë 28.02.2019 “Mbi pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare”.

Hartimi dhe miratimi i këtij projekt-akti është vlerësuar i domosdoshëm në referim të parashikimeve të nenit 11 pika 3 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenit 91 të Kodit të Punës, me qëllim zbatimin e njëjtë në të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit të dispozitave ligjore për kompensimin financiar të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionet në ditët e pushimit javor ose festave zyrtare.

3. Vendim nr. 72, datë 20.05.2019 “Mbi lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”.

Ky akt ka parashikuar rregulla të posaçme për dhënien e lejeve të papaguara për gjyqtarët që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, llojet e lejeve të papaguara, kriteret dhe procedurën e dhënies së lejeve, në referim të parashikimeve të nenit 24 të Ligjit nr. 96/2016. Mbi bazën e këtij akti është proceduar në vijimësi me trajtimin e kërkesave për dhënien e lejeve të papaguara për gjyqtarët.

4. Vendim nr. 71, datë 20.05.2019 “Për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës”.

Hartimi dhe miratimi i aktit për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës është diktuar nga parashikimet e Ligjit Nr. 98/2016 “Për

organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 27, 28 pika 9 dhe 37 të tij. Hartimi dhe miratimi i këtij akti është vlerësuar i domosdoshëm referuar parashikimeve ligjore që kanë ndryshuar tërësisht mënyrën e administrimit të gjykatave si dhe kompetencave të ndara në ligj ndërmjet Këshillit të Gjykatës, Kryetarit dhe Kancelarit. Ky akt ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave për funksionimin e Këshillit të Gjykatës bazuar në parimet e mirëqeverisjes, efektivitetit, dhe transparencës, duke siguruar rregulla të njëjta për të gjitha gjykatat dhe garantuar pjesëmarrjen aktive të anëtarëve të Këshillit të Gjykatës në arritjen e qëllimeve dhe misionit të gjykatës.

5. Vendim nr. 137, datë 19.07.2019 “Për një shtesë në vendimin nr. 7, datë 21.12.2018 “Rregullore për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të Gjykatave”¹⁴.

KLGG-ja me Vendimin Nr. 7, datë 21.12.2018 ka miratuar rregullat për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave në bazë të të cilit është zhvilluar procedura e zgjedhjes së tyre në të gjitha gjykatat, përveç Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Në këto gjykata ka rezultuar e pamundur zgjedhja e zëvendëskryetarit të gjykatës për shkak të numrit të gjyqtarëve dhe pamundësisë së rregullimit të situatës për zgjedhjen e zëvendëskryetarit në këto gjykata sipas vendimit të miratuar. Kjo situatë ka diktuar nevojën e ndërhyrjes nëpërmjet një dispozite shtesë në Vendimin nr. 7, datë 21.12.2018, me qëllim realizimin e procesit të zgjedhjes së zëvendëskryetarit të gjykatës në rast pamundësie të zgjedhjes së tij sipas rregullave tashmë të përcaktuara në vendimin përkatës.

6. Udhëzim nr. 79, datë 30.05.2019 “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur”.

Hartimi dhe miratimi i këtij akti, konceptuar në formën e një udhëzimi për zbatimin e të cilit janë ngarkuar Këshillat e Gjykatave, ka ardhur si domosdoshmëri për të rregulluar situatën e krijuar pas hyrjes në fuqi të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur miratuar me Ligjin nr. 37/2017, parashikimeve të nenit 13 pika 4 të K.Pr.P., pas ndryshimeve të tij me Ligjin nr. 35/2017 dhe Ligjit nr. 98/2016, si dhe situatës së krijuar lidhur me kompetencën lëndore për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të miturit viktimë të veprës penale. Miratimi i këtij udhëzimi paraqet rëndësi të posaçme në situatën në të cilën Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, përveç gjykatave ku më parë kishte funksionuar seksioni për të mitur sipas Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 6218, datë 07.07.2009, nuk gjykonin çështjet penale me të mitur por shpallnin moskompetencën lëndore për gjykimin e tyre, duke i dërguar këto çështje për gjykim pranë gjykatave përkatëse, në të cilat kishte funksionuar më parë seksioni për të mitur. Në referim të kuadrit ligjor të ndryshuar lidhur me drejtësinë penale

¹⁴ Ky vendim është shtesë në vendimin nr.7 i cili ishte miratuar nga KLGJ-ja me iniciativë të Kryetares së KLGJ-së, pasi Komisionet e Përhershme nuk ishin krijuar ende.

për të mitur dhe situatës konkrete lidhur me gjykimin e çështjeve penale me të mitur, mbi bazën e këtij udhëzimi janë caktuar në çdo gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm, gjyqtarët që gjykojnë çështjet me të mitur në konflikt me ligjin dhe gjithashtu ndjekin programin e trajnimit vazhdues duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në temat specifike që ndikojnë në specializimin e tyre në fushën e drejtësisë penale për të mitur.

7. Vendim nr. 114, datë 09.07.2019 “Mbi krijimin dhe administrimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të dosjes personale dhe regjistrit të gjyqtarëve”.

Hartimi i këtij akti ka për qëllim krijimin dhe administrimin e dosjes personale dhe regjistrit të gjyqtarëve, si një bazë unike e të dhënave profesionale dhe personale të gjyqtarëve e cila përmban informacion të domosdoshëm që përbën burim vlerësimi në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit si dhe për zhvillimin e procedurave të lëvizjes paralele ose ngritje në detyrë. Miratimi i këtij akti është hap i rëndësishëm për krijimin e dosjeve personale dhe regjistrit të gjyqtarëve pranë strukturës përkatëse të KLGJ-së, proces i cili është zhvilluar më pas gjatë vitit 2019.

8. Vendim nr. 104, datë 05.07.2019 “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, si propozim i përbashkët me Komisionin e Zhvillimit të Karrierës.

Ky akt vjen pas miratimit të strukturës organizative të Këshillit me vendimin nr. 12, datë 18.01.2019, strukturë në të cilën është parashikuar krijimi i Njesisë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme dhe Njesisë së Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve. Bazuar në këtë strukturë, nëpërmjet këtij vendimi është vlerësuar të bëhet shpallja e kërkesës për komandim të gjyqtarëve në pozicionin e këshilltarit ligjor dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, duke përcaktuar shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve, kohëzgjatjen, kriteret e komandimit dhe procedurën përkatëse për katër vende vakante (*dy vende vakante në pozicionin e këshilltarit ligjor dhe dy vende vakante në pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin*). Mbi bazën e këtij akti është zhvilluar procedura për komandimin e dy gjyqtarëve në pozicionin “Këshilltar ligjor” pranë Njesisë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme dhe procedura e komandimit të dy gjyqtarëve në pozicionin e “Nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njesisë e Vlerësimit Etik dhe Profesional. Kjo procedurë është finalizuar me komandimin e dy gjyqtarëve në pozicionin e këshilltarit në vitin 2019 dhe komandimin e dy gjyqtarëve në pozicionin e “Nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në fillim të vitit 2020. Konkretisht, në përfundim të kësaj procedure janë marrë vendimet nr. 206, datë 11.10.2019 dhe nr. 207, datë 11.10.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor nëpërmjet të cilëve janë komanduar për një periudhë dyvjeçare dy gjyqtarë në

pozicionin e këshilltarit pranë Njesisë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme.

9. Vendim nr. 205, datë 11.1.2019 “Për pezullimin e procedurave të komandimit të kandidatëve gjyqtarë që kanë aplikuar për pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin”.

Me anë të këtij akti është pezulluar në mënyrë të përkohshme procedura e komandimit të gjyqtarëve në pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, për shkak të ushtrimit të funksioneve në Njësinë e Vlerësimit të punonjësve që kanë ushtruar më parë detyrën e Inspektorit pranë Inspektoratit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Me krijimin e pozicioneve vakante në mënyrë përfundimtare (*pas mbarimit të ushtrimit të funksionit për dy prej punonjësve të mëparshëm*), procedura ka vijuar më pas në fillim të vitit 2020 nëpërmjet vendimit nr. 22 datë 14.01.2020 “Për shfuqizimin e pezullimit të procedurës së komandimit për pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin”, duke komanduar në detyrën e “Nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” dy gjyqtarw, përkatësisht me vendimet nr. 23, datë 14.01.2020 dhe nr. 24, datë 14.01.2020.

10. Vendim nr. 315, datë 19.12.2019 “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, si propozim i përbashkët me Komisionin e Zhvillimit të Karrierës.

Nëpërmjet këtij vendimi është shpallur kërkesa për kandidim për një pozicion si “Këshilltar ligjor”, procedurë e cila është finalizuar në fillim të vitit 2020 me komandimin e një gjyqtari në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme (*Vendim nr. 68 datë 06.02.2020*).

11. Vendim nr. 113, datë 09.07.2019 “Për shpalljen e rihapjes së procedurës së komandimit të një gjyqtari në pozicionin pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës”.

Ky akt është hartuar pas kërkesës¹⁵së Shkollës së Magjistraturës, nëpërmjet të cilës është përcjellë vendimmarrja e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës¹⁶ për shpalljen e një vendi vakant për pozicionin Pedagog i Brendshëm në Departamentin e Formimit Fillestar. Mbi bazën e këtyre kërkesave të Shkollës së Magjistraturës, është vendosur shpallja e rihapjes së procedurës së komandimit duke përcaktuar kriteret për komandim në pozicionin e kërkuar. Procedura e shqyrtimit të kandidaturave, është finalizuar me komandimin e një gjyqtari në pozicionin e pedagogut të brendshëm të Shkollës së Magjistraturës me vendimin nr. 225, datë 22.10.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

¹⁵Kërkesë me nr. 697 prot., datë 20.05.2019 dhe nr. 497 prot., datë 20.05.2019.

¹⁶Vendimmarrje e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës me nr. 6, datë 29.01.2019.

12. Në kuadër të bashkëpunimit më Shkollën e Magjistraturës për realizimin e programit të formimit fillestar dhe formimit vazhdues, janë trajtuar kërkesat e Shkollës së Magjistraturës finalizuar me vendimmarrjet si më poshtë:

- Vendim nr. 37 datë 28.2.2019 “Për praktikën profesionale të kandidatëve për magistratë të Shkollës së Magjistraturës” mbi bazën e së cilit është miratuar Vendimi nr. 112, datë 09.07.2019 “Për praktikën profesionale të kandidatëve për magistratë të Shkollës së Magjistraturës për periudhën Korrik 2019-Qershor 2020”, Vendimi nr. 111, datë 09.07.2019 “Për përditësimin e listës së magistratëve gjyqtarë udhëheqës për periudhën tre vjeçare 2017-2020” dhe Vendimi nr. 247, datë 04.11.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr. 112 datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Nëpërmjet këtyre akteve janë caktuar gjyqtarët udhëheqës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë, për çdo magistrat gjatë zhvillimit të praktikës profesionale.
- Vendimi nr. 246 datë 04.11.2019 “Për miratimin e pjesëmarrjes së magistratëve në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën Tetor-Dhjetor 2019” nëpërmjet të cilit është miratuar pjesëmarrja e gjyqtarëve në programin e trajnimit vazhdues, sipas kërkesave të tyre përcjellë pranë Shkollës së Magjistraturës.

13. Vendim nr. 208, datë 11.10.2019 “Për caktimin e një gjyqtari në pozicionin Këshilltar i Etikës”.

Me anë të këtij vendimi është caktuar në pozicionin e Këshilltarit të Etikës, për një periudhë pesë vjeçare gjyqtarja Albana Boksi. Caktimi i gjyqtarit në këtë pozicion vjen në përmbushje të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 83 pika 2 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

14. Vendim nr. 280 datë 10.12.2019 “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”.

Në zbatim të nenit 91 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe për të realizuar detyrimet që burojnë nga instrumentet ndërkombëtarë dhe kombëtarë, standardet e praktikave më të mira për administrimin e sistemit gjyqësor, promovimin dhe mbrojtjen e imazhit të një drejtësie të pavarur dhe të paanshme, cilësore dhe efiçente, Këshilli i Lartë Gjyqësor është angazhuar për vendosjen e marrëdhënieve sa më të mira me mediat. Në këtë kuadër, në zbatim të nenit 91 pika 3 të Ligjit nr. 115/2016, është zhvilluar procedura e njoftimit për shprehje interesi dhe më pas është proceduar me diskutimin e propozimeve për gjyqtarët e medias në juridiksionin apeli. Propozimi i Komisionit është miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 280, datë 10.12.2019 me të cilin janë caktuar tetë gjyqtarë për mediat sipas juridiksionit të Gjykatave të Apelit në vend.

15. Vendim nr. 81, datë 05.06.2019 “Për ndryshimin e vendimit nr. 52, datë 22.10.2018 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

Nëpërmjet këtij vendimi janë trajtuar kërkesa e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë z. Gjin Gjoni me datë 29.05.2019 dhe kërkesa e Anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë me nr. 3353 prot., datë 31.05.2019, duke konkluduar për ndryshimin e vendimit nr. 52, datë 11.10.2018 të ish-KLD-së dhe qartësimin e situatës lidhur me ushtrimin e detyrës si anëtar i Kolegjit Zgjedhor nga gjyqtari përkatës gjatë kohës që ai është me leje prindërore. Gjithashtu, një tjetër konkluzion i këtij vendimi lidhet me faktin se ushtrimi i funksionit të anëtarit të Kolegjit Zgjedhor përfshihet në veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit dhe në kohën që ai nuk ushtron këto funksione për shkak të lejes prindërore, nuk mund të ushtrojë as detyrën e anëtarit të Kolegjit Zgjedhor.

16. Vendim nr. 58, datë 24.04.2019 “Për përjashtimin e gjyqtarëve Margarita Buhali dhe Fatri Islamaj nga procedurat e ndarjes së çështjeve me short”.

Kjo vendimmarrje vjen pas administrimit dhe trajtimit nga Këshilli të kërkesave të gjyqtarëve respektivë dhe kërkesës së Kryetarit të KED-së me nr. 9 prot., datë 24.01.2019. Përjashtimi i gjyqtarëve respektivë nga shorti për një periudhë tremujore, ka bërë të mundur lehtësimin e punës së gjyqtarëve të angazhuar në cilësinë e anëtarit të KED-së, me qëllim krijimin e kushteve për përmbushjen efektive të detyrës së tyre në këtë cilësi. Pas mbarimit të efekteve të këtij vendimi, Gjyqtarët kanë përsëritur kërkesat e tyre për përjashtimin nga procedurat e shortit, kërkesë kjo e parashtruar edhe nga Kryetari i KED-së me nr. 511 prot., datë 03.09.2019. Pas shqyrtimit të kërkesave respektive dhe vlerësimit në tërësi të ngarkesës së gjyqtarëve në gjykatë dhe në cilësinë e anëtarit të KED-së, kërkesa e tyre është miratuar me vendimin *nr. 173, datë 11.09.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor*.

17. Vendim nr. 270 datë 4.12.2019 “Për refuzimin e kërkesës së gjyqtarës {...} për dhënie leje të papaguar”

Me anë të këtij vendimi është refuzuar kërkesa e një gjyqtari për leje të papaguar për shkak të mosplotësisimit të kushteve për dhënie të lejes në referim të nenit 24 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, nenit 132/1 të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë dhe Vendimit nr. 72 datë 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”.

18. Veprimtaria e Komisionit për hartimin e akteve plotësuese të sistemit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve.

Gjatë vitit 2019 Komisioni është angazhuar në mënyrë të posaçme në hartimin e rregullave të reja sa i përket vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, në referim të parashikimeve të neneve 68-99 të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Referuar

kuadrit ligjor në fuqi, Këshilli ka detyrimin për kryerjen e vlerësimit etik dhe profesional periodik të gjyqtarëve, vlerësim i cili nuk mund të fillonte pa u miratuar më parë rregullat plotësuese të skemës së vlerësimit të përcaktuar në Ligjin për Statusin, dhe një sërë aktesh të tjera të domosdoshme për realizimin e procesit të vlerësimit, të cilat kanë qenë në vëmendjen e posaçme të Komisionit. Hartimi dhe miratimi me prioritet i akteve që plotësojnë skemën e vlerësimit të gjyqtarëve, ka për qëllim fillimin praktik të procesit të vlerësimit periodik të tyre duke synuar përmirësimin në mënyrë të vazhdueshme të etikës dhe aftësive profesionale të trupës gjyqësore, vendosjen e standardeve të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së gjyqtarëve, zhvillimin e karrierës bazuar në meritat profesionale dhe identifikimin e nevojave për trajnim të gjyqtarëve dhe planifikimin efektiv të procesit të trajnimit vazhdues. Hartimi i akteve plotësuese të skemës së vlerësimit, ka kaluar në një proces të gjatë pune të zhvilluar me mbështetjen e ekspertëve të Misionit EURALIUS V dhe i është nënshtruar diskutimeve në tryeza të përbashkëta me përfaqësues të trupës gjyqësore. Gjithashtu, draftet finale i janë dërguar për mendim trupës gjyqësore duke reflektuar në versionin final të akteve propozimet dhe kërkesat e tyre për dispozita të caktuara të akteve përkatëse.

Në kuadër të këtij procesi, gjatë vitit 2019 janë hartuar dhe miratuar, me propozim të Komisionit, aktet e mëposhtme:

**18.1 Vendim nr. 263, datë 21.11.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor
“Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”,**

Ky vendim përcakton rregullat që plotësojnë skemën e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim vlerësimin e gjyqtarëve të caktuar në një pozicion në gjykatë, të cilët kanë ushtruar detyrën e gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit. Këto rregulla janë hartuar për të plotësuar skemën e vlerësimit të përcaktuar në ligj, duke respektuar parimet e pavarësisë, meritokracisë dhe zhvillimit të karrierës, efikasitetit, procesit të rregullt ligjor dhe konfidencialitetit. Në hartimin e rregullave plotësuese i është kushtuar vëmendje e veçantë:

- respektimit të parimeve të vlerësimit dhe parimeve të zhvillimit të procesit të vlerësimit etik dhe profesional, të parashikuara në ligj;
- respektimit me korrektësi të normave ligjore që rregullojnë skemën e vlerësimit të gjyqtarëve, duke qenë se ligjvënësi ka zgjedhur aplikimin e një sistemi formal të vlerësimit të gjyqtarit;
- kujdesit për mos përsëritjen e dispozitave ligjore që rregullojnë skemën e vlerësimit në aktin nënligjor dhe konceptimin e këtij të fundit si një akt plotësues për skemën e vlerësimit të përcaktuar me ligj;

- krijimin e një procesi vlerësimi të qartë, të kuptueshëm, të thjeshtë dhe të zbatueshëm pa vështirësi nëpërmjet parashikimit të rregullave të qarta dhe miratimin e akteve model të cilat plotësohen gjatë procedurës së vlerësimit;
- përcaktimin e fazave të procesit të vlerësimit duke bërë një ndarje të qartë në aspektin procedural të procesit në pesë faza kryesore, referuar llojit të procedurës që zhvillohet, subjekteve që marrin pjesë dhe natyrës së veprimtarisë në secilën fazë, saktësimin e detyrave, përgjegjësi dhe procedurave që ndjek çdo subjekt që merr pjesë në procedurën e vlerësimit;
- përcaktimin si prioritet në vlerësim, përfundimin e vlerësimit të gjyqtarëve që kalojnë procesin e rivlerësimit kalimtar me qëllim gradimin e tyre si dhe vlerësimin e përsheptuar të detyruar të gjyqtarëve për efekt të lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë me qëllim garantimin e funksionalitetit të gjykatave gjatë periudhës kalimtare.

18.2 Vendim nr. 264, datë 21.11.2019 “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarëve”.

Ky vendim është pjesë përbërëse e Skemës së Vlerësimit dhe ka për qëllim shpjegimin e mënyrës se si përcaktohet niveli i vlerësimit të gjyqtarit, për secilin kriter të vlerësimit të përcaktuar nga ligji me qëllim kryerjen e një vlerësimi sa më objektiv dhe të bazuar në një sistem pikësh, që caktohen mbi bazën e një analize të të dhënave të dala nga burimet e vlerësimit, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

18.3 Vendim nr. 316, datë 19.12.2019 “Për miratimin e tabelave standarde me të dhëna statistikore të nevojshme për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”.

Tabelat standarde me të dhëna statistikore janë hartuar duke iu referuar llojit të gjykatës sipas kompetencës lëndore dhe sipas nivelit të gjykatës (*gjykatë e shkallës së parë ose gjykatë apeli*), të dhënave të vlerësimit të përcaktuar në ligj dhe të dhënave të vlerësimit të parashikuar në aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli. Mbi këtë bazë janë hartuar tabelat me të dhëna statistikore për gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, të juridiksionit të përgjithshëm, për gjykatat administrative të shkallës së parë dhe të apelit dhe gjykatat për krime të rënda/gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, të shkallës së parë dhe të apelit.

19. Vendimi nr. 276 datë 10.12.2019 për miratimin e “Programit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2020”

Në hartimin e programit të vlerësimit është përcaktuar lista e gjyqtarëve që do të vlerësohen përgjatë vitit 2020 si dhe periudha e vlerësimit. Në lidhje me gjyqtarët që do të vlerësohen dhe periudhën e vlerësimit, programi synon:

- Gradimin e gjyqtarëve, të konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë nga organet e rivlerësimit, në vijim të procesit të vlerësimit për periudhën e vlerësimit 2013-2016, e cila përkon me periudhën 3-vjeçare të rivlerësimit kalimtar;
- Vlerësimin normal të gjyqtarëve me jo më pak se 3 vjet dhe jo më shumë se 15 vjet përvojë profesionale në datë 01.01.2017, për periudhën e vlerësimit 2017-2019;
- Vlerësim të përshpejtuar të detyruar për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 - 31.12.2019, sipas një programi të veçantë që Këshilli do të miratojë në rastet kur kërkohet nga gjyqtari, ngritja në detyrë ose lëvizja paralele.

Veç sa më sipër, gjatë vitit 2019 Komisioni ka trajtuar çdo kërkesë të paraqitur nga gjykatat, gjyqtarët dhe institucione të tjera, që ka të bëjë me fushën e veprimtarisë së tij si dhe çdo çështje tjetër të adresuar pranë tij për trajtim, duke proceduar sipas rastit me përgatitjen e opinioneve ose kthimin e përgjigjeve përkatëse në lidhje me veprimtari të tilla si:

- Ushtrimi i veprimtarisë jashtë funksionit të gjyqtarëve, kërkesa të cilat janë evidentuar në një regjistër elektronik të administruar pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore;
- Diskutimi dhe përgatitja e sugjerimeve për ndryshime ligjore në Ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- Caktimi i një përfaqësuesi të Komisionit në grupin e punës për hartimin e një plani masash për reduktimin e çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë. Komisioni ka caktuar Znj. Brunilda Kadi si përfaqësuese në këtë grup pune.
- Trajtim i kërkesave të gjyqtarëve dhe subjekteve të tjera për të cilat është proceduar me kthim përgjigje ose adresimin e kërkesës për zgjidhje.

Vlen të theksohet se veprimtaria e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale përgjatë vitit 2019, është fokusuar kryesisht në plotësimin e skemës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve me aktet e nevojshme nënligjore, pasi në zbatim të Ligjit për Statusin, vlerësimi periodik i gjyqtarëve, kryhet 1 herë në 3 vjet për gjyqtarët me më pak se 15 vjet përvojë profesionale dhe 1 herë në 5 vjet për gjyqtarët që kanë përvojë profesionale mbi 15 vjet. Në kushtet kur periudha e rivlerësimit kalimtar 2013-2016, për efekt të ligjit, konsiderohet periudhë vlerësimi për gjyqtarin që konfirmohet në detyrë, vlerësim që përfundon me gradimin e gjyqtarit (niveli i vlerësimit), fillimi i vitit të parë mbi të cilin duhet të llogaritet periudha e vlerësimit periodik të gjyqtarëve ishte viti 2017. Prandaj Këshilli duhej të fillonte vlerësimin periodik të gjyqtarëve në vitin 2020 (pra jo më parë), sikundër edhe ka miratuar programin e këtyre vlerësimeve, për periudhën e vlerësimit 2017-2019.

Një nga të metat thelbësore të procesit të vlerësimit të gjyqtarit, ka qenë pikërisht inkoherenca midis promovimit dhe vlerësimit të gjyqtarit. Prandaj përgjatë vitit 2019 Këshilli nuk ka kryer asnjë vlerësim të gjyqtarëve që i përkiste periudhës së vlerësimit 2010-2012, sepse neni 171, pika 1 e ligjit nr.96/2016, parashikon detyrimin e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë që të përfundonte vlerësimin e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit për periudhën 2007-2012, bazuar në rregullat ekzistuese para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ndërkohë, situata faktike me të cilën u përball Këshilli i Lartë Gjyqësor, ishte që ish-KLD-ja kishte përfunduar vlerësimin vetëm për periudhën 2007–2009, dhe për periudhën 2010-2012 kishte përfunduar vlerësimin vetëm për 14 gjyqtarë. Pra, aktualisht në sistem janë rreth 62 gjyqtarë të cilët nuk kanë asnjë vlerësim profesional të veprimtarisë së tyre si gjyqtarë, pa llogaritur numrin e gjyqtarëve të rinj të cilët janë emëruar në detyrë nga KLGJ-ja në vitin 2019. Kjo situatë sigurisht që përbën pengesë për këto magjistratë lidhur me promovimin e tyre në kushtet e mungesës së vlerësimit profesional. Por nëse KLGJ-ja do të vazhdonte të bënte vlerësimet e 2010-2012 për gjyqtarët që janë ende në proces rivlerësimi, në varësi të këtij të fundit, kishte gjasa që vlerësimi të mbetej pa efekt. Nga ana tjetër, impenjimi në kryerjen e vlerësimeve për vitet 2010-2012 sipas rregullave të mëparshme, përbënte jo vetëm vështirësi procedurale, por kërkonte kohë dhe burime njerëzore për të arritur në një rezultat që nuk kishte vlerë për karrierën e gjyqtarit sot në vitin 2019. Vazhdimi i vlerësimit të gjyqtarëve për periudhën 2010-2012 nuk do të kishte asnjë efekt, sepse nuk mund të përcaktonte aktualisht shkallën e aftësisë reale dhe profesionale të gjyqtarit.

I ndërgjegjshëm për rëndësinë që ka vijimi i ecurisë së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, ka hartuar aktet nënligjore të miratuara e në fuqi tashmë, rregulla që plotësojnë skemën e vlerësimit të gjyqtarëve, duke i shërbyer jo vetëm promovimit sipas meritës, por edhe nevojave për trajnime të vazhdueshme të gjyqtarëve me qëllim ngritjen profesionale të tyre.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka pasur dhe ka prioritet të punës së tij jo vetëm mbështetjen e organeve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, por edhe sigurimin e ekzekutimit të menjëhershëm të vendimeve të tyre. Në këtë kuadër, vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit, janë drejtpërsëdrejti të ekzekutueshme, që me njoftimin e shkurtimit të vendimit të këtyre organeve, për konfirmimin apo shkarkimin e gjyqtarëve. Në rast se shkarkimi vendoset nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, për gjyqtarin zbatohet në mënyrë të menjëhershme pezullimi i ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore deri në momentin kur vendimi i shkarkimit merr formë të prerë.

Në zbatim të nenit 59 pika 4 të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ka të drejtë që edhe kur vendos për konfirmimin e gjyqtarit në detyrë, të transferojë çështjen pranë organit kompetent për inspektim, ose në rast

se evidentohen shkaqe për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të tij. Në zbatim të këtij parashikimi ligjor, Komisionit për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale i është përcjellë vetëm 1 vendim nga organet e rivlerësimit. Vendimi Nr. 85 datë 13.12.2018 që i përket subjektit të rivlerësimit znj. E.M. aktualisht vendim i formës së prerë. Në pikën 1 të këtij vendimi është vendosur konfirmimi në detyrë i gjyqtares, ndërsa në pikën 2 të tij është disponuar: “Transferimi i çështjes Nr. 00112-291 të vitit 2018, pranë organit kompetent për t'u marrë në shqyrtim gjatë vlerësimit periodik të subjektit të rivlerësimit, znj. E.M. ... etj.”. Ky disponim detyron organin, në rastin konkret Këshillin e Lartë Gjyqësor që, sipas nenit 59 pika 4 të Ligjit nr. 84/2016, të fillojë menjëherë shqyrtimin e shkaqeve të referuara, por sipas legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në kushtet e referimit tek ky ligj, trajtimi i menjëhershëm i disponimit të mësipërm, nuk mund të bëhet nga Komisioni, sepse çështja e referuar i përket vitit 2018, dhe jo periudhës së rivlerësimit 2013-2016. Gjyqtarja e referuar nga organet e rivlerësimit është përfshirë ndërkohë në listën e gjyqtarëve për të cilët do të zbatohet programi i vlerësimit të vitit 2020, e cila do të vlerësohet për dy periudha vlerësimi, atë 2013-2016 (për të cilën do të përcaktohet grada) dhe 2017-2019 (vlerësimi normal). Në kushtet kur çështja e referuar ishte e vitit 2018, ajo mund të trajtohej vetëm në kuadër të procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares, që i përket periudhës së vlerësimit 2017-2019, për të cilën në zbatim të programit të miratuar dhe detyrimeve të parashikuara nga neni 85 pika 1 e Ligjit për Statusin, vlerësimi fillon në vitin pasardhës, që në këtë rast është viti 2020. Për këtë shkak kjo çështje nuk mund të trajtohej me përparësi, për sa kohë vlerësimi periodik i gjyqtares do të fillonte në vitin 2020.

Te rëndësishme!

- ❖ 35 akte nënligjore të hartuara dhe miratuara.
- ❖ Miratimi i akteve plotësuese të sistemit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve.
- ❖ Miratimi i programit për vlerësimin etik-profesional për 121 gjyqtarë për vitin 2020.
- ❖ Miratimi i procedurës së funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës, si një organ i ri kolegjal i administrimit të tyre.
- ❖ Administrimi dhe trajtimi i problematikave lidhur me drejtësinë penale për të mitur, dhe mbikëqyrja e trajnimit të tyre nga Shkolla e Magjistraturës
- ❖ Miratimi i aktit për krijimin dhe administrimin pranë KLGJ-së të dosjes personale dhe regjistrimit të gjyqtarëve dhe implementimi i tij me krijimin e databazës elektronike të të dhënave për 355 gjyqtarë.
- ❖ Caktimi i gjyqtarit në pozicionin e Këshilltarit të Etikës.
- ❖ Caktimi i 8 qivatarëve për mediat sipas iuridiksionit të Givkatave të Apelit.

1.3.1.3 KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (KZHK) ka në fokus shqyrtimin e kërkesave për emërim në gjykata duke paraqitur para Këshillit raportin përkatës shoqëruar me tabelat dhe listën e kandidatëve të pikëzuar, ndjekjen e procesit të plotësimit të vendeve vakante në gjykata përmes skemës së delegimit, transferimit të gjyqtarëve, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë, si dhe shqyrton kërkesat për kandidim në funksione drejtuese në gjykata. Gjithashtu, Komisioni shqyrton kërkesat e Shkollës së Magjistraturës për numrin e magjistratëve të rinj, emërimin dhe caktimin në pozicion të kandidatëve të diplomuar.

Përbërja

Kryetar: Ilir Toska
Anëtare: Marçela Shehu
Anëtar: Alban Toro
Anëtar Zëvendësues:
Naureda Llagami
Dritan Hallunaj

Duhet theksuar se KZHK-ja është Komisioni i cili ka mbajtur volumin më të madh të punës së Këshillit gjatë vitit 2019, dhe me ndikimin më të madh në të gjithë prioritetet dhe objektivat që Këshilli ka realizuar përgjatë këtij viti. Volumi i madh i punës vlerësohet jo vetëm në numrin e lartë të akteve që ka propozuar dhe janë miratuar nga KLGJ-ja, ku nga 315 vendime të miratuara në total nga KLGJ-ja për vitin 2019, 226 prej tyre janë propozuar nga KZHK-ja, por dhe në përmbajtjen dhe cilësinë e tyre.

Angazhimi i KZHK-së për shkak të fushës së veprimtarisë që mbulon është sa i domosdoshëm aq edhe i vështirë. Domosdoshmëria buron nga kuadri ligjor i cili e ngarkon KLGJ-në me përgjegjësinë për hartimin e rregulloreve të ndryshme të cilat lidhen me magjistratin dhe statusin e tij, me të drejtat dhe detyrimet e tyre, pranimet dhe emërimet në ushtrim të detyrës, zhvillimin e karrierës, vlerësimin etik dhe profesional, apo dhe përgjegjësinë disiplinore të tyre. Tre nga kompetencat e sipërpërmendura të KLGJ-së kanë lidhje me statusin e magjistratit dhe me zhvillimin e tij të karrierës, ndaj ato i përkasin tërësisht fushës së veprimtarisë së KZHK-së. Ndërkohë vështirësia lidhet me numrin e lartë të akteve ndërthurur me kohën e shkurtër që legjislacioni përcakton për krijimin e tyre, ku shumica e akteve duhet të përfundojnë brenda 6 muajve të parë të krijimit të KLGJ-së dhe të gjitha aktet rregullatorë duhet të përfundojnë brenda një viti. Krahas akteve nënligjore, Komisioni harton projektvendime, rregullore apo udhëzime të cilat i paraqiten Këshillit për miratim.

Për shkak të volumit të madh të punës, Komisioni është ndihmuar edhe nga stafi i administratës dhe duke filluar nga muaji shtator i vitit 2019 pranë tij janë caktuar për të punuar sistematikisht tre këshilltarë ligjorë, pjesë e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve në KLGJ.

Me aktet e mësipërme të propozuara dhe të miratuara nga Këshilli, Komisioni ka rregulluar çështje dhe problematika të cilat kanë ekzistuar që para krijimit të KLGJ-së apo dhe që u shfaqën në momentin e krijimit të tij. Komisioni u përball menjëherë me nevojën që shfaqej para KLGJ-së për të gjetur zgjidhje për çështje që i përkisnin fushës së veprimtarisë së tij si:

- Trajtimin e një numri të madh kërkesash të ardhura nga gjykatat ku kërkohej delegimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të caktuara;
- Nisjen e procesit të caktimit të përkohshëm të gjyqtarëve pranë Gjykatave së Posaçme për Gjykimin e Veprave Penale të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, kur ligji parashikonte një afat dyjavor nga krijimi i KLGJ-së;
- Nisja e procesit të emërimit dhe caktimi në detyrë i magistratëve të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018 dhe pranimet e reja në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2019-2020;
- Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës për caktimin e kuotave për magistratë dhe për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë;
- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore si rregullat për ngritjen në detyrë në nivele më të larta ose të specializuara të gjyqtarëve, rregullat për emërimin e anëtarëve jogjyqtarë të Gjykatës së Lartë, rregullat për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit, etj.

Nisur nga volumi i madh i kërkesave të ardhura pranë KLGJ-së, 179 kërkesa, nga gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë, në të cilat kërkonin delegim gjyqtarësh për plotësimin e trupave gjyqësore, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatiti rregulla të hollësishme për krijimin dhe aplikimin e skemës së delegimit dhe asaj të transferimit të përkohshëm. Ndonëse këto akte u hartuan dhe miratuan, implementimi i tyre në praktikë nuk ishte i mundur. Për rrjedhojë Komisioni hartoi dhe i propozoi KLGJ-së projektvendimin "Për rregullat dhe procedurat për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme", mekanizëm ky që i dha zgjidhje situatës dhe me të cilën KLGJ-ja ende operon.

Komisioni i dha rëndësinë e duhur dhe **hartimit të akteve të nevojshme për emërimin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë**, duke e konsideruar plotësimin e kësaj gjykate si një prioritet mbi prioritetet e tij. Pas hartimit të rregullave dhe shpalljes së njoftimit për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, për 4 pozicione nga radhët e juristëve të spikatur (në tre fushat e së drejtës administrative, civile dhe penale), Komisioni realizoi gjithashtu gjithë procesin e verifikimit të kandidaturave (23 kandidatë) duke konkluduar me dërgimin tek Presidenti i Republikës të 3 kandidatëve për emërim në Gjykatën e Lartë. *(për më shumë lexo seksionin 6.1 "Rifunksionalizimi i Gjykatës së Lartë", fq. 101)*

Të njëjtën rëndësi nga KZHK-ja mori edhe **procesi i emërimit të magistratëve të rinj**, të cilët e kishin përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018, duke bërë verifikimin e 10 kandidatëve për magistrat ashtu dhe caktimin në detyrë të tyre. Ndërkohë i njëjti proces vijoi dhe Komisioni realizoi verifikimin e 15 kandidatëve për magistrat të cilët kishin përfunduar SHM në vitin akademik 2018-2019.

Si një risi që reforma në drejtësi mbartte në vetvete ishte dhe krijimi i Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj dhe KLGJ-ja, dhe Komisioni pranë tij KZHK-ja, përgatiti aktin përkatës dhe më datë 18 dhjetor 2019 KLGJ-ja **deklaroi “Fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 19.12.2019”**. Ky proces u shoqërua edhe me caktimin e përhershëm ashtu dhe të përkohshëm pranë këtyre gjykatave të gjyqtarëve të ish-Gjykatave për Krimet e Rënda.

Në bashkëpunim me SHM-në, si dhe duke bërë një analizë të të gjithë situatës së sistemit gjyqësor në vend, të nevojave që ky sistem ka për gjyqtarë, KZHK-ja i propozoi KLGJ-së përcaktimin e numrit të përgjithshëm të kandidatëve në profilin gjyqtar që do të pranohen në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020. Njëkohësisht SHM-së iu propozua edhe numri i kandidatëve për këshilltar ashtu dhe për ndihmës ligjorë.

Gjatë vitit 2019 KZHK-ja, pasi ka trajtuar, bazuar në kërkesat e ardhura nga kryetarët e gjykatave, mungesën e plotësimit të organikës me gjyqtarë ka filluar procesin e transferimit të disa gjyqtarëve pranë këtyre gjykatave. Rëndësi përgjatë procesit të transferimit ka pasur edhe trajtimi i kërkesave të disa gjyqtarëve për dorëheqje nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit ashtu dhe të atyre për daljen në pension të parakohshëm.

226 akt-vendimet e përgatitura nga KZHK-ja dhe të miratuara nga KLGJ-ja i përkasin kategorive të ndryshme. Ndërkohë që një pjesë e tyre janë akte normative nënligjore që kanë dalë në zbatim të ligjit dhe që kanë efekte të përgjithshme mbi të gjithë gjyqtarët, një pjesë tjetër i përket krijimit të rregullave të brendshme të funksionimit apo procedurave të ndryshme ligjore. Megjithatë pjesën më të madhe të akteve të nxjerra nga ky Komision e zënë ato me karakter individual, administrativ dhe me lidhje të drejtpërdrejtë me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë.

Nisur nga koha e miratimit të këtyre akteve e deri tani, konstatohet se aktet e propozuara dhe të miratuara janë cilësore, garantojnë kritere objektive dhe një vendimmarrje të pacenueshme në të gjithë çështjet që ato rregullojnë. Nisur nga përmbajtja dhe përkufizimi që ligji parashikon këto akte të miratuara bazuar në propozimin e KZHK-së janë si më poshtë:

8 akte normative nënligjore (6 akte bazë, 2 akte janë ndryshim i dy prej tyre);
19 akte për miratim rregullash të brendshme;
46 akte administrative kolektive;
153 akte administrative individuale.

Komisioni gjatë vitit 2019 ka miratuar 6 akte normative nënligjore ndërkohë që dy prej tyre kanë pësuar ndryshime, pra duke u përmirësuar me dy akte të tjera. Nevoja për hartimin e këtyre akteve buron nga Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe janë rregulloret më të rëndësishme të miratuara nga KLGJ-ja përgjatë vitit 2019. Kjo për shkak se këto rregullore kanë ardhur si përgjigje e problematikave të identifikuara menjëherë pas krijimit të KLGJ-së. Vlen të përmendet situata e krijuar në shumë gjykata (të nivelit të parë dhe të dytë) si pasojë e numrit të vogël të gjyqtarëve në dispozicion për të gjykuar çështje. Gjithashtu, situata e krijuar në Gjykatën e Lartë për të cilën raportohej krijimi i një numri të lartë çështjesh të prapambetura (prej rreth 34 mijë të tilla), me ndikim negativ si në të gjithë sistemin gjyqësor dhe në jetën shoqërore të vendit. Konkretisht këto vendime janë:

- **Rregullorja për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit**, miratuar me vendimin nr. 22, datë 07.02.2019, ka dalë në zbatim të nenit 45 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në këtë dispozitë parashikohet se KLGJ-ja mund të krijojë “Skemën e delegimit” duke parashikuar miratimin e një tërësi rregullash për të komanduar gjyqtarë të cilët bëhen pjesë e saj, për të gjykuar në gjykata të tjera për një periudhë kohore të caktuar. Fillimi i punës së KZHK-së për hartimin e rregullave lidhur me këtë skemë mori shkas nga situata e krijuar pranë KLGJ-së si pasojë e një numri të lartë kërkesash të ardhura nga gjykatat, të cilat për shkak të pamundësisë së tyre objektive, kërkonin delegim të gjyqtarëve nga gjykata të tjera me qëllim krijimin e trupave gjyqësore dhe gjykimin e çështjeve të veçanta.

- **Rregullore për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit**, miratuar me Vendimin nr. 23, datë 07.02.2019, ka për qëllim krijimin e rregullave të hollësishme për krijimin e mekanizmit të transferimit të përkohshëm dhe zbatimin e tij në praktikë.

Kjo rregullore, që pasoi menjëherë rregulloren për skemën e delegimit, kishte për qëllim që të krijonte kuadrin e duhur nënligjor në funksion të dhënies së një zgjidhjeje dhe trajtimit të kërkesave të shumta që vinin nga gjykatat për delegim gjyqtarësh për shkak të organikës së tyre të pamjaftueshme ose të zvogëluar për shkaqe të ndryshme. Gjithashtu, në rastin kur një gjykatë ishte në nevojë dhe në skemën e delegimit nuk kishte gjyqtarë të caktuar apo këta të fundit ishin në pamundësi ligjore për të ushtruar funksionin e tyre, Këshilli do të procedonte me

transferimin e përkohshëm të gjyqtarit (sipas nenit 46 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë") me qëllim krijimin apo plotësimin e organikës së gjykatës për të bërë të mundur gjykimin e çështjeve .

- **Rregullat dhe procedura e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, është miratuar me Vendimin nr. 30, datë 14.02.2019 (e ndryshuar).**

Nevoja për të miratuar këto rregulla doli si një domosdoshmëri në kushtet kur skema e delegimit apo ajo e transferimit të përkohshëm, ishte e pamundur të aplikohet në praktikë dhe nevojat e gjykatave për caktim gjyqtarësh për të gjykuar çështje të ndryshme ishte në rritje. Këshilli gjithashtu vendosi se këto rregulla do të aplikohen vetëm dhe për sa kohë skema e delegimit dhe ajo e transferimit të përkohshëm janë të pamjaftueshme për t'iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave për krijim apo plotësim të trupës gjyqësore.

- **Vendimi "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë"**¹⁷ është miratuar në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të KLGJ-së, si institucioni përgjegjës për administrimin gjyqësor për zhvillimin e karrierës të gjyqtarëve.

Qëllimi i këtij vendimi është realizimi i procedurave për verifikimin e kandidatëve duke u bazuar në meritat e tyre, në procesin e rregullt ligjor, si edhe parimet e përgjithshme të procedurës administrative, veçanërisht ato të ligjshmërisë, transparencës, informimit, drejtësisë, paanësisë, objektivitetit, barazisë dhe i mos diskriminimit, mbrojtjes së të dhënave, konfidencialitetit e të sekretit shtetëror, si dhe proporcionalitetit. Kjo është një ndër vendimmarrjet e rëndësishme që Këshilli ka miratuar, për shkak se me këtë vendim miratohen rregulla më të hollësishme lidhur me procedurat për (i) verifikimin e kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidateve për gjyqtar, për emërimin dhe ngritjen në detyrë të kandidatëve gjyqtar, për riemërimin e kandidateve ish-gjyqtarë dhe për emërimin e kandidatëve gjyqtarë dhe jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë; ashtu si dhe për (ii) Verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidatëve.

Miratimi i këtij vendimi i hapi rrugë nisjes së menjëhershme të procesit të emërimit të magjistratëve të rinj të cilët kishin përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018, të atyre që përfunduan shkollën në vitin akademik

¹⁷ Vendimi nr. 75, datë 23.05.2019.

2018-2019 si dhe kandidatëve të tjerë magistratë për profilin gjyqtar që do të përfundojnë këtë shkollë në vitet në vazhdim.

- Vendimi **“Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”**¹⁸

Ky vendim përcakton ato kriteret që do të ndiqen me qëllim identifikimin e kandidatit jogjyqtar që përfaqëson juristin më të spikatur, i cili do të propozohet për t’u emëruar në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë. Kategoritë e kriterëve që do të vlerësohen me qëllim identifikimin e juristit më të spikatur, janë meritat profesionale; meritat morale dhe etike; meritat organizative dhe menaxheriale. Ndërsa për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve, Këshilli mbështetet në ekspertizën e veçantë të kandidatit në fusha të veçanta të ligjit; vlerësimin e punës së kandidatit; rezultatet e studimeve; reputacionin që kandidati gëzon në shoqëri dhe midis kolegëve; si dhe aftësitë gjuhësore dhe cilësinë e platformës dhe të vizionit të kandidatit. Vendimi shoqërohet dhe me shtojcë ku janë detajuar më tej kategoritë e kriterëve të vlerësimit dhe i treguesve për secilën nga ato, duke përcaktuar edhe peshën specifike të tyre në pikëzimin e kandidatëve.

Miratimi i këtij vendimi i hapi rrugën nisjes menjëherë të procesit të përzgjedhjes së kandidatëve nga radhët e juristëve të spikatur, për në Gjykatën e Lartë duke shpallur fillimisht 3 pozicione të lira në të tre fushat e së drejtës civile, administrative dhe penale. Ky proces do të pasohet më pas me shpalljen edhe të një pozicioni tjetër, duke e çuar në 4 numrin e pozicioneve të lira për në Gjykatën e Lartë.

- Miratimi i **“Metodologjia për Vlerësimin dhe Pikëzimin e Kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”**¹⁹

Kjo metodologji e miratuar nga Këshilli është një akt i rëndësishëm që i shërben në mënyrë të veçantë kandidatëve për anëtar në GJL si dhe anëtarëve të KLGJ-së duke i orientuar këta të fundit në elementët që duhet të marrin në konsideratë gjatë vlerësimit të kandidatëve dhe shumën e pikëve për çdo kategori meritash të përcaktuar paraprakisht. Gjithashtu metodologjia i ndihmon kandidatët të kuptojnë arsyet e vendimmarrjes së anëtarëve të KLGJ-së e cila (vendimmarrja) do të bazohet në vlerësimin dhe pikëzimin e cilësive dhe të dhënave konkrete të çdo kandidati në raport me kushtet dhe kriteret ligjore të kandidimit.

- Miratimi i vendimit **“Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”**²⁰,

¹⁸ Vendim nr. 102, datë 05.07.2019.

¹⁹ Vendim nr. 209, datë 11.10.2019.

²⁰ Vendimi nr.78, datë 30.05.2019 “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”.

Kjo ka qenë një ndërmarrje e rëndësishme e Këshillit, me iniciativë të KZHK-së, si në funksion të përmbushjes së përgjegjësisë për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor ashtu dhe në respektim të parimit qeverisës të efijencës. Vendimi përcakton rregullat standarde për sa i përket shortimit të çështjeve gjyqësore në gjykatat e apeleve me qëllim garantimin e efijencës dhe cilësinë e drejtësisë në këto gjykata. Ai përcakton rregulla të përgjithshme në lidhje me caktimin e datës dhe orës së gjykimit të çështjeve të ankmuara, të cilat caktohen nga gjyqtari relator në përputhje me kalendarin e tij të gjykimit të çështjeve. Vendimi gjithashtu rregullon trajtimin e çështjeve për të cilat Kodi i Procedurës Civile apo një ligj i veçantë ka përcaktuar ose jo afate për gjykimin e tyre. Në rastet kur legjislacioni në fuqi nuk ka vendosur afate, në caktimin e datës dhe orës së gjykimit, në përputhje me kalendarin e gjykimit të çështjeve, gjyqtari relator mban parasysh afatin e arsyeshëm të përcaktuar në Kodin e Procedurës Civile. Vendimi përcakton rastet në të cilat gjykimi i një çështjeje mund të përshpejtohet. Përshpejtimi i gjykimit kryhet me kërkesë të palëve për shkak të natyrës dhe kategorisë specifike të çështjes dhe kur kjo kërkesë nuk vjen në kundërshtim me ligjin.

Vlen të theksohet se, Komisioni gjatë punës së tij ka miratuar gjithashtu 19 akte të ndryshme që kanë të bëjnë me miratim rregullash të brendshme apo që lidhen me koordinimin e veprimtarisë së tij si Komision. Kryesisht këto akte kanë të bëjnë me:

- (i) caktim të anëtarëve të tij si relatorë në verifikimin e kushteve dhe kriterëve për procese të ndryshme si në rastet e kandidatëve në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ashtu dhe për ato që kanë përfunduar këtë shkollë, apo dhe kandidatët nga radhët e juristëve të spikatur për anëtarë në Gjykatës e Lartë;
- (ii) shpalljet e procedurave të emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur në të tre fushat e së drejtës, apo dhe fillimi i procedurës së përzgjedhjes së tyre;
- (iii) propozimi për ngritje të komisioneve të përkohshme për verifikimin e plotësimin të kriterëve të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë që do të pranohen për të ndjekur Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

Ndarja e këtyre akteve të miratuara bazuar në propozimin e Komisionit, sipas çështjeve është si më poshtë:

- 4 akte²¹ kanë të bëjnë me shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur në të tre fushat e së drejtës;

²¹ Vendimet nr.108, nr.109 dhe nr.110 datë 09.07.2019 si dhe akti nr. 172, datë 26.09.2019.

- 3 akte kanë të bëjnë me caktimin e relatorit për verifikimin e kushteve dhe kritereve si për kandidatët për në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020, ashtu dhe për emërimin e kandidatëve që kanë përfunduar këtë shkollë në vitin 2018 apo dhe në vitin 2019;
- 2 akte lidhur me fillimin e procedurës së verifikimit dhe caktimin e relatorëve për verifikimin e kushteve të kandidatëve për në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur;
- 4 akte për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur, për 4 pozicionet e lira të shpallura për këtë gjykatë;
- 3 akte për shpallje kërkesë për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, dhe për komandim të një gjyqtari në pozicionin pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, apo dhe në Ministrinë e Drejtësisë;
- 2 akte lidhur me ngritjen e Komisionit të Përkohshëm (i) për verifikimin e plotësimit të kritereve të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë që do të pranohen për të ndjekur Programin e Formimit Fillestar në SHM ashtu dhe (ii) për verifikimin e plotësimit të kritereve të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë;
- 1 akt që ka të bëjë me ndërmarrjen e nismës për fillimin e procesit të krijimit të skemës së delegimit;

Ndër aktet kryesore në këtë grup aktesh të sipërcituara janë shpallja e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur. Nëpërmjet vendimeve nr. 108, 109, dhe 110, datë 09.07.2019, dhe nr. 172, datë 11.09.2019, KLGJ-ja shpalli nisjen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për 4 pozicione të lira, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në tre fushat e së drejtës administrative, civile dhe penale.

Shpallja e këtyre pozicioneve erdhi menjëherë pas miratimit nga KLGJ-ja të Vendimit nr. 75, datë 23.05.2019, ***“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”***, dhe Vendimit të datës 5 korrik 2019, nr. 102, ***“Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”***.

Në hartimin e këtyre akteve nga Komisioni ka pasur si qëllim identifikimin e kandidatëve që përfaqësojnë juristin më të spikatur në kuptim të nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por edhe që kanë ekspertizën e veçantë në tre fushat e veçanta të së drejtës. Kjo

për faktin se edhe organizimi i Gjykatës së Lartë bëhet përmes tre kolegjeve, konkretisht Kolegjit Civil, Kolegjit Penal dhe Kolegjit Administrativ, çka përcakton dhe fushat respektive të së drejtës të profilizimit të gjyqtarëve të kësaj gjykate.

Gjithashtu në funksion të këtij procesi Komisioni i propozoi KLGJ-së, bazuar në Vendimin nr. 75, datë 23.05.2019, që brenda 7 ditëve nga përfundimi i afatit të kandidimit të nisë procedurën e verifikimit të kandidatëve, dhe në të njëjtën ditë të caktojë relatorin për secilin kandidat (miratuar me vendimet nr. 142, datë 26.07.2019 dhe vendimin nr. 182 datë 02.10.2019). Relatorë në këtë proces kanë qenë tre anëtarët e Komisionit, ndërkohë që Komisioni, për shkak të angazhimeve që kishte, propozoi që në procedurat e shortit, për caktimin e anëtarëve relatorë që do të ndjekin procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore, të përfshihej edhe z. Dritan Hallunaj, anëtar zëvendësues i këtij Komisioni. Këshilli e miratoi këtë propozim dhe caktimi i anëtarëve u krye përmes shortit në një proces tërësisht transparent.

Pas realizimi të procesit të verifikimit të 23 kandidatëve dhe kualifikimit, vetëm të 3 prej tyre për 4 pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë, Komisioni i propozoi KLGJ-së miratimin e 4 akteve²² për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në GJL të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur.

Gjithashtu gjatë vitit 2019 KZHK-ja ka pasur në fokus tij duke përpiluar rregulla të detajuara që përcaktojnë kriteret dhe procedurën që do të zbatohet Këshilli i Lartë Gjyqësor për renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për ngritje në detyrë. Aktualisht është përfunduar procesi i hartimit të këtij akti dhe KLGJ-ja ka miratuar më 7 shkurt 2020 rregulloren²³ për ngritje në detyrë të gjyqtarëve.

Gjatë vitin 2019 KLGJ-ja organizoi **3 procese²⁴ të rëndësishme**, që kishin të bënin me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore (i) për kandidatët për në Programin e Formimit Fillestar, profili gjyqtar, të SHM-së në vitin akademik 2019-2020, (ii) për kandidatët për magistratë që kishin përfunduar këtë shkollë në vitin 2018 dhe (iii) të kandidatëve për magistrat që përfunduan SHM-në në vitin akademik 2018-2019. Konkretisht janë verifikuar:

1. 26 kandidatë²⁵ për në formimin fillestar në SHM,
2. 10 kandidatë të cilët përfunduan SHM-në në vitin 2018 dhe (iii)
3. 15 kandidatë të cilët përfunduan SHM-në në vitin akademik 2018-2019.

Një ndër çështjet që Komisioni ka ndjekur ka qenë edhe ai lidhur me:

²² Vendimet nr.259, nr. 260, nr. 261 dhe nr.262 datë 13.11.2019.

²³ Vendimi nr.70, datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.

²⁴ Vendimet nr.82, nr.83 datë 05.06.2019 ashtu dhe nr. 103, datë 05.07.2019.

²⁵ Në total janë shqyrtuar dhe miratuar aktet për 28 kandidatë, 2 prej të cilave janë miratuar në janar të 2020. Deri 31 dhjetor 2019, janë miratuar 26 akte.

- a) kërkesën e SHM-së për komandimin e gjyqtarëve si pedagog të brendshëm pranë saj;
- b) nevojën e vetë KLGJ-së për komandim të magjistratëve apo dhe;
- c) të Ministrisë së Drejtësisë, për komandim të gjyqtarëve pranë këtyre institucioneve.

Procesi është ndjekur nga Komisioni (në bashkëpunim dhe me KVEP-në) i cili nëpërmjet 3 aktesh²⁶ shpalli kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për komandim të një gjyqtari në pozicionin pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, apo dhe në Ministrinë e Drejtësisë. Në të gjithë këtë proces Komisioni ndoqi me rigorozitet plotësimin e kërkesave nga kandidatët të cilët paraqitën kërkesa për komandim pranë SHM-së dhe KLGJ-së, kjo në raport edhe me nevojat e gjykatave nga ato vinin në mënyrë që të mos cenohet funksionaliteti i tyre. Në përfundim u komandua një gjyqtar pranë SHM-së si pedagog i brendshëm dhe pranë KLGJ-së u komanduan në Njësinë e Shërbimit të Komisioneve dy magjistratë të tjerë. Nuk rezultoi asnjë shprehje interesi nga gjyqtarët për t'u komanduar pranë strukturave të Ministrisë së Drejtësisë.

Për sa i përket akteve të nxjerra nga KZHK-ja në lidhje me statusin e të gjithë gjyqtarëve ose zyrtarëve të administratës gjyqësore, ato kanë pasur të bëjnë kryesisht me:

- (i) caktim të gjyqtarëve për të gjykuar çështje të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku kanë caktimin e përhershëm;
- (ii) nisje të procedurave të transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e pozicioneve të lira për transferim të përkohshëm në disa gjykata;
- (iii) caktim të numrit të kandidatëve që do të pranohen në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020.

Ndërkohë në një ndër aktet më të rëndësishme që i përket kësaj kategorie është fillimi i funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Nëse bëjmë një ndarje të 46 akteve administrative kolektive të propozuara dhe të miratuara nga KLGJ-ja konstatohet se:

- 31 akte kanë lidhje me caktimin e gjyqtarëve në gjykata të tjera për gjykimin e çështjeve të veçanta ku ndër këto vendime, 6 prej tyre janë shtesa apo ndryshime të tyre;
- 2 akte²⁷ kanë të bëjnë me caktimin e numrit të kandidatëve që do të pranohen në programin fillestar, profili gjyqtar, në SHM, dhe të

²⁶ Vendimet nr.33, datë 19.02.2019, nr. 104, datë 05.07.2019 dhe nr.281, datë 10.12.2019.

²⁷ Vendim nr.17, datë 29.01.2019 dhe nr. 20, datë 31.01.2019.

këshilltarëve dhe ndihmësve ligjore; njëri ndër këto vendime ka dalë në përmirësim të vendimit bazë;

- 1 akt²⁸ lidhur me praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës;
- 10 akte të cilat kanë të bëjnë me procesin e transferimit të përkohshëm në disa gjykata (2 prej tyre janë akte shfuqizuese të akteve bazë);
- 1 akt²⁹ lidhur me fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- 1 akt lidhur me shpalljen e vendeve vakante për gjyqtarët e emëruar nga KLGJ-ja specifikisht ato që kanë mbaruar SHM-në, për vitin 2019;

Sikurse u përmend dhe më sipër volumin më të madh të akteve të propozuara nga Komisioni për në mbledhjet plenare të KLGJ-së e zënë aktet administrative individuale me 153 të tilla. Shumica e këtyre akteve janë akte individuale të cilat kanë të bëjnë kryesisht me:

- (i) verifikimin e kandidatëve për në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur;
- (ii) verifikimin e kandidatëve për magjistratë që kishin përfunduar SHM-në në vitin 2018, si dhe në vitin akademik 2018-2019, apo dhe kandidatët për formimin fillestar pranë SHM-së;
- (iii) akte lidhur me kërkesa të ndryshme magjistratësh si, për dorëheqje nga detyra, për dalje në pension, etj.

Nëse bëjmë një ndarje të tyre sipas proceseve të zhvilluara apo dhe çështjeve që kanë zgjidhur konstatohet se:

- 30 akte, 10 akte për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për emërim si gjyqtar për kandidatët që kanë përfunduar SHM-në në vitin 2018; 10 akte të emërimit të tyre si gjyqtar dhe 10 akte të caktimit të tyre në pozicion;
- 19 akte që kanë të bëjnë me skualifikimin ose përfundimin e procesit të verifikimit për kandidatët nga radhët e juristëve të spikatur për në Gjykatën e Lartë;
- 26 akte³⁰ lidhur me verifikimin (24 të kualifikuar dhe 2 të skualifikuar) e kandidatëve për në formimin fillestar, profili gjyqtar, për në SHM;
- 15 akte për verifikimin e kandidatëve për emërim si magjistrat që kanë përfunduar SHM në vitin akademik 2018-2019 (14 të kualifikuar dhe 1³¹ i skualifikuar);

²⁸ Vendim nr.37, datë 28.02.2029.

²⁹ Vendim nr.286, datë 18.12.2019.

³⁰ Në total janë shqyrtuar dhe miratuar aktet për 28 kandidatë, 2 prej të cilave janë miratuar në janar të 2020. Deri 31 dhjetor 2019, janë miratuar 26 akte.

³¹ Kandidati i skualifikuar ushtroi të drejtën e ankimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit e cila me vendimin nr. 262, datë 23.12.2019 vendosi detyrimin e KLGJ-së për emërim si magjistrat.

- 5 akte³² i përkasin deklarimit të mbarimit të statusit të magjistratit për 5 ish-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë;
- 15 akte³³ që kanë lidhje me transferim, përsëritje transferimi apo ndërprerje transferimi të gjyqtarëve;
- 4 akte³⁴ refuzim kandidimi për në skemën e delegimit;
- 3 akte³⁵ i përkasin vendimeve për kualifikim të 3 kandidatëve për në Gjykatën e Lartë dhe vijim të procedurës së mëtejshme;
- 6 akte lidhur me caktimin në pozicion të gjyqtarëve, 5 në mënyrë të përhershme, 1 në mënyrë të përkohshme në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarës (mbledhja e datës 18.12.2019);
- 12 akte lidhur me caktimin në mënyrë të përkohshme të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (mbledhje e datës 18.12.2019);
- 8 akte lidhur me mbarimin e statusit të magjistratit bazuar në kërkesat e vetë magjistratit;
- 2 akte lidhur me kërkesa për përjashtim nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme;
- 2 akte lidhur me refuzim të 2 kërkesave për rikthim në detyrë të dy gjyqtarëve;
- 3 akte lidhur me procesin e komandimit të gjyqtarëve si pedagog të brendshëm pranë Shkollës së Magjistraturës;
- 1 akt lidhur me konfirmimin për të vijuar komandimin si ndihmës-magjistrat pranë Gjykatës së Lartë;

Siç dhe kemi theksuar më sipër në pjesën hyrëse të këtij raporti problematika me e rëndësishme e hasur menjëherë me krijimin e KLGJ-së ishte numri i lartë i kërkesave të ardhura nga kryetarët e gjykatave me qëllim delegim gjyqtarësh për plotësimin e trupave gjyqësore. Konkretisht, deri më 14 shkurt 2019, në KLGJ ishin akumuluar 179 kërkesa nga kryetarët respektivë të gjykatave për delegime të 259 gjyqtarëve në 179 çështje, me motivacionin që janë në pamundësi për shqyrtimin e tyre në kushtet e ekzistencës së pengesave ligjore për anëtarët e trupës së tyre gjyqësore.

³² Vendimet nr. 63, nr. 64, nr. 65, nr. 66 dhe nr. 67, datë 24.04.2019.

³³ Vendimet nr. 46, datë 12.03.2019; vendimet nr. 95, nr. 96, nr. 97, nr. 98 dhe 99, datë 21.06.2019; vendimet nr.175 dhe nr. 176, datë 11.09.2019; vendimet nr. 305, nr. 306, nr. 307, nr. 308, nr. 309, nr. 310 dhe nr.311, datë 18.12.2019.

³⁴ Vendimet nr.26, nr. 27, nr.28 dhe nr.29, datë 14.02.2019.

³⁵ Vendime nr. 255, nr.256, dhe nr.257, datë 12.11.2019.

- Nga gjykatat e apeleve janë paraqitur gjithsej 85 kërkesa për caktimin e 139 gjyqtarëve në 85 çështje gjithsej (48 çështje civile dhe 37 çështje penale).
- Nga gjykatat e shkallës së parë janë paraqitur gjithsej 94 kërkesa për caktimin e 120 gjyqtarëve në 94 çështje gjithsej (37 çështje civile, 57 çështje penale).
- Nga gjykatat administrative të shkallës së parë janë paraqitur 15 kërkesa për caktimin e 24 gjyqtarëve në 15 çështje administrative.

Kjo situatë u zgjidh nëpërmjet vendimit të sipërpërmendur nr. 30, datë 14.02.2019, të miratuar nga KLGJ-ja për “Rregullat dhe procedurat për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Me anë të këtij vendimi iu dha zgjidhje gjithë volumit të krijuar duke caktuar gjyqtarë nëpër gjykata të ndryshme nga ato që ushtrojnë funksionet për të zgjidhur çështje të veçanta.

Ndërkohë që gjatë të gjithë vitit 2019 janë depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor gjithsej 845 kërkesa për caktim gjyqtari nga kryetarët respektivë të gjykatave me motivacionin se janë në pamundësi për shqyrtimin e tyre, nga të cilat:

- 332 kërkesa të ardhura nga gjykatat e rretheve gjyqësore;
- 102 kërkesa të ardhura nga gjykatat administrative;
- 394 kërkesa të ardhura nga gjykatat e apeleve; si dhe
- 17 kërkesa të ardhura nga Gjykata e Lartë.

Në përgjigje të këtyre kërkesave janë caktuar 1209 (njëmijë e dyqind e nëntë) gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, nga të cilët:

- 401 gjyqtarë nga gjykatat e rretheve gjyqësore,
- 118 nga gjykatat administrative të shkallës së parë dhe
- 690 nga gjykatat e apeleve juridiksion i përgjithshëm dhe posaçëm.

Në fund të majit 2019, KLGJ-ja u përball me mosfunksionalitetin e plotë të Gjykatës së Lartë, kjo për mungesë të numrit minimal të gjyqtarëve për shqyrtimin e çështjeve. Kjo situatë solli përshpejtimin nga KLGJ-ja të proceseve të miratimit të akteve nënligjore për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, në veçanti ata nga radhët e juristëve të spikatur, procedura që ndiqen tërësisht nga ajo, si dhe hapjen e procedurave të emërimit në fillim të korrikut 2019. Megjithatë, Gjykata e Lartë informoi se një kategori çështjesh mund të dështonin në pritje të përmbylljes së procedurave të emërimit. Pas trajtimit të situatës së krijuar, KLGJ-ja konsideroi të adresonte këtë problematikë vetëm për një grup të kufizuar çështjesh, pikërisht për ato që kishin të bënin me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, ekskluzivisht me ekstradimin dhe transferimin e personave të dënuar, për të cilat shkronja “c”, pika 3, e nenit 462 të

Kodit të Procedurës Penale parashikon që vendim i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm është vendimi i Gjykatës së Lartë. Për këtë, me propozim të KZHK-së, më datë 23.07.2019, me Vendimin nr. 140, Këshilli miratoi rregulla plotësuese të veçanta duke i adaptuar në Vendimin e tij nr. 30, datë 14.02.2019.

Këshilli konsideroi se nga të gjitha çështjet që ndodhen për gjykim në Gjykatën e Lartë vetëm ato çështje që kanë të bëjnë me ekstradimin apo transferimin e personave të dënuar (në rastin konkret janë evidentuar gjashtë çështje të tilla), *çështje të cilat, referuar nenit 493, pika 4, të Kodit të Procedurës Penale, nëse nuk shqyrtohen brenda afatit 3-mujor nga data e regjistrimit të akteve në Gjykatën e Lartë, passjellin revokimin e masave shtrënguese, duke përfshirë edhe atë të “arrestit në burg”, paraqesin ngutshmëri dhe nevojë për ndërhyrje. Gjithashtu, duhet theksuar se me revokimin e “arrestit në burg” vihet në rrezik edhe procesi i dorëzimit të shtetasve të dënuar për efekt ekstradimi, në kushtet kur, sipas nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale, vendimi i formës së prerë, në raste të tilla, është ai i Gjykatës së Lartë.*

Gjithashtu dhe nëse KLGJ-ja nuk merrte masa për të ndërhyrë do të vihej në rrezik e gjithë procedura e ekstradimit, si dhe do të cenoheshin edhe marrëdhëniet ndërshtetërore të Republikës së Shqipërisë, të rregulluara nëpërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

Rregullat plotësuese të adaptuara në Vendimin nr. 30, datë 14.02.2019, konsiderojnë në veçanti ekzistencën e dy parakushteve që gjyqtarët e apelit duhet të plotësojnë për t'i caktuar në Gjykatën e Lartë për gjykimin e një çështjeje ekstradimi apo transferimi të personave të dënuar. Kështu, caktimi në Gjykatën e Lartë për gjykimin e këtij grupi çështjesh, do të bëhet vetëm ndërmjet atyre gjyqtarëve të gjykatave të apelit të cilët kanë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pra nga ata gjyqtarë që japin garanci për integritetin e tyre, si dhe që plotësojnë edhe kriterin e vjetërisë me “jo më pak se 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit” sipas përcaktimit kushtetues të nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Përzgjedhja e këtyre gjyqtarëve do të kryhet me short, pas kërkesës së Kancelarit të Gjykatës së Lartë drejtuar Këshillit.

Vlen të theksohet se Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka një kontribut të spikatur në drejtim të funksionalizimit të Gjykatës së Lartë dhe krijimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të cilat qenë prioritete kryesore në punën e Këshillit të Lartë Gjyqësor. *(për më shumë lexo seksionet 6.1 “Rifunksionalizimi i gjykatës së lartë”, faqe 101 dhe 6.2 “Krijimi i gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar” faqe 105).*

Të rëndësishme!

- ❖ 226 akte nënligjore të hartuara dhe miratuara.
- ❖ Miratimi i paketës me 4 akte nënligjore me qëllim hapjen e thirrjes për procedurën e emërimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur dhe për procedurën e ngritjes në detyrë nga radhët e gjyqtarëve.
- ❖ Hapja e thirrjes për 4 vende vakante në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur dhe përfundimi me emërim të 3 gjyqtarëve me dekret Presidenti në fillim të 2020.
- ❖ Krijimi i Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në shkallë të I & Apel dhe caktimi i përkohshëm dhe i përhershëm i gjyqtarëve të tyre.
- ❖ 76 verifikime të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për emërim në pozicione të ndryshme në Gjykatën e Lartë; magjistratët që mbaruan Shkollën e Magjistraturës për vitet 2018-2019 & 2019-2020; kandidatët për formim fillestar në Shkollën e Magjistraturës.
- ❖ Përcaktimi i kuotave me përkatësisht 25 dhe 40 kandidatëve në profilin gjyqtar që do të pranohen në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2018-2019 dhe 2019-2020.
- ❖ Miratimi i rregulloreve për kriteret dhe procedurat e: funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit; transferimit të përkohshëm të gjyqtarit; të caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.
- ❖ Caktimi i 1209 gjyqtarë për gjykimin e çështjeje gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, në përgjigje të 845 kërkesave të ardhura nga kryetarët respektivë të gjykatave.

1.3.1.4 KOMISIONI DISIPLINOR

Fusha e veprimtarisë së Komisionit Disiplinor (KD) e cila përkon me një ndër përgjegjësitë kryesore të KLGJ-së, është marrja e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve, sikurse përcaktohet në nenin 147/a të Kushtetutës së RSH.

Kjo veprimtari gjatë vitit 2019 nuk ka qenë në pritshmërinë që legjislacioni në kuadër të reformës në drejtësi i ka kushtuar procesit disiplinor të gjyqtarëve, por edhe kërkesave të qytetarëve apo institucioneve të ndryshme në funksion të rritjes së besimit të publikut në sistemin gjyqësor. Kjo ka ardhur si rezultat:

Përbërja:

Kryetar: Medi Bici
Anëtar: Maksim Qoku
Anëtar: Dritan Hallunaj
Anëtar Zëvendësues:
Brunida Kadi
Alban Toro

- a. i vonesave në plotësimin e të gjithë arkitekturës së organeve të reja të drejtësisë;
- b. dhe vonesave në plotësimin e kuadrit ligjor në fuqi për sa i përket dispozitave që rregullojnë procedimin disiplinor.

Për rrjedhojë ky Komision ka iniciuar vetëm 1 projektvendim, atë të **Krijimit të Komisionit të Përkohshëm kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari**, miratuar me Vendim KLGJ-së nr. 31, datë 14.02.2019 dhe që trajtoi 181 ankesat e depozituara në këtë institucion. *(për më shumë lexo seksionin 1.3.2 “Komisionet e përkohshme”, faqe 61)*

Vonesa në plotësimin e arkitekturës së organeve të reja të drejtësisë: Ushtrimi i funksionit të Komisionit Disiplinor, ndërlidhet me verifikimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve, përgjegjësi të cilën Kushtetuta (nenin 147/d) ia ka njohur Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD). Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, rregullon më hollësisht funksionet dhe përgjegjësitë e secilit organ kushtetues, duke përcaktuar se veprimtaria e verifikimit disiplinor të ankesave dhe fillimi i procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve është nën kompetencën e ILD-së, ndërsa veprimtaria e shqyrtimit të procedimit disiplinor dhe marrja e masave konkrete disiplinore është nën tagrin e KLGJ-së.

Ndërsa Këshilli i Lartë Gjyqësor është krijuar më datë 12.12.2018 dhe në funksion të plotë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë gjatë vitit 2019³⁶ nuk ishte zgjedhur ende. Procesi i zgjedhjes së ILD nga Kuvendi me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të tij ka përfunduar vetëm më 20.01.2020 me Vendimin nr. 2 të Kuvendit të RSH.

Ndaj ky vakum i krijuar me mungesën e konstituimit të autoritetit kryesor që ndërmerr veprime konkrete për hetimin disiplinor të gjyqtarëve, ka bërë që veprimtaria e KD-së të jetë e zbehtë duke mos pasur asnjë mundësi të reagojë ndaj kërkesave për hetimin e gjyqtarëve të iniciuara nga publiku, institucione apo media, të cilat në mungesë të ILD-së adresoheshin pranë Këshillit.

Nga 729 ankesa në total, Këshilli ka trajtuar 183 prej tyre ku në çdo rast ankuesi është informuar se sipas dispozitave kushtetuese³⁷ dhe ligjore³⁸ autoriteti përgjegjës për hetimin dhe verifikimin disiplinor ndaj gjyqtarëve është Inspektori i Lartë të Drejtësisë, dhe ankesa do të përcillet pranë kësaj strukture sapo kjo e fundit të krijohet.

Vonesave në plotësimin e kuadrit ligjor:

³⁶ Vendim i Kuvendit nr.2, datë 20.01.2020.

³⁷Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 147, 147/a dhe 147/d.

³⁸Ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nenet 193 deri 216.

Gjykata Kushtetuese me vendimet e saj nr. 34, datë 10.04.2017, duke konstatuar si në kundërshtim me Kushtetutën, ka shfuqizuar disa dispozita të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Ndër dispozitat e shfuqizuara janë edhe nenet 101 – 104 që përkojnë me listën e shkeljeve disiplinore. Shfuqizimi i kësaj liste ka penguar veprimtarinë e Këshillit, i cili është gjendur në kushtet e një vakumi ligjor për të përcaktuar nëse një veprim/mosveprim i gjyqtarëve do të konsiderohet ose jo, shkelje disiplinore.

Në këto kushte, do të duhej amendimi i këtyre dispozitave, nëpërmjet Ligjit nr. 48/2019 të miratuar më datë 18.07.2019, që të plotësohej vakumi ligjor, i cili do të mundësonte fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së Komisionit Disiplinor.

Hartimi i rregullave për dhënien e masave disiplinore:

Tashmë, si pasojë e situatave të përmendura më lart, veprimtaria e Komisionit është fokusuar në hartimin e rregullave për dhënien e masave disiplinore nga KLGJ-ja. Këto rregulla duhet të përcaktojnë në mënyrë të hollësishme të gjitha veprimet që duhet të ndërmerret Këshilli, kur pranë tij do të depozitohet një kërkesë nga ILD-ja për të kërkuar dhënie mase disiplinore ndaj gjyqtarit, me qëllim garantimin e një procesi të rregullt e ligjor. Pjesë integrale e këtyre rregullave do të jenë edhe veprimet që do të kryejë Komisioni Disiplinor në analizimin dhe verifikimin e kërkesës deri në shqyrtimin e saj në mbledhjen plenare të KLGJ-së.

Ndonëse legjislacioni nuk e ngarkon KLGJ-në me ndonjë dispozitë të veçantë për hartimin e rregullave për procesin disiplinor, domosdoshmëria e hartimit të tyre është thelbësore, kjo jo vetëm për të rregulluar proceset që Këshilli dhe Komisioni i Disiplinës duhet të ndërmerren në këtë drejtim, por edhe për të adresuar një seri dispozitash ligjore (138 -150, 101 -137) ku parashikohet se gjatë hetimit disiplinor nga ILD-ja, mund të kërkohet dhe vlerësimi apo qëndrimi i KLGJ-së.

Përmes kësaj rregulloreje ndër të tjera do të përcaktohen qartë të drejtat dhe përgjegjësitë e gjyqtarit, mënyra e njoftimit të palëve, zhvillimi i debatit në Këshill, si dhe procedura e vendimmarrjes deri në arsyetimin dhe zbardhjen e vendimit. Hartimi i këtyre rregullave do të përmbushte njëkohësisht edhe një ndërmasat e parashikuara në Strategjinë e KLGJ-së për vitet 2019-2020.

Të rëndësishme!

- ❖ Krijimi i Komisionit të Përkohshëm kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari.
- ❖ 181 kërkesa për hetimin e gjyqtarëve nga 729 të tilla kanë marrë përgjigje.
- ❖ Hartimi i rregullave për dhënien e masave disiplinore nga KLGJ-ja (në proces).

1.3.2 KOMISIONET E PËRKOSSHME

Ndërsa funksionet dhe përgjegjësitë e KLGJ-së sipas fushës së tyre janë shpërndarë në objekte të veprimtarisë së komisioneve të përhershme, Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar³⁹ autorizon KLGJ-në që për çështje të veçanta, të cilat nuk i përkasin veprimtarisë së ndonjërit prej Komisioneve të Përhershme, të krijojë Komisione të Përkohshme që do merren me shqyrtimin e këtyre çështjeve të veçanta.

Komisionet e Përkohshme që Këshilli ka krijuar përgjatë vitit 2019 janë të lidhura me procese *ad hoc* të ndërmarra në kuadër të adresimit të problematikave me të cilat është përballur sistemi gjyqësor, të tilla si:

- Vlerësimi etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve; *(për më shumë lexo kapitullin 3. Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve & masat e mara nga KLGJ-ja për garantimin e mbarëvajtjes së sistemit gjyqësor”, faqe 86)*
- Verifikimin e plotësisë të kriterëve të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që do të pranohen për të ndjekur Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2019-2020;
- Shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari;
- Vlerësimin e statusit individual dhe karriera e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Hartimin e një plani veprimesh lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë; *për më shumë informacion lutemi lexoni seksionin 6.1 “Rifunksionalizimi i Gjykatës së Lartë, fq 101)*
- Hartimin e Rregullores së Brendshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësisë të Kriterëve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë.

Në janar të 2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, vendosi⁴⁰ caktimin dhe publikimin e numrit maksimal të kandidatëve magjistratë, profili gjyqtar, këshilltarë dhe ndihmës ligjorë. Për shkak të numrit të lartë të aplikimeve të paraqitura për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, për të cilat duhet të bëheshin verifikimet mbi përmbushjen e kriterëve për formimin fillestar në SHM për vitin akademik 2019-2020, doli domosdoshmëri që kjo çështje të trajtohet nëpërmjet funksionimit të një Komisioni të Përkohshëm për Verifikimin e Plotësisë të Kriterëve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe

³⁹ Në nenin 62, pika 14 e ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

⁴⁰ vendimi nr.17, datë 29.01.2019.

Ndihmës Ligjorë⁴¹. Në përbërje të këtij Komisioni ishin Z. Erjon Muharremaj (njëkohësisht edhe Kryetar), Znj. Brunilda Kadi, dhe Znj. Brikena Ukperaj (Lubonja).

Konkretisht Komisioni i Përkohshëm ka verifikuar gjithsej 174 kandidatë, prej të cilëve 55 kandidatë për këshilltarë ligjorë dhe 119 kandidatë për ndihmës ligjorë. Në përfundim të procesit të verifikimit, Komisioni konkludoi në përcaktimin e:

- (i) listës emërore me 17 kandidatë për ndihmës ligjorë, që plotësojnë kriteret dhe 38 kandidatë që nuk i plotësojnë kriteret; dhe
- (ii) listës emërore me 93 kandidatë për Ndihmës Ligjorë që i plotësojnë kriteret dhe 26 kandidatë që nuk i plotësojnë kriteret.

Këto lista u hartuan pas një pune intensive 1-mujore dhe iu propozuan⁴² e u miratuan nga Këshilli më datë 10 mars 2019.

Komisioni i Përkohshëm kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari.

Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”⁴³ përcakton se pas çdo faze që lidhet me shqyrtimin fillestar dhe vlerësimin e ankesës, verifikimin apo mbylljen e saj, ankuesi ka të drejtën që të njoftohet për vendimmarrjen e çdo faze, si dhe njëkohësisht gëzon të drejtën e animimit në KLGJ.

Në kushtet kur në KLGJ ishin depozituar rreth 183 ankesa kundër vendimmarrjes së Kryeinspektorit të ish-KLD-së, për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, u propozua ngritja e një Komisioni të Përkohshëm i cili do të shqyrtonte këto ankesa. Krijimi i një komisioni të përkohshëm mbështetej dhe në nenin 62, pikat 13, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në të cilin ligjvënësi, duke qenë i vetëdijshëm për situatën tranzitore në të cilën do të kalonte procesi i zbatimit të reformës në drejtësi deri në krijimin e institucioneve të reja, kishte parashikuar në mënyrë specifike që ankesat ndaj vendimmarrjes së Kryeinspektorit të ish-KLD-së të trajtoheshin nga një komision i përkohshëm i krijuar për këtë proces vlerësues.

Ngritja dhe funksionimi i Komisionit të Përkohshëm⁴⁴ kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, u miratua me vendimin e KLGJ-së nr. 31, datë 14.02.2019. Ai përbëhej nga tre anëtarë, dy anëtarë jogjyqtarë dhe një anëtar

⁴¹ vendimi nr. 18, datë 29.01.2019.

⁴² vendimi nr.43, datë 12.03.2019 dhe vendimi nr.55, datë 19.04.2019.

⁴³ Neni 121, pika 3; Neni 122, pika 5; dhe Neni 122, pika 5 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁴⁴ Vendimi nr.32, datë 14.02.2019.

gjqqtar, konkretisht nga znj. Fatmira Lulit, z. Dritan Hallunaj dhe z. Alban Toro. Ky komision pasi analizoi të 183 ankesat e depozituara pranë zyrës së protokollit të ish-KLD-së, në përfundim vendosi që:

- 181 ankesa të mos pranohen;
- 1 ankesë të pranohet dhe të dërgohet pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- 1 ankesë të pushohet për shkak të dorëheqjes së saj nga vetë ankuesi.

Të gjitha vendimet e Komisionit të Përkohshëm janë të arsyetuara dhe u janë njoftuar subjekteve iniciues të ankesës sipas parashikimit të Vendimit nr. 31, datë 14.02.2019.

Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin e Statusit Individual dhe Karrierës së Inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Ndërkohë që KLGJ-ja u konstitua më datë 12 dhjetor 2018 si pasojë e transformimit total të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, administrata e institucionit pararendës ishte parashikuar të transferohej pranë KLGJ-së, për të paktën një periudhë 6-mujore pas krijimit të tij. Një parashikim i tillë nuk ishte i vlefshëm dhe për inspektorët e ish-KLD-së, saktësisht për një pjesë të tyre, për të cilët legjislatori parashikonte transferimin e tyre pranë ILD. Ndërkohë që zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, dita e krijimit të të cilës do të shërbente si moment i kalimit të këtyre inspektorëve pranë kësaj strukture, nuk ishte krijuar ende situata dhe statusi i inspektorëve të ish-KLD-së kishte mbetur i papërcaktuar.

Pra në pikën 10 të nenit 283 të Ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, por dhe në dispozitat kalimtare të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht në pikën 3 të nenit 168 të tij, theksohet “...se inspektorët në detyrë, të cilët janë caktuar kryesisht për kryerjen e hetimeve disiplinore, vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e inspektorit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe konsiderohen si të komanduar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në kohën e krijimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë...”.

Për rrjedhojë, ndërsa pozita e secilit inspektor, bazuar në funksionet e punës që kryenin pranë Inspektoratit të ish-KLD-së, dhe koha e transferimit të tyre do të bëhej pas krijimit të zyrës së ILD-së, përpara KLGJ-së dilte një përgjegjësi tjetër, ajo e përcaktimit të statusit të secilit prej tyre, në “magjistrat” ose “jomagjistrat”. Këtë përgjegjësi e nxirrte në pah, edhe ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve...” ku dispozitat kalimtare të tij, (nenet 165 dhe 168) rregullonin si vijueshmërinë në pozicionin e punës të inspektorëve jomagjistratë (neni 165) ashtu dhe vijueshmërinë në pozicionin e punës të inspektorëve magjistrat.

Për realizimin e këtij procesi KLGJ-ja vendosi t’ia besojë punën një Komisioni të Përkohshëm, mundësi të cilën e lejon edhe neni 62, pika 14 e Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Ngritja dhe funksionimi i Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin e Statusit Individual dhe Karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, u miratua me vendimin e KLGJ-së nr. 59, datë 24.04.2019. Në përbërje të tij ishin tre anëtarë, dy anëtarë jogjyqtarë dhe një anëtar gjyqtar dhe konkretisht, z. Maksim Qoku, znj. Fatmira Luli dhe z. Medi Bici. Ndonëse pati një kohëzgjatje më të madhe se afati i parashikuar në vendimin⁴⁵ e ngritjes së tij, Raporti i Komisionit për këtë çështje, u dorëzuar më datë 16 korrik 2019. Në këtë raport Komisioni kishte shqyrtuar me kujdes dosjet personale të Kryeinspektorit dhe secilit inspektor dhe duke u bazuar në të dhënat profesionale-individuale. Ai kishte përgatitur edhe historikun profesional për secilin inspektor që përmbante:

- a) Inspektorët veprimtaria e të cilëve ka qenë e lidhur me vlerësimin etiko-profesional të gjyqtarëve;
- b) Inspektorët veprimtaria e të cilëve ka qenë e lidhur me trajtimin e ankesave dhe hetimin disiplinor të gjyqtarëve;
- c) Inspektorët që gëzojnë statusin e magistratit dhe ata të cilët nuk e gëzojnë këtë status;
- d) Inspektorët, e emëruar nga ish-KLD-ja, të përzgjedhur ndërmjet gjyqtarëve që përmbushin kriteret për t'u emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit;
- e) Inspektorët, e emëruar nga ish-KLD-ja, të përzgjedhur ndërmjet juristëve që kanë shërbyer si gjyqtar për jo më pak se 5 vjet.

Gjithashtu raporti pasqyrore edhe pëlqimin ose jo të secilit inspektor për të vijuar ushtrimin e veprimtarisë pranë KLGJ-së deri në krijimin e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si dhe çdo e dhënë e cila kontribuonte në përmbushjen e qëllimit për të cilin ishte ngritur Komisioni i Përkohshëm.

Raporti i Komisionit, pas një analize të bërë kuadrit ligjor në fuqi⁴⁶, si dhe dosjeve personale të secilit prej inspektorëve, konkludoi me 3 propozime për statusin e inspektorëve. Ky proces u përmbyll nga KLGJ-ja duke vlerësuar:

- për 5 inspektorë konfirmim e statusit të magistratit;
- për 3 inspektorë moskonfirmim të statusit;
- për Kryeinspektorin e ish-KLD-së, u vendos të pritej vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit;
- për 1 inspektor komandimin e përkohshëm pranë ILD-së.

⁴⁵ Afati për dorëzimin e raportit ishte brenda dy muajve nga ngritja e Komisionit (data e ngritjes së Komisionit është me vendimin nr.59, datë 24.04.2019).

⁴⁶ Neni 283 i Ligjit nr.115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Nenet 165 dhe 168 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", legjislacionit pararendës dhe të shfuqizuar tashmë, konkretisht Ligjin nr. 8811 datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", si dhe dosjeve personale të secilit prej inspektorëve.

Komisioni i Përkohshëm për Hartimin e Rregullores së Brendshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në pozitë e një institucioni të ri me kompetenca shumë më të gjëra se paraardhësi i tij, dhe i vendosur në një kontekst me dinamika të reja si pasojë e reformimit të sistemit të drejtësisë, KLGJ-ja e çmoi të domosdoshme hartimin e rregullores së tij të brendshme. Vetë rregullimi dhe mirëfunksionimi i brendshëm i Këshillit është garanci për të ndërtuar dhe udhëhequr një sistem gjyqësor me performancë të lartë që synon ekselencën dhe meriton besimin e publikut. Pikërisht në funksion të këtij qëllimi, Këshilli me Vendimin nr. 318, datë 19.12.2019 miratoi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Hartimin e Rregullores së Brendshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Fokusi i këtij komisioni është hartimi i rregullave të mirëpërcaktuara për të gjitha proceset dhe vendimmarrjet që KLGJ-ja ndërmerr si në komisione ashtu edhe në seanca plenare.

Komisioni ka në përbërje 5 anëtarë, 3 prej të cilëve gjyqtarë dhe 2 anëtarë jogjyqtarë, konkretisht, z. Maksim Qoku, z. Medi Bici, znj. Brunilda Kadi, znj. Fatmira Luli dhe znj. Marçela Shehu.

Aktualisht, Komisioni po vijon punën në kuadër të identifikimit dhe hartëzimit të të gjitha proceseve dhe praktikave ekzistuese, me qëllim hartimin e një rregulloreje, e cila do të shërbejë si një manual praktik për të standardizuar proceset përmes përcaktimit të qartë të roleve dhe kompetencave të njësisë të ndërlidhura me punën e komisioneve dhe atë të vetë Këshillit. Partnerët ndërkombëtarë, Misioni EURALIUS V dhe Projekti “Drejtësi për të gjithë” – USAID po mbështesin procesin e hartimit të rregullores duke ofruar praktikat dhe modelet më të mira ndërkombëtare në këtë drejtim.

Komisioni i Përkohshëm për Mbrojtjen e Gjyqtarëve, të Familjes dhe të Pasurisë së tyre.

Në zbatim të Vendimit Nr. 564, datë 31.07.2019 "Për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e veçantë të magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij", të Këshillit të Ministrave u krijua Komisioni për Mbrojtjen e gjyqtarëve, i cili ka në përbërjen e tij përfaqësues nga institucione të ndryshme shtetërore.

Nga ana e KLGJ-së, anëtari i këtij Komisioni u caktua z. Bici, i cili aktualisht ushtron funksionin edhe të kryetarit të tij. Ky i fundit ka ndërmarrë masa organizative dhe administrative që lidhen si me bërjen funksionale të Komisionit ashtu dhe me garantimin e trajtimit të kërkesave të klasifikuara për mbrojtje. Aktualisht komisioni ka zhvilluar rreth 9 mbledhje dhe ka marrë masa mbrojtëse bazuar në kërkesat e disa gjyqtarëve.

1.4 BASHKËPUNIMI I BRENDSHËM DHE I JASHTËM

Këshilli i Lartë Gjyqësor, që në krijimin e tij ka qenë i orientuar drejt një politike të hapur bashkëpunimi institucionalo-ligjor. Krahas zhvillimit të proceseve konstituese, dhe veprimtarive që rrjedhin nga zbatimi i kuadrit ligjor në fuqi, Këshilli, gjatë vitit 2019, ka marrë pjesë dhe zhvilluar mbi 30 aktivitete bashkëpunuese brenda dhe jashtë vendit.

I vetëdijshëm se puna e tij nuk mund të kufizohet vetëm në përmbushjen e detyrimeve ligjore e institucionale, KLGJ-ja është investuar në një bashkëpunim vullnetar si me përfaqësues të shoqërisë civile ashtu dhe donatorë e partnerë ndërkombëtarë që veprojnë në fushën e drejtësisë.

Krijimi i urave të bashkëpunimit me qëllim zbatimin e standardeve të pavarësisë, paanësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit dhe shkëmbimi i praktikave më të mira në këtë drejtim ka qenë gjithashtu në fokus të veprimtarisë së institucionit të KLGJ-së.

Gjithashtu dhe në respekt të plotë të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, KLGJ-ja ka zhvilluar një gamë të gjerë aktiviteteve në të cilat përfshihen takime koordinuese, bashkërenduese dhe bashkëpunuese me institucione të ekzekutivit dhe legjislativit me qëllim sigurimin e mbarëvajtjes së sistemit gjyqësor.

Aktivitetet me institucionet vendase, ato ndërkombëtare apo shoqërinë civile, etj., janë zhvilluar në kuadër të fuqizimit të rolit të KLGJ-së, si institucion i pavarur qeverisës i gjyqësorit. Vlen të theksohet se në kuadër të transparencës dhe qasjes pro aktive të Këshillit ndaj publikut, çdo aktivitet i tij është pasqyruar në faqen e internetit: www.klgj.al.

1.4.1 BASHKËPUNIMI I BRENDSHËM

INSTITUCIONET SHTETËRORE

Sikurse është përmendur edhe më sipër Këshilli i Lartë Gjyqësor, u krijua nga reforma në drejtësi si një organ i pavarur i qeverisjes së gjyqësorit, në përputhje të plotë me doktrinën kushtetuese të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Në këtë frymë, ndonëse të ndarë, 3 pushtetet bashkëpunojnë me qëllim arritjen e objektivave të përbashkëta ato të qeverisjes së mirë. Këshilli i Lartë Gjyqësor në këtë trekëndësh interesash kombëtarë ka për mision *ndërtimin, udhëheqjen dhe qeverisjen e një sistemi gjyqësor me performancë të lartë, që meriton besimin e*

*publikut*⁴⁷. Në përmbushje të këtij misioni, Këshilli, gjatë vitit 2019, ka ndjekur një qasje sa institucionale, të diktuar nga ligji, aq dhe proaktive, duke bashkëpunuar ngushtësisht me aktorë të tjerë të rëndësishëm që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e drejtësisë. Bashkëpunimi me institucionet e ndryshme shtetërore vlerësohet si tepër frytdhënës dhe kjo veçanërisht në dy fusha kryesore, përkatësisht *në fushën e drejtësisë dhe atë të integritimit evropian*.

Në lidhje me fushën e drejtësisë bashkëpunimi ndërinstitutional është drejtuar nga detyrimet kushtetuese ligjore të cilat parashikojnë ndërveprim ose detyruet (ligji parashikon bashkëpunim për nxjerrje aktesh të përbashkëta) ose konsultativ (sugjerohet konsultimi me qëllim marrjen e një vendimmarrjeje apo nxjerrjen e praktikave të unifikuara). Për sa i përket formave të bashkëpunimit ato kanë pasur qëllime *informative dhe raportuese, për përmirësimin e kuadrit ligjor në fuqi, për hartimin dhe miratimin e akteve ligjore apo nënligjore të lidhura me sistemin e drejtësisë, për ushtrimin e iniciativave ligjore si dhe kryerjen e proceseve verifikuese të kandidatëve për magistratë apo për anëtarë të Gjykatës së Lartë, etj.*

Shumëllojshmëria e institucioneve me të cilat ka ndërvepruar dhe bashkëpunuar Këshilli brenda një viti, të tilla si Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Shërbimet e ndryshme Informative, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Shkolla e Magjistraturës, Ministria Për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Organet e Vettingut, etj., tregon jo vetëm për rëndësinë e institucionit por edhe për shumëllojshmërinë e problematikave që ka trajtuar dhe zgjidhur KLGJ-ja gjatë vitit 2019.

Bashkëpunimi me Kuvendin. Këshilli gjatë veprimtarisë së tij ka intensifikuar bashkëpunimin edhe me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, i cili ka konsistuar në katër drejtime kryesore lidhur me:

- raportimin vjetor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor;
- raportimin mbi zbatimin e ligjit nr. 115/2016;
- përmirësimin e legjislacionit në fushën e drejtësisë;
- si dhe zbatimin e detyrimeve që derivojnë nga procesi i Integritimit Evropian.

Përkatësisht me vendimin nr.69, datë 03.05.2019, KLGJ-ja miratoi Raportin Vjetor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2018. Ky raport i cili ofroi një analizë cilësore dhe sasiore të sistemit gjyqësor gjatë periudhës kur autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen, administrimin dhe mbarëvajtjen e gjykatave (pa përfshirë Gjykatën e Lartë) ka

⁴⁷ Plani Strategjik i KLGJ-së për vitin 2019-2020

qenë ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD-ja) si dhe periudhën e veprimtarisë pas ngritjes së KLGJ-së, u prezantua para Kuvendit në 10 korrik 2019.



Gjithashtu, në kuadrin e raportimeve pranë organeve të Kuvendit në datë 1 nëntor 2019 Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” zhvilloi një seancë dëgjimore publike me Kryetaren e Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi masat e marra, arritjet dhe sfidat në zbatimin e këtij ligji në praktikë.

Në vazhdim të bashkëpunimit me Kuvendin, KLGJ-ja ka informuar në 10 prill 2019 lidhur me përmbushjen e detyrimeve në fushën e sistemit të drejtësisë në kuadër të procesit të Integritimit Evropian pranë Këshillit Kombëtar të Integritimit Evropian.

Bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë. Përkatësisht, KLGJ-ja, bazuar në kërkesën e Ministrisë, ka hartuar 9 *opinione* mbi projektvendime apo projektligje të ndryshme të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë në sistemin gjyqësor. Këtu mund të theksohen disa nga opinionet më të rëndësishme që KLGJ-ja ka dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë, ato në lidhje me:

- Propozimin mbi llojin dhe masën e tarifave gjyqësore;
- Projektvendimin “Për ngritjen e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit”;
- Projekt-udhëzimin e përbashkët “Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre”. Pjesë e këtij bashkëpunimi ishte dhe organizimi i tryezës së rumbullakët konsultative me temë: “Përmirësimi i bazës së të dhënave për çështjet e dhunës në familje-mjet për parandalimin

dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës”. Ky aktivitet u organizua nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, me mbështetjen teknike të UNDP-së në kuadër të zbatimit të projektit “T’i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri” 2019-2021, financuar nga Qeveria e Suedisë në datë 01.10.2019.



Gjithashtu, dhe duke qenë se KLGJ-ja nuk disponon tagrin e ushtrimit të iniciativës ligjore, me qëllim adresimin e disa problematikave të lindura gjatë zbatimit të reformës në drejtësi, kryesisht në lidhje me zbatimin e Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në dhjetor të vitit 2019, i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë për të ushtruar këtë prerogativë të saj. Ministrisë i është kërkuar ndërhyrje në zbatimin e Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për sa i takon:

1. Adresimit të problematikave në lidhje me plotësimin e pozicioneve të lira në gjykatat e apelit, ato me juridiksion të përgjithshëm dhe ato me juridiksion të posaçëm veçanërisht duke marr në konsideratë vështirësitë, si
 - (i) në ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të ngritjes në detyrë për shkak të kushtëzimit për kalimin me sukses të rivlerësimit kalimtar dhe konfirmimin në detyrë të gjyqtarëve apo dhe të kushtëzimit me pasjen e dy vlerësimeve etik-profesionale të gjyqtarëve,
 - (ii) me procedurat për lëvizjen paralele, të cila kërkojnë ndjekjen e tre fazave (a) hapjen e pozicione për ata gjyqtarë që kanë dy vlerësime etike dhe profesionale, dhe në rast mungese kandidatësh nga kjo kategori (b), hapjen e pozicioneve për ata gjyqtarë që kanë vetëm një vlerësim etik profesional, dhe në rast mungese kandidatësh nga kjo kategori (c) hapjen e pozicioneve për ata gjyqtarë që nuk kanë asnjë vlerësim etik profesional. Kryerja e këtij procesi do t’i merrte një kohë të gjatë KLGJ-së, ndërkohë që evidentohet një mungesë vlerësimesh etiko -profesionale për 10 vitet e fundit për pothuajse të

gjithë gjyqtarët e juridiksionit të apelit, gjë e cila e bën jo koherente marrjen në konsideratë të vlerësimeve të kryera në një kohë kaq të largët.

Për sa i përket lëvizjeve paralele në Gjykatën Administrative të Apelit, kriteri i përvojës 5 vite në çështje të së drejtës administrative gjatë 9 viteve të fundit, nuk gjen reflektim në kushtet kur gjykatat administrative janë krijuar vetëm para 6 viteve. Për pasojë plotësimi i kriterit të përvojës profesionale prej 5 vitesh sipas përcaktimeve ligjore është i pamundur të plotësohet nga gjyqtarët. Në rastin më të mirë, kjo përvojë duhet të jetë më pak se 3 vite.

2. Adresimi i plotësimit me gjyqtarë i Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ndalon si transferimin ashtu dhe lëvizjen paralele të gjyqtarëve në këto gjykata. Për rrjedhojë, plotësimi i pozicioneve të lira në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mund të realizohet vetëm përmes mekanizimit të ngritjes në detyrë, i cili me fillimin e funksionimit të këtyre gjykatave (më datë 19.12.2019) dhe mungesat e gjyqtarëve në të për shkak të shkarkimeve nga procesi i rivlerësimit kalimtar, paraqet prioritet të lartë. *për më shumë informacion lutemi lexoni seksionin 6.2 “Krijimi i gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, faqe 105)*
3. Adresimi i çështjes së pagës shtesë të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ku legjislacioni në fuqi nuk është i plotë dhe paraqet vështirësi në zbatim të tij. Ndërkohë që elementi “shtesë për vështirësi” bazuar në ligj, parashikon një pagesë shtesë, në kushtet kur ligji nuk e përcakton këtë masë ashtu dhe nuk ka parashikuar ndonjë autoritet i cili mund të bëjë një përcaktim të tillë, amendimi i legjislacionit është vlerësuar si një zgjidhje.

KLGG-ja ka bashkëpunuar me Ministrinë e Drejtësisë edhe për hartimin e miratimin e planit të tij strategjik duke organizuar, në datë 8 korrik 2019, tryezën e rrumbullakët për prezantimin dhe konsultimin e këtij dokumenti me titullaren e institucionit. Ky bashkëpunim ishte pjesë e detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 71, pika 5, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i cili përcakton shprehimisht bashkëpunimin e KLGJ-së me Ministrinë e Drejtësisë (MD) ...“për të siguruar përputhjen e planeve strategjike dhe buxhetore të sistemit gjyqësor me politikat shtetërore dhe SNSD-në”. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, me shkresën nr. 5343 prot., Ministrja e Drejtësisë përcolli disa sugjerime dhe komente mbi dokumentet e sipërpërmendura me qëllim bashkërendimin e masave dhe zbatimin efikas të reformës në drejtësi. Këto komente janë marrë në konsideratë nga KLGJ-ja dhe janë reflektuar plotësisht në Planin Strategjik të miratuar me vendim nr. 126, datë 19.7.2019.

Vlen të theksohet se bashkëpunimi me MD ka qenë i ndërsjelltë, dhe ai reflektohet edhe në raportimin periodik të KLGJ-së në lidhje me zbatimin e Strategjisë Ndërsëktoriale të Drejtësisë, Strategjisë Kundër Korrupsionit, dhe Strategjisë për të Miturit. Në këtë kuadër, KLGJ ka caktuar një prej anëtarëve të tij në rolin e koordinatorit për mekanizmin e monitorimit të realizimit të strategjive të lartpërmendura.



Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës. Një ndër bashkëpunëtorët e përhershëm të Këshillit, është dhe do të mbetet Shkolla e Magjistraturës në kuadër të përcaktimit të kuotave për kandidatët për formimin fillestar dhe të vazhdueshëm të profilit magjistrat, këshilltar dhe ndihmës ligjorë sikurse është analizuar më lart. Ai është në bashkëpunim të vazhdueshëm, edhe në kuadër të formimit fillestar dhe formimit vazhdues që kjo Shkollë ofron. Në këtë kontekst vlerësohet se bashkëpunimi ka ndikim të drejtpërdrejtë si në rritjen profesionale të gjyqtarëve ashtu dhe në dhënien e drejtësisë nga këta të fundit. Në këtë kuadër janë miratuar dy vendime lidhur me pjesëmarrjen e gjyqtarëve në Programin e Formimit Vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, për periudhën tetor 2019 – dhjetor 2019 (vendim nr. 246 date 04.11.2019), ashtu dhe për periudhën janar-mars 2020 (vendim nr. 59 date 30.01.2020).

Gjatë periudhës kohore 6 qershor – 26 korrik 2019, Shkolla e Magjistraturës ka bashkëpunuar me Këshillin e Lartë Gjyqësor, dhe me mbështetjen e Projektit “Drejtësi për të Gjithë” të USAID, ka zhvilluar programin trajnues për kancelarët në detyrë. Ky program u shtri në një periudhë kohore 8-javore dhe përmbante 9 (nëntë) module trajnimi. Ai u ofronte kancelarëve në detyrë njohuri teorike dhe praktike mbi parimet kryesore të administrimit gjyqësor, efektivitetin dhe risitë në fushën e menaxhimit gjyqësor, duke mbajtur në vëmendje rolin e veçantë të kancelarit në këtë proces. Trajnimi, synoi të përmirësojë dhe unifikojë proceset e

menaxhimit në gjykatat e vendit, duke promovuar një veprimtari efikase dhe transparente, si një nga synimet parësore të Këshillit të Lartë Gjyqësor.



Bashkëpunimi i Institucioneve të pavarura të Drejtësisë me Qeverinë. Në datë 22.07.2019, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të gjithë anëtarët e tij morën pjesë në ceremoninë organizuar me rastin e 3-vjetorit të miratimit të amendamenteve kushtetuese që çelën siparin e reformës në drejtësi. Gjatë këtij eventi u krye dhe inaugurimi i godinës së Polit të Drejtësisë i cili shënoi dhe momentin e kalimit të kësaj godine nga Këshilli i Ministrave në emër të institucioneve të KLGJ-së, KLP-së dhe Shkollës së Magjistraturës. Aktualisht implementimi i projektit të “Polit të Drejtësisë” pritet të përmirësojë ndjeshëm infrastrukturën e KLGJ-së (VKM nr. 234, datë 17.4.2019 “Për programin e integruar të zhvillimit “Poli i Drejtësisë””).



Bashkëpunimi me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe Shërbimet Informative Shtetërore.

Një ndër proceset më të rëndësishme të kryera nga Këshilli gjatë vitit 2019 është ai i verifikimit të pasurisë dhe figurës të kryer për (28) kandidatët që aplikuan për formim fillestar në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2019, (25) kandidatët magjistratë që përfunduan studimet në këtë shkollë gjatë vitit 2018-2019 si dhe (23) kandidatët që aplikuan për anëtarë në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur. Gjatë këtij viti, KLGJ-ja ka pasur një bashkëpunim të shkëlqyer si me ILDKPKI dhe me SHISH në ndërveprim me të cilët ka realizuar rreth 76 verifikime. Si institucioni i ILDKPKI ashtu dhe SHISH i është përgjigjur në kohë reale dhe brenda afateve ligjore Këshillit gjatë procesit të verifikimit dhe kontrollit të figurës dhe pasurive të subjekteve të sipërpërmendura dukë bërë të mundur përmbylljen me sukses dhe brenda vitit si të emërimeve të kandidatëve dhe fillimin e studimeve për studentët e rinj që aspirojnë të bëhen gjyqtarët e ardhshëm të vendit.

Bashkëpunimi me Gjykatat. Me qëllim krijimin e një kulture inovacioni dhe forcimin e kapaciteteve në këtë drejtim, KLGJ-ja në bashkëpunim me Projektin “Drejtësi për të Gjithë” - USAID ka zhvilluar takime periodike me kryetarët e gjykatave nëpër rretheve. Takime të tilla janë zhvilluar në Durrës (janar 2019) Shkodër (mars 2019), Gjirokastrë e Berat (maj 2019), Vlorë (qershor 2019), Tiranë (shtator dhe dhjetor 2019), Sarandë (tetor 2019), Krujë (nëntor 2019), Pogradec (shkurt 2020). Ato kanë synuar njohjen nga afër të problematikave të gjykatave në rang vendi duke evidentuar si problemet sistemike, që i kanë të gjitha gjykatat, dhe ato individuale që janë specifike për gjykata të posaçme apo për zona e rajone të caktuara, me qëllim adresimin dhe zgjidhjen e tyre.

Nuk mund të lihet pa përmendur bashkëpunimi i ngushtë i KLGJ-së me *organet e rivlerësimit kalimtar të magjistratëve*, bashkëpunim ky i cili është analizuar në mënyrë të hollësishme gjatë analizës së procesit të Vettingut.

ORGANIZATAT JO-FITIMPRURËSE

Që në gjenezën e tij, Këshilli i Lartë Gjyqësor është ideuar si një institucion i pavarur me përbërje heterogjene (anëtarë gjyqtarë dhe jogjyqtarë) duke synuar në të njëjtën kohë garantimin e pavarësisë së sistemit gjyqësor por dhe duke shmangur praktikat klienteliste, korruptive dhe komprometuese që cenojnë profesionalizmin, transparencën dhe cilësinë e vendimmarrjes së tij. Përbërja e Këshillit me anëtarë jogjyqtarë, që përfaqësojnë aktorë të ndryshëm të sistemit të drejtësisë, synon gjithashtu pasqyrimin e pikëpamjeve të ndryshme të shoqërisë brenda në Këshill, duke i siguruar gjyqësorit një burim shtesë legjitimiteti. Vlen të theksohet se dhe shoqëria civile tashmë ka një zë në Këshillin e Lartë Gjyqësor duke u përfaqësuar me një anëtare të zgjedhur nga radhët e saj. Ky fakt ka bërë që dhe vetë Këshilli dhe veprimtaria e tij gjatë vitit 2019, pavarësisht ngarkesave dhe përgjegjësisive ligjore për t’u përmbushur, të këtë në fokus të veçantë bashkëpunimin me grupet e interesit dhe shoqërinë civile.

Ndaj, gjatë vitit 2019, Kryetarja dhe përfaqësues të Këshillit kanë zhvilluar shumë aktivitete me shoqërinë civile, ku ndër më të rëndësishmet do të veçonim:

- Tryezën e rumbullakët "Mbi gjetjet e raportit të monitorimit, mbi krijimin e funksionimin e organeve të reja të qeverisjes së drejtësisë" e organizuar në datën 25 prill 2019, në kuadrin e projektit të financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara dhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit.
- Tryezën e rumbullakët të dedikuar "Monitorimit të Integritetit Gjyqësor", të organizuar më 24 maj 2019, nga Instituti për Studime Publike e Ligjore në bashkëpunim me organizatat Save the Children dhe Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara, në kuadrin e një projekti të financuar nga Bashkimi Evropian.
- Aktivitetin përmbyllës të projektit "Rritja e aksesit të qytetarëve në drejtësi përmes edukimit ligjor të publikut" të organizuar, më 14 qershor 2019, nga Qendra ALTRI në bashkëpunim me disa nga organizatat anëtare të Koalicionit "Drejtësi për të gjithë",
- Takimin e punës me zyrtarë të Institucioneve të Drejtësisë dhe ekspert të Fushës, ku u diskutuan aspekte të legjislacionit që rregullojnë aksesimin nga publiku në informacion dhe dokumente që lidhen me Sistemin e Drejtësisë si dhe Individëve që Emërohen dhe Promovohen, organizuar në 4 tetor 2019, nga Organizata Instituti Shqiptar i Shkencave, në zbatim të Projektit "Akses Info Drejtësi e Reformuar".
- Takimin informues me partnerë dhe aktorë që luajnë një rol të rëndësishëm në fuqizimin e Sistemit të Ndihmës Juridike në Shqipëri, për prezantimin e objektivave dhe disa nga rezultatet e pritshme të projektit me titull: "Akses në Drejtësi për të Gjithë", organizua më 8 tetor 2019 nga organizata Tirana Legal Aid Society.
- Panairin "Shoqëria Civile për Drejtësinë" i organizuar, në datën 25 tetor 2019, në kuadër të përfundimit të projektit "Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri", i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.



Vlen të theksohet se KLGJ-ja ka bashkëpunuar me shoqërinë civile jo vetëm duke ftuar organizatat jo-fitimprurëse që të marrin pjesë në evente të organizuara prej tij siç ishte takimi konsultativ i Planit Strategjik të KLGJ-së, i sipërpërmendur, me pjesëmarrje të 15 organizatave të shoqërisë civile që punojnë në fushën e drejtësisë, por gjithashtu ka komunikuar me to dhe për dhënien e mendimeve gjatë hartimit të akteve, mendimeve apo propozimeve ligjore që prekin fushëveprimin e aktiviteteve të tyre si p.sh. Projekt-propozimin për tarifën gjyqësore etj. KLGJ-ja mbetet e dedikuar që të bashkëpunojë dhe forcojë dhe më tej bashkëpunimin dhe komunikimin me grupet e interesit dhe shoqërinë civile dhe po planifikon aktivitete të tjera në këtë drejtim gjatë vitit 2020.

1.4.2 BASHKËPUNIMI I JASHTËM

As reforma në drejtësi dhe as Këshilli Lartë Gjyqësor nuk do të ishin një realitet sot nëse nuk do të kishte qenë mbështetja e madhe dhe insistimi i komunitetit ndërkombëtar të përfaqësuar nga Bashkimi Evropian dhe SHBA. Në muajt e parë të krijimit Kryetarja e KLGJ-së u takua me Ambasadorët më të rëndësishëm të vendit si me Sh.T.Z. Luigi Soreca më të cilin takime periodike janë kryer gjatë gjithë vitit 2019 me qëllim për të folur për ecurinë e reformës në drejtësi si dhe rëndësinë e progresit në këtë fushë si një parakusht për integrimin evropian.



Në këtë kontekst, institucioni i KLGJ-së që në hapat e tij të parë ka qënë, në mënyrë të vazhdueshme, i mbështetur nga projekte të asistencës teknike të këtyre vendeve partnere. Që nga momenti i krijimit dhe gjatë gjithë vitit 2019, KLGJ-ja ka punuar dhe është konsultuar ngushtësisht, duke përfituar nga ekspertiza e vyer, me projektet “Drejtësi për të gjithë” - USAID, Misionin EURALIUS V si dhe Projektin e Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë, të Këshillit të Evropës. Gjithashtu ai ka qënë mbështetur dhe nga projekte dhe organizata të tjera si OPDAT, OSBE (Drejtësi pa Vonesa) etj.

Në arenën ndërkombëtare, KLGJ-ja, ka bashkëpunuar me organizata të ndryshme duke synuar jo vetëm njohjen dhe anëtarësimin në to por dhe ndjekjen e vazhdueshme të aktiviteteve periodike të organizuara prej tyre.

Kështu gjatë vitit 2019, Këshilli ka aplikuar duke fituar statusin e “Vendit Vëzhgues” pranë Rrjetit të Këshillave Gjyqësorë Evropian (ENJT) në 6 qershor 2020.

Përfaqësues të KLGJ kanë marrë pjesë aktive në aktivitetet e organizuara nga Komiteti Evropian i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ), Rrjetit të Këshillave Gjyqësorë Evropian (ENCJ), Rrjeti Evropian i Trajnimeve Gjyqësore (ENJT) dhe Shoqata Ndërkombëtare për Administrimin Gjyqësor (IACA), duke u njohur kështu me praktikat më të mira të këtyre organizatave si për çështje të cilësisë dhe efikasitetit të dhënies së drejtësisë (CEPEJ) dhe standardet dhe praktikat më të mira në lidhje me pavarësinë e sistemit gjyqësor (ENCJ) apo trajnimet bashkëkohore për magjistratët e profilit “gjyqtar” (ENJT).

Disa nga aktivitetet më të rëndësishme të organizuara brenda dhe jashtë vendit janë:

Simpoziumi i organizuar në kuadër të bashkëpunimit të KLGJ-së me Komisionin e Këshillit të Evropës për Eficiencën në Drejtësi (CEPEJ), në Tiranë, më datë 25.09.2019. Në takim moderuar nga znj. Naureda Llagami dhe Presidenti i CEPEJ, z. Ramin Gurbanov, u diskutua mbi forcimin e bashkëpunimit, si një garanci për rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë në Shqipëri.



Tryeza e rumbullakët e organizuar nga Ndihmës Administratori i USAID, Z. Brock Bierman në datë 3 maj 2019, në Tiranë me disa anëtarë të KLGJ-së. Ndërkohë që Kryetarja dhe anëtarët e KLGJ-së folën për reformën në drejtësi si dhe veprimtarinë e Këshillit në muajt e parë të krijimit z. Bierman ofroi mbështetjen e tij për këtë institucion për të çuar përpara reformën në drejtësi.



Takimi i parë koordinues i nivelit të lartë me donatorë dhe partnerë ndërkombëtarë, i mbajtur në Tiranë më 30 tetor 2020, me qëllim prezantimin dhe konsultimin e Planit Strategjik të KLGJ-së, i cili përcakton prioritetet dhe objektivat e punës së Këshillit për vitet 2019-2020. Në këtë takim Këshilli kërkoi mbështetjen e partnerëve dhe organizatave ndërkombëtare që veprojnë në fushën e drejtësisë dhe sundimit të ligjit, për 3 nga prioritetet kryesore që ka sot drejtësia shqiptare, ato që lidhen me nevojat për: (i) vendosjen e standardeve cilësore të shërbimeve në gjykata, (ii) sisteme moderne të administrimit të çështjeve dhe (iii) rritjen e aksesit të qytetarëve në drejtësi.

Ky takim ishte një mënyrë e mirë jo vetëm për të kanalizuar asistencën e donatorëve në aspektet më prioritare të KLGJ-së por edhe një mundësi për të prodhuar sinergji midis aktorëve të ndryshëm.



Konferenca e Organizatës Ndërkombëtare për Administrimin Gjyqësor, e organizuar në datat 16-18 shtator 2019 në Nur-Sultan, të Kazakistanit, ku kryetarja e KLGJ-së u ftua si folëse në panelin e dedikuar: “Mundësive dhe Sfidave të Gjykatave në Botë”. Znj. Llagami ndau me pjesëmarrësit përpjekjet dhe sfidat e institucioneve shqiptare, veçanërisht KLGJ-së, në lidhje me zbatimin dhe arritjet e deritanishme të reformës në drejtësi.



Konferenca Rajonale e Këshillit të Lartë Gjyqësor e organizuar më 11 nëntor 2019, në Bashkëpunim me OSBE me të ftuar nga të gjitha (6) Këshillat Gjyqësor të rajonit në lidhje me çështjen e “Administrimit të Gjykatave dhe Menaxhimit të Çështjeve”.



Seminari i organizuar, nga Misioni EURALIUS V në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, në datë 4 mars 2019, në lidhje me hartimin e akteve nënligjore të KLGJ-së dhe KLP-së, gjatë të cilit u diskutuan aktet nënligjore në axhendën e KLGJ-së për zbatim të legjislacionit në fuqi.



Tryeza e rumbullakët, e organizuar më 4 nëntor 2019, nga Misioni EURALIUS V së bashku me Këshillin e Lartë Gjyqësor, me pjesëmarrjen e gjyqtarëve nga të gjitha gjykatat e vendit me qëllim diskutimin e paketës nënligjore të akteve plotësuese të hartuar nga KVEP në lidhje me skemën e vlerësimit etik-profesional të gjyqtarëve.



Vlen të theksohet se përveç takimeve dhe aktiviteteve të ndryshme, KLGJ-ja ka nënshkruar disa Memorandume Bashkëpunimi me organizata të ndryshme ku më të rëndësishmet mund të përmenden me Qendrën e Berlinit për Ndërmjetësim Integrativ, me Administratën Kombëtare të Gjykatave Suedeze, Fondacionin Konrad Adenauer, etj.

Mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë dhe takimet si bi dhe multi-laterale me përfaqësues të Këshillave të Lartë Gjyqësor Evropian dhe Ballkanik përgjatë vitit 2019 nuk kanë munguar. Për vitin 2020, KLGJ-ja angazhohet që të forcojë dhe intensifikojë me tej këtë bashkëpunimin duke përfituar nga eksperiencat e tyre. Duke qenë një organ i krijuar rishtazi, shkëmbimi i informacioneve, eksperiencave dhe praktikave më të mira në funksion të mirëqeverisje së sistemit gjyqësor, është një aset i shtuar në kuadër të rritjes së kapaciteteve të vetë institucionit por edhe miradministrimit të gjykatave.

2. TRANSPARENCA

Këshilli si organ i ri qeverisës i gjyqësorit, i ka kushtuar dhe i kushton një rëndësi shumë të madhe si transparencës në vendimmarrje ashtu dhe ofrimit të shpejtë dhe të saktë të informacionit për publikun dhe kjo e mundësuar përmes platformave të ndryshme të komunikimit.

Transparenca si parakusht për vendimmarrje të drejtë. Transparenca ka qenë një parakusht dhe ka shoqëruar të gjitha proceset vendimmarrëse të KLGJ-së si në rekrutim, përzgjedhje, emërim dhe promovim të gjyqtarëve ashtu dhe ato që kanë të bëjnë me sistemin në tërësi apo me shpërndarjen e burimeve njerëzore dhe financiare në KLGJ e në gjykatat e vendit.

Vlen të theksohet se përpara hapjes së vendeve vakante në Gjykatën e Lartë apo edhe në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, KLGJ ka miratuar rregulla të detajuara duke përcaktuar në mënyrë të qartë dhe pa ekuivoqe kritere dhe procedura transparente për kandidatët aplikantë dhe kjo me qëllim që procesi të mos cenohet dhe paragjykohet qoftë nga gjyqtarët ashtu dhe nga publiku i gjerë. Kjo ka mundësuar që vendimmarrja e KLGJ-së të konsiderohet e drejtë në sytë e gjyqtarëve si dhe të rritet besimi i publikut në institucionin e KLGJ-së.

Organizimi i mbledhjeve të hapura plenare. Në këtë kuadër, Këshilli ka organizuar të gjithë mbledhjet e tij plenare në mënyrë të hapur dhe në prezencë të mediave, shoqërisë civile dhe organizatave të ndryshme monitoruese. Këto grupe interesi janë ftuar të ndjekin debatet dhe vendimmarrjet e KLGJ-së me qëllim krijimin e një panorame të qartë dhe reale mbi gjendjen e sistemit gjyqësor, arritjet dhe sfidat e këtij të fundit si në nivelin e organeve qeverisëse të sistemit (KLGJ) e gjykatave (Këshillave të gjykatave) ashtu dhe në nivel individual, atë të vetë gjyqtarëve. Vlen të përmendet prezenca e përhershme e përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë, Misionit EURALIUS V, USAID, OSBE, Këshillit të Evropës, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Institutit të Studimeve Politike etj. në mbledhjet dhe aktivitetet publike të Këshillit.

Vendimmarrje të drejta e pa konflikt interesi dhe integriteti pasuror i zyrtarëve të KLGJ-së. KLGJ-ja është pjesë e institucioneve shtetërore dhe si i tillë mbart detyrimin për zbatimin e legjislacionit për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë (...) dhe parandalimin e konfliktit të interesit (...). Gjatë vitit 2019, Departamenti i Burimeve Njerëzore që funksionon si Autoritet Përgjegjës në KLGJ për deklarimin e pasurive dhe parandalimin e konfliktit të interesave ka vazhduar të ndjekë zbatimin e akteve ligjore që rregullojnë parandalimin e konfliktit të interesit në institucion si dhe ka mbyllur në kohë procedurat për

deklarimin e pasurisë nga subjektet që mbartin detyrimin për deklarim, sipas funksioneve që ata kryejnë.

Është përgatitur dhe dërguar në kohë pranë ILDKPKI-së Raporti Vjetor i Autoritetit Përgjegjës (AP) për veprimtarinë e kryer në këtë fushë gjatë vitit 2019 dhe vazhdojnë komunikimet institucionale në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në fund të muajt mars 2019 janë mbledhur të gjitha deklaratat fillestare dhe periodike të pasurisë dhe janë bërë rakordimet për 415 subjektet përkatëse me ILDKPKI-në duke i përmbyllur ato me sukses.

Gjatë vitit 2019 është punuar për hartimin e Rregullores së re për parandalimin e konfliktit të interesave e cila është miratuar në KLGJ në mars 2020. Ndërkohë që deri më sot nuk evidentohet asnjë vendimarrje në kushtet e konfliktit të interesave apo asnjë rast i regjistruar në regjistrin e krijuar në vitin 2019 për këtë çështje.

Faqe e re interneti që mundëson akses informacioni në kohë reale. Gjithashtu, përgjatë gjithë vitit 2019, KLGJ-ja në bashkëpunim të ngushtë me Projektin “Drejtësi për të gjithë” - USAID, ka punuar për të dizenuar dhe bërë aktive *faqen e re të internetit*: www.klgj.al. Kjo faqe e re përveç se përmbush detyrimet e përcaktuara në Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, synon vendosjen e marrëdhënieve proaktive, transparente e informuese me publikun dhe median. Ajo krahas informacioneve mbi rolin, funksionet, kompetencat dhe strukturën organizative të Këshillit jep informacion pothuajse në kohë reale të veprimtarisë dhe vendimarrjes së KLGJ-së nëpërmjet rubrikave dedikuar vendimeve, aktiviteteve dhe njoftimeve për shtyp.

Përmes faqes së re të internetit është mundësuar *publikimi online i regjistrimeve audio të mbledhjeve të Këshillit*, gjë e cila për arsye teknike nuk ishte e mundur në faqen e mëparshme, duke rritur kështu transparencën mbi vendimarrjet e Këshillit. Faqja aktuale është një zgjidhje e përkohshme, pasi KLGJ-ja po punon me partnerët ndërkombëtarë për zhvillimin e një Portali gjyqësor, i cili do të sigurojë standarde bashkëkohore dhe do të shërbejë për një akses të menjëhershëm në veprimtarinë, sfidat dhe rezultatet e Këshillit dhe gjykatave në të gjithë vendin.

Miratim i Programit Institucional të Transparencës. Gjithashtu dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është miratuar me Urdhrin nr. 19 të Sekretarit të Përgjithshëm, datë 09.04.2019 *Programi i Transparencës për Këshillin e Lartë Gjyqësor*. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së KLGJ-së për sa i përket informacionit publik të aksesueshëm me ose pa kërkesë. Programi i transparencës është një mënyrë konkrete, nëpërmjet të cilës Këshilli ndërton dhe rrit transparencën mbi veprimtarinë e tij institucionale, nën garancinë e ligjit për të drejtën e informimit.

Caktimi i Koordinatorit për të drejtën e informimit. Krahas miratimit të këtij programi, KLGJ-ja ka caktuar dhe Koordinatorin e të Drejtës së Informimit, i cili mban marrëdhënie të vazhdueshme me mediat dhe publikun lidhur me kërkesat e tyre për informacion. Gjithashtu, përmes publikimit të njoftimeve për shtyp, KLGJ-ja synon jo vetëm të vendosë raporte transparente komunikimi me mediat por njëkohësisht të ndërmarrë një rol proaktiv në kuadër të përmirësimit të treguesve të besueshmërisë së publikut. Gjatë këtij viti KLGJ-ja ka publikuar rreth 72 njoftime për shtyp, ndër të cilat 46 sqarojnë publikun për vendimmarrje të rëndësishme të KLGJ-së si dhe 26 të tjera mbi aktivitete dhe veprimtari të tjera të Këshillit.

Trajtimi në kohë i kërkesave për informacion. Gjatë vitit 2019, KLGJ-ja ka trajtuar 68 kërkesa për informacion të ardhura si përmes postës elektronike ashtu edhe në rrugë zyrtare duke u ka kthyer përgjigje, brenda një afati të arsyeshëm, të gjithë kërkuesve të informacionit. Në asnjë nga rastet e trajtuara të kërkesave për informacion, nuk është konstatuar ankim tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale lidhur me refuzimin e informacionit apo kalimin e afateve ligjore të parashikuara për dhënien e informacionit.

Caktimi i Anëtarit të KLGJ-së për marrëdhëniet me publikun. Me qëllim rritjen e komunikimit publik dhe transparencës, vlen të përmendet që KLGJ-ja me Vendimin nr. 68, datë 24.04.2019 “Për caktimin e anëtarit për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun” ka caktuar që një nga anëtarët e tij të mbajë marrëdhëniet me publikun dhe median, duke garantuar kështu një kanal të drejtpërdrejtë të përcjelljes së informacionit zyrtar me qëllim garantimin dhe rritjen e transparencës mbi vendimmarrjen e vetë KLGJ-së.

Hartimi i Strategjisë së KLGJ-së për komunikimin me publikun. Pas miratimit të Planit Strategjik të KLGJ-së, në muajin shtator të vitit 2019, anëtari i KLGJ-së për marrëdhëniet me publikun, i mbështetur dhe nga ekspertët e Projektit “Drejtësi për të gjithë” - USAID, filloi punën për hartimin e një dokumenti strategjik për komunikimin me publikun. Ky dokument është përfunduar dhe aktualisht (gjatë vitit 2020) po konsultohet në mjedise të ndryshme, përfshi këtu dhe përfaqësues të medias së shkruar dhe asaj audio-vizive, para së të miratohet me vendim KLGJ-je. KLGJ-ja nëpërmjet këtij dokumenti, synon të sigurojë marrëdhënie transparente dhe proaktive me mediat dhe publikun e gjerë, me qëllim që këta të fundit të jenë plotësisht të informuar për zhvillimet në sistemin gjyqësor në një kohë sa më të arsyeshme.

Caktimi i gjyqtarëve për median nëpër Gjykata. Me qëllim rritjen e transparencës së punës së sistemit gjyqësor dhe përmirësimin e nivelit të besimit

të publikut, KLGJ-ja ka miratuar, gjithashtu, caktimin e gjyqtarëve për median në secilën gjykatë të juridiksionit të apelit⁴⁸.

Problematika: Me gjithë masat e ndërmarra nga KLGJ-ja për rritjen e transparencës së vendimmarrjes së tij, publikimi në kohë i vendimeve të gjykatave në faqen e tyre të internetit mbetet ende një sfidë për sistemin gjyqësor. Aksesimi online i vendimeve gjyqësore lë ende për të dëshiruar për shkak të kohëzgjatjes që merr procesi i anonimizimit të vendimeve me qëllim respektimin e së drejtës së privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale. *Publikimi i menjëhershëm apo për një kohë të shkurtër i vendimeve gjyqësore* do të mund të mundësohet vetëm kur portali i ri gjyqësor dhe një sistem i ri i menaxhimit të çështjeve të jetë funksional dhe të mundësojë këtë funksionalitet në mënyrë elektronike. Për rrjedhojë krijimi i Portalit të ri Gjyqësor është një nga prioritetet dhe rekomandimet e nevojshme për zbatim. *(për më shumë informacion lutemi lexoni kapitullin 5. “Sistemet e menaxhimit të çështjeve gjyqësore” faqe 97)*

⁴⁸Vendimi Nr.280 datë 10.12.2019

3. RIVLERËSIMI KALIMTAR I GJYQTARËVE & MASAT

E MARRA NGA KLGJ-JA PËR GARANTIMIN E MBARËVAJTJES SË SISTEMIT GJYQËSOR

Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Kuadër të Procesit të Rivlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve u krijua me vendimin nr. 15, datë 22.01.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe përbëhet nga pesë anëtarë, tre nga të cilët janë anëtarë gjyqtarë dhe 2 janë anëtarë jogjyqtarë, si më poshtë:

- z. Dritan Hallunaj (kryetar)⁴⁹
- z. Maksim Qoku (anëtar)
- z. Ilir Toska (anëtar)
- z. Medi Bici (anëtar)
- z. Erjon Muharremaj (anëtar)

Ngritja e këtij komisioni erdhi si nevojë imediate bazuar në përcaktimin e bërë në nenin 171 pika 2 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me anë të cilit parashikohet detyrimi i Këshillave për të mbështetur organet e rivlerësimit kalimtar në realizimin e vlerësimit të aftësive profesionale, duke ndjekur udhëzimet dhe kërkesat e këtyre organeve dhe duke pasur parasysh faktin se dhënia e ndihmës për këto organe ka përparësi.

Një ndër detyrat e Komisionit ishte dhe miratimi i rregullave dhe procedurave për funksionimin e tij. Për rrjedhojë, dhe me propozim të Komisionit, në mbledhjen e datës 07.02.2019, KLGJ-ja me vendimin nr. 24, datë 07.02.2019 miratoi rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve”. Hartimi dhe miratimi i rregullores ka për qëllim vendosjen e një praktike të unifikuar mbi “modus operandi” të Komisionit në lidhje me procesin ndihmës të hartimit të raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar për analizën e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit bazuar në nenet 43 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në hartimin dhe përpilimin e kësaj rregulloreje u mbajtën parasysh praktikat më të mira të zhvillimit të procesit dhe veprimtarisë

⁴⁹ Kryetari i këtij komisioni z. Dritan Hallunaj është zgjedhur bazuar në propozimin e Kryetares së KLGJ-së, i bërë konform pikës 6 të nenit 62 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ku në fjalinë e parë theksohet se komisionet zgjedhin kryetarët përkatës bazuar në propozimin e Kryetarit të Këshillit.

nga ana e dy institucioneve të rivlerësimit, përkatësisht Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK-së) dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (KPA-së), si dhe praktikës së zhvilluar më herët nga ana e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Në funksion të zhvillimit të veprimtarisë, KPVEP-ja gjatë periudhës 22.01.2019 deri 31.03.2020 ka zhvilluar rreth 140 mbledhje në të cilat janë mbajtur 140 procesverbale. Objekti i këtyre mbledhjeve ka qenë caktimi i nëpunësve përgjegjës për hartimin e raportit të aftësive profesionale, caktimi i relatorit përgjegjës (nga anëtarët e Komisionit) për kontrollimin në drejtim të saktësisë dhe standardizimit të raportit të aftësive profesionale, miratimi i raporteve si dhe diskutimi mbi çështje të tjera sipas nevojës.


Ashtu si dhe parashikohet në rregullore, Komisioni ka organizuar punën me qëllim përmbushjen e funksioneve, duke zhvilluar veprimtarinë e tij, si më poshtë:

- komunikim me KPK-në, përmes të cilit përcaktohen emrat e subjekteve që do i nënshtrohen procesit të rivlerësimit në vazhdim (sipas shortit të kryer nga ana e tyre pranë institucionit të KPK-së);
- nxjerrje të urdhrit për kalimin e dosjes së subjektit të rivlerësimit tek nëpunësi përgjegjës, për hartimin e projekt-raportit të analizimit të aftësive profesionale;
- kontroll statistikash dhe marrja e të gjitha masave për saktësinë e tyre para zhvillimit të shortit;
- njoftim të gjyqtarëve që i nënshtrohen shortit në lidhje me datën dhe orën e zhvillimit të tij;
- njoftim të kryetarëve të gjykatave respektive në lidhje me marrjen e masave të nevojshme organizative për të lehtësuar zhvillimin e shortit;
- kërkim të dosjeve të përzgjedhura më short dhe në vijim gjurmimi i tyre në gjykatat ku ato ndodhen;
- kontroll i raportit analitik të aftësive profesionale për sa i përket saktësisë dhe standardizimit të tij nga relatori (anëtar i Komisionit) dhe miratimi në mbledhje;
- inventarizim dhe dorëzim i raporteve së bashku me dokumentet përkatëse mbi bazën e të cilëve është hartuar ky raport pranë KPK-së.

Konstatohet se, duke iu referuar të dhënave në regjistrin e posaçëm të administruar në KLGJ, rezulton se në periudhën 21.10.2016 - 31.03.2017 janë depozituar formularët dhe dokumentacioni shoqërues për vlerësimin profesional nga 466 subjekte rivlerësimi. Nga analiza paraprake rezulton se këto subjekte janë:

- 374 gjyqtarë të shkallës së parë dhe të dytë;
- 16 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë;
- 19 ndihmës ligjorë të Gjykatës së Lartë;
- 7 anëtarë të Gjykatës Kushtetuese;
- 9 këshilltarë ligjorë të Gjykatës Kushtetuese;
- 10 inspektorë dhe Kryeinspektorja e Inspektoratit të ish-KLD-së;
- 2 gjyqtarë të komanduar në institucione të tjera;
- 27 ndihmës ligjorë të gjykatave administrative të shkallës së parë dhe të dytë;
- 2 ish-gjyqtarë.

Sa më lart, KPVEP-ja përgjatë periudhës 22.01.2019 deri 31.12.2019, ka organizuar punën për zhvillimin e 104⁵⁰ shorteve për përzgjedhjen e 5 dosjeve për 104 subjekte të rivlerësimit pranë gjykatave respektive. Pas organizimit të shorteve për përzgjedhjen e dosjeve, Komisioni ka organizuar punën për kërkimin e gjithsej 520 dosjeve gjyqësore/dokumente ligjore në gjykatat respektive ku administrohen këto akte, secila prej tyre në 2 kopje (një kopje për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK-në) dhe një kopje për Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM-në). Kjo fazë ka pasur disa vështirësi në rastet kur dosja gjyqësore ka lëvizur nga njëra gjykatë tek tjetra.



Në vijim të punës së tij, KPVEP-ja ka proceduar me depozitimin e raporteve dhe të dosjeve gjyqësore pranë KPK-së grupuar sipas institucioneve. Bazuar në këtë

⁵⁰Ndërkohë në total, deri më 30.03.2020 Komisioni ka zhvilluar **150** shorte për 150 subjekte të rivlerësimit, ku **104** shorte janë zhvilluar pranë gjykatave të shkallës së parë dhe **46** shorte pranë gjykatave të apeleve dhe ka kërkuar 750 dosje nga gjykatat respektive.

qasje janë depozituar pranë KPK-së (përgjatë periudhës 22.01.2019 deri 31.12.2019) gjithsej 99⁵¹ raporte të analizimit të aftësive profesionale, të shoqëruara me 495 dosje gjyqësore për 99 subjekte të rivlerësimit kalimtar.




Duhet theksuar se në përpilimin e raporteve është respektuar me rigorozitet vlerësimi në një kohë më të shpejtë të subjekteve prioritare të caktuara nga ligji, apo subjekteve të kërkuara nga KPK-ja, duke iu përgjigjur në kohë të gjitha kërkesave të këtij të fundit. Gjithashtu, Komisioni është asistuar në veprimtarinë e tij nga Njësia Mbështetëse për Rivlerësimin Kalimtar të gjyqtarëve si dhe nga stafi administrativ i Këshillit, dhe duke filluar nga muaji shtator i vitit 2019 është asistuar edhe nga këshilltarë ligjorë, pjesë e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve në KLGJ.

Në lidhje me kontrollin e raporteve nga ana e relatorëve/anëtarë të Komisionit, konstatohet se gjatë periudhës së raportimit janë kontrolluar në drejtim të standardizimit dhe saktësisë, raportet si më poshtë:

- nga z. Dritan Hallunaj 43 raporte;
- nga z. Maksim Qoku 33 raporte;
- nga z. Medi Bici 18 raporte;
- nga z. Erjon Muharremaj 15 raporte, dhe
- nga z. Ilir Toska 8 raporte.

⁵¹Ndërsa në total deri më 30.03.2020 janë dorëzuar 110 raporte të analizimit të aftësive profesionale të shoqëruara me 550 dosje, nga të cilat 50 raporte i përkasin subjekteve të rivlerësimit pranë gjykatave të shkallës së parë dhe 60 raporte subjekteve pranë gjykatave të apelit. Aktualisht janë miratuar nga Komisioni dhe janë gati për t'u dorëzuar një paketë tjetër prej 7 raportesh për 7 subjekte të rivlerësimit



Në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së tij në ndihmë të procesit të rivlerësimit, ky Komision, përmes kryetarit të tij, ka koordinuar punën dhe është shprehur edhe për:

- kërkesat për informacion⁵² dërguar nga KPK-ja në lidhje me subjektet e rivlerësimit, për sa i përket numrit të përgjithshëm të ankesave, dosjes personale, procedimeve disiplinore apo kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e këtyre subjekteve. Në lidhje me këtë të fundit, ky proces ka pasur vështirësitë e tij, pasi deri vonë vendimi në lidhje me pranimin ose jo të kërkesës për përjashtim gjyqtari në një çështje gjyqësore nga ana e palëve në gjykim ka qenë pjesë e dosjes së themelit. Për rrjedhojë gjurmimi i këtyre kërkesave dhe vendimeve përkatëse nga ana e Komisionit ka qenë tepër e vështirë;
- raportim për KPK-në dhe ONM-në, për gjyqtarët ndaj të cilëve është zhvilluar apo po zhvillohet procesi i rivlerësimit kalimtar. Ky raportim ka kërkuar si kohën e nevojshme dhe saktësinë më të lartë të mundshme, pasi mbi bazën e tij ka vijuar procesi i zhvillimit të shorteve dhe vijimi i praktikës. Prosesi ka pasur vështirësitë e veta, pasi gjatë periudhës së rivlerësimit, ka pasur gjyqtarë që kanë zhvilluar veprimtari gjyqësore në disa gjykata të ndryshme;
- kërkesat për informacion dërguar nga ONM-ja në lidhje me statusin e subjekteve të rivlerësimit, shortet e zhvilluara për ta, hartimin e raporteve të analizimit të aftësive profesionale apo dorëzimin e tyre pranë KPK-së;
- kërkesat e tipit “urgjent” dërguar nga KPK-ja në përgjigje të të cilave Komisioni ka kërkuar dosje apo informacione të një rëndësie të Posaçme për zhvillimin e hetimit administrativ të subjekteve të rivlerësimit, pranë

⁵² Në lidhje me këtë informacion janë përpunuar dhe kthyer përgjigje për rreth 74 shkresa/kërkesa për informacion

gjykatave të ndryshme të vendit. Në lidhje me këtë, koordinimi i punës nga ana e Komisionit me gjykatat në vend është zhvilluar me shpejtësi, përparësi dhe mund të vlerësohet si tepër efikas;

- dhënie mendimi apo interpretimi ligjor mbi çështje të zhvillimit të shortit apo përzgjedhjes së dosjeve, për subjekte të rivlerësimit me specifika⁵³ të veçanta, bazuar në kërkesat e KPK-së;
- relativitet dhe kthim përgjigje në lidhje me ankesat e shtetasve për subjektet e rivlerësimit, përcjellë nga KPK-ja;
- interpretim dhe kthim përgjigje në lidhje me kërkesat e vetë subjekteve të rivlerësimit për t'iu vënë në dispozicion raportet e analizimit të aftësive profesionale;
- informacione të tjera sipas kërkesës.

PROBLEMATIKAT DHE MASAT E NDËRMARRA NGA KLGJ-JA

Gjatë gjithë procesit të punës Komisioni ka ndjekur udhëzimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Gjithashtu me kërkesë të shprehur të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, i gjithë dokumentacioni që depozitohet pranë KPK-së i është përcjellë edhe ONM-së. Kopjet e raporteve përfundimtare janë përcjellë përveçse fizikisht edhe në rrugë elektronike pranë të dyja institucioneve. Në tërësi procesi ka qenë efikas dhe ka dhënë rezultate, ku po të kemi parasysh nga 466 subjekte të rivlerësimit që kanë paraqitur formularët e rivlerësimit, gjatë vitit të parë të zhvillimit të veprimtarisë së tij, Komisioni ka përpunuar/relatuar dhe dërguar pranë KPK-së 99 raporte të analizimit të aftësive profesionale, gjë që përbën pothuajse 1/5 e totalit të subjekteve⁵⁴. Ndërkohë në total, që nga fillimi i procesit të rivlerësimit janë dorëzuar pranë KPK-së 220 raporte të analizimit të aftësive profesionale dhe kjo përbën pothuajse 50% të të gjithë subjekteve që kanë paraqitur formularin e rivlerësimit pranë ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Konstatohet se procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve ka pasur impakt në gjykata, sidomos në gjykatat me një numër më të vogël gjyqtarësh, ku si pasojë e shkarkimit të 46 gjyqtarëve⁵⁵, janë krijuar vakanca⁵⁶ duke shkaktuar një situatë të pazakontë në sistemin gjyqësor.

⁵³ Të tillë si ato subjekte që nuk kanë ushtruar veprimtarinë gjatë periudhës së rivlerësimit apo kanë qenë të pezulluar.

⁵⁴ Po të marrim të mirëqenë faktin se për 466 subjektet e rivlerësimit do hartohen raporte. Kjo gjë do ishte në rastin ideal, pasi nga tërësia e këtyre subjekteve, ka një përqindje të konsiderueshme të atyre që kanë dhënë dorëheqjen apo kanë dalë në pension, pa u mbyllur procesi me hartimin e një raporti analize profesionale.

⁵⁵ Deri më datë 31.12.2019.

⁵⁶ Këto vakanca konsiderohen si fiktive, pasi deri në momentin e dhënies së vendimit përfundimtar nga KPA-ja, gjyqtarët janë pjesë e organikës së gjykatës dhe nuk mund të zëvendësohen.

Si e tillë, me qëllim adresimin e situatës së krijuar, KLGJ-ja ka aplikuar një qasje proaktive në funksion të mirë-menaxhimit dhe mbarëvajtjes së sistemit gjyqësor. Kështu, masat e marra nga KLGJ-ja në këtë drejtim janë:

- Emërimi dhe caktimit në detyrë i 25 magjistratëve të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018 dhe 2019;
- Caktimi i gjyqtarëve në një gjykatë të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet e në mënyrë të përhershme. Gjatë vitit 2019, Këshilli ka shqyrtuar në total 845 kërkesa për caktim gjyqtari në përgjigje të të cilave ka caktuar 1209 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.
- Skema e delegimit të gjyqtarëve. Ndonëse e miratuar në vitin 2019, kjo skemë u bë funksionale në fillim të vitit 2020⁵⁷ kur KLGJ-ja pranoi kërkesën dhe komandoi një gjyqtare në Skemën e Delegimit. Këshilli e caktoi gjyqtaren në fjalë për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë për periudhë pothuajse 7-mujore;
- Transferimi i gjyqtarëve. Aktualisht gjatë kësaj periudhe janë transferuar në total 12 magjistratë⁵⁸;
- Zgjedhja e zëvendëskryetarëve të gjykatave. Me anë të vendimit nr. 7, datë 21.12.2018, KLGJ-ja miratoi rregullat mbi zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave. Kjo i hapi rrugë procesit të zgjedhjes së tyre, që përfundoi plotësisht me zgjedhjen e 36 zëvendëskryetarëve nga 37 gjykatat në vend (për shkak të mungesës së numrit të mjaftueshëm të gjyqtarëve në njërin nga gjykatat e vendit ishte e pamundur zgjedhja e zëvendëskryetarit). Në kushtet kur si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar u shkarkuan 24 kryetarë gjykatash, zgjedhja e zëvendëskryetarëve ishte me rëndësi për realizimin e miradministrimit të gjykatave.

Duke mbajtur parasysh interesin që procesi i rivlerësimit të kryhet pa vonesa dhe duke monitoruar ecurinë e procesit koordinues midis gjykatave, deri më tani, evidentohet se:

1. Ka një mosrakordim nga ana e gjykatave në lidhje me vendndodhjen e dosjeve, gjë e cila sjell një punë voluminoze për të gjurmuar dosjen deri në marrjen e saj. Kjo mungesë informacioni ka sjellë rrjedhimisht vonesa në hartimin e raportit dhe dorëzimin pranë KPK-së. Rekomandohet një proces më i shpejtë në kthimin e përgjigjeve nga ana e gjykatave.
2. Aktet e nisura nga gjykatat në disa raste kanë pasur mangësi dhe kjo ka bërë që kërkesat të ripërsëriten dhe afati i dorëzimit të dokumentacionit të tej zgjatet. Rekomandohet saktësi më e lartë në kryerjen e procesit të

⁵⁷ Në mbledhjen e datës 20 shkurt 2020.

⁵⁸ Janë transferuar 12 gjyqtarë nga të cilët 5 me pëlqim.

gjetjes dhe fotokopjimit të materialeve nga ana e gjykatave ku kërkohen dosjet.

3. Nëpunësit përgjegjës për hartimin e raportit të analizimit të aftësive profesionale në disa raste kanë dhënë dorëheqjen, kanë dalë në pension apo janë transferuar në institucione të tjera brenda sistemit të drejtësisë, gjë e cila ka sjellë ricaktimin dhe rishpërndarjen e dosjeve që ata kanë pasur për të mbyllur me raport analizimi duke rritur dhe ngarkesën e punës. Kjo gjë ka sjellë një punë të shtuar për Komisionin si dhe vonesa në mbylljen e raporteve.
4. Pasaktësitë në nxjerrjen dhe hartimin e statistikave nga ana e gjykatave kanë sjellë shumë probleme në zhvillimet e shorteve. Kjo për faktin se statistikak mbahen dhe përpunohen në mënyrë manuale nga administrata gjyqësore pasi sistemi aktual i menaxhimit të çështjeve nuk prodhon statistika. Si pasojë e kësaj situatë ka pasur vonesa në dërgimin e statistikave në institucion dhe në disa raste ka qenë e vështirë rregullimi i tyre në kohë dhe përgatitja e biletave sipas statistikave të reja. Probleme të tilla, nëse nuk do ishin trajtuar në kohë rekord me efikasitet nga ana e Komisionit, do sillnin dështimin e shorteve. Rekomandohet një saktësi më e madhe në mbledhjen e hartimin e statistikave, si dhe sjellja brenda kohës së përcaktuar në shkresa.

Të rëndësishme!

- ❖ Miratimi i rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve”.
- ❖ 466 subjekte të rivlerësimit që kanë paraqitur formularët e rivlerësimit që në fillim të procesit në vitin 2017.
- ❖ Zhvillimi i 104 shorteve për përzgjedhjen e 5 dosjeve dhe kërkimi në total i 520 dosjeve gjyqësore në gjykatat respektive ku administrohen këto akte.
- ❖ Depozitimi i 99 raporteve të hollësishme dhe të arsyetuara dhe të shoqëruara me 495 dosjeve gjyqësore pranë KPK-së për 99 subjekte të rivlerësimit kalimtar grupuar sipas institucioneve.
- ❖ Gjatë vitit të parë të veprimtarisë së tij, Komisioni ka përpunuar/relatuar dhe dërguar pranë KPK-së 110 raporte të analizimit të aftësive profesionale, që përbën 1/5 e totalit të subjekteve.
- ❖ Në total, nga fillimi i procesit të rivlerësimit janë dorëzuar pranë KPK-së 220 raporte të analizimit të aftësive profesionale ose 50% të të gjithë subjekteve që kanë paraqitur formularin e rivlerësimit pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

4. *H*ARTA GJYQËSORE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka parashikuar si prioritet të punës së tij, ndër të tjera, vlerësimin dhe riorganizimin e gjykatave dhe të kompetencave të tyre tokësore. Për këtë qëllim, bazuar në urdhrin nr. 78, datë 18.02.2019, miratuar nga Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për ngritjen e grupit institucional të punës për vlerësimin dhe riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave”, është ngritur një grup ndër-institucional pune, i cili ka vlerësuar gjendjen aktuale, volumin e çështjeve në gjykata, çështjet e mbartura etj. Grupi ndër-institucional gjatë punës së tij, ka marrë në konsideratë gjithashtu dhe studimet ndërkombëtare në këtë drejtim, rekomandimet dhe modelet më të mira të vendeve Evropiane.

Në përmbushje të këtij detyrimi ligjor, për Këshillin e Lartë Gjyqësor, mbi riorganizimin e Hartës së Re Gjyqësore, grupi i punës në tërësi ka zhvilluar 7 (shtatë) mbledhje, të cilat përkohë me periudhën shkurt 2019 - janar 2020. Në kuadër të të gjithë kësaj pune janë zhvilluar disa takime intensive në disa nga qytetet kryesore të Shqipërisë, si Shkodër, Vlorë, Përmet, Gjirokastër, Elbasan, dhe Gjykatën e Krimeve të Rënda, Tiranë. Nga takimet është konstatuar fakti se sistemi gjyqësor po punon në maksimumin e tij dhe me shumë sforco. Situata e vështirë shkaktuar nga vettingu, por dhe rënia e besimit të publikut tek sistemi gjyqësor, ka krijuar një zbalancim në dhënien e drejtësisë dhe ankimim në dhënien e vendimeve gjyqësore.

Në të gjithë këtë proces të rëndësishëm, pjesëmarrës të mbledhjeve kanë qenë: Z. Maksim Qoku (kryetar i grupit të punës dhe zv/kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor), Znj. Brikena Ukperaj (anëtare e KLGJ-së), Znj. Marçela Shehu (anëtare e KLGJ-së), Z. Florjan Kalaja (përfaqësues i Gjykatës së Lartë), Z. Kastriot Selita (kryetar, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë), Znj. Iliba Bezati (kryetare, Gjykata e Apelit Vlorë), Znj. Joana Qeleshi (ish-kryetare, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës), zëvendësuar më pas nga z. Markelian Koca (zv/kryetar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës), Znj. Enkeledi Hajro (ish-kryetare, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë), zëvendësuar më pas nga Z. Petrit Çomo (zv/kryetar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë), Z. Arbër Çela (zv/kryetar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër), Znj. Edlira Bako (ish-përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë), Znj. Elona Hoxha (përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë), Z. Besmir Beja (përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë), si dhe zë vend për t’u theksuar pjesëmarrja e partnerëve ndërkombëtarë, pa të cilët nuk do ishte e mundur kryerja e të gjithë këtij procesi të gjatë dhe të vështirë, Këshilli i Evropës, Misioni EURALIUS dhe ekspertët e tyre të cilët kanë qenë në dispozicion të grupit të punës, si znj. Carmela Germinario (EURALIUS), z. Paolo Bartolomeo (EURALIUS), znj. Anne Trice (USAID), z. Jesper Wittrup (USAID), të cilët gjatë

këtij procesi kanë dhënë orientime, kanë sjellë eksperiencat e tyre, kanë paraqitur raporte, kanë ndihmuar në ecurinë e procesit të punës, kanë paraqitur gjithashtu studimet e kryera prej tyre lidhur me efektivitetin e gjykatave dhe ngarkesën e tyre, etj.

Po ashtu dhe përfaqësues të tjerë nga misione ndërkombëtare të cilët kanë qenë të pranishëm hap pas hapi në këtë proces kanë qenë konkretisht dhe z. Grzegorz Borkowski, ekspert i Nivelit të Lartë pranë Misionit EURALIUS, z. Rene van Veen, ekspert i Nivelit të Lartë pranë Misionit EURALIUS, z. Klodian Rado, konsulent ligjor pranë Misionit EURALIUS, znj. Blerta Ngucaj, përfaqësuese e Misionit EURALIUS, z. Tedi Dobi, ekspert vendas pranë Misionit EURALIUS, znj. Olta Lolo, përfaqësuese e USAID-it (Projekti “Drejtësi për të gjithë”), znj. Laurela Muça, dhe znj. Marjana Papa, përfaqësuese të CoE, znj. Ama Kraja, përfaqësuese e OSCE, z. Olsi Denai, znj. Sava Radovicka nga COE, etj.

Grupi i Punës ka ndjekur një metodologji të caktuar që në fillimet e punës së tij, metodologji e cila është bazuar gjithashtu dhe në nenin 14 dhe nenin 15 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Më konkretisht metodologjia konsiston në studimin e tre çështjeve të rëndësishme siç janë: popullsia, ngarkesa e çështjeve për secilin gjyqtar, si dhe numri i çështjeve të reja në gjykata. Gjithashtu një faktor shumë i rëndësishëm që është marrë parasysh në vazhdimësi është largësia midis qytetarëve dhe gjykatave, duke i dhënë kështu një rëndësi parësore garantimit të aksesit në drejtësi të qytetarëve, si dhe reduktimi i kostove, rritjen e cilësisë dhe performancës në dhënien e shërbimeve gjyqësore.

Në përcaktimin e kësaj harte të re gjyqësore, janë ndjekur 4 (katër) hapa thelbësorë për të përcaktuar një hartë të re gjyqësore, konkretisht:

- Vlerësimi i hartës ekzistuese dhe treguesve të gjykatave ekzistuese;
- Përcaktimi i objektivave dhe kriterëve;
- Përcaktimi dhe marrja e të dhënave (statistika);
- Përcaktimi i hartës së re gjyqësore.

Si rrjedhojë e kësaj metodologjie, parimeve, objektivave dhe kriterëve të sipërcituara, përgjatë takimeve të zhvilluara, grupi i punës ka ngritur variantet e tij duke përdorur si bazë të dhëna të sakta statistikore të nxjerra nga gjykatat mbi veprimtarinë e tyre gjyqësore. Këto të dhëna kanë shërbyer si bazë për përlllogaritjen e ngarkesës për çdo gjykatë dhe për çdo gjyqtar.

Së pari, të dhënat mbi të cilat grupi i punës kreu studimin ishin ato të tre viteve të fundit, pra vitet 2016, 2017, 2018. Ndërkohë që viti 2019 nuk u përfshi në vlerësim, pasi gjatë kohës së kryerjes së studimit, të dhënat statistikore nuk ishin krijuar ende e për rrjedhojë nuk mund të grumbulloheshin e të merreshin në konsideratë. Të dhënat statistikore të përdorura në studim ishin ato të marra si nga Ministria e Drejtësisë edhe ato të ardhura nga gjykatat e vendit.

Së dyti, një tjetër e dhënë e marrë në konsideratë ishte mesatarja e ngarkesës së gjykatave në tre vitet e fundit, bashkëlidhur me ngarkesën për çdo gjyqtar, e cila solli dhe përcaktimin e një norme standarde të përgjithshme, që sipas llogaritjeve do të jetë përafërsisht 260 çështje për gjyqtar. Së treti, u morën në konsideratë si parashikimi ligjor që gjykatat nuk mund të kenë më pak se 7 (shtatë) gjyqtarë për gjykatë dhe largësia apo distancat midis qytetarëve dhe gjykatave.

Në mbledhjen e fundit, mbajtur më datë 17 janar të vitit 2020, u miratua dhe varianti i fundit për hartën e re gjyqësore i cili u dakordësua nga të gjithë pjesëmarrësit në këtë mbledhje. Ky variant është në përpunim e sipër nga grupi i punës për të arritur në një vendimmarrje përfundimtare, që do t'i propozohet KLGJ-së për diskutim dhe miratim në mbledhje plenare sa më shpejtë që të jetë e mundshme.

Si përfundim, vlen të theksohet se puna e këtij grupi pune ka ndeshur një mori problematikash që lidhen kryesisht me mbledhjen e statistikave dhe sidomos mosrakovimin e tyre mes të dhënave të ardhura nga vetë gjykatat, me të dhënat e marra nga Ministria e Drejtësisë. Si rezultat i këtij mosrakovimi u kërkua dhe u organizua një takim i dedikuar me të gjithë kancelarët e gjykatave. Në këtë takim u dakordësua dhe miratua bashkarish një tabelë model mbi bazën e të cilës u bë dhe një herë hedhja e të dhënave statistikore nga kancelarët e gjykatave. Këto të dhëna shërbyen si për vlerësimin e çështjeve për gjyqtarë në vit dhe për çështjet e reja të ardhura në çdo gjykatë për tre vitet e fundit.

Një tjetër vështirësi e hasur ka qenë përbërja heterogjene e grupit të punës i cili ishte i përbërë me anëtarë nga disa institucione dhe organizata rajonale dhe ndërkombëtare. Për rrjedhojë, organizimi i takimeve ka marrë më shumë kohë. Gjithashtu, fatkeqësisht përveç pushimeve verore vonesë ka sjellë dhe situata emergjente shkaktuar nga tërmeti i muajit nëntor 2019 si dhe situata e shkaktuar nga pandemia globale e COVID-19 në mars të vitit 2020.

Aktualisht grupi i punës po vazhdon të punojë për të nxjerrë një raport analitik në lidhje me gjithë veprimtarinë e ndërmarrë që do t'i paraqesë KLGJ-së. Është e pritshme përfundimi i këtij raporti brenda vitit 2020.

5. SISTEMET E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Falë zhvillimeve në fushën e Teknologjisë së Informacionit, prej më se 15 vjetësh është e mundur që shërbimet e ofruara nga gjykatat të jenë të aksesueshme online nga qytetarët, përfaqësuesit e medias, si dhe nga aktorë të tjerë të shoqërisë civile. Prej vitit 2005, në gjykatat shqiptare operojnë dy sisteme të ndryshme elektronike për ndarjen e çështjeve gjyqësore dhe ecurinë e zhvillimit të tyre në proces (ARK-IT dhe CCMIS/ICMIS, këtu e në vijim sistemi i menaxhimit të çështjeve). Aktualisht sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore (civile, penale dhe administrative) është funksional në të gjitha gjykatat e vendit, përfshirë Gjykatën e Lartë. Përjashtim nga aplikimi i këtij sistemi (ICMIS) bën vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Duhet theksuar se aplikimi i këtyre teknologjive ishte risi për sistemin tonë gjyqësor dhe si të tilla këto sisteme elektronike kanë ndihmuar në rritjen e transparencës dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore, duke ndikuar pozitivisht në tërësinë e funksionimit të sistemit gjyqësor.

Aplikimi i sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykatat shqiptare do duhej të mundësonte ndjekjen e çështjes dhe dokumentimin e të gjitha veprimeve të kryera nga momenti i regjistrimit dhe hapjes së dosjes gjyqësore deri në dhënien e vendimit nga gjykata për të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor. Gjithashtu, ky sistem do duhej të prodhonte statistika, raporte, dhe akte procedurale si fletëthirrje, etj., duke rregulluar kështu, të gjithë aspektin procedural dhe menaxherial të sistemit gjyqësor. Përpos kësaj, sistemi do duhej të mundësonte që çështjet të kërkohen dhe shikohen në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, edhe pasi ato të kenë kaluar në Gjykatat e Apelit dhe Gjykatën e Lartë. Kjo pasi vetëm në këtë mënyrë ky sistem do të përmbushte funksionin për të pasur efekt të dukshëm tek publiku në kuadër të rritjes së transparencës dhe aksesit në veprimtarinë e gjykatave. Nga ana tjetër vetëm në këtë mënyrë ky sistem do të mund të rriste efikasitetin e vetë gjykatave, përmes saktësisë së statistikave të raportuara të cilat do të udhëhiqnin në vendimmarrje bazuar në të dhëna faktike (evidence-based).

Pavarësisht investimeve të vazhdueshme për mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve, eksperiencia e deri tanishme në aplikimin dhe përdorimin e tij nga gjykatat ka nxjerr në pah një numër të konsiderueshëm problematikash. Mangësitë e raportuara nga vetë gjykatat janë të natyrave të ndryshme dhe tashmë janë kthyer në pengesë të punës në gjykata. Shumë nga këto problematika që lidhen kryesisht me procesin e regjistrimit të çështjeve, hedhjen e shortit, publikimin e vendimit si dhe sigurimin e informacionit janë kritike për mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore e për pasojë edhe për funksionimin e gjykatave. Ndonëse pritej që aplikimi i teknologjive të reja të lehtësonte punën e

gjykatave, për shkak të funksionaliteteve të munguara, sot gjykatat kryejnë punë dyfishe. Kjo për faktin se një sërë të dhënash gjykatat e mbajnë në mënyrë manuale, pasi sistemi nuk ia plotëson këto nevoja.

Problematikat kryesore të sistemit ekzistues janë:

- Sistemi nuk mundëson anonimizim automatik të të dhënave personale në tekstin e vendimeve. Aktualisht ky anonimizimi, me qëllim respektimin e së drejtës së privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale, kryhet manualisht. Si rrjedhojë, publikimi online i menjëhershëm i vendimeve gjyqësore nuk është teknikisht i mundur.
- Sistemi duhet përditësuar me teknologji të reja pasi sistemi ICMIS funksionon vetëm me shfletuesin e internetit (Internet Explorer 8) por jo në versionet më të fundit, që janë të instaluar në kompjuterët dhe serverët në gjykata. Kjo sjell problem pasi pajisjet e reja kompjuterike dhe serverët e gjykatave, nuk e mbështesin instalimin e këtij versioni të internetit (Explorer 8).
- Sistemi nuk mundëson gjenerimin e raporteve dhe të dhënave statistikore të sakta të tilla si p.sh: kërkesat për heqje dorë nga gjykimi, identifikimin e ngarkesës individuale të punës së gjyqtarëve, mosgjenerimin e raporteve mbi përqindjen e seancave të cilat kanë filluar në kohë apo me vonesë (të dhëna të kërkuara me vendim *Nr. 25 datë 07.02.2019 nga KLGJ “Mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore”*) si dhe një seri kërkesash të tjera për gjenerime statistikore të cilat nuk janë funksionale ose nuk janë integruar ndonjëherë. Për rrjedhojë, shpesh gjykatat i gjenerojnë statistikatat në mënyrë manuale dhe ky proces kërkon më tepër kohë për shfletimin e regjistrave fizikë dhe shpesh ka edhe pasaktësi. mosgjenerimin e raporteve dhe të dhënave statistikore të sakta; mungesa e një rregulloreje për të gjitha gjykatat për sistemin ICMIS
- Sistemi nuk mundëson një shpërndarje të barabartë në shortin elektronik, kjo pasi algoritmi nuk merr parasysh numrin e ngarkesës së çështjeve të caktuara paraprakisht për secilin gjyqtar. Për pasojë, sistemi nuk e ka lehtësuar punën e gjyqtarëve, përkundrazi në disa raste i ka mbingarkuar ata.
- Sistemi nuk është i azhurnuar me ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Civile/Penale si dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit, të cilat paraqesin një rëndësi mjaft të lartë.
- Sistemi nuk realizon komunikimin elektronik në kohë reale ndërmjet përdoruesve të ndryshëm në gjykatë (sekretarja e regjistrimit, ndihmësit

ligjorë) dhe as nuk mundëson gjenerimin e alarmeve sinjalizuese për të njoftuar këta përdorues lidhur me afatet kohore të shqyrtimi të çështjeve.

- Sistemi nuk kategorizon një listë të unifikuar të objekteve të padive, llojit të palëve, apo tipet e dispozitivit gjë e cila nuk ia lehtëson aspak punën administratës gjyqësore.
- Ai nuk mundëson funksionalitetin e lidhjes elektronike me sistemin online të menaxhimit të çështjeve të prokurorisë, regjistrin elektronik kombëtar të gjendjes civile, sistemin e Zyrës Rajonale të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, sistemin e përmbarimit etj.

Këto problematika të sistemit janë të përsëritura ndër vite, ndaj Këshilli me qëllim adresimin e tyre, gjatë prezantimit të buxhetit për vitin 2020 në Komisionin Parlamentar për Çështjet Ligjore, më datë 21.11.2019, kërkoi një shtesë në shpenzime operative prej 25 milion lekë për mirëmbajtjen e sistemit ICMIS. Gjithashtu, bazuar në nevojën e artikulluar nga vetë gjykatat, Këshilli parashitroi para Komisionit Parlamentar edhe kërkesën për një fond prej 100 milion lekë investime për fillimin e ndërtimit të një sistemi të ri elektronik për menaxhimin e çështjeve gjyqësore, i cili është pjesë e Planit Strategjik të KLGJ-së. Meqenëse fondi i kërkuar për fillimin e ndërtimit të sistemit të ri, për shkak të situatës së krijuar si pasojë e fatkeqësisë natyrore të tërmetit, nuk u akordua nga Kuvendi, aktualisht Këshilli është në proces bisedimesh me partnerët ndërkombëtarë për të mundësuar gjetjen e shumës së nevojshme, e cila do të ofrojë zgjidhjen njëherë e mirë të problematikave të hasura në lidhje me sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore.

Neni 277 i Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikonte që jo më vonë se 1 muaj nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sistemet aktuale të teknologjisë së informacionit, përfshirë edhe kontratat në fuqi për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e këtyre sistemeve, si dhe çdo dokument tjetër teknik ose juridik t’i kalonin në dorëzim dhe përgjegjësi Këshillit të Lartë Gjyqësor nga drejtoria përgjegjëse e Ministrisë së Drejtësisë. Ndonëse ligji parashikon afatin njëmuajor për transferimin e sa më sipër, ky proces paraqiti disa vështirësi për shkak të mungesës së buxhetit nga ana e KLGJ-së për rinovimin e kontratës së mirëmbajtjes për sistemin ICMIS. Pavarësisht vonesave, sistemi i menaxhimit të çështjeve është marrë në administrim nga KLGJ-ja në muajin qershor të 2019.

Gjithashtu nevojë tjetër prioritare në drejtim të sistemeve TIK, është ngritja e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë, në kuadër të së cilës ekziston një bashkëpunim i vazhdueshëm me MD-në. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka dhënë mendim për projektvendimin që po hartohet nga Ministria e Drejtësisë në qershor të vitit 2019.

Në përfundim, duke njohur situatën dhe vështirësitë me të cilat përballen gjykatat, Këshilli e ka vlerësuar imediate dhe prioritare nevojën për një sistemi të ri elektronik plotësisht të automatizuar dhe të unifikuar për të gjitha nivelet e gjyqësorit. Kjo nevojë është artikulluar si e tillë edhe nga vetë gjykatat, të cilat në raportimet tremujore janë shprehur për domosdoshmërinë e krijimit të një sistemi të ri elektronik që të garantojë efikasitet gjyqësor, menaxhimin aktiv të qarkullimit të çështjeve, gjenerimin e të dhënave statistikore si dhe aksesin e drejtpërdrejtë të KLGJ-së në këto të dhëna. Kjo do të bënte të mundur shmangien e përgatitjes së statistikave në mënyrë manuale dhe do të mundësonte gjenerimin në një kohë të shpejtë dhe në mënyrë elektronike të statistikave.

Sistemi i ri do duhet të përcaktojë qartë proceset e punës, rolet dhe atributet e secilit përdorues, të mundësojë transferimin elektronik të dosjeve gjyqësore ndërmjet gjykatave të të gjitha niveleve, si dhe të ndërveprojë me sistemet e tjera elektronike të Prokurorisë, Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, Qendra Kombëtare e Biznesit. Gjithashtu, sistemi i ri do duhet të ndërveprojë me portalin e ri gjyqësor (www.gjykata.gov.al), për gjenerimin automatik ditor të çdo informacioni apo vendim të përditësuar, të ofrojë gjenerim të saktë të çdo statistike, si p.sh. ngarkesës e punës së gjyqtarëve, ndihmesave/këshilltarëve ligjorë.

6. ANALIZA MBI SITUATËN E GJYKATAVE

6.1 RIFUNKSIONALIZIMI I GJYKATËS SË LARTË

Reforma në drejtësi dhe Gjykata e Lartë. Reforma në Drejtësi solli ndryshime thelbësore si në përbërje dhe kompetencat e Gjykatës së Lartë ashtu dhe në funksionimin e saj duke e vendosur tashmë nën kontrollin e KLGJ-së për efekte të administrimit të gjykatës, përzgjedhjes dhe propozimit për emërim të anëtarëve të saj dhe vlerësimin e tyre. Nisur nga problematikat e konstatuara ndër vite reforma synoi që ta bënte këtë gjykatë pjesë të sistemit gjyqësor duke e shndërruar në një gjykatë karriere dhe duke përcaktuar qartë kriteret dhe procedurat për të qenë anëtar i saj. Ndryshe nga procedura e mëparshme e përzgjedhjes së kandidatëve për GJL, e cila linte vend për subjektivizëm, aktualisht, ligjvënësi ka përcaktuar qartë raportet midis anëtarëve që vijnë nga jashtë dhe atyre që promovohen nga brenda sistemit gjyqësor duke vendosur në favor të një maxhorance (prej 4/5 të numrit të përgjithshëm) për këta të fundit. Në përpjekje për të depolitizuar GJL dhe për ta shndërruar atë në një gjykatë karriere, për të rritur pavarësinë dhe integritetin e saj në favor të një reputacioni të rinovuar dhe profesional për gjyqtarët e saj, procedurat e përzgjedhjes ju besuan Këshillit të Lartë Gjyqësor, si një organ i pavarur i qeverisjes së gjyqësorit.

Situata e stokut të çështjeve të mbetura në Gjykatën e Lartë. Prej më se dy vitesh situata në Gjykatën e Lartë raportohet si problematike, pasi konstatohet një rritje progresive e stokut të çështjeve të mbartura në këtë gjykatë. Në fund të vitit 2017 numri i çështjeve të mbartura raportohet të ishte 22 000, ndërsa në fund të vitit 2018 ky numër ishte rritur me 6657 çështje duke mbërritur në 28 657 dosje të pa trajtuara. Në mes të vitit 2019, kur kjo gjykatë mbeti me një anëtar nga 19 të parashikuar në organigramën e saj, numri i dosjeve në pritje për t'u gjykuar raportohet të jetë 3431 ose 5654 çështje më shumë se viti i shkuar (2018).



Përpjekjet dhe hapat e ndërmarra nga KLGJ-ja për funksionalizimin e Gjykatës së Lartë. Përballë kësaj situatë, rifunksionalizimi i Gjykatës së Lartë u kthye në një domosdoshmëri dhe prioritet në veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe kjo që nga momenti i krijimit të tij. Për sa më sipërme, KLGJ-ja gjatë vitit 2019 ka punuar intensivisht dhe me shumë kujdes për të hartuar të gjitha aktet nënligjore të nevojshme për të mundësuar hapjen e procedurës për përzgjedhje dhe emërim të anëtarëve në Gjykatën e Lartë dhe si rrjedhojë funksionalizimin e saj.

Aktet nënligjorë të miratuara përpara hapjes së vendeve vakante në këtë gjykatë:

- KLGJ-ja miratoi vendimin nr. 75, datë 23.5.2019, "*Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për avancimin e karrierës së gjyqtarëve dhe emërimin e gjyqtarëve të gjykatës së lartë*".
- KLGJ-ja miratoi vendimin nr. 102, datë 5.7.2019 "*Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë*".
- KLGJ-ja miratoi me vendimin nr. 209, datë 11.10.2019, "*Metodologjia për Vlerësimin dhe Pikëzimin e Kandidatëve jo-gjyqtarë për në Gjykatën e Lartë*"
- Gjithashtu në fillim të vitit 2020, KLGJ miratoi vendimin nr. 70, datë 07.2.2020, "*Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve*".

Miratimi i tre akteve të para garanton një procedurë përzgjedhjeje dhe verifikimi bazuar në një proces tërësisht të rregullt dhe ligjor, si dhe përcakton kriteret e duhura për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve me qëllim identifikimin e

kandidatit jogjyqtar që përfaqëson juristin më të spikatur, me merita profesionale, morale dhe etike, apo dhe organizative dhe menaxheriale.

Vendimi i fundit synon të përcaktojë rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën që zbaton Këshilli i Lartë Gjyqësor për renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për ngritje në detyrë sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Të gjitha këto akte nënligjore të miratuara nga KLGJ-ja kanë për qëllim parësor të garantojnë një proces të hapur dhe transparent për përzgjedhjen e kandidatëve në mënyrë të tillë që rezultati i tij nuk komprometohet dhe as paragjykohet si nga vetë kandidatët ashtu dhe nga publiku i gjerë.

Në hartimin e këtyre rregullave Këshilli është mbështetur nga Misioni EURALIUS V, ekspertët e të cilit kanë kontribuar intensivisht duke dhënë opinionin e tyre, në mënyrë që aktet të jenë në përputhje me standardet evropiane.

Hapja e thirrjeve për aplikim për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur. KLGJ-ja gjatë vitit 2019 krahas tre vendimeve të mësipërme të karakterit rregullator, ka miratuar gjithashtu 4 vendime për shpalljen publike për 4 vende në GJL nga radhët e juristëve të spikatur, dhe ka realizuar procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për 22 nga 23 kandidatët aplikantë, nga ku rezultoi:

- 3 kandidatë kualifikohen për në fazën tjetër;
- 19 kandidatë skualifikohen dhe përjashtohen nga procedura e emërimit për shkak të mosplotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit;
- 1 kandidat vijon ende procedura e kualifikimit.

3 kandidatët e kualifikuar iu nënshtruan fazës së dytë, asaj të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes dhe me vendimet nr. 110, nr. 111 dhe nr. 112 datë 05.03.2020 KLGJ-ja i ka dorëzuar Presidentit të Republikës listën e kandidatëve të propozuar për emërim në GJL. Ndërkohë Presidenti i Republikës ka bërë dekretimin e tyre⁵⁹, dhe në një ceremoni publike është bërë edhe betimi i këtyre 3 anëtarëve më të rinj të Gjykatës së Lartë, para këtij institucioni në datën 11 mars 2020.

Këshilli ka në proces verifikimi edhe kandidatin për pozicionin e 4 të lirë të shpallur në fushën e së drejtës civile. Nga KLGJ-ja ishte parashikuar që i gjithë procesi i verifikimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të kualifikuar, ashtu dhe dërgimi i propozimit pranë Presidentit të Republikës për këtë pozicion të katërt të përfundonte brenda muajit mars 2020. Kjo nuk është bërë e mundur për shkak të situatës së krijuar si pasojë e pandemisë globale COVID-19, e cila çoi në pezullimin e aktiviteteve të Këshillit. Procesi u rihap me vendimin nr. 142, datë

⁵⁹ Dekretet. nr. 11452, 11453 dhe 11454, datë 11.03.2020.

22.04.2020 “Për rifillimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së COVID-19”.

Hapja e thirrjeve për aplikim për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqtarëve. KLGJ-ja, në përputhje me vendimin nr.70, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, në mbledhjen e datës 26 shkurt 2020, ka hapur dhe procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për 6 pozicione të lira, 3 në fushën e së drejtës administrative dhe 3 në fushën e së drejtës civile. Kjo ndarje është bërë për shkak të numrit të lartë të çështjeve të regjistruara në pritje për tu shqyrtuar në të tri lëndët, por kryesisht në ato administrative dhe civile. Përmes mekanizmit të ngritjes në detyrë të 6 gjyqtarëve të tjerë përveç atyre gjyqtarëve të përzgjedhur nga radhët e juristëve të spikatur, KLGJ-ja synon plotësimin me anëtarë të Gjykatës së Lartë dhe për pasojë rifunksionalizimin e saj. Vlen të theksohet se sistemi i ri i promovimit të gjyqtarëve është një risi në Shqipëri dhe synon të sigurojë një proces objektiv dhe të paanshëm, i cili bazohet tërësisht në një procedurë transparente dhe konkurruese. Thirrja për aplikantët nga gjyqësori është pezulluar që prej datës 12 mars 2020, për shkak të pezullimit të aktiviteteve të Këshillit si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia globale COVID-19⁶⁰.

Masa të tjera për reduktimin e stokut të çështjeve të mbetura në Gjykatën e Lartë. KLGJ është koshiente së plotësimi i numrit të gjyqtarëve të kësaj gjykate është hapi më i rëndësishëm në këtë proces. Ndërkohë përveç këtij hapi të ndërmarrë, *ngritja e grupit të punës nga KLGJ-ja, fokusi i veprimtarisë të secilit është reduktimi i numrit të lartë të çështjeve në Gjykatën e Lartë* ka filluar të japë rezultat. Ky grup pune së fundmi i propozoi KLGJ-së miratimin e një Memorandum mirëkuptimi për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë, sipas rekomandimeve të Projektit “Drejtësi për të gjithë” - USAID⁶¹ (miratuar me vendimin nr. 131, datë 30.03.2020). Ndër kontributet më të rëndësishme që Memorandumi ofron në zgjidhjen e situatës së krijuar në Gjykatën e Lartë, është rekrutimi i një stafi mbështetës juristësh të cilët do të ndihmojnë administratën e kësaj gjykate për të trajtuar me shpejtësi çështjet e stokut të mbetura në gjykatë.

Gjithashtu, memorandumi ka në fokus të tij edhe (i) mbështetjen e nevojshme teknike për të realizuar hartëzimin gjithëpërfshirës të procesit të punës për të

⁶⁰ Me vendimin nr. 142, datë 22.04.2020 “Për rifillimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së COVID-19”, KLGJ-ja vendosi rifillimin e procedurave administrative të pezulluara, ndër të tjera edhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë.

⁶¹ Memorandumi i Mirëkuptimit, lidhur me Zbatimin e Projektit “Drejtësi për të gjithë (“JFA”) në Shqipëri me qëllim Zbatimin e Synimit Strategjik 1 dhe Objektivave Strategjikë 1.5 dhe 1.6 të Këshillit të Lartë Gjyqësor të Shqipërisë, u nënshkrua në datë 29 prill 2020, nga Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, së bashku me znj. Mikaela Meredith, përfaqësuese vendore e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

gjitha proceset aktuale në këtë gjykatë; të përcaktojë procese më efikase, të cilat të jenë në pajtim me kodet procedural të rishikuara, me ligjet e reformës dhe me modelet e praktikave më të mira; (ii) bashkëpunimin me ekspertë për të përfunduar vlerësimin e sistemit aktual të ICMIS-it (Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore) dhe përcaktimin e ndryshimeve të nevojshme, mbështetur në hartëzimin e proceseve të punës nga “siç janë” në “siç duhet të jenë”.

Krahas elementëve të përmendura me lart, Memorandumi parashikon, gjithashtu bërjen e vlerësimeve buxhetore dhe financiare për modifikimet në sistemin ICMIS, e cila konsiderohet si thembra e Akilit në sistemin aktual gjyqësor.

Për sa është përmendur më sipër, rezulton se funksionalizimi i Gjykatës së Lartë dhe reduktimi i stokut të çështjeve në këtë gjykatë mbeten një nga prioritet kryesorë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për rrjedhojë, KLGJ-ja ka ndërmarrë masa si për plotësimin e trupës gjyqësore të kësaj gjykate duke hapur procedurat për rekrutimin e gjyqtarëve për Gjykatën e Lartë ashtu dhe për shtimin e burimeve njerëzore mbështetëse në të. Ecuria e procesit të plotësimit të vendeve vakante, do të varet qoftë nga dinamika dhe nga numri i aplikimeve që do të vijnë nga radhët e gjyqësorit ashtu dhe nga kohëzgjatja që do të marrin procedurat për verifikimin, vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve.

Vlen të theksohet se zbatimi i mekanizmit të ngritjes në detyrë për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë, kushtëzohet si nga procesi i rivlerësimit kalimtar ashtu dhe nga procesi i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtarëve që mund të kandidojnë për t’u bërë anëtarë në këtë gjykatë. Ndaj është e pritshme që procedurat të zgjasin më tepër se afatet e parashikuara në ligj apo rregulloret e miratuara nga KLGJ-ja. Nga një përlllogaritje e përafërt mendohet që procedurat për zgjedhjen e tyre të shkojnë nga 4 muaj deri në 9 muaj nga moment i mbylljes së thirrjes për aplikim.

Në 26 shkurt 2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për 6 pozicionet e lira. Këto procedura u pezulluan për shkak të pandemisë në 12 mars 2020. Megjithatë, angazhimi i KLGJ-së në këtë drejtim pritet të vijojë normalisht pas rifillimit të veprimtarisë së KLGJ-së me vendimin nr. 142, datë 22.04.2020.

6.2 KRIJIMI I GJYKATAVE TË POSAÇME PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Në ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, dhe konkretisht neni 135 i Kushtetutës, parashikohet krijimi i Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 162, parashikon transformimin e gjykatave të

shkallës së parë dhe të apelit për krimet e rënda në Gjykata të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si dhe kriteret që duhet të plotësohen nga gjyqtarët për të qenë pjesë e gjykatave të posaçme.

Këshilli i Lartë Gjqësor, që në mbledhjen e datës 27 dhjetor 2018, në zbatim të ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", dhe ligjit 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", konsideroi me përparësi të lartë krijimin e gjykatave speciale për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar. Kështu, Këshilli vendosi të fillojë procedurën për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat Speciale kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, duke i hapur rrugën krijimit të këtyre gjykatave.

Në këtë kuadër u kërkua nga gjyqtarët në detyrë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe të Apelit, dakordësia për të vijuar ushtrimin e detyrës së gjyqtarit pranë Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke:

1. shprehur interesin e tyre me shkrim;
2. dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas parashikimeve ligjore, së bashku me familjarët e tyre.

Për sa më sipër, dhanë pëlqimin pranë KLGJ-së 14 nga 15 gjyqtarë të cilët ushtronin detyrën pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, ndërkohë nga 11 gjyqtarë që ushtronin detyrën pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, dhanë pëlqimin vetëm 8 gjyqtarë.

Ky proces i krijimit të gjykatave të posaçme u koordinua ngushtë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë në mënyrë që të dy institucionet - gjykatat e posaçme dhe prokuroria e posaçme - të krijohehin dhe të fillonin veprimtarinë gjyqësore në të njëjtën kohë. Ndërsa KLGJ-ja pati pëlqimin e shumicës dërrmuese të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda, që në tremujorin e parë të vitit 2019, mundësimi i vënies në funksion të gjykatave të reja të juridiksionit të posaçëm u kushtëzua në thelb nga përfundimi i procesit paralel të administruar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Kjo dhe për faktin që për krijimin e Gjykatave të Posaçme (...) ligji nuk parashikonte që për fillimin e punës së tyre gjyqtarët të kishin kaluar domosdoshmërisht procesin e rivlerësimit kalimtar ndërkohë që për prokurorët e Prokurorisë së Posaçme (...) ky ishte një detyrim ligjor dhe parakusht për t'u zgjedhur në këtë prokurori.

Më 18 dhjetor 2019 Këshilli i Lartë Gjqësor mori një ndër vendimet më të rëndësishme gjatë veprimtarisë tij, siç është miratimi i vendimit nr. 286 për vënien në funksionim të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ky hap i ndërmarrë nga KLGJ-ja vjen në vazhden e jetësimit të

reformës në drejtësi dhe si një përpjekje konkrete ndaj luftës kundër korrupsionit e krimit të organizuar. Kështu, Këshilli, me vendimet nr. 287-304, datë 18.12.2019 ka caktuar në mënyrë të përhershme 5 gjyqtarë dhe në mënyrë të përkohshme 13 gjyqtarë (në pritje të përfundimit të rivlerësimit kalimtar të tyre).

Ndërkohë që aktualisht (gjatë vitit 2020), KLGJ-ja ka caktuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar 5 gjyqtarë dhe në mënyrë të përkohshme 1 gjyqtar. Ndërsa, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar janë caktuar në mënyrë të përhershme 4 gjyqtarë, si dhe në mënyrë të përkohshme 6 gjyqtarë. Gjatë këtij procesi janë transferuar edhe 9 gjyqtarë në gjykata të ndryshme (kryesisht për shkak të pezullimit të tyre sipas vendimit të shkarkimit të KPK-së).

Për sa i përket plotësimit të vendeve të tjera vakant në këtë gjykatë, KLGJ-ja në mbledhjen e datës 7 shkurt 2020, pas një konsultimi me trupat gjyqësore dhe me partnerët ndërkombëtarë, miratoi me Vendimin nr.70, kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave të detajuara që do të zbatohen për renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për ngritje në detyrë, ndër të tjera, dhe për Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Për rrjedhojë, më datë 26 shkurt të vitit 2020 KLGJ-ja hapi thirrjen për mbushjen e vakancave në këto gjykata, afatet e cilave u pezullua më pas në datë 12 mars 2020 për shkak të pandemisë globale COVID-19. Me vendimin nr. 142, datë 22.04.2020 “Për rifillimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së COVID-19”, KLGJ-ja vendosi rifillimin e procedurave administrative të pezulluara, ndër të tjera edhe për ngritjen në detyrë në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Problematikat në lidhje me plotësimin e Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar kryesisht derivojnë nga disa dispozita të paqarta të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Plotësimi me gjyqtarë i Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ligji 96/2016 “Për statusin...” në pikën 8, të nenit 42, përcakton se “Një gjyqtar nuk lejohet të transferohet në mënyrë të përkohshme ose të përhershme në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar”. Ndaj si transferimi ashtu dhe lëvizja paralele nuk janë të mundshme për këto gjykata.

Për rrjedhojë, plotësimi i pozicioneve të lira në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, mund të realizohet vetëm përmes mekanizimit të ngritjes në detyrë, i cili me fillimin e funksionimit të këtyre gjykatave (më datë 19.12.2019) dhe mungesat e gjyqtarëve në të për shkak të

shkarkimeve nga procesi i rivlerësimit kalimtar, paraqet prioritet të lartë. Ndonëse procedurat në fjalë filluan me hapjen e thirrjes për aplikim në datë 26 shkurt 2020, afatet e tyre u pezulluan për shkak të pandemisë globale COVID-19 në 12 mars 2020 dhe u rihapën me vendimmartjen e fundit të KLGJ-së⁶², më 22 prill 2020.

KLGG-ja për menaxhimin e situatës ka miratuar vendimin nr. 125, datë, datë 06.03.2020 “Mbi gjyqtarët e caktuar në çështje gjyqësore të veçanta në ish-Gjykatat për Krimet e Rënda, sot Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” i cili lejon vijimin gjykimit në këto gjykata nga gjyqtarët e juridiksionit të përgjithshëm të caktuar para krijimit të këtyre gjykatave, pavarësisht se këta të fundit nuk kanë plotësuar kriteret e sigurisë.

Pagat e gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Për sa i përket pagave të gjyqtarëve, legjislacioni në fuqi nuk është i plotë dhe krijon vështirësi në zbatim. Konkretisht, sipas shkronjës “d”, të pikës 5, të nenit 12, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, “Paga mujore bruto e magjistratit përbëhet ndër të tjera nga një d) “*shtesë për vështirësi pune, sipas parashikimeve të ligjit nr.95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar". Ky i fundit (ligji nr. 95/2016) përmban vetëm një rregullim indirekt që lidhet me pagën e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme⁶³ (...), dhe pa përcaktuar në mënyrë eksplicite masën e pagesës shtesë. Pra, kjo masë nuk është e përcaktuar apo e përcaktueshme konkretisht. Për më tepër që mungon autoriteti që mund ta përcaktojë atë, ndërkohë që sipas ligjit elementi “shtesë për vështirësi pune” i pagës bruto përcaktohet vetëm nga ligji.*

6.3 ANALIZA E TË DHËNAVE STATISTIKORE

Një ndër detyrat⁶⁴ kryesore të KLGJ-së është edhe përcaktimi i standardeve për funksionimin e brendshëm të gjykatave, ku ndër të tjera edhe standardeve lidhur me efikasitetin dhe cilësinë e drejtësisë që jepet në gjykata. Në këtë kontekst monitorimi i vazhdueshëm i treguesve të efikasitetit dhe cilësisë dhe analiza e treguesve sasiorë dhe cilësorë është po aq i rëndësishëm sa vendosja e standardeve pasi ai bën të mundur që organi qeverisës i gjyqësorit të këtë një qasje proaktive

⁶²Vendimi nr. 142, datë 22.04.2020 “Për rifillimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së COVID-19”

⁶³Në Shtojcën B të ligjit, pikërisht të “Deklarata 1 - VETË DEKLARIM (i gjyqtarëve dhe prokurorëve)”, parashikohet se “Gjithashtu jam dakord që, në këmbim të këtyre kushteve, të kompensohem me një pagesë shtesë”.

⁶⁴ Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”

duke reaguar në mënyrë të aty çastshme ndaj problematikave që shfaqen.

Qëllimi i kësaj analize është matja dhe interpretimi i treguesve të performancës së gjyqësorit me synim evidentimin e nevojave për përmirësimin e punës dhe ofrimin e një drejtësie cilësore dhe pa vonesa ndaj qytetarëve.

Në këtë kuadër janë marrë në konsideratë dhe analizuar shembujt më të mirë që ofrohen nga Komisioni Evropian për Efiçencën e Drejtësisë (CEPEJ), opinione të Komisionit të Venecias, projekte të financuara nga BE-ja, Instituti CEELI (që prej disa vjetësh po mbështet Rrjetin e Evropës Qendrore dhe Lindore të shkëmbimit gjyqësor), parimet e Bangalorit, udhëzimet e OKB-së mbi sundimin e ligjit, rekomandimet e Kievit (përgatitur në bashkëpunim me OSBE) për pavarësinë e gjyqësorit në Evropën Lindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore, etj.

Për sa më sipër, kjo analizë synon të trajtojë parimet e përgjithshme që drejtojnë sistemin gjyqësor si pavarësia, efiçenca dhe llogaridhënia dhe treguesit e cilësisë së drejtësisë, bazuar në indikatorët më të konsoliduar që përdoren aktualisht nga sistemet gjyqësore në Evropë dhe më gjerë.

Matja e parametrave dhe për më tepër analiza e të dhënave është një element kyç për përmirësimin e drejtësisë. Treguesit e drejtësisë dhe të sundimit të ligjit janë mjete të dobishme për të vlerësuar performancën, për të tërhequr vëmendjen ndaj çështjeve, për të vendosur standarde, për të monitoruar progresin dhe për të vlerësuar ndikimin e ndërhyrjeve apo reformave. Treguesit, së bashku me mekanizmat e tjerë të monitorimit dhe vlerësimit, janë thelbësore për të siguruar reagimin e duhur. Kur publikohen, këta tregues kontribuojnë në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së sistemit të drejtësisë.

6.3.1 METODOLOGJIA

Kuadri ligjor dhe standardet kryesore

Paketa ligjore, e njohur ndryshe si paketa e reformës në drejtësi, dhe konkretisht ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ngarkojnë KLGJ-në me detyrën e përcaktimit të disa standardeve dhe treguesve bazë të funksionimit dhe performancës së gjykatave dhe në përgjithësi të sistemit të drejtësisë.

Konkretisht, KLGJ ka detyrimin⁶⁵ për përkufizimin e treguesve për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore dhe

⁶⁵ Ligji 96/2016, neni 74.

kohën mesatare për marrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor për një çështje.

Po kështu, Këshilli i Lartë Gjyqësor kujdeset për organizimin⁶⁶ dhe funksionimin e shërbimeve që lidhen me administrimin gjyqësor duke ushtruar kompetencat e mëposhtme:

- a) harton dhe ndjek zbatimin e politikave për administrimin gjyqësor;
- b) monitoron dhe menaxhon ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe aspekte të tjera të administrimit gjyqësor, bazuar në të dhënat e mbledhura përmes sistemit të menaxhimit të çështjeve, me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave ose uljen e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të nëpunësve civilë gjyqësorë;
- c) miraton rregullat e brendshme standarde të gjykatës dhe rregullat standarde⁶⁷ për funksionimin e brendshëm të gjykatave ku përfshihen norma në lidhje me strukturën e gjykatave, efikasitetin dhe cilësinë e drejtësisë që jepet në këto gjykata.

KLGGJ-ja, në përcaktimin e kriterëve dhe treguesve të performancës së gjyqësorit, konsulton standardet evropiane⁶⁸ për treguesit e punës së gjyqësorit, të tilla si **norma e evadimit të çështjeve, numri i çështjeve për gjyqtar, kohëzgjatja mesatare e çështjeve, etj.**;

Rregullat standarde për efikasitetin e drejtësisë përfshijnë parashikime për: **afatet standarde kohore për gjykimin e llojeve të ndryshme të çështjeve gjyqësore**, përfshirë, kur është e mundur, edhe **afatet për fazat kryesore të procedurës, për ekzekutimin e vendimeve**, duke mbajtur parasysh organizimin gjyqësor dhe normat procedurale. Këto rregulla përfshijnë, ndër të tjera, domosdoshmërisht edhe rregullimet e mëposhtme:

- a) zhvillimi i vrojtimit për vlerësimin e shërbimeve të gjykatave nga përdoruesit e tyre;
- b) **zhvillimi, testimi dhe përdorimi i treguesve për cilësinë e shërbimeve gjyqësore;**
- c) masa për përmirësimin e cilësisë së punës të ekspertëve gjyqësorë;
- d) masa për përmirësimin e qasjes në drejtësi.

Mjetet e vlerësimit

Monitorimi dhe vlerësimi i aktiviteteve të gjykatave, ndër të tjera, synon në zbulimin e mangësive dhe nevojave, dhe për këtë arsye ndihmon sistemin e drejtësisë të rrisë cilësinë e tij. Vlerësimi i rregullt periodik mund të përmirësojë reagimin e sistemit të drejtësisë ndaj sfidave aktuale dhe të ardhshme.

⁶⁶ Ligji 115/2016, neni 89.

⁶⁷ Ligji 115/2016, neni 94.

⁶⁸ Ligji 115/2016, neni 92.

Mjetet adekuate të teknologjisë së informacionit mund të sigurojnë sisteme efikase të menaxhimit të çështjeve dhe mund të ndihmojnë në sigurimin e statistikave gjyqësore të standardizuara në mbarë vendin në kohë reale. Përveç kësaj, ato mund të përdoren për menaxhimin e çështjeve të prapambetura/mbartura (backlog) dhe sistemeve të automatizuara të paralajmërimit të hershëm.

Sondazhet janë thelbësore për të vlerësuar se si funksionojnë sistemet e drejtësisë nga perspektiva e profesionistëve ligjorë dhe përdoruesve të gjykatave. Një ndjekje e duhur e vrojtimit është një parakusht për të përmirësuar cilësinë e sistemeve të drejtësisë.

Raportimet periodike të gjykatave janë gjithashtu një ndër mjetet që përdoren për të pasur një panoramë sa më të qartë të gjyqësorit. Ky mjet, në kushtet kur sistemet elektronike të menaxhimit të çështjeve ende nuk janë në gjendje të gjenerojnë të dhëna të plota dhe të sakta për treguesit e gjyqësorit, mbetet edhe mjeti kryesor i shkëmbimit të informacionit.

Duke marrë parasysh që sistemet aktuale të menaxhimit të çështjeve (ARK IT dhe ICMIS) nuk ofrojnë të dhëna statistikore të detajuara, ky raport u hartua bazuar në të dhëna të gjeneruara automatikisht si dhe të nxjerra manualisht nga gjykatat, bazuar në formatin e paracaktuar nga KLGJ-ja. Gjithashtu, situata e krijuar si pasojë e tërmetit të nëntorit 2019, i cili nxori jashtë funksionit dy gjykata shtoi vështirësinë në mbledhjen dhe saktësinë e të dhënave statistikore nga gjykatat. Për sa më sipër, këto të dhëna, dhe rrjedhimisht edhe rezultatet e përfuara nga përpunimi i tyre, mund të paraqesin një marzh gabimi që konsiderohet i pranueshëm dhe nuk kompromenton nxjerrjen e përfundimeve.

Përcaktimi i indikatorëve

Pavarësia, cilësia dhe efikasiteti janë parametra thelbësorë të një sistemi gjyqësor efektiv, pavarësisht nga modeli i sistemit kombëtar të drejtësisë ose tradita ligjore në të cilën është ankoruar, shifrat mbi këto tre parametra duhet të lexohen së bashku, pasi të tre elementët janë të domosdoshëm për efektivitetin e sistemit të drejtësisë dhe shpesh ndërliken (iniciativat për përmirësimin e njërës prej tyre mund të kenë ndikim nga ana tjetër).

Në përcaktimin e indikatorëve janë marrë parasysh një numër elementësh:

- Qasja pragmatike - për t'i bërë ato të dobishëm për përfituesit.
- Të kontribuojnë në axhendën e integritit në BE.
- Të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së raportimit.
- Të jenë relevante për planifikimin e aktiviteteve të ardhshme.
- Të kontribuojnë në monitorimin dhe vlerësimin më të mirë të aktiviteteve të zbatuara.

Në përcaktimin e indikatorëve gjithashtu merren në konsideratë elementë të tillë si:

- Përdorimi, kur është e mundur, e treguesve shumëdimensionalë që të trajtojnë kompleksitetin e problemit.
- Indikatorët duhet të jenë të lidhur me vlerat thelbësore të sistemit të drejtësisë.
- Të drejtojnë/udhëzojnë drejt një numri të kufizuar masash specifike të përmirësimit të performancës.
- Përdorimi i matjeve që janë relativisht të pakontestueshme dhe përfaqësojnë në terma të qartë se çfarë synon të ofrojë sistemi.
- Të kenë kuptim për publikun e gjerë.
- Të maten rregullisht me kalimin e kohës për të evidentuar ndryshimet.
- Të zhvillohen në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe konsultative por të mund të maten ose verifikohen në mënyrë të pavarur.

6.3.2 VOLUMI I PUNËS SË GJYKATAVE

Numri i çështjeve të mbartura nga viti i kaluar dhe numri i çështjeve të reja të regjistruara përbëjnë volumin e punës me të cilin përballlet çdo gjykatë gjatë vitit të referencës. Si rregull, çështjet e pazgjidhura në vitin e mëparshëm, mbarten dhe emërtohen si stoku i çështjeve të mbartura. Pavarësisht se në terma absolutë këto shifra nuk janë tregues në vetvete, krahasimi i tyre me vitet e mëparshme përbën një element tregues të ecurisë së punës së gjykatës specifike dhe të kapaciteteve të saj për të përballuar një volum specifik pune por edhe të trendit të regjistrimit të çështjeve të reja që varet nga elementë ligjorë, demografikë, ekonomikë, socialë, etj.


6.3.2.1 STOKU I ÇËSHTJEVE TË MBARTURA

Stoku i çështjeve të mbartura është një ndër treguesit më të rëndësishëm të efijencës së sistemit gjyqësor pasi tregon sa arrin gjyqësori dhe gjykatat individuale që të përballojnë fluksin e çështjeve të regjistruara në vitin e referencës. Sa më i madh numri i çështjeve të mbartura aq më e vonuar drejtësia e dhënë, dhe kjo bazuar në parimin “një drejtësi e vonuar është një drejtësi e munguar”.

Numri i çështjeve të mbartura nga viti 2018 për në vitin 2019, është në total **77 853 çështje**. Shpërndarja e stokut të çështjeve të mbartura sipas gjykatave është në proporcion të drejtë me numrin total të çështjeve ose me ngarkesën e punës që përballojnë këto gjykata. Numrin më të madh të çështjeve të mbartura e mbajnë **Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë, çështjet e mbartura të të cilave përbëjnë 55 972 çështje ose rreth 72% të totalit të çështjeve të mbartura në**

shkallë vendi.

Në vijim paraqiten grafikisht të dhënat e stokut të çështjeve të mbartura sipas juridiksionit:



Numri më i madh i çështjeve të mbartura në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm e ka Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me 37% të totalit të çështjeve të mbartura. Ndërkohë janë 6 gjykata, ato të rretheve Tiranë, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Durrës dhe Fier që kanë rreth 70% të totalit të çështjeve të mbartura ndërsa 16 gjykata të tjera kanë 29%.



Në gjykatat e apelit, juridiksioni i përgjithshëm, Gjykata e Apelit Tiranë ka dukshëm numrin më të lartë të çështjeve të prapambetura në nivelin e apelit të

juridiksionit të përgjithshëm, ose 58% të tyre.



Për sa i përket gjykatave të juridiksionit administrativ, ndër gjykatat e shkallës së parë numrin më të madh të çështjeve të prapambetura e ka Gjykata e Durrësit dhe më pas ajo e Tiranës. Por Gjykata Administrative e Apelit ka rreth tre herë më shumë çështje të mbartura krahasuar me totalin e të gjithë gjykatave administrative të shkallës së parë.

Funksionimi i Gjykatës së Lartë gjatë vitit 2019 për disa muaj me kapacitet të reduktuar dhe më pas për një periudhë disamujore vetëm me një gjyqtar në detyrë duke pamundësuar funksionimin e saj, ka bërë që të evidentohet një ndikim i dukshëm në rritjen e stokut të çështjeve të mbartura. Stoku i çështjeve të mbartura të kësaj gjykate ka shkuar nga 22 000 në fund të vitit 2017, në 34311 në fund të vitit 2019, ose një rritje prej 56% në dy vjet.


Nëse krahasojmë ecurinë në tre vitet e fundit të stokut të çështjeve të mbartura, vërehet një rritje prej 12,86% nga viti 2017 në vitin 2018 dhe prej 19% nga viti 2018 në vitin 2019, sipas tabelës së mëposhtme:

	2017	2018	# në %	2019	# në %
BACKLOG	68 982	77 853	+12,86%	92 602	+19%

Stoku i çështjeve të papërfunduara në fund të vitit 2018, prej 77853 çështjesh, të cilat u mbartën në vitin 2019, përbëheshin në masën 48,6 nga çështje civile, 33,5% çështje administrative dhe 18,4% çështje penale themeli.

Stoku i vitit 2019, që mbartet në vitin 2020, prej 92 602 çështje, përbëhet

respektivisht nga 50,9 % çështje civile, 31,2% çështje administrative dhe 17,9 % çështje penale themeli.



Vlen të vëzhgohet ecuria e këtij treguesi duke përjashtuar të dhënat e Gjykatës së Lartë për shkaqe të përmendura më sipër. Në tabelën më poshtë pasqyrohen të dhënat për vitin 2018 dhe vitin 2019, me dhe pa Gjykatën e Lartë.


	2018		2019		2018	2019
	Me GJL	Pa GJL	Me GJL	Pa GJL	Ndryshimi në % me GJL	Ndryshimi në % pa GJL
Stoku i çështjeve civile	37656	22640	47168	29598	25%	31%
Stoku i çështjeve penale	14291	10185	16559	11515	16%	13%
Stoku i çështjeve administrative	25906	16371	28875	17178	11%	5%
TOTAL	77853	49196	92602	58291	19%	18%

Siç vërehet nga të dhënat e tabelës së mësipërme, rritja e stokut të çështjeve të mbartura në rang vendi, duke përjashtuar Gjykatën e Lartë, është sërish në nivel të konsiderueshëm, me një rritje prej rreth 18% për 2019 (nga 49 196 çështje të mbartura në 2018 në 58291 çështje që mbarten nga viti 2019).

Rezultoni se disa gjykata, ndër të cilat Gjykatat e Rretheve Elbasan, Fier, Krujë, Kurbin, Lushnje dhe Shkodër kanë ulur numrin e çështjeve të mbartura duke shënuar rritje të efektshmërisë së punës së tyre krahasuar me vitin e mëparshëm. Ndërsa Gjykata të tjera si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, Sarandë, etj., kanë rritje të dukshme të stokut në përqindje për vitin 2019. Në gjykatat e apelit vihet re rritje e stokut në të gjitha gjykatat, ndër të cilat rritje më të madhe krahasuar me

vitin 2018 e shënojnë Gjykata e Apelit Vlorë dhe Durrës.

Grafiku i mëposhtëm pasqyron ndryshimin e stokut të çështjeve të mbartura nga viti 2018 në vitin 2019.



Ndër gjykatat Administrative të Shkallës së Parë, vetëm Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe Shkodër kanë shënuar rritje të stokut. Ndërkohë që Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë, Gjirokastrë dhe Vlorë e kanë ulur stokun duke shënuar rritje të performancës dhe kjo krahasimisht me një vit më parë. Në Gjykatën Administrative të Apelit shënohet rritje e stokut me 5%.


Ndërkohë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe atë të Apelit për Krime të Rënda stoku në vitin 2019 është ulur në raport më atë të vitit 2018, pavarësisht rritjes së ndjeshme të numrit të çështjeve të trajtuara në këto gjykata, duke treguar përmirësim të performancës.

Nga sa u tha më lart vihet re që ndryshimi i stokut të çështjeve të mbartura, në disa gjykata me rritje dhe në disa të tjera me ulje, është në përpjesëtim të zhdrejtë me rendimentin mesatar të çështjeve të zgjidhura për gjyqtar (shih treguesin ER në vijim) dhe me numrin e gjyqtarëve në dispozicion të çdo gjykate (shih për më tepër seksionin mbi burimet njerëzore) dhe në përpjesëtim të drejtë me numrin e çështjeve të reja të regjistruara. Kështu rritja e stokut në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm mund të thuhet që është ndikuar nga rritja e numrit të çështjeve të regjistruara në vitin 2019 me 2.12% në shkallë vendi por kryesisht është ndikuar nga reduktimi i numrit të gjyqtarëve nga 91% e organikës në vitin 2018 në 70% të organikës në vitin 2019.


Për vitin 2019 në këtë këndvështrim arsyetimi i mësipërm gjen aplikueshmëri për

ankimit ose çështje në juridiksion fillestar të këtyre gjykatave, ndërsa 6 149 çështjet e regjistruara në Gjykatën e Lartë.

gjykata të shkallës së parë	gjykatat e apelit	Gjykatën e Lartë	Total
123 481	22 769	6 149	152 399
81%	15%	4%	100%



Siç vërehet qartë edhe nga grafiku në vijim, numrin më të madh të çështjeve të regjistruara e ka Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me 36 116 çështje të regjistruara në vitin 2019. Kjo përbën edhe rreth 29% të çështjeve të regjistruara në shkallë të parë, ose rreth 24% të totalit të çështjeve të regjistruara në gjykatat e të gjitha niveleve.



Përveç Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila është gjykata më e madhe në vend sa i përket shtrirjes territoriale dhe numrit të popullsisë në territorin në të cilin shtrihet juridiksioni i saj, numër të lartë çështjesh kanë regjistruar edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me 7884 çështje (6,4% e çështjeve të regjistruara në shkallë të parë) dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me 7821 çështje (6,3% e çështjeve të regjistruara në shkallë të parë). Ndërkohë gjykata me numrin më të ulët të çështjeve rezulton të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet me 558 çështje të regjistruara për vitin 2019 (0,5% e çështjeve të regjistruara në shkallë të parë). Këto shifra lidhen kryesisht me numrin e popullsisë dhe hapësirën territoriale në të cilën gjykatat shtrijnë juridiksionin e tyre.

Në gjykatat administrative të shkallës së parë janë regjistruar në total 13 682 çështje. Numrin më të madh të çështjeve të regjistruara e ka Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me 4781 çështje, që përbëjnë rreth 35% të çështjeve administrative të regjistruara në shkallë të parë dhe numrin më të vogël Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me 1020 çështje ose rreth 7.5%.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda në vitin 2019 janë regjistruar 2013 çështje ndërsa në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda janë regjistruar 379 çështje.


Në gjykatat e apelit janë regjistruar në total 22 769 çështje nga të cilat 4620 ose 20.3 % janë çështje administrative të regjistruara në Gjykatën Administrative të Apelit. Në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm janë regjistruar 18 149 çështje, nga të cilat 9956 ose rreth 55% (ose 43.7% e çështjeve në rang apeli, bashkë me apelin administrativ) janë çështje civile dhe janë 8193 ose rreth 45% (ose 36 % e çështjeve në rang apeli, bashkë me apelin administrativ) janë çështje penale.

Në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, numri më i madh i çështjeve është regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë me 7118 çështje të cilat përbëjnë rreth 39 % të çështjeve të regjistruara në gjykatat e apelit të këtij juridiksioni. Ndërsa numri më i vogël i çështjeve është regjistruar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë me 903 çështje. Numri i lartë ose i ulët i çështjeve në gjykatat e apelit lidhet me faktorë të tillë si numrin e gjykatave të shkallës së parë në juridiksionin e tyre, shtrirjen territoriale dhe numrin e popullsisë.

Në Gjykatën e Lartë në vitin 2019 rezultojnë të jenë regjistruar 6149 çështje nga të cilat 2381 ose rreth 39 % janë çështje administrative, 1118 ose rreth 18 % janë çështje penale dhe 2650 ose rreth 43 % janë çështje civile.

Në lidhje me llojin e çështjeve sipas natyrës së tyre, përveç kategorizimit të çështjeve në civile, penale dhe administrative, janë administruar të dhëna për disa nënkategori çështjesh (çështje civile themeli, kërkesa civile, familjare, tregtare,

penale themeli, krime dhe kundërvajtje dhe kërkesa penale) dhe për disa kategori të veçanta të vlerësuara me natyrë sensitive (marrëdhënie pune dhe çështje me të mitur në konflikt me ligjin).



Konkretisht, për çështjet civile, nga 72 235 çështje të regjistruara, 53 301 ose rreth 73.8 % janë çështje civile të përgjithshme, 13 822 ose rreth 19,1 % çështje familjare, 3252 ose rreth 4.5% janë çështje më objekt mosmarrëveshje që burojnë nga marrëdhëniet e punës dhe 1859 ose 2.6 % janë çështje tregtare.

Në çështjet penale , nga 59 481 çështje në total, 11 503 çështje ose 19.3 % janë penale themeli për krime, 3735 çështje ose 6.3 % themeli për kundërvajtje penale dhe 528 çështje ose 0.9 % me të mitur në konflikt me ligjin. Pjesa tjetër e çështjeve penale e cila zë volumin më të madh të çështjeve penale në tërësi, konkretisht 43 715 ose rreth 73.5 % janë kërkesa penale të fazës së hetimit, seancës paraprake dhe kërkesa gjatë fazës së ekzekutimit.


Në çështjet penale me të mitur në konflikt me ligjin rezultojnë në total 528⁶⁹ ose rreth 0.9 % e çështjeve penale në total. Numri më i madh për këtë kategori çështjes është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me 211 çështje ose rreth 40 % të totalit të çështjeve me të mitur në konflikt me ligjin.

Sipas një rendi kronologjik i regjistrimit të çështjeve në të tre shkallët e gjyqësorit, në vitet 2017- 2019 na rezultojnë matrica e mëposhtme:

⁶⁹ Në numrin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin bëjnë pjesë të gjitha kategoritë e çështjeve penale (penale themeli dhe kërkesa penale) në të cilat i pandehuri ose viktimi është i mitur sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penal për të Mitur.

	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Regjistruar në sh. 1	109478	117037	123481
Regjistruar në Apel	17649	21850	22769
Regjistruar në GJL	9627	8536	6149
TOTAL	136754	147423	152399

Paraqitja grafike e ecurisë së regjistrimit të çështjeve në 3 vitet e fundit pasqyron edhe një trend në rritje që ruhet si për totalin e çështjeve ashtu edhe për çështjet e regjistruara në shkallë të parë dhe në apel. Por vihet re një ulje e çështjeve të reja që janë regjistruar pranë Gjykatës së Lartë nga viti 2017 në vitin 2018, ulje e cila thellohet në vitin 2019. Trendi në rënie i numrit të çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Lartë në tre vitet e fundit mund të jetë rrjedhojë e ndryshimeve të legjislacionit procedural civil dhe penal të cilat kanë hyrë në fuqi në vitin 2017⁷⁰ dhe kanë ndryshuar dispozitat përkatëse që parashikojnë shkaqet e rekursit në Gjykatën e Lartë. Koncretisht nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile, kanë ngushtuar diapazonin e shkaqeve për të cilat palët mund t'i drejtohen kësaj gjykate.



Gjykatat kanë pasur ecuri të ndryshme për sa i përket çështjeve të reja të regjistruara. Në grafikun më poshtë pasqyrohet kjo ecuri, pra ndryshimi në përqindje mes numrit të çështjeve të reja të regjistruara në vitin 2018 dhe në vitin 2019. Për efekt të qartësisë së prezantimit grafik është hequr gjykata e shkallës së parë e krimeve të rënda e cila ka një rritje prej rreth 15 herë, nga 123 në vitin 2018 në 2013 çështje në vitin 2019.

⁷⁰ Ligji nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar “është botuar në fletoren zyrtare nr. 97 datë 05.05.2017, dhe ka hyrë në fuqi më datë 1.8.2017. Ligji nr. 38/2017, 30.03.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996” Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, është botuar në fletoren zyrtare nr. 98 datë 05.05.2017 dhe ka hyrë në fuqi më datë 05.11.2017.

Numri i çështjeve të regjistruara në gjykata është një element që duhet marrë parasysh në analizën e indikatorëve të performancës së gjyqësorit. Ky numër ndikon drejtpërdrejtë në indikatorët e efijencës dhe lidhet me faktorë të tillë si juridiksioni i gjykatës, shtrirja territoriale dhe numri i popullsisë. Ndryshimet në numrin e çështjeve të regjistruara në gjykata implikojnë edhe nevojën për një fleksibilitet më të lartë të sistemit gjyqësor për t’iu përgjigjur ndryshimeve që mund të vijnë nga faktorë demografikë e socialë por edhe nga ndryshime në fushën e legjislacionit. Në gjykatat e vogla, numri i kufizuar i gjyqtarëve ofron një marzh të kufizuar fleksibiliteti dhe mund të çojë në rritje të ndjeshme të stokut të



çështjeve dhe uljen e efijencës nëse nuk garantohe mirëfunktionimi i skemës së delegimit dhe transferimit të gjyqtarëve.

6.3.3 BURIMET NJERËZORE

Në përputhje me udhëzimet e CEPEJ-it, të dhënat mbi stafin gjyqësor (gjyqtarët dhe nëpunësit e gjykatave, etj.) janë kërkuar nga gjykatat që të jepen në ***ekuivalentin me kohë të plotë***. Kjo jep një ide më të saktë të burimeve njerëzore që realisht një gjykatë ka pasur në dispozicion gjatë vitit dhe mundëson një interpretim më realist të të dhënave të përfuara. Ekuivalenti në kohë të plotë ose ndryshe thënë numri efektiv i gjyqtarëve në dispozicion, është shumatorja e raportit të muajve që ka punuar çdo gjyqtar me numrin 12. P.sh. nëse një gjykatë gjatë gjithë vitit ka pasur 2 gjyqtarë në punë dhe në dhjetor i janë shtuar edhe 2 të tjerë, nuk mund të merret si numër gjyqtarësh numri 4 por llogaritet si $2 + 2 \cdot 1/12 = 2,16$.

Tabela në vijim prezanton tablonë e përgjithshme të situatës së burimeve njerëzore në gjykata për vitin 2019.

Gjykata	Nr. i gjyqtarëve		fakti vs dekreti ne %	Nr. i stafit mbështetës		fakti vs organika ne %	Raporti staf mbështetës për gjyqtar	
	Dekreti	Fakt		Organika	Fakt		Organika	Fakti
Berat	10,00	5,22	52,20	19,00	18,70	98,42	1,90	3,58
Dibër	4,00	3,00	75,00	14,00	13,00	92,86	3,50	4,33
Durrës	17,00	13,00	76,47	34,00	34,00	100,00	2,00	2,62
Elbasan	14,00	11,90	85,00	27,00	27,00	100,00	1,93	2,27
Fier	14,00	12,00	85,71	28,00	28,00	100,00	2,00	2,33
Gjirokastrë	6,00	5,00	83,33	15,00	15,00	100,00	2,50	3,00
Kavajë	4,00	4,00	100,00	12,00	12,00	100,00	3,00	3,00
Korçë	14,00	10,25	73,21	27,00	25,00	92,59	1,93	2,44
Krujë	4,00	4,00	100,00	13,00	13,00	100,00	3,25	3,25
Kukës	4,00	3,00	75,00	12,00	11,50	95,83	3,00	3,83
Kurbini	4,00	2,70	67,50	14,00	15,00	107,14	3,50	5,56
Lezhë	5,00	5,00	100,00	15,00	14,50	96,67	3,00	2,90
Lushnje	5,00	4,17	83,40	14,00	11,77	84,07	2,80	2,82
Mat	4,00	3,16	79,00	12,00	12,00	100,00	3,00	3,80
Përmet	4,00	2,00	50,00	11,00	11,00	100,00	2,75	5,50
Pogradec	4,00	3,00	75,00	12,00	10,00	83,33	3,00	3,33
Pukë	4,00	2,00	50,00	12,00	12,00	100,00	3,00	6,00
Sarandë	6,00	5,00	83,33	15,00	15,00	100,00	2,50	3,00
Shkodër	14,00	11,25	80,36	27,00	27,00	100,00	1,93	2,40
Tiranë	76,00	66,82	87,92	135,00	188,60	139,70	1,78	2,82
Tropojë	4,00	2,50	62,50	12,00	12,00	100,00	3,00	4,80
Vlorë	14,00	11,00	78,57	28,00	28,00	100,00	2,00	2,55
Shk.LKr.R	16,00	14,00	87,50	36,00	36,00	100,00	2,25	2,57
Apeli Tiranë	31,00	20,75	66,94	58,00	60,25	103,88	1,87	2,90
Apeli Shkodër	10,00	9,34	93,40	18,00	16,00	88,89	1,80	1,71
Apeli Durrës	13,00	6,84	52,62	20,00	19,83	99,15	1,54	2,90
Apeli Korçë	6,00	3,80	63,33	12,00	12,00	100,00	2,00	3,16
Apeli Gjirokastrë	6,00	6,00	100,00	12,00	12,00	100,00	2,00	2,00
Apeli Vlorë	12,00	8,00	66,67	18,00	17,50	97,22	1,50	2,19
Apel Kr.R.	11,00	6,00	54,55	16,00	15,00	93,75	1,45	2,50
Apel Adm	13,00	12,00	92,31	39,00	42,00	107,69	3,00	3,50
Adm Tiranë	16,00	16,00	100,00	42,00	32,00	76,19	2,63	2,00
Adm Shkodër	4,00	1,54	38,50	12,00	11,00	91,67	3,00	7,14
Adm Durrës	4,00	3,00	75,00	17,00	16,00	94,12	4,25	5,33
Adm Korçë	4,00	2,00	50,00	12,00	8,70	72,50	3,00	4,35
Adm Gjirokastrë	4,00	2,00	50,00	12,00	12,00	100,00	3,00	6,00
Adm Vlorë	4,00	4,00	100,00	16,00	14,50	90,63	4,00	3,63

Gjykata e Lartë	19,00	1,00	5,26	112,00	59,00	52,68	5,89	59,00
TOTAL	408,00	306,2	75,06	960,00	937,9	97,69	2,35	3,06

Grafiku më poshtë paraqet numrin e gjyqtarëve që kanë kontribuar për sistemin gjyqësor në vitin 2019 (gjyqtarë efektiv) në raport me numrin e gjyqtarëve që sistemi gjyqësor është duhet të kishte sipas dekretit të Presidentit të RSH.




Siç shihet edhe nga paraqitja grafike, vetëm 6 nga 38 gjykata kanë funksionuar me 100% të kapacitetit njerëzor ku mesatarja kombëtare është në shifrat **75,06%**.


Nëse marrim në shqyrtim të dhënat mesatare mbi sistemet gjyqësore në Evropë, bazuar në raportimet e CEPEJ-it, mesatarja Evropiane është 17.8 gjyqtarë për 100.000 banorë. Në Shqipëri sipas organikës duhet të ishte 14.22. Fakti është që më 31 dhjetor 2019 në Shqipëri ka pasur 11.85 gjyqtarë për 100.000 banorë. Në realitet, gjatë këtij viti ngarkesa është përballuar nga vetëm 306 gjyqtarë (ekuivalenti në kohë të plotë pune) e cila përkthehet në 10.66 gjyqtarë për 100.000 banorë. Kjo e dhënë është më pak se 60% të normës Evropiane.

Mesatarja Evropiane	Shqipëri sipas dekretit	Shqipëri fakti 31.12.2019	Shqipëri efektive
17.8	14.22	11.85	10.66

Grafiku në vijim paraqet gjendjen faktike të stafit mbështetës në gjykata në raport me organikën. Vihet re që shumica e gjykatave kanë një staf mbështetës të plotësuar në masën 100%.



Një e dhënë me interes për krahasimin me sistemet gjyqësore evropiane është raporti mes gjyqtarëve dhe stafit mbështetës. Ky raport, prezanton një variancë të konsiderueshme ndërmjet gjykatave, siç paraqitet edhe në grafikun në vijim, por ndikohet së tepërmi nga numri i ulët i gjyqtarëve në sistem, si rrjedhojë e procesit të vettingut:



Raporti gjyqtar/staf mbështetës është 1:2,76. ndërkohë mesatarja evropiane⁷¹ është 1:3,1. Në Shqipëri ka 32,68 staf mbështetës për 100 000 banorë ndërsa në Evropë mesatarja është 55 staf mbështetës gjyqësor për 100 000 banorë.

Në konkluzion, duke marrë në konsideratë treguesit mesatarë të sistemeve gjyqësore në Evropë, me qëllim rritjen e cilësisë dhe të efijencës së drejtësisë, mund të thuhet që kryesisht numri i gjyqtarëve por edhe ai i stafit administrativ mbështetës në gjykata, ka nevojë të rritet. **Kjo për shkak se organikat e gjykatave nuk pasqyrojnë nevojat reale për staf/administratë gjyqësore në rang popullate.** (për më shumë lexo seksionin 6.3.3 “burimet njerëzore” fq 122).

⁷¹ https://public.tableau.com/profile/cepej#!/vizhome/CEPEJ-Overviewv5_0EN/Overview

6.3.4 NGARKESA MESATARE E GJYQTARËVE (TREGUESI WR)

Ngarkesa e gjykatave, ashtu siç u përmend më sipër, përbëhet nga dy komponentë: stoku i çështjeve të mbartura nga një vit më parë dhe nga çështjet e regjistruara gjatë vitit të referencës. Ky volum pune, me të cilin përballet çdo gjykatë gjatë vitit të referencës, nëse pjesëtohet me numrin efektiv të gjyqtarëve rezulton në ngarkesën mesatare të çështjeve për gjyqtar. Ky tregues është i ndryshëm nga norma e efikasitetit (treguesi ER) që llogaritet mbi bazën e çështjeve të zgjidhura.

Tabela në vijim pasqyron treguesin WR për vitet 2018 dhe 2019 si dhe ndryshimin në përqindje.

Gjykata	WR 2018	WR 2019	Ndryshimi në %
Berat	448	915	104%
Dibër	473	630	33%
Durrës	510	586	15%
Elbasan	769	802	4%
Fier	568	645	14%
Gjirokastrë	465	610	31%
Kavajë	816	714	-13%
Korçë	509	544	7%
Krujë	1030	778	-24%
Kukës	784	641	-18%
Kurbin	760	688	-9%
Lezhë	968	843	-13%
Lushnje	785	805	3%
Mat	286	404	41%
Përmet	150	316	111%
Pogradec	506	627	24%
Pukë	252	491	95%
Sarandë	459	603	31%
Shkodër	574	701	22%
Tiranë	542	643	19%
Tropojë	353	446	26%
Vlorë	608	821	35%
Shk.I.Kr.R	14	149	964%
Apeli Tiranë	490	741	51%
Apeli Shkodër	432	400	-7%
Apeli Durrës	401	651	62%
Apeli Korçë	253	346	37%
Apeli Gjirokastrë	228	189	-17%
Apeli Vlorë	645	746	16%
Apel Kr.R.	34	69	103%
Apel Adm	1290	1403	9%
Adm Tiranë	367	363	-1%
Adm Shkodër	915	1297	42%
Adm Durrës	383	1059	177%

Adm Korçë	594	1066	79%
Adm Gjirokastrë	472	985	109%
Adm Vlorë	547	690	26%
Mesatare në shkallë vendi	518	640	24%

Siç shikohet edhe nga tabela më lart, pjesa më e madhe e gjykatave përballen me një volum mesatar të shtuar pune për gjyqtar, pra me tregues WR më të lartë krahasuar me vitin 2018. Mesatarja në shkallë vendi është 640 çështje për gjyqtar nga 518 që ishte në vitin 2018, pra një rritje prej 24%.

Duhet theksuar që treguesi WR bazohet në shumën e çështjeve të mbartura me ato të regjistruara dhe si i tillë tregon një pamje të momentit të ngarkesës mesatare për gjyqtar, të gjykatave të veçanta apo të sistemit gjyqësor në përgjithësi. Ndryshimi i këtij treguesi në periudha të ndryshme kohore, në vetvete nuk përbën tregues pozitiv apo negativ. Diçka e tillë mund të verifikohet rast pas rasti, duke krahasuar të dhënat individuale, sepse ndryshimi i ngarkesës së punës mund të vijë si nga faktorë të brendshëm (efiçenca dhe rendimenti në punë) ashtu edhe nga faktorë të jashtëm (ligjorë, demografikë, socialë, etj.).

Nga matrica e paraqitur më lart rezulton që vetëm 8 gjykata kanë një tregues WR më të ulët në vitin 2019, pra edhe një volum pune më të ulët. 29 gjykatat e tjera përballen me rritje të volumit mesatar të punës për gjyqtar, që në disa raste kalon 100% si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, Përmet, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe ajo e Apelit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës dhe Gjirokastrë. **Pra rreth 75% e gjykatave në vend përballen me një volum të shtuar pune.**

Ky tregues do të përdoret në vijim për interpretimin e disa treguesve kryesorë.

6.3.5 NORMA E EFIÇENCËS (TREGUESI ER)

Treguesi ER ose raporti ndërmjet numrit të gjyqtarëve dhe outputit/zgjidhjes së çështjeve nga e njëjta gjykatë në fund të vitit. Ai përfaqëson një element të rëndësishëm të analizës – tregues të ritmeve mesatare të punës për gjyqtar. Pavarësisht se një tregues i tillë i përgjithësuar mbart deri diku edhe një ngarkesë artificiale (shifrat nuk arrijnë të japin një peshë të ponderuar të çështjes që trajton një gjyqtar i ish-gjykatës së krimeve të rënda⁷² dhe një çështjeje më të thjeshtë si ato te divorci pa palë kundërshtare), gjithsesi ky i fundit arrin të japë një panoramë të përgjithshme dhe krahasuese mes gjykatave të të njëjtit juridiksion.

⁷² për vitin 2019 do të vijohet të përdoret ky emërtim për shkak se Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar u krijuan vetëm në dhjetor 2019.

$$ER = \frac{\text{numrit të çështjeve të zgjidhura gjatë periudhës}}{\text{numri i gjyqtarëve efektive}}$$


Treguesi ER, ose rendimenti mesatar për gjyqtar, tregon një variancë të theksuar në gjykata të ndryshme. Ndërsa disa gjykata e kanë treguesin ER në nivele mjaft të larta (Gjykata Administrative Korçë – 987,5 dhe Gjykata Administrative Gjirokastrë – 921,5), gjykata të tjera e kanë këtë tregues ndjeshëm më të ulët (Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka vetëm 281,1).

Treguesi ER paraqitet në formë tabelare, nga treguesi më i lartë në atë më të ulët, në vijim:


GJYKATA	TREGUESI ER
Adm Korçë	987,5
Adm Gjirokastrë	921,5
Berat	749,8
Lezhë	714,0
Vlorë	703,8
Lushnje	694,0
Krujë	693,0
Adm Durrës	682,7
Elbasan	667,1
Shkodër	593,6
Kavajë	580,8
Kurbin	572,6
Adm Vlorë	569,0
Fier	557,9
Dibër	539,7
Kukës	539,3
Pogradec	507,0
Gjirokastrë	506,0
Tiranë	500,2
Adm Shkodër	497,4
Sarandë	495,8
Gjykata e Lartë	495,0
Durrës	469,1
Korçë	465,8
Pukë	449,0
<i>Treguesi ER në shkallë vendi</i>	448,3
Tropojë	396,4
Mat	352,5
Apeli Durrës	337,1
Apel Adm	332,8

Apeli Vlorë	317,4
Adm Tiranë	281,1
Përmet	258,5
Apeli Korçë	254,7
Apeli Shkodër	233,2
Apeli Tiranë	217,3
Shk.I.Kr.R	144,6
Apeli Gjirokastrë	138,2
Apel Kr.R.	64,8

Treguesi ER në rang vendi është 448,3 çështje të zgjidhura për gjyqtar në vit, që shënon një përmirësim të ndjeshëm, me një rritje prej rreth 31% krahasuar me mesataren e një viti më parë kur ishte 310,8 çështje për gjyqtar.




Për të pasur një pasqyrim më realist të ecurisë së treguesit ER, në grafikët në vijim jepen të dhënat sipas shkallëve dhe tipologjisë së gjykatave.




Mesatarja e treguesit ER për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm është 527 çështje në vit për gjyqtar. Ka një numër gjykatash që janë nën mesataren si p.sh. ER më të ulët kanë Gjykatat e Rretheve Përmet dhe Mat. Ndërsa ER më të lartë shënojnë Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Lezhë dhe Vlorë. Përgjithësisht në shumicën e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm treguesi ER është më i lartë ose afër mesatares. Përjashtim bëjnë dy gjykatat e mësipërme të cilat gjatë vitit 2019 shënojnë nivelin më të ulët të ER. Megjithatë këto gjykata janë ato me numër më të ulët çështjesh në raport me gjykatat e tjera. Po ashtu vlen të përmendet se numri i çështjeve të zgjidhura ndikohet drejtpërdrejt nga volumi i çështjeve që trajtohen në këto gjykata si dhe një sërë faktorësh të tjerë të cilët do të trajtohen më poshtë.

Ndërsa për gjykatat e apelit, juridiksioni i përgjithshëm, kemi situatën e paraqitur në vijim:



Mesatarja e ER për vitin 2019 në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm është 244. ER më të lartë shënon Gjykata e Apelit Durrës (337.1) dhe më të ulët Gjykata e Apelit Gjirokastrë (138.2). Në Gjykatën Administrative të Apelit treguesi ER është 332,8 ndërsa në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda (Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar) treguesi ER është 64.8.

Për gjykatat administrative të shkallës së parë vihet re një disproporcionalitet më i madh se në grafikët e mëparshëm. Nëse mesatarja për këto gjykata është 469,73 çështje për gjyqtar, rezulton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë ka shënuar nivelin më të lartë të ER. Kjo gjykatë pasohet nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë. Dy gjykatat e mësipërme kanë ER dukshëm më të lartë se mesatarja. Ndërsa Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka ER më të ulët 281.1 çështje për gjyqtar në krahasim me gjykatat e tjera administrative të shkallës së parë.



Duke iu referuar të dhënave statistikore të marra në shqyrtim më sipër mund të thuhet që gjykatat me ER të ulët kanë hapësira për të rritur ritmin e punës. Veçanërisht kur rezulton që këto gjykata kanë mbartur një stok të konsiderueshëm çështjesh në vitin 2020 – pra çështje të pazgjidhura në vitin 2019. Kjo do të thotë që vlerat e ulëta të ER nuk kanë ardhur gjithmonë si pasojë e mungesës së çështjeve. Në gjykatat administrative të shkallës së parë vihet re që në gjykata me organikë jo të plotë siç janë Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe Gjirokastrë të cilat kanë funksionuar me rreth 50% të numrit të gjyqtarëve në raport me organikën, ER është i lartë, çka tregon se një numër më i lartë çështjesh janë shpërndarë dhe trajtuar nga një numër më i vogël gjyqtarësh. Kjo do të thotë që gjyqtarët kanë trajtuar një numër relativisht më të madh çështjesh dhe të ndikuar edhe nga afatet kohore procedurale janë shtyrë të rrisin rendimentin. Në këtë tregues ndikon sigurisht edhe elementi i menaxhimit dhe llogaridhënies, që është i ndryshëm në gjykata të ndryshme. Gjithashtu elementët e vështirësisë së

çështjes, numri i palëve në gjykime etj., ndikojnë drejtpërdrejt në kohëzgjatjen e çështjes e për rrjedhje dhe në numrin e çështjeve të trajtuara për gjyqtar, pra në rritjen ose uljen e rendimentit (ER) për gjyqtar.

Treguesi ER, për të dhënë një pasqyrim sa më të saktë për rendimentin e gjyqtarit, duhet analizuar edhe në raport me të dhëna të tjera si numri i çështjeve të regjistruara, numri i çështjeve të mbartura, ngarkesa për gjyqtar (treguesi ËR) etj. Si pasojë e këtyre faktorëve, jo gjithmonë niveli i ulët i treguesit ER lidhet drejtpërdrejt me ritmin e punës së gjyqtarëve, pasi ai ndikohet nga një sërë faktorësh objektivë, të pavarur nga gjyqtari. Pra, pavarësisht të dhënave statistikore dhe nivelit të rendimentit për gjyqtar që evidenton grafiku më sipër, duhet theksuar se ky tregues nuk mund të tregojë saktësisht rendimentin e gjyqtarit për disa arsye:

- Ky tregues ndikohet drejtpërdrejt nga volumi i çështjeve që trajtohen në një gjykatë në një periudhë të caktuar kohore. Numri i lartë i çështjeve të regjistruara passjell edhe një numër të lartë çështjesh të caktuara dhe të zgjidhura për gjyqtar. Ndërkohë që në gjykata të vogla ose me lëndë specifike volumi i çështjeve është më i ulët duke ndikuar në uljen e treguesit ER dhe kjo pavarësisht nga performanca e gjyqtarëve për zgjidhjen e çështjeve brenda periudhës përkatëse.
- Treguesi nuk merr parasysh llojin dhe kompleksitetin e çështjeve që trajtohen në juridiksione të ndryshme. Përgjithësisht një çështje penale në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm zgjidhet për një kohë më të shkurtër se sa një çështje penale në gjykatat e posaçme në të cilat çështjet, për shkak të lëndës, paraqesin kompleksitet dhe për pasojë marrin një kohë më të gjatë për t'u trajtuar dhe përfunduar.
- Treguesi nuk merr parasysh faktorë të tillë si ngarkesa e gjykatës, e cila duke qenë më e lartë ndikon në kohëzgjatjen brenda së cilës trajtohen çështjet dhe për pasojë edhe në numrin e çështjeve të përfunduara brenda një hapësire kohore, etj.

Pavarësisht faktorëve që ndikojnë në këtë tregues, leximi i nivelit të rendimentit duhet interpretuar në kontekstin e një sërë faktorësh që nuk lidhen specifikisht me performancën e gjyqtarit (juridiksioni i gjykatave, lloji i çështjeve, numri i gjyqtarëve, volumi i çështjeve të regjistruara, etj.) të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në të. Duke analizuar numrin e çështjeve të përfunduara në vitin 2019 në krahasim me një vit më parë, rezulton se numri i çështjeve të përfunduara në gjykata është rritur dhe kjo pavarësisht rritjes së ngarkesës së gjykatave në përgjithësi dhe uljes së numrit të gjyqtarëve si pasojë e efekteve të procesit të rivlerësimit. **Konkretisht në vitin 2018 rezulton të jenë raportuar 111 970 çështje të përfunduara. Për vitin 2019 numri i çështjeve të përfunduara është 137451 çështje (25 481 çështje ose 22.76% më shumë), në një kohë që numri i**

gjyqtarëve efektivë është reduktuar nga 364 në 306 çka do të thotë rreth 19% reduktim.

Tabela më poshtë pasqyron të dhënat mbi çështjet e përfunduara në vitet 2018 dhe 2019, personelin efektiv në këto vite, treguesin ER për çdo vit dhe ndryshimin në përqindje të këtij treguesi.

<i>Gjykata</i>	<i>përfunduar 2018</i>	<i>përfunduar 2019</i>	<i># në %</i>	<i>Gjyqtarë 2018</i>	<i>Gjyqtarë 2019</i>	<i>ER 2018</i>	<i>ER 2019</i>	<i># në % i ER</i>
Berat	1452	3914	170%	9	5	161	750	365%
Dibër	752	1619	115%	4	3	188	540	187%
Durrës	6726	6098	-9%	16	13	420	469	12%
Elbasan	2583	7939	207%	12	12	215	667	210%
Fier	6887	6695	-3%	14	12	492	558	13%
Gjirokastrë	963	2530	163%	6	5	161	506	215%
Kavajë	979	2323	137%	4	4	245	581	137%
Korçë	4826	4774	-1%	12	10	402	466	16%
Krujë	2361	2772	17%	3	4	787	693	-12%
Kukës	498	1618	225%	2	3	249	539	117%
Kurbin	658	1546	135%	4	3	165	573	248%
Lezhë	1226	3570	191%	5	5	245	714	191%
Lushnje	1236	2894	134%	4	4	309	694	125%
Mat	325	1114	243%	4	3	81	353	334%
Përmet	477	517	8%	4	2	119	259	117%
Pogradec	1451	1521	5%	4	3	363	507	40%
Pukë	219	898	310%	3	2	73	449	515%
Sarandë	1075	2479	131%	6	5	179	496	177%
Shkodër	3631	6678	84%	13	11	279	594	113%
Tiranë	33260	33421	0%	74	67	449	500	11%
Tropojë	366	991	171%	3	3	122	396	225%
Vlorë	2850	7742	172%	14	11	204	704	246%
SH 1	74801	103653	39%	220	190	340	546	60%
Shk.I.Kr.R	142	2025	1326%	15	14	9	145	1428%
Apeli Tiranë	7181	4509	-37%	29	21	248	217	-12%
Apeli Shkodër	1760	2178	24%	10	9	176	233	32%
Apeli Durrës	1377	2306	67%	10	7	138	337	145%
Apeli Korçë	696	968	39%	6	4	116	255	120%
Apeli Gjirokastrë	882	829	-6%	6	6	147	138	-6%
Apeli Vlorë	1856	2539	37%	10	8	186	317	71%
APEL	13752	13329	-3%	71	55	194	244	26%
Apel Kr.R.	114	389	241%	11	6	10	65	526%
Apel Adm	5551	3993	-28%	13	12	427	333	-22%
Adm Tiranë	7774	4498	-42%	16	16	486	281	-42%

Adm Shkodër	1163	766	-34%	2	2	582	497	-14%
Adm Durrës	1150	2048	78%	3	3	383	683	78%
Adm Korçë	2393	1975	-17%	2	2	1197	988	-17%
Adm Gjirokastrë	2299	1843	-20%	2	2	1150	922	-20%
Adm Vlorë	2308	2276	-1%	4	4	577	569	-1%
ADMIN	17087	13406	-37%	29	29	589	470	-20%
Gjykata e Lartë	1673	495	-70%	5	1	335	495	48%

Nëse të dhënat për gjykata të të njëjtit juridiksion krahasohen me të dhënat e vitit 2018, vërehet rritje e dukshme e numrit të çështjeve të përfunduara në pjesën më të madhe të gjykatave. Gjithashtu, pavarësisht një trendi të përgjithshëm të uljes së gjyqtarëve efektivë për çdo gjykatë, vihet re një rritje e konsiderueshme e treguesit ER në pjesën më të madhe të gjykatave.

ER mesatare e gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë është përmirësuar nga 340 në 546 ose 60% më mirë.

ER mesatare e gjykatave të apelit, juridiksioni i përgjithshëm, gjithashtu tregon një përmirësim të ndjeshëm: nga 194 në 244 ose plus 26%.

Gjykatat administrative të shkallës së parë kanë raportuar një tregues ER 20% më i ulët se ai i një viti më parë. Pra nga 589 në 470 çështje për gjyqtar. Megjithatë këtu duhet theksuar që gjykatat administrative të shkallës së parë gjithsesi tregojnë një rendiment mjaft të mirë dhe ende mbi mesataren në shkallë vendi që është 448.

Pavarësisht faktorëve të analizuar më sipër të cilat e bëjnë treguesin ER një tregues që nuk duhet lexuar vetëm matematikisht për të matur performancën e gjyqtarëve, duke qëndruar në gjykatat e të njëjtit nivel, me të njëjtën kompetencë lëndore dhe që kanë një ngarkesë të përafërt të çështjeve, mund të konkludohet që gjykatat me ER më të ulët se sa mesatarja dhe njëkohësisht me stok të lartë çështjesh të mbartura kanë hapësira për të përmirësuar ritmin e punës. P.sh., nëse krahasojmë Gjykatat e Rretheve Durrës dhe Vlorë, si gjykata të të njëjtit juridiksion dhe me ngarkesë të krahasueshme, vërehet se:

	Çështje të përfunduara	Nr. gjyqtarë	ER	WR
Durrës	6098	13	469	586
Vlorë	7742	11	704	821

Në konkluzion mund të thuhet që treguesi ER ose raporti ndërmjet numrit të personelit të përdorur në gjykatë dhe outputit/zgjdhjes së çështjeve nga e njëjta gjykatë në fund të vitit, përfaqëson një element të rëndësishëm të analizës, tregon

ritmet mesatare të punës për gjyqtar, dhe në realitet paraqet një variancë të theksuar në gjykata të ndryshme, nga 987,5 (Gjykata Administrative Korçë) deri në 281,1 (Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë).

Treguesi ER në rang vendi për vitin 2019 (448,3 çështje të zgjidhura për gjyqtar në vit) është rritur me 31% krahasuar me mesataren vitit 2018 (310,8). Nga 38 gjykata të vendit, 76% e tyre (29) e kanë përmirësuar ndjeshëm treguesin ER nëse krahasohen të dhënat e vitit 2019 me vitin 2018.


6.3.6 RAPORTI I QARKULLIMIT TË ÇËSHTJEVE

Raporti i qarkullimit të çështjeve është raporti ndërmjet numrit të çështjeve të zgjidhura (të përfunduara gjatë vitit), me numrin e çështjeve të pazgjidhura (të mbartura), në fund të periudhës. Ky raport tregon sa gjykata është në gjendje të ruajë ritmin, pra të procesojë çështjet e ardhura. Mesatarja në shkallë vendi për këtë tregues është 1.3 për çështjet civile, 3.4 për çështjet penale dhe 0.6 për çështjet administrative. Nëse në përlogaritjen e indikatorit RQC përjashtohet Gjykata e Lartë, për arsyet e funksionimit të pjesshëm dhe të kufizuar në vitin 2019, vlerat mesatare në rang vendi do të ishin përkatësisht 2,1; 4,9 dhe 1,0.

$$RQC = \frac{\text{numri i çështjeve të zgjidhura}}{\text{numri i çështjeve të pazgjidhura në fund të periudhës}}$$

Ky tregues përdoret më së shumti në kombinim me indikatorë të tjerë dhe në përgjithësi sa më i lartë të jetë aq më “shëndetshëm” funksionon sistemi gjyqësor.

Ky raport është përlogaritur referuar llojit të çështjeve, civile, penale dhe administrative duke u pasqyruar grafikisht për çdo gjykatë. Nga këto të dhëna rezulton se në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm RQC për çështjet penale është më i lartë se për çështjet civile. Këtu përbën rast përjashtimor Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë e cila tregon RQC dukshëm më të lartë për çështjet civile në raport më ato penale. Në rastin e kësaj gjykate ky tregues demonstroi vlera të tilla sepse edhe numri i çështjeve të regjistruara në këtë gjykatë në vitin 2019 ka pasur një trend disi të panatyrshëm krahasuar me gjykatat e tjera të juridiksionit të përgjithshëm: 668 çështje civile dhe 248 penale. RQC më i lartë për çështjet penale lidhet me kohën e procedimit të tyre dhe afatet ligjore procedurale të shkurtra të parashikuara nga legjislacioni procedural brenda të cilave duhet të përfundohet shqyrtimi i çështjeve penale, sipas llojit të tyre.



Në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm raporti i qarkullimit të çështjeve është më i lartë se sa në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Kjo tregon se çështjet në gjykatën e shkallës së parë kanë qarkullim më të shpejtë se sa ato në gjykatën e apelit të të njëjtit juridiksion. E njëjta situatë vërehet dhe në Gjykatën për Krime të Rënda⁷³ në raport me Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda. Të dy këto gjykata kanë RQC të lartë. Kjo tregon për një qarkullim më të shpejtë të çështjeve. Megjithatë gjykata e shkallës së parë ka nivel më të lartë RQC në raport me gjykatën e apelit për krime të rënda.

Në Gjykatat Administrative RQC në Gjykatën e Apelit është tepër i ulët, çka lidhet drejtpërdrejt dhe me numrin e lartë të çështjeve të mbartura në këtë gjykatë. Ndërkohë në gjykatat administrative të shkallës së parë RQC më të lartë e kanë Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Gjirrokastër dhe Korçë. Nivelin më të ulët të RQC e shënojnë Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Shkodër.

Në nivelin e ulët të RQC ndikon drejtpërdrejt ngarkesa e gjykatave si dhe numri i gjyqtarëve në raport me ngarkesën në rritje. Vihet re se nivel të ulët të RQC shënojnë gjykatat e apeleve të cilat kanë një ngarkesë të lartë çështjesh dhe gjatë vitit 2019 janë përballur edhe me një ulje të numrit të gjyqtarëve për shkak të procesit të rivlerësimit, duke bërë që çështjet të procedohen më ngadalë duke rritur kohën e trajtimit të tyre dhe për pasojë duke ulur nivelin e RQC.

Në konkluzion, raporti i qarkullimit të çështjeve është raporti ndërmjet numrit të çështjeve të zgjidhura (të përfunduara gjatë vitit), me numrin e çështjeve të pazgjidhura (të mbartura), në fund të periudhës.

Raporti i qarkullimit të çështjeve ka tregues shumë pozitivë për çështjet penale

⁷³ Aktualisht të transformuara në Gjykatat e Posaçme.

dhe çështjet civile. **Ndërkohë që RQC administrative ka ende hapësira për përmirësim të mëtejshëm.** Mesatarja në shkallë vendi për këtë tregues është 1.3 për çështjet civile, 3.4 për çështjet penale dhe 0.6 për çështjet administrative. Pra për çdo 1,3 çështje të zgjidhura civile, në fund të vitit ka mbetur një çështje civile e pazgjidhur. Nëse në përlogaritjen e indikatorit RQC përjashtohet Gjykata e Lartë, për **arsye të funksionimit të pjesshëm dhe të kufizuar në vitin 2019**, vlerat mesatare në rang vendi do të ishin përkatësisht 2,1; 4,9 dhe 1,0. RQC më i lartë për çështjet penale lidhet me kohën e procedimit të tyre dhe afatet ligjore procedurale më të shkurtra brenda të cilave duhet të përfundohet shqyrtimi i çështjeve penale, sipas llojit të tyre, të parashikuara nga legjislacioni procedural. E njëjta gjë vihet re midis gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm ku RQC është më i lartë se sa në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

6.3.7 KOHA E NEVOJSHME PËR EVADIMIN E ÇËSHTJES (TREGUESI DT)

Treguesi DT krahason numrin e çështjeve të zgjidhura gjatë periudhës së monitoruar dhe numrin e çështjeve të pazgjidhura në fund të periudhës së monitoruar. Numri 365 pjesëtohet me numrin e çështjeve të zgjidhura të pjesëtuar me numrin e çështjeve të pazgjidhura në fund në mënyrë që të mundësohet të shprehurit **në ditë**.

$$DT = \frac{365}{RQC} \quad DT = 365 \times \frac{\text{numri i çështjeve të pazgjidhura në fund të periudhës}}{\text{numrit i çështjeve të zgjidhura gjatë periudhës}}$$

Treguesi DT demonstroi sa arrijnë t'i përgjigjen gjykatat stokut të krijuar të çështjeve, pra sa ditë do t'i duheshin atyre për të trajtuar mesatarisht një çështje. Sa më i lartë treguesi DT aq më e vështirë është për gjykatat që të trajtojnë backlogun e krijuar. Gjithashtu, treguesi DT tregon kohën mesatare të parashikuar (në ditë) të nevojshme për të zgjidhur një çështje në gjykatë, pra kohën mesatare që i nevojitet gjykatës për të marrë një vendim. Treguesi DT krahason numrin e çështjeve të zgjidhura gjatë periudhës së monitoruar dhe numrin e çështjeve të pazgjidhura në fund të periudhës së monitoruar. Raporti mat se sa shpejt sistemi gjyqësor punon mbi çështjet e marra, që do të thotë sa kohë duhet për një lloj të caktuar çështjeje për t'u zgjidhur. Ky tregues jep një perceptim se si sistemi gjyqësor menaxhon sasinë apo fluksin e çështjeve të ardhura.

Nga të dhënat statistikore të gjykatave, treguesi DT rezultoi sipas tabelës në vijim:


GJYKATA	DT CIVILE	DT PENALE	DT ADMIN
Berat	98	53	NA
Dibër	86	38	NA
Durrës	94	85	NA
Elbasan	142	33	NA

Fier	66	45	NA
Gjirokastrë	85	66	NA
Kavajë	160	32	NA
Korçë	101	29	NA
Krujë	52	39	NA
Kukës	72	66	NA
Kurbin	102	44	NA
Lezhë	71	62	NA
Lushnje	63	48	NA
Mat	76	36	NA
Përmet	97	57	NA
Pogradec	149	43	NA
Pukë	21	79	NA
Sarandë	100	44	NA
Shkodër	86	54	NA
Tiranë	128	55	NA
Tropojë	55	34	NA
Vlorë	79	36	NA
Shk.I.Kr.R	NA	12	NA
Apeli Tiranë	1355	483	NA
Apeli Shkodër	379	133	NA
Apeli Durrës	524	162	NA
Apeli Korçë	151	106	NA
Apeli Gjirokastrë	177	44	NA
Apeli Vlorë	1095	183	NA
Apel Kr.R.	NA	23	NA
Apel Adm	NA	NA	1171
Adm Tiranë	NA	NA	106
Adm Shkodër	NA	NA	587
Adm Durrës	NA	NA	201
Adm Korçë	NA	NA	29
Adm Gjirokastrë	NA	NA	24
Adm Vlorë	NA	NA	68
Gjykata e Lartë	66803	10228	19495

Në lidhje me mesataren në shkallë vendi, vlerat e treguesit DT janë dhënë më poshtë, si duke përfshirë Gjykatën e Lartë ashtu edhe duke e përfshirë atë, për shkak se Gjykata e Lartë, e cila për vitin 2019 nuk ka funksionuar normalisht, ndikon "artificialisht" në përkeqësimin e vlerave mesatare të të gjithë sistemit:

	DT civile	DT penale	DT administrative
DT mesatare përfshirë GJL	274,5 ditë	106,1 ditë	598,2 ditë
DT mesatare përjashtuar GJL	172,5 ditë	74 ditë	360,4 ditë

Siç shihet edhe nga grafiku i mëposhtëm, vetëm disa gjykata, si ajo e apelit Tiranë, apelit Vlorë dhe apelit administrativ shfaqen në vështirësi me treguesin DT që shkon mes 3 dhe 4 vjetëve. Në këto kushte, dhe sidomos duke pasur parasysh që backlogu i gjykatave në përgjithësi shënon rritje nga viti 2018 në vitin 2019, duhen shtuar përpjekjet për gjetjen e zgjidhjeve që do të trajtojnë çështjen e kohës së trajtimit të çështjes sidomos për gjykatat e apelit dhe rrjedhimisht rritjen e efijencës në drejtësi nëpërmjet trajtimit në kohë të çështjeve dhe dhënien pa vonesë të drejtësisë.



Një element krahasimor me mjaft vlera mbi treguesin DT është raporti me vlerat mesatare të sistemeve gjyqësore në Evropë.

	Civile		Penale		Administrative	
	BE	AL	BE	AL	BE	AL
Shkalla e parë	192 ditë	104 ditë	117 ditë	48 ditë	229 dite	119 ditë
Apel	122 ditë	784 ditë	77 ditë	267 ditë	228 dite	1171 ditë
GJL	179 ditë	66803 ditë	105 ditë	10228 ditë	187 dite	19495 ditë

Siç shihet nga tabela më sipër, në të cilën janë pasqyruar treguesit DT për secilën shkallë të gjykimit përkundrejt mesatares evropiane sipas raportit CEPEJ për 2016⁷⁴, rezulton se në shkallë të parë treguesi DT është ndjeshëm më mirë se niveli mesatar evropian, kurse për apelin ky tregues ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm.

Në shkallë të parë, për të tria kategoritë e çështjeve, treguesi DT është ndjeshëm më mirë krahasuar me mesataren evropiane, duke treguar për efijencë të lartë të

⁷⁴ https://public.tableau.com/profile/cepej#!/vizhome/CEPEJ-Overviewv5_0EN/Overview

gjykatave të shkallës së parë në trajtimin e çështjeve në një kohë më të shkurtër.

Për gjykatat e apelit treguesi i kohës së nevojshme për evadimin e çështjeve është mbi nivelin mesatar evropian për të gjitha kategoritë e çështjeve, veçanërisht për çështjet administrative. Kjo e dhënë reflekton ngarkesën e lartë të çështjeve në gjykatat e apelit si dhe disbalancim të burimeve njerëzore në këto gjykata në raport me ngarkesën. Faktor tjetër që mund të ndikojë në këtë tregues është edhe aspekti procedural i trajtimit të çështjeve. Konkretisht në gjykatat e shkallës së parë çështjet vihen në lëvizje brenda pak ditësh pasi depozitohen në gjykatë pavarësisht ngarkesës që mund të ketë gjyqtari me çështje të tjera. Në gjykatën e apelit jo të gjitha çështjet vihen në lëvizje pas depozitimit të tyre, duke lejuar një kohë më të gjatë në të cilën çështja qëndron në pritje⁷⁵, e duke ndikuar kështu drejtpërdrejt në kohëzgjatjen e procedimit të saj.

Në lidhje me Gjykatën e Lartë, për shkak të mosfunksionimit normalisht për vitin 2019, DT është në nivele tepër të larta dhe të pakrahasueshme më normën evropiane për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Koha e nevojshme për evadimin e çështjeve, sipas kategorive në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit, në raport më afatin e arsyeshëm të parashikuar në nenin 399/2⁷⁶ të Kodit të Procedurës Civile. Në këtë nen përcaktohet afati i arsyeshëm për gjykimin në të tre shkallët e gjykimit për çështjet sipas kategorisë së tyre (penale, civile, administrative).

Në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, për çështjet civile, KPrC përcakton afatin e arsyeshëm prej dy vitesh për secilën shkallë gjykimi. Nga krahasimi i DT për gjykatat e shkallës së parë me afatin e arsyeshëm rezulton se norma mesatare e DT është ndjeshëm më e ulët se afati i arsyeshëm dhe në asnjë nga gjykatat nuk konstatohet normë më e lartë DT se sa afati i arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve civile. Për treguesin DT të çështjeve civile në gjykatat e apelit rezulton se mesatarja e DT kalon afatin e arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve të përcaktuar nga ligji (2 vjet ose 730 ditë).

⁷⁵ Në gjykatat e apelit çështjet shqyrtohen sipas kalendarit të shqyrtimit në referim të nenit 460 të Kodit të Procedurës Civile dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.78, datë 30.05.2019 “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”.

⁷⁶ Neni 399/2 i K.Pr.C parashikon se “1. Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen:

- a) në gjykimin administrativ në shkallën e parë dhe në apel, përfundimi i gjykimit brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë;
- b) në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjykimit brenda dy viteve, në gjykim civil në apel brenda dy vjetëve; dhe gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, brenda dy vjetëve;.....
- d) në gjykimin penal në shkallë të parë, afati i gjykimit të krimeve 2 vjet dhe i kundërvajtjeve 1 vit, në gjykimin në apel përfundimi i gjykimit për krimet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj dhe në Gjykatën e Lartë, përfundimi i gjykimit për krimet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj.”.

Për çështjet penale neni 399/2 parashikon si afat të arsyeshëm për gjykimin e çështjeve penale për krime afatin 2-vjeçar në shkallë të parë dhe 1-vjeçar në shkallë të dytë dhe për kundërvajtjet penale afatin 1-vjeçar për gjykimin në shkallë të parë dhe 6-mujor për gjykimin në shkallë të dytë.

Duke krahasuar mesataren e DT me afatin e arsyeshëm të parashikuar nga ligji (në mungesë të të dhënave për kohën e trajtimit të çështjeve penale sipas ndarjes në krime dhe kundërvajtje) rezulton se **DT mesatar për shkallën e parë është 48 ditë, ndjeshëm më i mirë se afati i arsyeshëm i parashikuar nga ligji ndërsa për apelin nivelin mesatar i DT është 267 ditë, gjithashtu brenda afatit të arsyeshëm për veprat penale të llojit krime.**

Referuar treguesve mesatarë si më sipër, në raport me afatin e arsyeshëm të parashikuar nga legjislacioni procedural, mund të thuhet se çështjet civile, penale dhe administrative në shkallë të parë gjykohen brenda afateve të arsyeshme dhe po kështu në gjykatat e apelit me përjashtim të çështjeve administrative për të cilat treguesi DT në disa raste e kalon afatin e arsyeshëm të parashikuar nga neni 399/2 pika 1 shkronja “a” i Kodit të Procedurës Civile.

6.3.8 NORMA E ZGJIDHJES SË ÇËSHTJEVE (TREGUESI CR)

Treguesi CR përcaktohet nga raporti ndërmjet çështjeve të përfunduara brenda një periudhe dhe çështjeve të reja, dhënë në përqindje.

$$CR = \frac{\text{numrit të çështjeve të zgjidhura}}{\text{numrit të çështjeve të ardhura}} \times 100$$

Treguesi CR ofron një trend të përgjithshëm mbi gjendjen e sistemit gjyqësor për sa i përket ecurisë së sistemit në harkun kohor prej një viti, pra ofron një pasqyrë nëse gjykatat kanë arritur të ruajnë ritmin mes çështjeve të reja të regjistruara dhe atyre të përfunduara. Llogaritja e Treguesit CR bëhet duke pjesëtuar numrin e çështjeve të përfunduara me numrin e çështjeve të reja dhe vlera shumëzohet me 100 për t’u shprehur rezultati në përqindje. Për rastet kur treguesi është nën 100% mund të thuhet që ritmet nuk kanë qenë të mundur të ruhen dhe backlog-u i çështjeve është rritur në krahasim me një vit më parë. Në këto raste një analizë e thelluar duhet të shqyrtojë edhe alternativat për zgjidhjen e problematikës në një kohë sa më të shkurtër të mundshme në mënyrë që numri i çështjeve të prapambetura të mos bllokojë sistemin dhe që zgjidhja e çështjeve të bëhet brenda afateve të caktuara në legjislacionin procedural në fuqi.

Tabela në vijim pasqyron treguesit CR për të gjitha gjykatat e vendit, të ndara sipas kategorive të çështjeve.

GJYKATA	CR CIVILE	CR PENALE	CR ADMIN
Berat	97	96	
Dibër	94	101	
Durrës	94	95	
Elbasan	107	98	
Fier	98	102	
Gjirokastrë	98	90	
Kavajë	96	100	
Korçë	94	103	
Krujë	101	101	
Kukës	91	92	
Kurbin	103	102	
Lezhë	96	97	
Lushnje	102	98	
Mat	95	101	
Përmet	91	95	
Pogradec	91	97	
Pukë	101	90	
Sarandë	88	96	
Shkodër	101	101	
Tiranë	90	96	
Tropojë	101	96	
Vlorë	95	103	
Shk.I.Kr.R	NA	101	
Apeli Tiranë	50	82	
Apeli Shkodër	85	103	
Apeli Durrës	71	90	
Apeli Korçë	102	91	
Apeli Gjirokastrë	89	99	
Apeli Vlorë	50	95	
Apel Kr.R.		103	
Apel Adm			86
Adm Tiranë			94
Adm Shkodër			75
Adm Durrës			102
Adm Korçë			110
Adm Gjirokastrë			101
Adm Vlorë			101
Gjykata e Lartë	4	16	9

Referuar tabelës rezulton se një pjesë e gjykatave **më të rëndësishme në vend** kanë shënuar CR që kalon 100 % siç janë Gjykata e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë, Gjirokastrë dhe Vlorë dhe Gjykatat e Rretheve Krujë, Kurbin dhe Shkodër.

Për efekt krahasimi, në tabelën më poshtë janë pasqyruar treguesit CR për vitin 2019 për të tre shkallët e gjykimit përkundrejt mesatares evropiane sipas të

dhënave të CEPEJ-it⁷⁷.

	Civile		Penale		Administrative	
	BE	AL	BE	AL	BE	AL
Shkalla e parë	100	94,5	101,2	98,7	100	98
Apel	100,2	63,3	100,2	89,9	97,9	86,4
GJL	100	3,6	99,5	16,1	98,9	9,2

Siç shihet nga kjo tabelë, mesatarja e vendit tonë për treguesin CR është në rrugën e duhur për të arritur mesataren evropiane. Diferenca më e theksuar mes mesatares evropiane të CR dhe mesatares për Shqipërinë për vitin 2019 rezulton në Gjykatën e Lartë dhe në gjykatat e apelit, vetëm në lidhje me çështjet civile. Për sa i përket Gjykatës së Lartë situata e funksionimit të saj me 3 dhe 1 gjyqtar gjatë gjithë vitit 2019 përbën shkakun e kësaj situatë. Aktualisht me masat e marra nga KLGJ-ja kjo gjykatë pritet që në fund të vitit 2020 të behët me 10 gjyqtarë. Për rrjedhojë dhe situata në lidhje me këtë indikator do të ndryshojë ndjeshëm.

Për sa i përket gjykatave të apelit dhe indikatorit CR më të ulët për çështjet civile në raport me dy kategoritë e tjera, ky i fundit ndikohet nga faktorë që lidhen me:

kompleksitetin e çështjeve, numrin e palëve ndërgjyqëse dhe kohën e nevojshme të trajtimit të tyre me ngarkesën në rritje të gjykatave në tërësi por edhe burimet njerëzore të pamjaftueshme në shumicën prej tyre (siç rezulton, vetëm 6 gjykata kanë funksionuar me numrin e plotë të gjyqtarëve të parashikuar në organikën e tyre) veçanërisht si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar.

Në tabelat në vijim paraqitet edhe krahasimi i treguesit CR për vitet 2018 dhe 2019, për të gjitha gjykatat e vendit, me përjashtim të Gjykatës së Lartë, për të cilën mosfunksionimi për një pjesë të mirë të vitit 2019 e bën të pavlefshëm krahasimin:

GJYKAT	CIVILE	CIVILE	# CIV	PENALE	PENALE	# PEN
A	2018	2019		2018	2019	
Berat	76,6	96,9	20,3	88,0	95,7	7,7
Dibër	86,0	93,8	7,8	89,0	101,3	12,3
Durrës	95,7	94,0	-1,7	90,5	94,6	4,1
Elbasan	102,0	107,2	5,2	91,0	98,4	7,4
Fier	101,3	98,2	-3,1	98,8	102,1	3,3
Gjirokastrë	89,8	97,6	7,8	108,0	90,4	-17,6
Kavajë	74,0	95,5	21,5	92,0	100,1	8,1
Korçë	98,4	94,2	-4,1	95,7	102,5	6,8
Krujë	85,3	100,6	15,3	87,6	101,0	13,4

⁷⁷ https://public.tableau.com/profile/cepej#!/vizhome/CEPEJ-Overvieëv5_0EN/Overvieë

Kukës	79,8	90,6	10,8	86,4	91,8	5,4
Kurbini	97,5	102,6	5,1	98,0	101,9	3,9
Lezhë	97,8	96,3	-1,6	95,5	96,9	1,5
Lushnje	110,0	102,2	-7,8	106,0	98,4	-7,6
Mat	81,5	95,2	13,7	87,5	100,8	13,3
Përmet	83,0	91,3	8,3	89,0	94,9	5,9
Pogradec	111,4	91,4	-20,0	98,5	96,6	-1,9
Pukë	85,4	101,0	15,7	90,1	89,9	-0,2
Sarandë	105,4	87,9	-17,5	99,9	96,3	-3,6
Shkodër	80,0	101,1	21,1	85,3	100,6	15,3
Tiranë	101,4	90,5	-10,9	99,0	97,8	-1,2
Tropojë	57,7	101,2	43,5	21,1	95,7	74,6
Vlorë	97,4	95,1	-2,3	108,6	103,0	-5,6
Apeli Tiranë	75,8	49,9	-25,9	123,0	81,7	-41,3
Apeli Shkodër	96,0	84,7	-11,3	152,4	102,8	-49,6
Apeli Durrës	79,0	71,4	-7,6	103,0	90,3	-12,7
Apeli Korçë	93,4	102,3	8,9	110,0	91,2	-18,8
Apeli Gjirokastrë	92,7	88,7	-4,0	102,9	99,2	-3,6
Apeli Vlorë	114,9	49,7	-65,2	113,0	94,6	-18,3

Krahasimi i treguesit CR për vitin 2018 me atë të vitit 2019 për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm demonstroi që në përgjithësi ka pasur një përmirësim të këtij treguesi **17 gjykata nga ku në 11 prej tyre përmirësim të plotë** (si për çështjet penale ashtu edhe për ato civile) **dhe** për 7 gjykata ka pasur përmirësim të **pjeshëm** (vetëm njërit prej indikatorëve CR). Ndërsa për 9 gjykata treguesi CR si për çështjet civile ashtu edhe për ato penale ka pësuar rënie.

GJYKATA	PENALE 2019	PENALE 2018	# PEN
Shk.I.Kr.R	100,6	100,4	0,2
Apel Kr.R.	102,6	100,0	2,6

Gjykatat e juridiksionit të posaçëm për krimet e rënda kanë përmirësuar treguesin CR për të dyja shkallët e gjykimit.

GJYKATA	ADM 2019	ADM 2018	# ADM
Apel Adm	86,4	107,9	-21,5
Adm Tiranë	94,1	101,1	-7,0
Adm Shkodër	75,1	110,0	-34,9
Adm Durrës	102,1	84,2	17,9
Adm Korçë	110,2	102,5	7,7
Adm Gjirokastrë	101,1	97,7	3,4
Adm Vlorë	100,7	99,0	1,7

Gjykatat e juridiksionit administrativ kanë përmirësuar treguesin CR në katër raste ndërsa është në tre raste të tjera ka pasur pak rënie.


Në përfundim mund të thuhet që gjatë vitit 2019 në përgjithësi sistemi gjyqësor ka treguar përmirësime të ndjeshme, të plota apo të pjesshme, në 25 nga 38 gjykatat e vendit, ose në më shumë se 65% të tyre. Puna e disa gjykatave që ende nuk e arrijnë mesataren evropiane të treguesit CR, sidomos për çështjet civile, po vazhdon me qëllim mbërritjen e tyre në vitet në vijim.

6.3.9 REGJISTRIMI AUDIO NË GJYKATA

Zbatimi i sistemit të regjistrimit digjital audio në gjykata përbën një kërkesë të detyrueshme ligjore, çka garanton saktësi të nivelit të lartë të dokumentimit të seancës gjyqësore dhe rrit transparencën, efikasitetin si dhe përmirëson administrimin e gjykatave. Për më tepër, regjistrimi audio i seancave garanton transparencë dhe efikasitet më të lartë në përdorimin e burimeve të sistemit gjyqësor. Përdorimi i sistemit audio të regjistrimit të seancave gjyqësore, përbën një investim të rëndësishëm në sistemin gjyqësor në funksion të transparencës dhe efijencës.

Sipas të dhënave statistikore të pasqyruara në grafikun e mëposhtëm, regjistrimi audio i seancave në rang vendi për vitin 2019 është 64,80%. Vërehet se pjesa më e madhe e gjykatave kanë nivel përdorimi të sistemit audio mbi 90 % ndërkohë që disa gjykata kanë nivel të përdorimit të sistemit audio nën nivelin mesatar në shkallë vendi. Konkretisht nga gjykatat e shkallës së parë shënon nivel përdorimi nën mesataren në shkallë vendi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, niveli i përdorimit të sistemit audio është mbi 80 % ndërsa në gjykatat administrative të shkallës së parë, përveç Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, të gjitha gjykatat e tjera kanë nivel më të ulët të përdorimit të sistemit krahasuar me mesataren në shkallë vendi, ndërsa nivel dukshëm të ulët shënon Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës.



Lidhur me shkaqet që kanë ndikuar në nivelin e përdorimit të sistemit audio për regjistrimin e seancave, argumentimi i referohet raportimit periodik të kryetarëve të gjykatave. Në këto raportime, në zbatim të vendimit nr. 25, datë 07.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore”, pasqyrohet edhe përdorimi i sistemit audio dhe problematikat e lidhura me të. Në këtë kontekst, shkak kryesor që raportohet si ndikues mbi numrin e seancave të cilat regjistrohen nëpërmjet audios, është pamjaftueshmëria e sallave të pajisura me sistemet e regjistrimit audio ku të mund të zhvillohen gjykimet.

Në përlogaritjen e përdorimit të sistemit të regjistrimit audio, të dhënë në tabelën më poshtë, nuk llogariten seancat në dhomë këshillimi, të cilat sipas legjislacionit procedural, nuk janë të detyrueshme të regjistrohen.

Gjykata	Seanca të regjistruara audio	Seanca të paregjistruara audio	Seanca në dhomë këshillimi	Seanca gjithsej	Regj audio 2019	Regj audio 2018	Diferenca
Berat	8993	1690	800	11483	84,18	78,32	5,86
Dibër	2918	21	605	3544	99,29	82,34	16,95
Durrës	9166	10825		19991	45,85	45,85	0,00
Elbasan	14414	402	1355	16171	97,29	89,13	8,15
Fier	14518	4085	1052	19655	78,04	73,86	4,18
Gjirokastrë	7035	0	23	7058	100,00	99,67	0,33
Kavajë	6938	912	0	7850	88,38	88,38	0,00
Korçë	11214	240	240	11454	97,90	97,90	0,00
Krujë	7603	47	490	8140	99,39	93,40	5,98
Kukës	3652	174	0	3826	95,45	95,45	0,00
Kurbini	4065	637	0	4702	86,45	86,45	0,00
Lezhë	8037	138	799	8974	98,31	89,56	8,75
Lushnje	5915	144	588	6647	97,62	88,99	8,64
Mat	2210	14	363	2587	99,37	85,43	13,94

Përmet	1136	0	110	1246	100,00	91,17	8,83
Pogradec	4689	61	61	4750	98,72	98,72	0,00
Pukë	2074	6	0	2080	99,71	99,71	0,00
Sarandë	7059	22	222	7303	99,69	96,66	3,03
Shkodër	16220	182	3344	19746	98,89	82,14	16,75
Tiranë	13655	73419		87074	15,68	15,68	0,00
Tropojë	1925	190	11	2126	91,02	90,55	0,47
Vlorë	13177	2465	2426	18068	84,24	72,93	11,31
Shk.I.Kr.R	2894		231	3125	100,00	92,61	7,39
Apeli Tiranë	8055	1667	1667	9722	82,85	82,85	0,00
Apeli Shkodër	4705	7		4712	99,85	99,85	0,00
Apeli Durrës	4841	422	0	5263	91,98	91,98	0,00
Apeli Korçë	2110	113	113	2223	94,92	94,92	0,00
Apeli Gjirokastrë	2968	23	0	2991	99,23	99,23	0,00
Apeli Vlorë	1749	0	353	2102	100,00	83,21	16,79
Apel Kr.R.	788	27	27	815	96,69	96,69	0,00
Apel Adm	3053	0	4663	7716	100,00	39,57	60,43
Adm Tiranë	9587	11059	3730	24376	46,44	39,33	7,11
Adm Shkodër	1219	667	109	1995	64,63	61,10	3,53
Adm Durrës	1178	5061	1344	7583	18,88	15,53	3,35
Adm Korçë	2448	1354	1354	3802	64,39	64,39	0,00
Adm Gjirokastrë	1844	1235	1133	3079	59,89	59,89	0,00
Adm Vlorë	3575	914	1054	5543	79,64	64,50	15,14
Gjykata e Lartë	7			7	100,00	100,0	0,00

Nga informacioni i përcjellë, konstatohet se një numër i konsiderueshëm gjykatash: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, Mat, Krujë, Sarandë, Pukë, Gjirokastrë, Përmet, Gjykatat e Apelit Gjirokastrë, Shkodër, Vlorë, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Gjykata e Apelit Administrativ dhe Gjykata e Lartë përdorin në nivelin 99% regjistrimin audio në seanca gjyqësore.

Gjykata me përqindjen më të ulët të përdorimit të sistemit të regjistrimit audio mbetet Gjykata Rrethit Gjyqësor Tiranë, me 15.68%, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës me 18.88%, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me 45.85%. Shkaku kryesor që raportohet si ndikues mbi numrin e seancave të cilat regjistrohen nëpërmjet audios, është mungesa e sallave të pajisura me sistemet e përshtatshme të regjistrimit audio për shkak të numrit të lartë të çështjeve për gjykim si dhe numri i lartë i seancave gjyqësore që zhvillohet në ditë për gjyqtarë.

Gjithashtu, krahasimi i treguesve të vitit 2019 me treguesit e nivelit të përdorimit

të regjistrimit audio gjatë vitit 2018, demonstroi që 21 gjykata ose mbi 55% e kanë përmirësuar përqindjen e regjistrimit audio të seancave.

6.3.10 KOHËZGJATJA E ÇËSHTJEVE

Lidhur me kohëzgjatjen e çështjeve, për vitin 2019 është kërkuar nga gjykatat të raportojnë numrin e çështjeve të përfunduara gjatë vitit 2019, të ndara sipas kategorive, për çdo segment kohëzgjatjeje (nga momenti i regjistrimit në gjykatë deri në momentin e marrjes së vendimit): më pak se një muaj, 1-6 muaj, 7-12 muaj, 1-2 vjet dhe më shumë se 2 vjet. Gjithashtu është kërkuar e njëjta ndarje çështjesh, për kategori, për çështjet që më datë 31 dhjetor 2019 ishin ende në gjykim.

Në të dhënat tabelare dhe grafike përfshihen çështjet e të gjitha gjykatave, pa përjashtuar Gjykatën e Lartë, që duke mos funksionuar normalisht gjatë vitit 2019, ndikon ndjeshëm treguesit e kohëzgjatjes së gjykimit për të gjitha kategoritë e çështjeve. Nëse në analizë nuk do të përfshihen çështjet e Gjykatës së Lartë, për shkak të mosfunksionimit të saj, të gjithë treguesit e kohëzgjatjes së gjykimeve do të shënonin vlera më pozitive.

Çështjet e përfunduara gjatë vitit 2019 në përqindje, përkundrejt totalit të kategorisë respektive të çështjes:

	CESHTJE TE PERFUNDUARA GJATE VITIT				
	< 1 muaj	1-6 muaj	7-12 muaj	1-2 vjet	> 2 vjet
civile të përgjithshme	38,2	39,3	12,5	7,3	2,8
familjare	25,8	58,2	12,2	3,3	0,5
marrëdhënie pune	4,6	49,2	32,8	10,7	2,7
tregtare	46,8	41,8	10,1	0,9	0,3
TOTAL CIVILE	33,8	44,8	13,3	6,1	2,0
penale themeli (krime)	26,2	46,2	17,6	7,4	2,7
penale themeli (kundërvajtje)	23,7	62,0	7,0	2,4	4,9
kërkesa administrative penale	45,0	53,0	1,4	0,3	0,2
penale me të mitur në konflikt me ligjin	67,2	31,6	0,7	0,1	0,4
TOTAL PENALE	39,7	47,5	7,9	3,1	1,7
administrative të përgjithshme	29,3	51,6	5,2	5,2	8,7
marrëdhënie pune	41,2	34,1	3,4	4,2	17,1
TOTAL ADMINISTRATIVE	30,7	49,6	5,0	5,1	9,7
GRAND TOTAL	36,0	47,0	9,2	4,5	3,3

Nga të dhënat tabelare të mësipërme, rezulton se numri më i madh i çështjeve janë

shqyrtuar dhe kanë përfunduar brenda një afati 1 deri në 6 muaj, konkretisht rreth 83% e çështjeve të përfunduar në vitin 2019, nga të cilat 36% e çështjeve kanë përfunduar për një periudhë deri në 1 muaj nga momenti i regjistrimit. Konstatohet se ritmin më të shpejtë të shqyrtimit brenda një afati 1 deri në 6 muaj nga regjistrimi e kanë çështjet penale me 88%, më pas çështjet administrative me 81% dhe në fund çështjet civile me 79%.

Lidhur me çështjet të cilat kanë përfunduar tej një afati të arsyeshëm, nga të dhënat e raportuara rezulton se në çështjet civile vetëm 2% e çështjeve kanë përfunduar për një afat kohor më tepër se dy vjet duke cenuar standardin e afatit të arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve civile të përcaktuar në nenin 399/2 pika 1 shkronja “b” të K.Pr.C.

Në kategorinë e çështjeve të klasifikuara si sensitive për shkak të objektit, çështjet për marrëdhënie pune, rezulton se në gjykatat civile vetëm 2.7 % e tyre kanë zgjatur mbi dy vjet, duke tejkaluar afatin e arsyeshëm për trajtimin e çështjeve në gjykatat civile sipas nenit 399/2 pika 1 shkronja “b” të K.Pr.C .

Në çështjet penale në total rezulton se 4.8 % e çështjeve kanë zgjatur më tepër se një vit dhe vetëm 1.7 % kanë zgjatur mbi 2 vjet. Referuar kategorive të çështjeve të themelit për të cilat ligji parashikon afat të arsyeshëm gjykimi në nenin 399/2 të K.Pr.C konstatohet se 2.7 % e çështjeve penale të themelit për krime dhe 4.9 % për kundërvajtje kanë zgjatur mbi 2 vjet. Theksojmë se për në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, po t’i referohemi të dhënave statistikore pa përfshirë çështjet e Gjykatës së Lartë, përqindja e çështjeve penale të cilat kanë zgjatur mbi 2 vjet do të rezultojë tepër e ulët.

Për çështjet administrative, për të cilat neni 399/2 pika 1 shkronja “a” e K.Pr.C parashikon afatin e arsyeshëm 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit në shkallë të parë dhe në apel, nga të dhënat statistikore rezulton se 85,2 % e çështjeve janë zgjidhur brenda afatit njëvjeçar ndërsa 5,1 % e çështjeve kanë zgjatur nga 1 deri në 2 vjet dhe 9,7 % e tyre kanë zgjatur mbi 2 vjet. Pra 14,8 % e çështjeve administrative janë gjykuar tej afatit të arsyeshëm 1-vjeçar. Në kategorinë e çështjeve të klasifikuara si sensitive për shkak të objektit, çështjet për marrëdhënie pune, rezulton se në gjykatat administrative 21,3% e tyre janë trajtuar jashtë afatit të arsyeshëm 1-vjeçar.

Sa i përket ecures së çështjeve që më datë 31 dhjetor 2019 janë ende në proces, të dhënat janë pasqyruar në tabelat e mëposhtme:

	çështje ende në gjykim				
	< 1 muaj	1-6 muaj	7-12 muaj	1-2 vjet	> 2 vjet
civile të përgjithshme	6,9	16,7	15,7	24,4	36,2
familjare	20,8	50,3	21,1	6,7	1,0

marrëdhënie pune	14,1	27,8	26,8	30,0	1,4
tregtare	26,9	33,6	27,2	8,6	3,7
TOTAL CIVILE	9,0	20,7	17,1	22,9	30,3
penale themeli (krime)	14,0	27,3	25,0	19,1	14,5
penale themeli (kundërvajtje)	15,8	33,3	17,1	18,3	15,5
kërkesa administrative penale	33,4	39,8	16,5	6,7	3,6
kërkesa për hetim paraprak (masa sigurimi etj....)	46,5	32,1	11,1	5,3	5,0
TOTAL PENALE	18,8	30,0	21,7	16,7	12,8
administrative të përgjithshme	8,0	24,1	19,8	26,0	22,1
marrëdhënie pune	7,0	14,2	5,8	20,7	52,3
TOTAL ADMINISTRATIVE	7,9	23,0	18,3	25,4	25,5
GRAND TOTAL	11,5	23,8	18,7	21,7	24,3

Lidhur me kohëzgjatjen e çështjeve ende në proces shqyrtimi, sipas të dhënave statistikore rezultojnë se 11,5% e çështjeve kanë më pak se një muaj që janë regjistruar në gjykatë, 23,8% kanë 1 deri në 6 muaj, 18,7 % e çështjeve kanë 7 deri në 12 muaj, 21,7 % e çështjeve kanë 1 deri në 2 vjet që janë regjistruar dhe 24,3 % e çështjeve rezultojnë të jenë regjistruar në gjykata prej një periudhe më të gjatë se 2 vite dhe ende nuk kanë përfunduar. Siç rezultojnë nga tabela dhe grafiku përkatës, konstatohet se 46 % e çështjeve të papërfunduara në vitin 2019 kanë më shumë se një vit që janë regjistruar në gjykata dhe ende nuk kanë përfunduar gjykimin.

Lidhur me afatet e arsyeshme për shqyrtimin e çështjeve parashikuar nga neni 399/2 i Kodit të Procedurës Civile, konstatohet se për çështjet civile 30,3% e çështjeve në proces kanë kaluar afatin e arsyeshëm 2-vjeçar për shqyrtimin e tyre. Ndërkohë që në kategorinë civile për marrëdhënie pune janë 1,4% e çështjeve që kanë kaluar afatin 2-vjeçar nga momenti i regjistrimit.

Në çështjet administrative 50,9 % e çështjeve në proces në fund të vitit 2019 kanë kaluar afatin e arsyeshëm njëvjeçar për gjykimin e tyre. Në lidhje me çështjet që kanë për objekt konfliktet që burojnë nga marrëdhëniet e punës rezultojnë se 73 % e çështjeve të kësaj kategorie në gjykatat administrative kanë kaluar afatin e arsyeshëm njëvjeçar brenda të cilit duhet të shqyrtohen.

Në lidhje me çështjet penale ligji parashikon afate të ndryshme shqyrtimi për gjykimin në shkallë të parë, në apel dhe në gjykatën e lartë. Nga të dhënat statistikore rezultojnë se për gjykimet e themelit për vepra penale të llojit krime 33,6 % e çështjeve kanë kaluar afatin 1-vjeçar nga momenti i regjistrimit, nga të cilat 14,5 % kanë kaluar më shumë se dy vjet, ndërsa për kundërvajtjet penale 50,9 % e çështjeve kanë kaluar afatin 6-mujor nga momenti i regjistrimit, nga të cilat 18,3 % e çështjeve kanë 1 deri në 2 vjet të regjistruara dhe 15,5 % kanë mbi 2 vjet që janë regjistruar në gjykata dhe nuk kanë përfunduar, duke cenuar afatet e

arsyeshme të gjykimit të parashikuara nga ligji.

Në lidhje me çështjet e papërfunduara të cilat kanë tashmë dy vite që janë regjistruar në gjykata por nuk kanë përfunduar ende rezulton se rreth 24,3 % e çështjeve për të cilat ende nuk është marrë një vendim në fund të vitit 2019, kanë mbi dy vite në proces. Nga këto numrin më të lartë të çështjeve që kanë zgjatur mbi dy vjet e zë Gjykata e Lartë me 69.33 %, Gjykata Administrative e Apelit me 14.8 % dhe Gjykata e Apelit Tiranë me 8.7%.

Ndërkohë disa gjykata si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Kavajë dhe Përmet e kanë zero numrin e çështjeve që kanë zgjatur mbi 2 vjet dhe kanë qenë ende në proces në fund të vitit 2019.

Lidhur me arsyet e kohëzgjatjes së gjykimeve, referuar informacionit periodik që përcillet nga gjykatat, arsyet e zvarritjes së çështjeve lidhen kryesisht me shkaqe procedurale siç janë pezullimi i gjykimit, marrje provash, letërporosi për jashtë shtetit, vendimmarrje nga Gjykata e Lartë lidhur me juridiksionin ose kompetencën si dhe ngarkesën e gjykatave e cila vjen duke u rritur për shkak të mungesës së gjyqtarëve nga largimet prej procesit të rivlerësimit.

Në përfundim mund të thuhet që kohëzgjatja e çështjeve të përfunduara gjatë vitit 2019 ka qenë përgjithësisht e kënaqshme pasi numri më i madh i çështjeve (rreth 83%) janë shqyrtuar dhe kanë përfunduar brenda një afati 6-mujor.

Lidhur me çështjet të cilat kanë përfunduar tej një afati të arsyeshëm, rezulton se në çështjet civile vetëm 2% e çështjeve kanë përfunduar për një afat kohor më tepër se dy vjet duke cenuar standardin e afatit të arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve civile. Referuar kategorive të çështjeve të themelit për të cilat ligji parashikon afat të arsyeshëm gjykimi, konstatohet se 2.7 % e çështjeve penale të themelit për krime dhe 4.9 % për kundërvajtje kanë zgjatur mbi 2 vjet.

Të rëndësishme!

STOKU I ÇËSHTJEVE TË MBARTURA (BACKLOG)

- ❖ Në analizë evidentohet se për vitin 2019, numri i çështjeve të mbartura nga viti 2018 është 77 853 çështje, duke shënuar një rritje rreth 13% krahasuar me një vit më parë.
- ❖ Numrin më të madh të çështjeve të mbartura ose rreth 72% të totalit e mbajnë Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë.
- ❖ Me gjithë vështirësitë, disa nga gjykatat si ato Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë, Gjirokastrë dhe Vlorë e kanë ulur stokun duke shënuar rritje të performancës në krahasim me një vit më parë.
- ❖ Stoku në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm ka pësuar rritje bazuar në shkaqe objektive që lidhet me reduktimin e numrit efektiv të gjyqtarëve si dhe rritjen e numrit të çështjeve të regjistruara në vitin 2019.

- ❖ Standardizimi i raportimit dhe besueshmëria e të dhënave të raportuara, në mungesë të një sistemi automatik të gjenerimit të statistikave ndikon cilësinë dhe konsistencën e të dhënave që janë bazë e analizës statistikore për sistemin gjyqësor.
- ❖ Gjykatat kanë bërë përpjekje për të ruajtur ritmin e zgjidhjes së çështjeve dhe për të mbajtur nën kontroll rritjen e stokut, pavarësisht rritjes së numrit të çështjeve të regjistruara dhe uljen e numrit të gjyqtarëve efektivë.

ÇËSHTJE TË REGJISTRUARA

- ❖ Në vitin 2019 u regjistruan 152 399 çështje në shkallë vendi. Nga këto 123 481 çështje (ose 81%) janë regjistruar si të tilla për herë të parë, pranë gjykatave të shkallës së parë. 22 769 ose 14.9% janë çështjet që janë regjistruar në gjykatat e apelit, nëpërmjet ankimit ose çështje në juridiksion fillestar të këtyre gjykatave. Ndërsa 6 149 ose rreth 4% janë çështje të regjistruara në Gjykatën e Lartë.
- ❖ Numrin më të madh të çështjeve të regjistruara e ka Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me 36 116 çështje të regjistruara në vitin 2019 (rreth 33% e çështjeve të regjistruara në shkallë të parë, ose rreth 24% e totalit të çështjeve të regjistruara në gjykatat e të gjitha niveleve).
- ❖ Numri i çështjeve të regjistruara në vitin 2019 është 3,37% më i lartë se në vitin 2018 dhe 11,44% më i lartë se në vitin 2017.

BURIMET NJERËZORE

- ❖ Pjesa më e madhe e gjykatave ose 84.2% e tyre nuk kanë funksionuar me kapacitetin e plotë të gjyqtarëve. Vetëm 6 nga 38 gjykata kanë funksionuar me 100% të kapacitetit. Mesatarja kombëtare është në shifrat 75,06%.
- ❖ Në Shqipëri sipas organikës ky raport duhet të ishte 14.22 gjyqtarë për 100.000 banorë, ndërkohë që më 31 dhjetor 2019 ka pasur 11.85. Sipas standardeve të CEPEJ-it, mesatarja Evropiane është 17.8 gjyqtarë për 100.000 banorë.
- ❖ Ngarkesa e punës në gjykata është përballuar nga vetëm 306⁷⁸ gjyqtarë ose 10.66 gjyqtarë për 100.000 banorë. Ky raport është më pak se 60% e normës Evropiane.
- ❖ Në Shqipëri ka 32,68 staf mbështetës për 100.000 banorë në krahasim me mesataren Evropiane që është 55 staf mbështetës për 100.000 banorë. Nevojat për staf mbështetës për nevojat e sistemit vlerësohen rreth 100 punonjës shtesë për vitin 2020⁷⁹.

NGARKESA MESATARE E GJYQTARËVE (TREGUESI WR)

Koment: Ngarkesa e gjykatave vlerësohet duke marrë në konsideratë stokun e çështjeve të mbartura nga një vit më parë dhe çështjet e regjistruara gjatë vitit të referencës, pjesëtuar me numrin efektiv të gjyqtarëve. Ky raport tregon volumin e ngarkesës së punës për gjyqtar dhe nuk duhet ngatërruar me normën e efikasitetit (treguesi ER) që llogaritet mbi bazën e çështjeve të zgjidhura.

⁷⁸Këtu merren në konsideratë gjyqtarët që kanë punuar me kohë të plotë si dhe ata me kohë të pjesshme. Tek këta të fundit përfshihen gjyqtarët e shkarkuar me vendim të KPK-së ose ata të futur rishtazi në sistem gjatë vitit 2019.

⁷⁹Për më shumë informacion lidhur me nevojat për burime njerëzore, shikoni kapitullit Nevojat financiare dhe Buxhetore të KLGJ-së dhe Sistemit Gjyqësor.

- ❖ Gjatë vitit 2019, pjesa më e madhe e gjykatave përballen me një volum të shtuar pune për gjyqtar. Në rang vendi ky volum është rritur me 24%. Mesatarja në shkallë vendi është rreth 122 çështje më shumë për gjyqtar, pra 640 çështje nga 518 që ishte në vitin 2018.
- ❖ 29 gjykata ose ndryshe 76% e sistemit në tërësi raportojnë një rritje të volumit të punës që në disa raste kalon masën 100%⁸⁰.
- ❖ Vetëm 8⁸¹ gjykata ose 25% e sistemit kanë një tregues WR më të ulët në vitin 2019, pra edhe një volum pune më të ulët.

NORMA E EFIÇENCËS (TREGUESI ER)

Koment: Treguesi ER është raporti i numrit të personelit të përdorur në gjykatë dhe outputit/zgjidhjes së çështjeve nga e njëjta gjykatë në fund të vitit. Ai është tregues i ritmeve mesatare të punës për gjyqtar.

- ❖ Treguesi ER në rang vendi është 448,3 çështje të zgjidhura për gjyqtar në vit, që shënon një rritje prej 31% krahasuar me mesataren e një viti më parë, që ishte 310,8 çështje të zgjidhura për gjyqtar në vit.
- ❖ Treguesi ER varion nga 281,1 deri në 987,5 çështje të zgjidhura për gjyqtar.
- ❖ 76% e gjykatave të vendit e (29) e kanë mbajtur treguesin ER në nivele të kënaqshme në krahasim me vitin 2018.
- ❖ Treguesi ER ka mbajtur ritme të kënaqshme dhe kjo megjithëse numri i gjyqtarëve efektiv është reduktuar nga 364 në 306 ose rreth 19% nga viti 2018 në vitin 2019.
- ❖ ER mesatare e gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë është përmirësuar me 60%, pra nga 340 çështje të zgjidhura për gjyqtar në 2018 në 546 çështje të tilla për 2019.
- ❖ ER mesatare e gjykatave të apelit, juridiksioni i përgjithshëm, ka qenë në rritje me 26% ose nga 194 çështje të zgjidhura për gjyqtar në 2018 në 244 çështje të tilla për 2019.

RAPORTI I QARKULLIMIT TË ÇËSHTJEVE (TREGUESI RQÇ)

Koment: Raporti i qarkullimit të çështjeve është raporti ndërmjet numrit të çështjeve të zgjidhura (të përfunduara gjatë vitit), me numrin e çështjeve të pazgjidhura (të mbartura) në fund të periudhës.

- ❖ Ky raport është pozitiv për çështjet penale dhe civile ndërkohë që për çështjet administrative përmirësim i mëtejshëm është i nevojshëm.
- ❖ Mesatarja në shkallë vendi për këtë tregues është 1.3 për çështjet civile të zgjidhura⁸², 3.4 për çështjet penale dhe 0.6 për çështjet administrative.
- ❖ Nëse në përlogaritjen e indikatorit RQÇ përjashtohet Gjykata e Lartë, për arsyet e mosfunksionimit të saj në vitin 2019, vlerat mesatare të qarkullimit të çështjeve në rang

⁸⁰Disa nga gjykatat që kanë rritje të volumit të punës janë: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, Përmet, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime dhe Rënda dhe ajo e apelit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës dhe Gjjirokastër.

⁸¹ Gjykata e Apelit Gjjirokastër dhe Shkodër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, Lezhë, Kavajë, Kukës, Kurbin dhe Gjykata Administrative Tiranë.

⁸²Pra për çdo 1,3 çështje të zgjidhura civile, në fund të vitit ka mbetur një çështje civile e pazgjidhur.

vendi do të ishin përkatësisht 2,1; 4,9 dhe 1,0.

- ❖ Çështjet penale kanë RQÇ më të lartë për shkak të afateve ligjore dhe procedurale më të shkurtra për shqyrtimin dhe përfundimin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- ❖ Qarkullim më i mirë i çështjeve vihet re në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe kjo në krahasim me gjykatat e apelit.

KOHA E NEVOJSHME PËR EVADIMIN E ÇËSHTJEVE (TREGUESI DT)

Koment: Treguesi DT vlerëson sesa arrijnë gjykatat t'i përgjigjen fluksit të çështjeve, pra sa ditë do t'i duheshin atyre për të trajtuar mesatarisht një çështje. DT krahason numrin e çështjeve të zgjidhura me numrin e çështjeve të pazgjidhura në fund të periudhës së monitoruar.

- ❖ Koha e nevojshme për evadimin e çështjeve përcaktohet sipas kategorive të gjykatave (shkallës së parë dhe apelit) dhe afatit të gjykimit të arsyeshëm të parashikuar në ligjin procedural.
- ❖ Në gjykatat e shkallës së parë, juridiksioni i përgjithshëm, për secilën shkallë gjykimi rezulton se norma mesatare e DT është ndjeshëm më e ulët se afati i arsyeshëm prej 2 vitesh përcaktuar në ligj dhe se norma mesatare evropiane e vendeve të BE-së.
- ❖ Problematike mbetet situata në gjykatat e apelit, ku norma mesatare e DT kalon afatin e arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve të përcaktuar si nga ligji ashtu edhe atë të vendeve të BE-së.
- ❖ Për sa i përket çështjeve penale në shkallë të parë DT mesatare është 48 ditë. Ky tregues mesatar është në nivele më të kënaqshme se afati i parashikuar nga ligji procedural.
- ❖ Në nivel apeli DT mesatare është brenda afatit të arsyeshëm dhe llogaritet me 267 ditë për çështje.
- ❖ Për çështjet administrative, treguesi DT e kalon afatin e arsyeshëm ligjor. Kjo sjell nevojën për nxitjen e përmirësimeve të mëtejshme.

NORMA E ZGJIDHJES SË ÇËSHTJEVE (TREGUESI CR)

Koment: CR është një tregues i përgjithshëm mbi gjendjen e sistemit gjyqësor. Ai tregon ecurinë e sistemit në harkun kohor prej një viti, nëse gjykatat kanë arritur të ruajnë ritmin mes çështjeve të reja të regjistruara dhe atyre të përfunduara.

- ❖ Gjatë vitit 2019, sistemi gjyqësor ka mbajtur të njëjtat ritme me vitin që shkoi. Nga 38 gjykata 25 ose 65% e tyre kanë njohur përmirësime të plota ose të pjesshme. Ndërkohë që 35% e gjykatave ende nuk e arrijnë normën mesatare evropiane të treguesit CR.
- ❖ Disa nga gjykatat më të rëndësishme që kanë shënuar CR që kalon 100 % janë Gjykata e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë, Gjirokastrë dhe Vlorë dhe Gjykatat e Rretheve, Krujë, Kurbin dhe Shkodër etj.
- ❖ Diferenca më e theksuar mes mesatares evropiane të CR dhe mesatares për Shqipërinë për 2019, sidomos për çështjet civile, rezulton për Gjykatën e Lartë, e cila nuk ka funksionuar gjatë këtij viti dhe në gjykatat e apelit për shkak të volumit të lartë të çështjeve gjyqësore dhe mungesave të gjyqtarëve.

PËRDORIMI SISTEMIT AUDIO

Koment: Zbatimi i sistemit të regjistrimit digjital audio në gjykata garanton saktësi të nivelit të lartë të dokumentimit të seancës gjyqësore, rrit transparencën, efikasitetin si dhe përmirëson administrimin e gjykatave.

- ❖ Regjistrimi audio i seancave në rang vendi për vitin 2019 është 64,80%.
- ❖ Pjesa më e madhe e gjykatave kanë nivel përdorimi të sistemit audio mbi 90 %.
- ❖ Ndërkohë që disa gjykata, ku niveli i përdorimit të regjistrimit audio është i ulët, shkaqet kryesore raportohet të jenë: mungesa e sallave të pajisura me sistemet e përshtatshme të regjistrimit audio, numri i lartë i çështjeve dhe seancave ditore gjyqësore për gjyqtar.
- ❖ Gjithashtu, krahasimi i treguesve të vitit 2019 me ato të 2018 për treguesit e nivelit të përdorimit të regjistrimit audio, tregon që 21 gjykata ose mbi 55% e kanë përmirësuar përqindjen e regjistrimit audio të seancave.

KOHËZGJATJA E ÇESHTJEVE

- ❖ Për vitin 2019 është kërkuar nga gjykatat të raportojnë numrin e çështjeve të përfunduara të ndara sipas kategorive, për çdo segment kohëzgjatjeje.
- ❖ Kohëzgjatja e çështjeve të përfunduara gjatë vitit 2019 ka qenë përgjithësisht e kënaqshme. Numri më i madh i çështjeve (rreth 83%) janë shqyrtuar dhe kanë përfunduar brenda një afati 6-mujor.

Lidhur me çështjet të cilat kanë përfunduar tej një afati të arsyeshëm, rezulton se:

- ❖ Në çështjet civile vetëm 2% e çështjeve kanë përfunduar për një afat kohor më tepër se dy vjet.
- ❖ Referuar kategorive të çështjeve penale të vlerësuara konstatohet se vetëm 2.7 % e çështjeve penale të themelit për krime dhe 4.9 % për kundërvajtje kanë zgjatur mbi 2 vjet.
- ❖ Për çështjet administrative rezulton se vetëm 14.8% e këtyre çështjeve shkon përtej afatit 1-vjeçar të përcaktuar nga ligji.

7. *V* EPRIMTARIA FINANCIARE DHE BUXHETI

7.1 BUXHETI I NEGOCIUAR DHE ALOKUAR PËR VITIN 2019

Me Ligjin nr.99, datë 03.12.2018 “Për buxhetin për vitin 2019”, është miratuar buxheti për pushtetin gjyqësor për vitin 2019, i cili përbëhet nga shpenzimet korrente (shpenzime personeli, shpenzime operative) dhe nga shpenzimet kapitale. Sikurse ilustron në tabelën 1, buxheti i miratuar është 75% e buxhetit të kërkuar për vitin 2019.

Tabela 1. Buxheti i kërkuar, i miratuar, i rishikuar dhe realizmi i tij për Këshillin e Lartë Gjyqësor për vitin 2019 (dy programet)


Në 000 lekë

Emërtimi	Buxheti i kërkuar për vitin 2019	Buxheti i miratuar për vitin 2019	Buxheti i Rishikuar për vitin 2019	Buxheti i Realizuar për vitin 2019	Raporti (në %) Realizim/ Buxheti i rishikuar për vitin 2019
Paga Sigurime Shoqërore	2,701,300	1,890,300	2,176,280	2,144,867	99 %
Shpenzime Operative	474,650	454,730	423,980	410,453	96.81%
Investime	162,000	162,000	182,000	119,217	65.50%
TOTALI	3,337,950	2,507,450	2,785,910	2,706,875	97%

Ndonëse buxheti i akorduar është më i vogël se buxheti i kërkuar për vitin 2019, në raport me buxhetin e miratuar për vitin paraardhës (2018), evidentohet që ka një rritje. Përkatësisht, buxheti i akorduar për vitin 2019 ka rritje në masën 21% krahasuar me vitin 2018. Kjo rritje ka qenë kryesisht për shpenzimet e personelit, si rrjedhojë e rritjes së pagave të magjistratëve, efekti financiar i të cilave filloi në 1 janar 2019.

Miratimi i buxhetit për vitin 2019, kaloi në disa faza duke filluar nga negociatat me Ministrinë e Financave e deri në mbrojtjen e tij në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e RSH. Në këto takime, përfaqësues të KLGJ-së kanë parashtruar argumentet përkatës mbi domosdoshmërinë e rritjes së mëtejshme të buxhetit për Pushtetin Gjyqësor. Në mënyrë të përmbledhur fazat e negociimit të buxhetit ilustron si më poshtë:

Fazat e negociimit të buxhetit



Fondi buxhetor i miratuar në fillim të vitit nuk merrte parasysh:

- Efektin financiar të rritjes së pagave të magjistratëve - Në janar të vitit 2019, sipas parashikimeve në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, hynë në fuqi pagat e reja për magjistratët.
- Efektin financiar të pagave të punonjësve shtesë në sistemin gjyqësor të miratuar me Ligjin e Buxhetit për vitin 2019.
- Efektin financiar të krijimit dhe funksionimit të KLGJ-së, si në shpenzime korrente ashtu edhe në shpenzime kapitale.

Si rezultat i negociatave të zhvilluara dhe argumenteve të parashtruara, Ministria e Financave ka miratuar kërkesën e KLGJ-së për shtesë fondi, ndonëse jo në masën 100% të kërkesës, për të tre efektet financiare të evidentuara si më sipër, të cilat i përkasin të dy programeve buxhetore.

Në muajin maj, në zbatim të Vendimit nr. 343, datë 02.05.2019 të Këshillit të Ministrave “Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve dhe të fondeve buxhetore për Institucionet e Sistemit të Drejtësisë, për vitin 2019”, pikat;1,2/a,3,4,5, janë rishikuar fondet dhe numri i punonjësve për programin 01110 – “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” dhe është miratuar shtesa e fondit në shpenzime korrente dhe në ato kapitale.

Për sa i përket investimeve, për programin 03310 – Buxheti Gjyqësor, buxheti i miratuar është në nivelin e tavanit të përcaktuar nga Ministria e Financave dhe nuk pësoi rritje të mëtejshme të tij. Shpenzimet për investime, të cilat sigurojnë përmirësimet cilësorë të sistemit gjyqësor dhe arritjen e synimeve për një shërbim eficient, transparent e të shpejtë për publikun, kanë mbetur të pandryshuara

krahasuar me një vit më parë.

Tabela nr. 2 - Të dhëna për buxhetet në vite për Pushtetin Gjyqësor

	Në 000 leke			
Përshkrimi	2017	2018	2019	2020
Shpenzime Korrente	2,018,000	2,140,000	2,596,510	3,201,150
Shpenzime Kapitale	170,000	160,700	189,400	208,000
Buxheti Total	2,188,000	2,300,700	2,785,910	3,409,150
Ndryshimi në % i buxhetit	-3%	5%	21%	22%
Nr. Total i punonjësve të miratuar me ligj	1,364	1,369	1,493	1,593
Shpenzime totale të buxhetit të shtetit	467,599,000	497,069,000	519,577,000	549,374,000
Raporti në % i buxhetit të gjykatave me buxhetin e shtetit	0.47%	0.46%	0.54%	0.62%

Referuar të dhënave të pasqyruara në Tabelën 2, rezulton se buxheti i sistemit gjyqësor ka trend rritës për tre vitet e fundit (2018 – 2020). Rritja e konsiderueshme e buxhetit të vitit 2019 prej 21% kundrejt 2018, ka ardhur për shkak të rritjes së konsiderueshme të pagave të gjyqtarëve. Ndërsa rritja në buxhetin e vitit 2020 prej 22% kundrejt vitit 2019, vlerësohet si pasojë e shtimit të numrit të administratës gjyqësore me 100 punonjës. Për herë të parë ka një rritje të konsiderueshme të numrit të administratës gjyqësore, e cila do të ndihmojë sistemin gjyqësor në realizimin e synimit të tij për një shërbim gjyqësor më të mirë dhe efikas.

Në raportin e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), të publikuar në muajin mars 2018, vihet re se Shqipëria vazhdon të ketë nivelin më të ulët të buxhetit të alokuar për gjykatat krahasuar me vendet e rajonit ashtu edhe me vendet evropiane, ku mesatarja është 39 euro/banor. Sipas këtij raporti, në Shqipëri shuma e alokuar për buxhetin gjyqësor është 6 euro/banor ndërsa në Maqedoninë e Veriut (14 euro/banorë), Bosnje dhe Hercegovina (25 euro/banorë), Malin e Zi (45 euro/banorë), dhe Kroaci (40 euro/banorë)⁸³. Është për t'u theksuar se shtetet që janë mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe nga partneret ndërkombëtare për funksionimin e shtetit të së drejtës, sikurse është vendi ynë, kanë angazhim më të madh, i cili pasqyrohet edhe në rritjen e buxhetit të alokuar për gjyqësorin nga viti në vit. Përqindja që zë buxheti i gjyqësorit kundrejt buxhetit të shtetit është mesatarisht 0.46%. Ndërsa në vende si Bosnja dhe Hercegovina është 0,77%, Bullgaria 0,56%, Kroacia 0,49%, etj.

Ndërsa vendet e Evropës Perëndimore, të cilat kanë dhe një nivel më të lartë mirëqenieje duket sikur shpenzojnë më pak (në GDP për frymë) për të financuar

⁸³Raporti i CEPEJ 2018, f. 42

gjykatat. Ky efekt deformues duhet të kihet parasysh për krahasime të mundshme, për të mos konkluduar gabimisht se këto vende nuk i kushtojnë vëmendjen e duhur funksionimit të gjykatave. Përkundrazi, këto vende kanë arritur standardin e dëshiruar në sistemin e drejtësisë dhe investimi në sistem shkon kryesisht për ruajtjen e standardeve, pa lënë pas zhvillimet për përmirësim të mëtejshëm. Në raportin e ardhshëm të CEPEJ-it do të pasqyrohet rritja e shpenzimeve të buxhetit gjyqësor në raport me shpenzimet e buxhetit të shtetit për vitin 2019 – 0.54% dhe 2020 – 0.64%.

7.1.1 NË SHPENZIME PERSONELI

Me Ligjin nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019” u miratua buxheti për sistemin gjyqësor. Gjithashtu u miratua numri i punonjësve 1389, ku ishte parashikuar rritja prej 20 punonjësish për administratën gjyqësore. Buxheti i akorduar në shpenzime personeli nuk i mbulonte të gjitha nevojat për pagat e rritura të gjyqtarëve, por në nenin 13 të ligjit të lartpërmendur, ishte përcaktuar fondi rezervë prej 1 miliard lekë për financimin e pagave të magjistratëve, pra për gjyqtarët dhe prokurorët.

KLJGJ-ja akoma nuk ishte krijuar dhe nuk kishte një datë fikse për krijimin e saj, nga ana tjetër, funksionaliteti i gjykatave do të vazhdonte sipas organizimeve të mëparshme.

Këshilli i Lartë Gjyqësor u krijua më 12.12.2018 dhe menjëherë filloi puna për organizimin e institucionit. Me miratimin e organigramës së KLGJ-së, prej 125 punonjësish, Këshilli i Ministrave, me VKM Nr. 343, datë 02.05.2019 “Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve dhe të fondeve buxhetore për institucionet e sistemit të drejtësisë për vitin 2019” akordoi fondet e nevojshme shtesë për funksionimin e institucionit, fondin shtesë prej 400 milion lekë për mbulimin e shtesës së pagave të gjyqtarëve, si dhe numrin e nevojshëm shtesë për sistemin gjyqësor. Në përfundim, numri total i punonjësve në sistemin gjyqësor arriti në 1493, nga të cilët 125 punonjës për KLGJ-në dhe 1368 punonjës për sistemin e gjykatave.

Deri në fund të vitit 2019, në sistemin gjyqësor ka pasur 189 mungesa, përkatësisht 79 magjistratë dhe 110 personel administrativ, nga të cilët 80 në gjykata dhe 30 në KLGJ. Duke qenë se numri i magjistratëve, pagat e të cilëve kanë një efekt financiar më të madh në buxhet, është në ndryshim të vazhdueshëm për shkak të dorëheqjeve, pezullimeve dhe procesit të rivlerësimit kalimtar, njësia e buxhetit në KLGJ, ka monitoruar ecurinë e realizimit të fondeve buxhetore në këtë zë, për përdorimin sa më eficient të tyre. Si rrjedhojë e këtij monitorimi janë rialokuar fondet në shpenzime personeli nga njëra gjykatë në tjetrën, apo janë transferuar fondet nga shpenzime personeli në ato operative, sipas nevojave të paraqitura gjatë vitit ushtrimor nga vetë gjykatat.

Detajimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për çdo gjykatë, në fillim të vitit, u krye sipas numrit faktik të punonjësve, (në kushtet e pamjaftueshmërisë së fondeve buxhetore në shpenzime personeli, si u shpjegua më sipër). Detajimi i kryer sipas kësaj mënyrë mbulonte me paga një periudhë 7-8 -mujore për të gjitha gjykatat.

Gjatë vitit 2019, Ministria e Financave ka miratuar kërkesën e KLGJ-së për shtesë fondi në shpenzime personeli si dhe rialokimin e tij në nivel artikulli dhe njësie shpenzuese në paga dhe sigurime shoqërore. Edhe ky fond u detajua bazuar në numrin faktik të punonjësve në gjykata.

7.1.2 NË SHPENZIME OPERATIVE

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit, është 423,980 mijë pothuaj i njëjtë më kërkesën buxhetore për këtë zë shpenzimesh. Realizimi paraqitet në masën 97% e buxhetit të rishikuar sikurse ilustron në tabelën 1.

Në reflektim të politikave të qeverisë për menaxhimin e buxhetit, KLGJ-ja dhe gjykatat vazhdimisht kanë marrë masa në drejtim të efijencës dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve buxhetore, për aq sa këto masa nuk cenojnë proceset gjyqësore dhe funksionin kryesor të gjykatave. Me buxhetin në dispozicion për shpenzime operative për vitin 2019 është realizuar mbështetja e aktivitetit të përditshëm të gjykatave në funksion të çështjeve të gjykuara gjatë vitit.

Hartimi i nevojave për këtë zë të shpenzimeve, është bërë duke analizuar në mënyrë të hollësishme, çdo element përbërës të kërkesave buxhetore të gjykatave, në funksion të realizimit të objektivave të parashikuara në projektbuxhet. Për detajimin e shpenzimeve operative u morën në konsideratë: kërkesat e bëra nga vetë gjykatat gjatë hartimit dhe rishikimit të PBA-së, ruajtja e standardit për zëra të njëjtë shpenzimesh për secilën nga gjykatat, detyrimet e mbartura për ekzekutim vendimesh gjyqësore; specifika të veçanta sipas gjykatave, etj.

7.1.3 NË SHPENZIME KAPITALE

Për vitin 2019, kërkesa buxhetore në investime është në nivelin e tavanit paraprak të miratuar në vlerën 182,000 mijë lekë dhe realizimi është 98,275 mijë lekë ose 66%, si rezultat i:

- Tepëricave të fondeve nga procedurat e prokurimeve të realizuara, si diferencë midis fondit limit të përcaktuar dhe vlerës së kontraktuar.
- Disa procedura prokurimi kanë zgjatur jashtë parashikimit kohor të vlerësuar sipas ligjit të Prokurimeve Publike, madje disa procedura mbetën të pezulluara për shkak të ankimimeve të bëra nga operatorët dhe mungesës së përgjigjes nga Agjencia e PP. Shkarkimi i disa kryetarëve të gjykatave nga KPK-ja,

pashmangshmërisht ka ndikuar në ecurinë jo pozitive të menaxhimit të fondeve buxhetore të investimeve të alokuara në çdo gjykatë dhe gjatë vitit 2019, janë shkarkuar një numër i madh i kryetarëve të gjykatave.

- Shkresës nr. 21920 prot., datë 02.12.2019, “Mbi prioritetet e pagesave në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, e cila pezulloi të gjitha procedurat e prokurimeve si dhe pagesat përkatëse, duke ndikuar ndjeshëm në realizimin e plotë të fondeve buxhetore,

Referuar Planit Strategjik të KLGJ-së si dhe Strategjisë Ndërsektoriale të Sistemit të Drejtësisë, nevojat për investime në gjyqësor janë më të larta se buxheti i miratuar. Megjithatë, për vitin 2019 janë trajtuar me prioritet:

- **Përmirësimi i infrastrukturës elektronike të gjykatave.** Investimi për rinovimin e pajisjeve elektronike të amortizuara është i nevojshëm për të garantuar vazhdimin normal të punës si dhe për të ruajtur standardin e arritur në drejtim të dixhitalizimit të procesit të gjykimit. Gjithashtu është i nevojshëm investimi në pajisje të reja për shkak të detyrimit ligjor për të garantuar regjistrimin audio të seancave dhe mbledhjeve në gjykata dhe në KLGJ;
- **Kompletimi i gjykatave me pajisje dhe mobilie.** Ky investim është i rëndësishëm për garantimin e kushteve të punës dhe gjykimit si dhe solemnitetin gjatë proceseve gjyqësore. Gjithashtu investime të tjera në këtë drejtim janë të nevojshme për të rinovuar pjesërisht pajisje të amortizuara në gjykata.
- **Përmirësimi i situatës së transportit.** Në kuadër të mirëfunksionimit normal të punës në gjykata, janë bërë investime në blerjen e automjeteve për të plotësuar nevojat e këtyre të fundit për lëvizjen e gjyqtarëve që komandohen për kryerjen e çështjeve gjyqësore në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku kryejnë veprimtarinë e përditshme. Për shkak të përdorimit të gjatë si dhe lëvizjeve të shumta për transport të gjyqtarëve për gjykim në rrethe të tjera, është vlerësuar e nevojshme blerja e mjeteve të reja për të zëvendësuar mjetet ekzistuese tashmë të amortizuara.

7.2 BUXHETI I MIRATUAR PËR PUSHTETIN GJYQËSOR PËR VITIN 2020

Për vitin 2020, buxheti i miratuar për sistemin gjyqësor është 3,409,150 mijë lekë. Krahasuar me kërkesën në projektbuxhet, buxheti i miratuar është 12% ose 451,100 mijë lekë më i ulët, por 22% më i lartë se viti 2019. Numri i punonjësve shtesë të kërkuar për administratën gjyqësore është 157, ndërsa ai i miratuar është 100 punonjës.

7.2.1 NË SHPENZIME KORRENTE (NË PERSONEL DHE OPERATIVE)

Fondet buxhetore të miratuara nuk janë të plota për të garantuar aktivitetin financiar të gjykatave dhe KLGJ-së, në përputhje me strukturat organike të miratuara me ligj si dhe për punonjësit shtesë të administratës gjyqësore dhe atyre me kontratë të miratuar. Këto fonde janë rreth 260 milion lekë më të ulëta se kërkesa buxhetore, por kjo situatë do të menaxhohet duke pasur parasysh mungesat e konsiderueshme të gjyqtarëve.

Situata në shpenzime korrente do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga KLGJ-ja për të bërë të mundur plotësimin e nevojave për mirëmbajtjen e programit ICMIS apo nevoja të tjera në funksion të garantimit të punës së gjykatave.

7.2.2 NË SHPENZIME KAPITALE

Buxheti i miratuar është rreth 191 milion lekë më i ulët se kërkesa buxhetore. Duhet theksuar se në fondin e miratuar nuk është marrë në konsideratë kërkesa e bërë lidhur me fillimin e ndërtimit të sistemin të ri elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, si dhe krijimi e funksionimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit (QTI).

7.3 NEVOJAT BUXHETORE

Pavarësisht trendit rritjes që ka pësuar kurba e buxhetit gjyqësor, nevojat buxhetore të këtij sistemi, për të garantuar efikasitet, transparencë dhe shërbime sa më cilësore, janë më të larta se buxheti i alokuar.



Përcaktimi i qartë i nevojave reale në infrastrukturën ndërtimore, elektronike dhe burime njerëzore do të ndodhë me finalizimin dhe miratimin e hartës së re

gjqësore, për sa kohë rikonfigurimi i sistemit gjyqësor përmes kësaj harte pritet të sjell një realitet të ri. Megjithatë, pavarësisht miratimit të kësaj harte, nevojat për burime njerëzore mbetet emergjente.

7.3.1 NEVOJA PËR INVESTIME NË INFRASTRUKTURËN GJYQËSORE

Të tre godinat e gjykatave të Tiranës (Gjykata e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë) kanë nevoja të theksuara për hapësira fizike pasi nuk kanë salla të mjaftueshme për kryerjen e proceseve gjyqësore. Kjo gjendje infrastrukturore ndikon negativisht në transparencën e procesit gjyqësor dhe shpejtësisë e qarkullimit të çështjeve, duke shkaktuar shpeshherë vonesa në gjykim. Përveç mungesës së hapësirave fizike, këto gjykata kanë mungesa në skemën funksionale të tyre, duke mos u përputhur me standardet bashkëkohore.

Në kërkesat buxhetore për periudhën 3-vjeçare kjo nevojë nuk është përfshirë. Nga përllogaritjet paraprake të kryera nga ekspertë të huaj, rezulton se buxheti për ndërtimin e tre gjykatave të Tiranës shkon rreth 30 milion euro.

7.3.2 NEVOJA PËR INVESTIME NË SISTEMET TIK

Eksperiencia e deritanishme e gjykatave në përdorimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve ka nxjerrë në pah një numër të konsiderueshëm problematikash të cilat ndikojnë në performancën dhe cilësinë e shërbimeve gjyqësore. Për pasojë nevoja për ndërtimin e një sistemi të ri për menaxhimin e çështjeve gjyqësore është thelbësore në kuadër të garantimit të cilësisë së shërbimeve dhe rritjes së besimit të publikut. Sistemi i ri i menaxhimit të çështjeve do të mundësojë gjenerimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore dhe raporteve analitike të domosdoshme, për hartimin e politikave që i shërbejnë miradministrimit të sistemit gjyqësor. Nga vlerësimet e ekspertëve të Misionit EURALIUS, ky sistem vlerësohet të kushtojë rreth 3,500 mijë euro ose 440 milion lekë. Për vitin e parë u kërkua një fond rreth 100 milion lekë nga buxheti i shtetit, i cili për shkak të situatës së fatkeqësisë natyrore të tërmetit, nuk u aprovua.

Pranë KLGJ-së është parashikuar të ngrihet Qendra e Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë (QTI)⁸⁴. Kostimi i aktivitetit që do të ushtrojë kjo qendër, është vlerësuar në masën e 13 milion lekëve. *(Për më shumë lexo kapitullin 5. Sistemet e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, fq. 97)*

7.3.3 NEVOJA PËR INVESTIME NË BURIME NJERËZORE

Bazuar në Ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 41 parashikon se Administrata Gjyqësore realizon

⁸⁴ Mbështetur në projekt vendimin “Për krijimin, organizimin, funksionimin, kompetencat dhe miratimin e politikave të përgjithshme shtetërore për Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë”

misionin e saj nëpërmjet: a) shërbimeve gjyqësore b) shërbimeve administrative c) shërbimeve mbështetëse.

KLGG-ja edhe vjet ka përgatitur dhe ka paraqitur përpara Kuvendit paketën e plotë për nevojat që ka gjyqësori për punonjës administratë gjyqësore shtesë, sipas detyrimeve që rrjedhin nga ligji i mësipërm.

Për realizimin e misionit dhe objektivave të KLGJ-së të përcaktuara në Planin e tij Strategjik kërkohet sigurimi i burimeve të mjaftueshme e të përshtatshme financiare dhe njerëzore. Që nga miratimi i reformës në drejtësi ish-ZABGJ-ja dhe më pas KLGJ-ja, kanë kryer një vlerësim të nevojave për burime njerëzore në sistem në përmbushje të detyrime ligjore dhe parametrave të efikasitetit përcaktuar në raportin e CEPEJ-it, duke vlerësuar këtë nevojë me rreth 300 punonjës shtesë. Ky vlerësim është kryer në vitin 2018⁸⁵. Kuvendi e pa të arsyeshme të miratojë 120 punonjës shtesë për sistemin gjyqësor, përkatësisht 20 për vitin 2018 dhe 100 për 2019.

Sikurse është përmendur më lart, nevojat për burime njerëzore nuk janë adresuar plotësisht. Ndonëse këtë vit kemi një shtim cilësor të numrit të punonjësve të miratuar sikurse ilustron në grafikun më poshtë, këto plotësime nuk reflektojnë të gjitha nevojat reale të sistemit. Për këtë qëllim nevojat për 180 punonjës më shumë se numri aktual i punonjësve në sistemin gjyqësor mendohet të kërkohen në mënyrë graduale në funksion të garantimit të mirëfunksionimit dhe efikasitetit të sistemit. *(Për më shumë informacion lexo seksionin 6.3.3 “Burimet njerëzore”, faqe 122)*



⁸⁵ Për vitin 2018, ish-ZABGJ ka kërkuar 83 punonjësish shtesë për administratën gjyqësore dhe i janë akorduar 20 punonjës, ndërsa për vitin 2019 ka kërkuar 157 punonjës nga të cilat i janë miratuar 100 të tillë.

Të rëndësishme!

Buxheti për vitin 2019

- ❖ Buxheti i miratuar është 75% e buxhetit të kërkuar.
- ❖ Buxheti i akorduar ka rritje në masën 21% krahasuar me vitin 2018, si rrjedhojë e rritjes së pagave të magistratëve.
- ❖ Fondi i akorduar për shpenzime personeli - 2,176,280 mijë. Masa e realizimit 96.81%
- ❖ Fondi i akorduar për shpenzime operative - 423,980 mijë. Masa e realizimit 96.81%
- ❖ Fondi i akorduar për investime - 182,000 mijë lekë. Masa e realizimit 66%.
- ❖ Numri i punonjësve shtesë të kërkuar për administratën gjyqësore është 83, ndërsa ai i miratuar është 20 punonjës.

Buxheti për vitin 2020

- ❖ Buxheti i miratuar është 3,409,150 mijë lekë, 12% më i ulët se kërkesa buxhetore, por 22% më i lartë se viti 2019.
- ❖ Numri i punonjësve shtesë të kërkuar për administratën gjyqësore është 157, ndërsa ai i miratuar është 100 punonjës.
- ❖ Nevojat buxhetore për të garantuar efikasitet, transparencë dhe shërbime sa më cilësore, janë më të larta se buxheti i alokuar.
- ❖ Nevoja për investime në infrastrukturë – ndërtimi i tre gjykatave të Tiranës, 30 milion euro.
 - Nevoja për investime në sistemet e TIK – Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore 440 milion lekë dhe Qendra e Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë (QTI) 13 milion lekë.
 - Nevojat për burime njerëzore - 180 punonjës më shumë se numri aktual i punonjësve në sistemin gjyqësor

8. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Duke mbajtur në konsideratë detyrimet ligjore që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe kuadri ligjor në zbatim të saj, në përputhje me misionin dhe vizionin e përcaktuar në dokumentet strategjike të miratuara, me qëllim final garantimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm, efikas dhe llogaridhënës, KLGJ-ja raporton për aktivitetin vjetor, sfidat dhe problematikat, masat e ndërmarra dhe arritjet e deritanishme, duke theksuar veçanërisht:

1. Fundit i vitit 2018 - fillimi i vitit 2019, shënoi jo vetëm konstituimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor si një organ i pavarur kushtetues qeverisës i gjyqësorit, së bashku me organet e tij drejtuese, por dhe ngritjen e katër Komisioneve të Përhershme⁸⁶, e miratimin e strukturës organizative të administratës së institucionit, me një përbërje prej 125 punonjësish. Gjatë vitit 2019, KLGJ-ja ka zhvilluar 57 mbledhje plenare dhe miratuar 315 vendime prej të cilave 286 të iniciuara me nisëm të Komisioneve të Përhershme.
2. Për të trajtuar çështje të veçanta, të cilat kërkonin fleksibilitet vendimmarrjeje dhe shpejtësi

⁸⁶ Komisioni për Planifikimin Strategjik, Administrimin dhe Buxhetin; Komisioni Disiplinor; Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale; Komisioni i Zhvillimit të Karrierës

veprimi, KLGJ-ja ka krijuar 6 Komisione të Përkohshme.

3. Në funksion të orientimit strategjik, me qëllim garantimin e mbarëvajtjes së sistemit gjyqësor, më datë 19 korrik 2019, Këshilli miratoi Planin e tij të parë Strategjik 2019-2020 duke përcaktuar pritshmëritë, prioritetizuar synimet dhe disiplinuar veprimet dhe masat e nevojshme me qëllim zbatimin e reformës në drejtësi.
4. Bazuar në ndryshimet Kushtetuese të cilat përcaktojnë konstituimin e Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, KLGJ-ja në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, deklaroi fillimin e funksionimit të këtyre gjykatave më datë 18 dhjetor 2019. Ky proces u shoqërua edhe me caktimin në mënyrë të përhershme të 5 gjyqtarëve dhe në mënyrë të përkohshme të 13 gjyqtarëve⁸⁷, të cilët vinin nga Gjykatat e Krimeve të Rënda.
5. Duke mbajtur parasysh efektet e procesit të rivlerësimit kalimtar në Gjykatën e Lartë, ku ushtronin detyrën vetëm 1 nga 19 gjyqtarë, KLGJ-ja intensifikoi përpjekjet për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore⁸⁸ të nevojshme për

⁸⁷ Të dhënat reflektojnë situatën faktike të numrit të gjyqtarëve në momentin e krijimit të gjykatave në dhjetor 2019.

⁸⁸ Rregullorja e ngritjes në detyrë është hartuar gjatë vitit 2019 por është miratuar me vendimin nr. 70 datë 7 shkurt 2020.

plotësimin e trupës së kësaj gjykate dhe rivënien në funksion të saj. Këto akte i hapën rrugë fillimit të procesit të përzgjedhjes për emërimin e kandidatëve për Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, i cili përfundoi me dekretimin për emërim nga Presidenti i Republikës i 3 prej kandidatëve⁸⁹ të kualifikuar, vlerësuar, pikëzuar dhe renditur nga KLGJ-ja (në përputhje me legjislacionin në fuqi) në fillim të vitit 2020.

6. Duke mbajtur parasysh rëndësinë e procesit të vettingut, KLGJ-ja u angazhua menjëherë për të ngritur strukturën përkatëse “Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Përfundim në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe subjekteve të tjera të rivlerësimit”, si dhe miratoi rregullat e funksionimit të këtij Komisioni për të garantuar vijueshmërinë e bashkëpunimit me organet e rivlerësimit kalimtar. Komisioni ka hedhur 104 shorte, dhe ka përpunuar, relatuar dhe dërguar pranë KPK-së 99 raporte të analizimit të aftësive profesionale, që përbën 1/5⁹⁰ e totalit të subjekteve, duke trajtuar dhe analizuar rreth 495 dosje gjyqësore. Ndërkohë në total, që nga fillimi i procesit të rivlerësimit janë dorëzuar pranë KPK-së 220 raporte të analizimit të aftësive profesionale dhe kjo përbën pothuajse 50% të të gjithë subjekteve që kanë paraqitur

⁸⁹ Një kandidat është ende në garë pasi nuk ka përfunduar ende procesi i verifikimit.

⁹⁰ Po të marrim të mirëqenë faktin se për 466 subjektet e rivlerësimit do hartohen raporte.

formularin e rivlerësimit pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

7. Me qëllim lehtësimin e efekteve të krijuara në gjykatat e vendi nga mungesa e burimeve njerëzore në sistem, dorëheqjeve dhe shkaqeve të tjera, Këshilli ndërmori një numër masash emergjente, ku mund të theksohen:
 - a. Duke nisur nga numri i lartë i kërkesave të kryetarëve të gjykatave për plotësimin e trupave gjyqësore, dhe në pamundësi për përdorimin e skemës së delegimit dhe transferimit, KLGJ-ja operoi me miratimin e rregullave për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të caktuara në gjykata të ndryshme nga ato ku ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme. Kjo nismë u mor si masë emergjente, në mungesë të përgjigjes nga ana e gjyqtarëve për t’u përfshirë në skemën e delegimit dhe padobishmërisë së aplikimit të mekanizimit të transferimit të përkohshëm. Gjatë vitit 2019 janë depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, 845 kërkesa për caktim gjyqtari (nga kryetarët respektivë të gjykatave) dhe në rang vendi, janë bërë 1209 caktime gjyqtarësh për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.
 - b. Gjatë periudhës së raportimit janë transferuar përkohësisht me pëlqim në total 5 magjistratë⁹¹ në gjykata të ndryshme.

⁹¹ Në total janë transferuar 12 gjyqtarë.

- c. Me qëllim ruajtjen e vijimësisë së ushtrimit të funksionit drejtues në gjykata, në kushtet e mungesës së kryetarëve të disa gjykatave, të shkarkuar nga institucionet e rivlerësimit kalimtar, KLGJ-ja ndërhyri duke miratuar rregullat për mënyrën dhe procedurën e zgjedhjes së zëvendëskryetarëve të gjykatave. Këshilli ndoqi nga afër zgjedhjet e zëvendëskryetarëve në 36 gjykatat e vendit të nivelit të parë dhe të apelit duke treguar mbështetjen e tij për këtë proces.
- d. Me qëllim rivitalizimin me burime njerëzore të disa gjykatave në vend dhe për të siguruar mbarëvajtjen e tyre në funksion të ofrimit të një drejtësie pa vonesa për qytetarët, Këshilli i Lartë Gjyqësor gjatë vitit 2019, emëroi dhe caktoi në detyrë në total 25 kandidatë magjistratë që kishin përfunduar Shkollën e Magjistraturës gjatë viteve 2018 dhe 2019. Emërimi në detyrë i këtyre magjistratëve u krye pas përfundimit të procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.
- e. Me qëllim zëvendësimin e burimeve njerëzore të munguara (gjyqtarëve të dalë nga sistemi), në vitin 2019, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, KLGJ-ja përcaktoi në 25 numrin e kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranoheshin në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës⁹². Në këtë rast, ndërsa

⁹² Në vendimin nr. 17 datë 29.1.2019 pika 1 shkronja "c" të KLGJ-së është parashikuar se në rast se, në përfundim të procedurës së

përcaktoi edhe në 25 numrin e kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej nëntë muajsh Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, KLGJ-ja vendosi po ashtu në rast se, në renditjen përfundimtare të testimit profesional ka konkurrentë për magjistratë mbi numrin 50 (25 profili gjyqtar dhe 25 profili prokuror), që sipas Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës arrinin pikët e nevojshme për kandidatët për magjistratë, kuotat e planifikuara për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë mund t'i shtoheshin numrit të përgjithshëm të kandidatëve për magjistratë, të profilit gjyqtar. Nisur nga kjo, në përfundim të konkursit për magjistratë, profili gjyqtar, fituar 28 kandidatë, ndërsa për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë 6 të tillë.

8. Hartimi dhe miratimi nga KLGJ-ja i akteve plotësuese të sistemit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve i hapi rrugë fillimit të procesit të vlerësimit periodik të tyre. Ky proces synon përmirësimin në mënyrë të vazhdueshme të etikës dhe aftësive profesionale të trupës gjyqësore, vendosjen e standardeve të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së gjyqtarëve, zhvillimin e karrierës bazuar në

aplikimeve për pranimin në formimin fillestar, nuk ka kërkesa që plotësojnë numrin e planifikuar të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, kuotat për këto të fundit do t'i shtohen kandidatëve për magjistratë të profilit gjyqtar"

meritat profesionale, identifikimin e nevojave për trajnim të gjyqtarëve dhe planifikimin efektiv të procesit të trajnimit vazhdues. Kjo vendimmarrje u pasua nga miratimi i “Programit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2020” në të cilin parashikohet për herë të parë hapja e procesit të vlerësimit profesional sipas skemës së re për 121 gjyqtarë në RSH.

9. Me qëllim përzgjedhjen dhe emërimin e kandidatëve më profesionist dhe me integritet të lartë, KLGJ-ja ka kryer brenda 1 viti një volum të lartë pune duke verifikuar 76 kandidatë. Verifikimi i pasurisë dhe figurës është kryer për 28 kandidatët që aplikuan për formim fillestar në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2019, 25 kandidatët magjistratë që përfunduan studimet në këtë shkollë gjatë vitit 2018-2019 si dhe 23 kandidatët që aplikuan për anëtarë në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur.
10. Në funksion të garantimit të transparencës së KLGJ-së, si dhe duke mbajtur si prioritet informimin dhe aksesin e publikut mbi veprimtarinë dhe rezultatet e arritura, Këshilli i Lartë Gjyqësor krijoi një faqe interneti të përkohshme www.klgj.al. Po kështu, më datë 24 prill 2019, Këshilli caktoi një nga anëtarët e tij për të mbuluar marrëdhëniet me publikun. Anëtari që ka kryer këtë funksion gjatë vitit 2019 është z. Erjon Muharremaj.
11. Me qëllim këshillimin dhe zgjidhjen e çështjeve etiko-morale gjatë

ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, Këshilli më datë 11.09.2019 emëroi gjyqtaren znj. Albana Boksi në funksionin e Këshilltarit të Etikës. Ky këshilltar, me kërkesë të çdo gjyqtari, jep këshilla për sjelljet më të përshtatshme brenda dhe jashtë gjykatës dhe për çështje të diskutueshme të etikës.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka hartuar rregulloren mbi “Procedurën e verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjorë në gjykatat e apelit” e cila është në fazë konsultimi dhe pritjet të miratohet brenda vitit 2020. Ai i ka hapur rrugë procesit të verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, si dhe verifikimit të figurës dhe të pasurisë së kancelarëve në detyrë. Deri më tani 32 nga 37 kancelarët kanë ndjekur programin 8 javor të formimit në lidhje me administrimin gjyqësor, të organizuar nga KLGJ-ja në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe Projektin “Drejtësi për të gjithë”.
13. Viti 2019 është karakterizuar nga një frymë institucionale-ligjore bashkëpunimi si të brendshëm ashtu edhe të jashtëm. KLGJ-ja ka zhvilluar një gamë të gjerë aktiviteteve në të cilat përfshihen rreth 30 takime dy dhe shumëpalëshe, konferenca, simpoziume, trajnime dhe vizita studimore etj. Këto aktivitete me institucionet vendase, ndërkombëtare, shoqërinë civile, etj.,

janë zhvilluar në kuadër të fuqizimit të rolit të KLGJ-së, si institucion kyç në strukturën e sistemit të drejtësisë.

14. Gjendja e sistemi gjyqësor në tërësi. Gjatë vitit 2019, sistemi gjyqësor është përballur me një ngarkesë pune në rritje, ku numri i çështjeve të regjistruara në vitin 2019 është 3,37% më i lartë se në vitin 2018 dhe 11,44% më i lartë se në vitin 2017. Pjesa më e madhe e gjykatave ose 84.5% e tyre kanë funksionuar me kapacitet të reduktuar të gjyqtarëve, ndërsa në nivel kombëtar vetëm 75,06% e organikës së gjyqtarëve kanë qenë efektivisht në detyrë gjatë vitit 2019. Ngarkesa e punës në gjykata është përballuar nga vetëm 306 gjyqtarë ose 10.66 gjyqtarë për 100.000 banorë. Ky raport është më pak se 60% e normës evropiane. Gjykatat kanë bërë përpjekje për të ruajtur ritmin e zgjidhjes së çështjeve dhe për të mbajtur nën kontroll rritjen e stokut, pavarësisht rritjes së numrit të çështjeve të regjistruara dhe uljes së numrit të gjyqtarëve efektivë. Këtë e kanë arritur duke rritur ndjeshëm rendimentin mesatar të punës për gjyqtar: në rang vendi gjatë vitit 2019 sistemi gjyqësor ka zgjidhur mesatarisht 448,3 çështje për gjyqtar, që shënon një rritje prej 31% krahasuar me mesataren e një viti më parë, që ishte 310,8 çështje të zgjidhura për gjyqtar në vit.

I dedikuar për garantimin e pavarësisë dhe mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor, i vetëdijshëm dhe në njohje të thellë të situatës së tij, i ndërgjegjshëm për problematikat e hasura gjatë vitit të parë të ushtrimit

të veprimtarisë institucionale, KLGJ-ja angazhohet që gjatë vitit 2020, të punojë për përmbushjen e një sërë detyrash, ku ndër prioritetet kryesore theksohen:

- Vazhdimin e zbatimit të reformës në drejtësi përmes hartimit dhe miratimit të akteve të tjera nënligjore të nevojshme për konsolidimin institucional të KLGJ-së në përputhje me praktikën e mira të punës së evidentuar nga organet e tij vendimmarrëse⁹³ si dhe adresimin në kohë të nevojave të gjykatave me qëllim dhënien e një drejtësie të shpejtë dhe pa vonesa për qytetarët;
- Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve për 6 pozicione të lira, 3 në fushën e së drejtës administrative dhe 3 në fushën e së drejtës civile dhe plotësimi i kësaj gjykate në një kohë sa më të shpejtë me të paktën 10 gjyqtarë.
- Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për 5 pozicione të lira, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe 5 pozicione të lira, në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe emërimin me prioritet të gjyqtarëve të cilët konfirmohen në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar.
- Vijimin e bashkëpunimit me organet e rivlerësimit kalimtar për prioritetimin e subjekteve të rivlerësimit si dhe përshpejtimin e përmbylljes së këtij procesi, për sa i

⁹³ Komisioneve të përhershme apo të përkohshme dhe praktikave të tyre të punës.

përket dorëzimit të raporteve të aftësive profesionale të gjyqtarëve në kohë, duke synuar lehtësimin e impaktit të procesit të rivlerësimit kalimtar si në lidhje me vendet vakante në gjykata ashtu dhe me efektet financiare që i krijohen buxhetit të shtetit nga pezullimet nga detyra.

- Nisjen për herë të parë dhe përfundimin e procesit të vlerësimit etik-profesional të 121 gjyqtarëve, sipas programit të vlerësimit për vitin 2020, në përputhje me skemën e re të vlerësimit të gjyqtarëve⁹⁴.
- Përfundimin e analizës për rikonfigurimin e hartës gjyqësore dhe miratimin e propozimit/eve në KLGJ, si dhe nisjen e një procesi të ngushtë konsultimesh me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Ministrinë e Drejtësisë dhe atë të Financave me qëllim miratimin e një harte të re gjyqësore të dakordësuar me të gjithë aktorët që veprojnë në fushën e drejtësisë dhe kjo me mbështetjen e partnerëve tanë ndërkombëtarë.
- Përfundimin e emërimit dhe caktimit në detyrë të magistratëve që do të

⁹⁴ Vendimet e KLGJ-së nr. 263, datë 21.11.2019 “Rregullat plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”. Po kështu, KLGJ-ja me vendimin nr.316, datë 19.12.2019, miratoi tabelat standarde me të dhëna statistikore të nevojshme për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve. Programi i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2020 u miratua me vendimin nr.276, datë 10.12.2019. Në bazë të këtij programi, gjatë vitit 2020, pritet të vlerësohen 121 gjyqtarë.

përfundojnë studimet në vitin 2020, si bashkëpunim i vazhdueshëm me Shkollën e Magistraturës për ngritjen e kapaciteteve dhe vlerësimin e kuotave për magistratë për vitin e ardhshëm për t’iu përgjigjur nevojave të sistemit, sidomos pas efekteve të reformës.

- Verifikimin dhe konfirmimin në detyrë të kancelarëve, në përputhje me Rregulloren mbi “Procedurën e verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit” të miratuar gjatë vitit 2020⁹⁵.
- Hartimin e rregullores së brendshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të funksionimit të Komisioneve të Përhershme, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe praktikën më të mira evropiane.
- Hartimin, konsultimin, miratimin dhe shpërndarjen e rregullave të etikës për gjyqtarët si dhe përpilimin e manualit praktik zbërthyes të këtyre rregullave.
- Mbështetjen për Këshillat e Gjykatave si organe të reja që do t’i shërbejnë miradministrimit në çdo gjykatë nëpërmjet takimeve periodike me kryetarët e gjykatave dhe miratimit të rregullave për nëpunësit gjyqësor.

Për sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor kërkon mbështetjen e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në lidhje me:

⁹⁵Aktualisht janë 37 kancelarë në detyrë (por 5 prej tyre janë të komanduar)

- **Përmirësimin e kuadrit ligjor** nëpërmjet rishikimit, më veçanërisht të ligjeve nr. 115/2016, e nr. 96/2016 dhe nr. 98/2016, me qëllim përmirësimin e tyre si rezultat i nevojave të identifikuara gjatë zbatimit të tyre në praktikë
- Rritjen e burimeve njerëzore në gjykata me **të paktën 100 punonjës** për administratën gjyqësore në shkallë vendi, kur nevojat e vlerësuara kanë qenë për të paktën 300 punonjës⁹⁶.
- **Mbështetjen financiare në investime** për:
 - rikonstruksionin apo ndërtimin e gjykatave, më veçanërisht ato të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore - tërmeti i muajit nëntor 2019, si dhe
 - sisteme bashkëkohore të teknologjisë së informacionit, veçanërisht për krijimin e një Sistemi të ri për Menaxhimin e Çështjeve Gjyqësore si dhe mirëmbajtjen e sistemeve aktuale të gjykatave deri në krijimin e këtij të fundit.



⁹⁶ 120 punonjës shtesë janë akorduar tashmë nga Kuvendi për sistemin gjyqësor, përkatësisht 20 për vitin 2018 dhe 100 për 2019

